

Libri Hutbeja e **Xhumasë**



Autor: Shejh Dr. Salih ibn Feuzan ibn Abdullah Ali Feuzan.

Burimi: www.alfawzan.af.org.sa

Përktheu: Agim Bekiri

Përktheu: Mirsim Maliqi

Përktheu: Irfan Jahiu

Përktheu: Shpend Zeneli

Hytbet e Xhumasë.



Rëndësia e hytbes së xhumasë.

Hytbja vazhdon të mbetet një nga mjetet më ndikuese në përhapjen e thirrjes Islame, për këtë arsye ajo zë një vend të veçantë në ndikimin e përhapjes së thirrjes dhe kumtimin e saj, që në kohën kur filloi të përhapej mesazhi muhamedan.

Sekreti qëndron në faktin se hytbja është gjëja më e shpejtë që kuptojnë njerëzit e thjeshtë dhe lë gjurmë të mëdha duke ndikuar tek të gjithë. Veç të tjerash ajo zotëron ndikim të shpejtë dhe drejtpërdrejt në drejtimin e mendimit të shumicës. Për këtë arsye hytbja e xhumasë duhet të realizojë qëllimet e mëposhtme:

01 - Këshillimin dhe përkujtimin për Allahun, ditën e fundit dhe idetë që ngjallin zemrat, pa lënë mënjanë thirrjen në gjërat e mira, urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja.

02 - T'u mësojë muslimanëve të vërtetat rreth fesë së tyre nga libri i Allahut dhe Suneti i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), duke i kushtuar një rëndësi të veçantë besimit të pastër larg nga legendat, ruajtjen e adhurimit nga depërtimet e bidateve, ruajtjen e moraleve dhe normave nga shmangiet dhe gjërat e neveritura.

03 - Korrigjimi i mendimeve të gabuara rreth Islamit duke iu kundërvënë dyshimeve dhe kotësive që publikohen nga armiqtë e Islamit, të cilët kanë si qëllim çoroditjen e mendimeve duke përdorur metoda bindëse, larg injorimeve dhe sharjeve. Pra, duhet t'u bëjmë ballë mendimeve shkatërruese duke parashtruar Islamin e vërtetë.

04 - Kërkohet që hytbja të ketë lidhje me jetën dhe aktualitetin që jetojnë njerëzit, gjithmonë të jetë në shërbimin e kurimit të sëmundjeve shoqërore, duke parashtruar zgjidhjen konkrete të problemeve sipas dritës së Legjislacionit Islam.

05 - Shfrytëzimi i rasteve të volitshme Islame, siç është muaji i Ramazanit, haxhi, sprovat dhe fatkeqësitë e ndryshme e gjëra të tjera, të cilat u interesojnë dëgjuesve dhe kërkojnë që të hidhet sadopak dritë në kuptimin e tyre.

06 - Të rrënjosë tek ata kuptimin e saktë të Vëllazërisë Islame dhe solidaritetin e umetit të tij, duke luftuar çdo lloj fanatizmi, racizmi apo medhhebizmi të sëmurë, e shumë gjëra të tjera, të cilat e përçajnë unitetin e umetit. Nga ana tjetër t'u kushtojë rëndësi gjërave që e mbajnë të lidhur me muslimanët, pra, duhet të lidhet mendërisht dhe shpirtërisht me vëllezërit e tij muslimanë.

07 - Kërkohej që hytjës të jetë larg shndërrimit të saj në vend ku bëhen reklama apo sharje ndaj një personi. Ajo duhet të jetë e pastër vetëm për Allahun e Madhëruar, kumtimin dhe lartësimin e fesë së Tij. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas Allahut!”** (Sure Xhin, 18.)

Vlerat e ditës së xhuma:

Nuk ekzistojnë polemika mes dijetarëve se dita e xhuma është dita më e vlefshme e javës, madje është dita më e mirë në të cilën shkëlqejnë rrezet e diellit.

Ebu Hurejra përcjell se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Dita më e mirë në të cilën shkëlqejnë rrezet e diellit është dita e xhuma. Të xhumanë u krijua Ademi, atë ditë ai hyri në xhenet dhe po atë ditë doli nga xheneti. Edhe kiameti do të ndodhë të xhumanë.”** (E përcjell imam Muslimi.)

Allahu e ruajti këtë ditë për këtë umet dhe e veçoi atë me anë të kësaj dite, duke i shmangur nga gjetja e saj hebretë dhe të krishterët.

Ebu Hurejra dhe Hudhejfja përcjellin se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Allahu i shmangu nga gjetja e xhumasë ata që ishin para nesh, prandaj hebretë zgjodhën të shtunën, ndërsa të krishterët të dielën. Allahu na solli neve dhe na orientoi në gjetjen e ditës së xhuma, duke e radhitur atë para së shtunës dhe të dielës. Në të njëjtën mënyrë ata do të jenë pas nesh Ditën e Gjykimit, pra, ne ishim (umeti) të fundit në dunja, por të parët nga krijesat që do të llogaritemi Ditën e Gjykimit.”** (E përcjell imam Muslimi.)

Shpërblimet për atë që shkon në namazin e xhumasë:

Buhariu në Sahihun e tij ka shënuar se Selman Farisiu ka thënë: I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kushdo që merr gusul ditën**

e xhuma dhe pastron veten e tij sa ka mundësi, pas kësaj parfumose në shtëpinë e tij, niset për në xhami dhe nuk shkakton ndarje mes dy njerëzve (që janë ulur), pastaj falet aq sa ka shkruar Allahu të falet dhe më pas dëgjon me vëmendje atë që thotë imami, këtij njeriu do t'i falen të gjitha mëkatet ndërmjet kësaj xhumaje dhe xhumasë që vjen.”

Eus bin Eus eth-Thekafiu përcjell se e ka dëgjuar Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) duke thënë: **“Kush lahet mirë ditën e xhuma dhe më pas niset herët për të shkuar në xhami, ecën duke mos hipur në ndonjë mjet dhe i afrohet imamit dhe e dëgjon atë pa folur, në çdo hap të tij do të ketë shpërblime sikur ka agjëruar dhe është falur natën për një vit.”** (E përcjell imam Ahmedi, ndërsa Albani këtë hadith e konsideron të saktë.)

Ebu Hurejra përcjell se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kushdo që merr gusul ditën e xhuma dhe pastron veten e tij sa ka mundësi, pas kësaj parfumose në shtëpinë e tij, niset për në xhami dhe nuk shkakton ndarje mes dy njerëzve (që janë ulur), pastaj falet aq sa ka shkruar Allahu të falet dhe më pas dëgjon me vëmendje atë që thotë imami, këtij njeriu do t'i falen të gjitha mëkatet ndërmjet kësaj xhumaje dhe xhumasë që vjen.”** (E përcjell imam Ahmedi, ndërsa Albani këtë hadith e konsideron të saktë.)

Veçoritë e ditës së xhuma:

Rreth ditës së xhuma janë përmendur vlera të panumërta, e si e tillë muslimani duhet t'i kushtojë interes dhe të mos e neglizhojë atë.

Këtu po përmendim disa prej këtyre veçorive:

01 - Në këtë ditë ka një orë në të cilën Allahu i përgjigjet çdo personi që lutet. Në të dy librat e saktë të hadithit **(Buhariu dhe Muslimi)**

Shënohet nga Ebu Hurejra, se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Ditën e xhuma është një orë, e cila nëse përputhet me një rob musliman që falet dhe kërkon diçka prej Allahut, Ai i përgjigjet lutjes së tij.”** Pas kësaj Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) bëri shenjë me dorën e tij për të treguar se janë të pakët ata që e shfrytëzojnë këtë çast.

02 - Leximi i sures **“Elif lam mim, tenzil” (Sexhde)** dhe sures **“Hel eta alet insani” (Insan)** gjatë namazit të sabahut ditën e xhuma. Këtë lexim e praktikonte i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Disa dijetarë duke e komentuar këtë gjest shprehen: I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i lexonte këto dy sure në mëngjesin e ditës së xhuma, sepse në përmbajtjen e tyre pasqyrojnë gjërat që kanë ndodhur dhe që do të ndodhin në ditët e mëvonshme. Në këto dy sure përmendet krijimi i Ademit, pasqyrohet bota e ardhshme dhe ringjallja e njerëzve, gjë e cila do të ndodhë ditën e

xhuma, prandaj leximi i këtyre dy sureve është si përkujtim që i bëhet umetit për gjërat që kanë ndodhur dhe që do të ndodhin. Ndërsa sexhdja që ndodhet në sure vjen si pjesë e sures dhe jo e qëllimshme, e bëjmë këtë sqarim në mënyrë që namazliu gjatë leximit të saj (**Sures Sexhde**) të mos ketë qëllim vetëm rënien në sexhde.

03 - Ditën e xhuma pëlqehet të dërgohen sa më shumë salavate mbi Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Eus bin Eusi përcjell se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Dita më e virtytshme e ditëve tuaja është dita e xhuma. Në atë ditë u krijua Ademi dhe në atë ditë vdiq, në atë ditë do t’I fryhet surit dhe njerëzit do të ngrihen nga varret! Shtojini salavatet për mua pasi salavatet për mua do të paraqiten para meje. Njerëzit i thanë: O i Dërguari i Allahut! Si do të paraqiten salavatet tona, kur ti do të jesh larguar? Ai tha: Allahu ia ka ndaluar tokës të tretë trupat e profetëve.”** (E përcjell Ebu Daudi, Nesaiu, Ibn Maxhe dhe e ka saktësuar Albani.)

Imam Shemsudin Muhamed bin Ebi Bekri ka thënë: **“I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është zotëria i të gjithë njerëzve, ndërsa dita e xhuma është dita më e mirë e javës. Prandaj salavatet për të gjatë asaj dite përmbajnë një të veçantë, që nuk e kanë ditët e tjera.”**

Duhet ditur se kjo vepër përmban edhe një urtësi tjetër që është: çdo e mirë që i ka ardhur këtij umeti në këtë jetë dhe në jetën tjetër ka ardhur nëpërmjet tij. Allahu i Lartësuar i ka mbledhur të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër për këtë umet dhe nderi e sukcesi më i madh do t’u jepet atyre në ditën e xhuma. Në atë ditë do t’u jepen shtëpitë dhe pallatet e tyre në xhenet, dhe ajo është dita ku do t’u dhurohet shpërblimi shtesë.

“Ajo është një ditë feste për ta në këtë botë, gjithashtu është dita në të cilën Allahu i Lartësuar i plotëson nevojat e tyre dhe u përgjigjet lutjeve dhe kërkesave të kësaj bote. Ata janë të vetëdijshëm për të gjitha këto dhe kanë mundësi t’i përfitojnë ato në sajë të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), nëpërmjet të cilit u pajisën me mësim të tilla. Kështu që në shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi për këto të mira që na janë dhënë duhet të bëjmë shumë salavate për të gjatë ditës dhe natës së xhuma.”

04 - Pëlqehet të lexohet surja Kehf gjatë ditës dhe natës së xhuma. Ebu Seid Hudriu përcjell se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kush e lexon suren Kehf ditën e xhuma, këtij njeriu do t’i jepet ndriçim prej drite nga kjo e xhuma e deri në xhumanë tjetër.”** (E përcjell Sujuti në **“El Xhami”**, ndërsa Albani e konsideron hadithin të saktë.)

[Hyttbet e Xhumasë]

Përmbatja:

- 01 - Kuptimi i dy dëshmimeve dhe kërkesës së tyre.
- 02 - Vlera e fjalës la ilahe il-lallah.
- 03 - Dashuria e Allahut dhe të dërguarit të Tij, sal-lallahu 'alejhi ue sel-lem.
- 04 - Përgjigjuni Allahut dhe të dërguarit të Tij.
- 05 - Ligjësimi i selamit dhe dobitë e Tij.
- 06 - Rëndësia e namazit.
- 07 - Frytet e imanit.
- 08 - Vepra e mirë.
- 09 - Virtytet e besimtarëve.
- 10 - Disa nga cilësitë e besimtarëve në Kuran.
- 11 - Besimi i vërtetë dhe shenjat e Tij.
- 12 - Zbukurimi i lejuar dhe ai i ndaluar.
- 13 - Nxitje për vepra të mira.
- 14 - Kujdesi nga shoqërimi me të këqijtë.
- 15 - Rreziku i padrejtësisë.
- 16 - Rreziku i përngjasimit me jobesimtarët.
- 17 - Mendjemadhësia dhe dëmi i saj.
- 18 - Zilia dhe dëmi i saj.
- 19 - Qartësimi i shkaqeve të lumturisë.
- 20 - Zararet e gjuhës!

- 21 - Ryshfeti.
- 22 - Rreziku i kamatës.
- 23 - Sëmundja e zemrës dhe shërimi i saj.
- 24 - Islami dhuntia më e madhe.
- 25 - Veçoritë e muajit ramazan.
- 26 - Dobitë dhe etika e agjërimin.
- 27 - Përgëzimi me ardhjen e muajit ramazan.
- 28 - Dhjetë ditët e fundit të muajit ramazan.
- 29 - Gjendja e njerëzve pas ramazanit.
- 30 - Muajt e haxhit dhe vlera e tyre.
- 31 - Teuhidi i adhurimit në ritet e haxhit.
- 32 - Përgatitja për haxh.
- 33 - Disa veçori të haxhit dhe kushtet e tij.
- 34 - Ibadeti në muajin dhul hixhe.
- 35 - Vlera e xhihadit dhe llojet e tij.
- 36 - Vlera e besimit në fshehtësinë – gajbin dhe kuptimi i tij.
- 37 - Besimi në shenjat e kiametit.
- 38 - Divorci dhe dispozitat e tij.
- 39 - Rreziku i pijeve alkoolike dhe narkotikëve.
- 40 - Ndalesa e pirjes së duhanit.
- 41 - Rreziku i dëgjimit të muzikës.
- 42 - Leximi i kuranit.
- 43 - Dispozitat e xhenazes.

01 - KUPTIMI I DY DËSHMIVE DHE KËRKESËS SË TYRE.

Hutbeja e parë

Lavd-falënderimi i takon Allahut, i Cili nuk ka fëmijë, as ortak në sundim, e as ndihmëtar! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, Një dhe i pa ortak; I Lartësuar me një lartësim të madh është nga ajo që thonë zullumqarët dhe mohuesit!

Dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, e dërgoi Allahu përpara çastit të Kiametit: përgëzues, e qortues, thirrës për tek Allahu me lejen e Tij dhe pishtar ndriçues, -Allahu e lavdëroftë dhe e shpëtoftë atë, shokët e tij e të gjithë pasuesit e tij deri në ditën e fundit-!

Më tej: O njerëz, druani Allahut dhe respektojeni!

Robër të Allahut! Me të vërtetë shtylla e parë prej shtyllave të Islamit është shehadeti: Dëshmia se s'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, dhe që Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Dhe kjo shtyllë është themeli mbi të cilin ngrihen shtyllat e tjera, mbi të ndërtohen dispozitat e fesë, e ky themel po që i shëndoshë e i fortë, punët e tjera përqendrohen e do të jenë të pranuar tek Allahu dhe do t'i bëjnë dobi vepruesit; e kjo shtyllë po u prish, të gjithë punët e tjera shkatërrohen e bëhen **“hi e pluhur”** (Furkan 23), e bëhen **“si mjegulla (fatamorgana) në rrafshinë, të cilën, i etshmi e konsideron ujë, por kur të arrijë tek ai vend, nuk gjen asgjë”** (Nur 39), e bëhen **“si hiri, të cilin me pui e shkapërderdh era në ndonjë ditë të stuhishme”** (Ibrahim 18), bëhet vetëm lodhje për vepruesin e tyre në këtë botë, e keqardhje, qeder dhe shkatërrim në ditën e Kiametit!

Robër të Allahut! Me të vërtetë dy dëshmitë kanë kuptim, po edhe kërkesa, e patjetër shqiptuesi i tyre të njeh atë domethënie e të punojë me atë kërkesë, ngase veç shqiptimi në vete nuk i bën dobi. E, kuptimi i **“La ilahe il-Allah”**, është: Pohimi se nuk meriton adhurimin askush përveç Allahut dhe se çdo i adhuruar përveç Tij është i kotë: **“Kjo ngase Allahu është Ai i vërteti, dhe atë që lusin ata pos Tij është e kotë. Allahu është vërtetë Ai i larti, i madhi”** (Haxh 62)

E, kërkesa e dëshmisë **“La ilahe il-lAllah”**, është: Të njësoh Allahun me adhurim dhe të mos adhurosh askënd bashkë me Të; ngase kur thua: Dëshmoj se s’ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, ti veçse ke shpallur distancim nga çdo i adhuruar përveç Allahut dhe i je përkushtuar adhurimit të Allahut të Vetëm, veprimit të asaj që të ka urdhëruar dhe lënies së asaj që të ka ndaluar. Po pra, atëbotë kur Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, u tha mushrikëve: **“Thuani: La ilahe il-lAllah”**, ata e kuptuan nga kjo se ai kërkon nga ata adhurimin e Allahut të Vetëm dhe lënien e adhurimit të idhujve, andaj u ndalën nga të thënit e kësaj fjale dhe e kundështuan, e thanë: **“A mendon ai t’i bëjë zotat Një Zot? Vërtet, kjo është gjë shumë e çuditshme! Paria nga mesi i tyre shkoi duke i thënë njëri-tjetrit: vazhdoni të jeni të qëndrueshëm në adhurimin e zotave tuaj, pse kjo është një gjë e kurdisur. Ne nuk kemi dëgjuar diçka të këtillë në popullin (në fenë) e fundit; kjo nuk është tjetër, pos një trillim!”** (Sad 5-7)

Kjo është pra kuptimi i **“La ilahe il-lAllah”** të bësh adhurimin për një të adhuruar (**për Allahun, të adhuruarin e vërtetë, sh.p.**) dhe braktisja e çdokujt përveç Tij; e, mushrikët këtë e kishin kuptuar ngase ishin arabë elokuentë, kurse sot adhuresit e varreve nuk e kuptojnë dot domethënien e **“La ilahe il-lAllah”**, e as që dinë për kërkesat e saj, andaj ata thonë: **“La ilahe il-lAllah”** e prap i adhurojnë të vdekurit. Mushrikët e parë ishin më të ditur se këta për domethënien dhe kërkesat e **“La ilahe il-lAllah”**. Këta adhurues varresh thonë: **“La ilahe il-lAllah”**, po megjithëkëtë thonë: O Alij! O Husejn! O AbdulKadër! U luten të vdekurve e u kërkojnë ndihmë atyre për kryerjen e nevojave e kërkesave dhe heqjen e vuajtjeve, bëjnë tavaf rreth varreve të tyre e presin kurbane për ta, e vallë çfarë kuptimi ka tek këta **“La ilahe il-lAllah”**, e ç’dobi mund të kenë nga kjo?! Me të vërtetë ata janë një popull që nuk mendojnë, **“Harruan Allahun (nuk iu bindën), prandaj Ai i harroi (nga mëshira)”** (Teube 67) **“Atyre u janë hijeshuar veprat e tyre të këqia. Po, Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin mohues”** (Teube 37)

Robër të Allahut! Nga kërkesat e **“La ilahe il-lAllah”** është të falësh namazin, që është shtylla e dytë pas shehadetit. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, ka thënë: **“Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë i keni vëllezër në fe.”** (Teube 11)

Dhe gjithashtu, prej kërkesave të dëshmisë **“La ilahe il-lAllah”** është të japësh zekatin, të agjërosh muajin ramazan dhe të kryesh Haxhin nëse ke mundësi, t’i kryesh obligimet fetare dhe të lësh ndalesat. Sahabët, radijallahu anhum, nën komandën e Ebu Bekër Sidikut, radijallahu anhu, patën luftuar ata që kishin ndalë zekatin, e që edhe këta thoshin: **“La ilahe il-lAllah”**, e sahabët thanë: **“Me të vërtetë zekati është hak i “La ilahe il-lAllah””**.

I është thënë Hasan Basriut, rahimehullah: **“Njerëzit po thonë: Kush thotë: “La ilahe il-lAllah”, do të hyjë në Xhennet”**, e ai atëherë u tha: **“Kush thotë fjalën “La ilahe il-lAllah” dhe i ka kryer hakun që ka dhe ia ka përmbushur**

detyrimet, po, do të hyjë në Xhennet". Vehb ibën Munebihu i pati thënë atij që e pyeti: "A nuk është **"La ilahe il-Allah" çelësi i Xhennetit?**" se: **"Po si jo, porse s'ka çelës veçse i ka edhe dhëmbët, e nëse vjen me çelës që ka dhëmbë atëherë ka për t'u hapur, e përndryshe jo, s'të hapet"**.

Robër të Allahut! Po sikur shirku i madh që e rrënon dhe e kundërshton **"La ilahe il-lAllah"**, ashtu edhe mëkatet e tjera e mangësojnë kërkesën e kësaj fjale dhe ia pakësojnë shpërblimin, varësisht prej gjynahut që del nga robi; Nga muslimani është e kërkuar të thotë: **"La ilahe il-lAllah"**, dhe t'ia di domethënien e saj dhe të punojë me kërkesën e saj haptazi e fshehurazi, e të drejtohet në të. Allahu, subhanehu ue teala, thotë: **"Ata që i adhuruan pos Tij, nuk mund të ndërmjetësojnë (të bëjnë shefat), përveç kush dëshmoi të vërtetën, e ata e dinë"** (Zuhruf 86) **"...kush dëshmoi të vërtetën..." d.m.th.: tha: "La ilahe il-lAllah", "...e ata e dinë..."** me zemrat e tyre se ç'fjalë shqiptuan me gjuhët e tyre. Keni frikë Allahun o robër të Allahut, njiheni domethënien e kësaj dëshmie dhe punoni me kërkesat e saj, ngase nuk është për qëllim nga ajo thjesht vetëm shqiptimi, duke mos pasur kuptim, bindje të argumentuar për të dhe vepër me të, ngase kësaj është e padobishme, pra s'të sjell dobi. Kërkoj mbrojtje tek Allahu të më ruajë nga shejtani i mallkuar, **"Ne, nuk kemi dërguar asnjë peygamber para teje e që të mos i kemi shpallur atij: "Ska të adhuruar me të drejtë përveç Meje, andaj adhuromëni Mua!"** (Enbija 25).

Hutbeja e dytë

Lavd-falënderimi i takon Allahut që e dërgoi Pejgamberin me udhëzim dhe fe të vërtetë që të dominon mbi çdo fe, e i mjaftoi Allahu për Dëshmitar; Dëshmoj se nuk të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, i Vetëm e pa ortak, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, -Allahu e lavdëroftë dhe e shpëtoftë atë, shokët e tij e të gjithë pasuesit e tij deri në ditën e fundit-!

Më tej: O njerëz, kuptimi i **"Eshhedu ene Muhameden resulullah"** është: Të vërtetuarit me bindje në zemër se Muhamedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, është i Dërguar nga ana e Allahut. E, kërkesa e kësaj dëshmie përmbledhet në katër çështje: Respektimi i tij në atë që ka urdhëruar, besimi në atë që ka lajmëruar, shmangia e frenimi nga ajo që ka ndaluar dhe të adhuorsh Allahun me atë që ai ka ligjësuar. Kur ti dëshmon se ai është i Dërguar i Allahut obligohesh ta respektosh në atë që ty të ka urdhëruar, e të largohesh nga ajo që të ka ndaluar dhe ta besosh në atë që lajmëron për Allahun, subhanehu ue teala, për fshehtësirat e së kaluarës e të së ardhmes, dhe të mos afrohesh tek Allahu me diçka prej adhurimeve përveç nëse është në përputhshmëri me Sheriatin e tij, pra të lësh shpikjet e risitë-bidatet, të braktisësh fjalët që janë në kundërshtimin me Sunetin e tij, sado që thënësi i atyre fjalëve të ketë arritur dije e kuptim. Çdonjërit prej nesh i merret fjala, e i lihet, përveç të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Imam Maliku, rahimehullah, thotë: **"Çdo njërit prej nesh i merret fjala, e i kthehet**

(s'i pranohet), përveç pronarit të këtij varri!", -dhe bëri me shenjë nga varri i të Dërguarit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Imam Muhamed ibën Idriz Shafiu, rahimehullah ka thënë: **"Të gjithë dijetarët janë të një mendimi se secilido që i qartësohet Suneti i të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, kurrsesi nuk i takon atij ta lë atë për fjalën e ndokujt tjetër"**. Imam Ahmed ibën Hanbeli, rahimehullah, thotë: **"Jam i çuditur me njerëzit, e njohën isnadin (zinxhirin e hadithit) dhe saktësinë e tij, dhe megjithëkëtë shkojnë tek mendimi i Sufjanit, ndërsa Allahu, subhanehu ue teala, thotë: "...le të druajnë ata që i kundërshtojnë urdhrit të tij, që të mos i arrijë ndonjë fitne ose që të mos i godas ata dënimi i dhembshëm."** (Nur 63) Vallë, a e di ç'është fitne? Fitneja është shirku; Kam druajtjen që nëse dikush i kthen prapa disa fjalë të tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, paskëtaj të bie në zemrën e tij diç nga devijimi e të shkatërrohet, e Allahu, subhanehu ue teala, thotë: **"Çka t'ju jep i Pejgamberi, atë merreni e çka t'ju ndalojë, përmbahuni prej saj..."** (Hashër 7)

Robër të Allahut! T'i keni frikë Allahut dhe ta respektoni, e ta keni në dijeni se fjala më e mirë është libri i Allahut, e udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e punët më të këqija janë ato të shpikurat.

Marrë nga libri: Salih el-Fevzan, **"El Hutabul minberijeh fil munasebatil asrijeh"**, botim i Mektebetul Mearif lin neshri uet teuzië', vëll. 1, f. 7-11

02 - VLERA E FJALËS LA ILAHE IL-LALLAH.

Falënderimi i takon Allahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë mbështetje tek Allahu nga të këqijat e shpirtit dhe të këqijat e veprave tona. Atë që e udhëzon Allahu, nuk ka kush që e humbë dhe atë që e humbë, nuk ka kush ta udhëzojë. Dëshmoj se s'ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut, i Cili është i Vetëm dhe i pa shok, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij. Salavati dhe selami qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij, si dhe mbi të gjithë ata që e pasojnë atë dhe kapen për Sunetin e tij deri në Ditën e Gjykimit...

O ju muslimanë, Allahu i Madhëruar na porositi ta përmendim Atë në çdo kohë, pakufishëm, duke na thënë: **"O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje"**. (Ahzab 41-42). E veçanërisht na urdhëroi ta përmendim pasi të lirohemi nga adhurimet e caktuara, në kohët e tyre të posaçme: **"Pasi të kryeni namazin, përmendeni Allahun duke qëndruar në këmbë, ulur dhe të shtrirë"**. (Nisa 103), dhe tha:

“Pasi t’i kryeni ritet e haxhillëkut, përmendni Allahun ashtu siç i kujtoni prindërit tuaj, madje edhe më tepër!”. (Bekare 200).

Përmendja e Allahut i përfshin të gjitha adhurimet, ato me gojë dhe ato me gjymtyrë. Pra çdo adhurim është përmendje e Allahut. Besimtari gjithmonë e përmendën Allahun, e sidomos me gojë, duke e falënderuar **(duke thënë Elhamdulillah)** apo lartësuar **(duke thënë Subhanallah)** apo madhëruar **(duke thënë Allahu Ekber)**, ngase se ky lloj i të përmendurit e Allahut është më i lehtë për njeriun në të gjitha gjendjet e tij, qoftë duke ecur apo duke qenë i hipur mbi kafshë, apo duke qenë në këmbë apo ulur apo i shtrirë. Kjo e tëra, ngase gjuha nuk lodhet nga lëvizjet e bëra kur e përmend Allahun, në krahasim me organet e tjetra, të cilat lodhen nga lëvizjet e tepërta.

Padyshim se fjala më e mirë nga të përmendurit e Allahut, është fjala: La ilahe il-Allah. Për këtë arsye ajo duhet shqiptuar sa më tepër.

I Dërguari i Allahut, sal-Allahun 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Fjala më e mirë që kam thënë unë dhe Pejgamberët para meje, është La ilahe il-Allahu vahdeu la sherike lehu, lehu el-mulku ve lehu el-hamdu ve huve ala kuli shejin kadir (S’ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut. Ai është Një dhe i pa Shok. Atij i takon sundimi dhe lavdërimi dhe Ai është i Gjithëfuqishëm për çdo gjë)”**.

Pasi që kjo fjalë zë këtë pozitë në mesin e llojeve të dhikrit, e që për të lidhen vendime, ka kushte e domethënie, përmban kërkesa, nuk është fjalë që thuhet vetëm se me gojë. Këtë fjalë muslimanët e shfaqin kur e thirrin ezanin dhe ikametin dhe e shfaqin nëpër ligjëratat dhe bisedat e tyre. Ajo është fjalë për të cilën janë krijuar qiejt e toka. Për të janë krijuar të gjitha krijesat dhe për të kanë zbritur librat dhe janë dërguar Pejgamberët dhe janë caktuar ligje. Për të janë vënë peshore dhe regjistra dhe është hapur tregu i Xhenetit dhe Xhehenemit. Është fjalë që i ndan krijesat në besimtar dhe jobesimtar. Për të dhe për detyrimet e saj që e pasojnë do të pyetet robi në varr dhe për të do të llogaritet dhe do të dënohet apo shpërblehet. Për të janë ngritur shpatat e xhihadit.

Ajo fjalë është fjala e Islamit dhe çelësi i Xhenetit. Ajo është fjala e devotshmërisë dhe lidhja e fortë. Ajo është fjala e sinqeritetit dhe ajo e dallon kufrin nga imani. Me thënien e saj mbrohet gjaku, pasuria dhe nderi në dynja. Kush e thotë i bindur thellësisht në të nga zemra, i shpëton zjarrit të Xhehenemit dhe hyn në Xhenet.

I Dërguari i Allahut, sal-Allahun 'alejhi ue sel-lem, thotë:

“Allahu ia ka ndaluar zjarrin e Xhehenemit atij që thotë la ilahe il-Allah, dhe me të e kërkon fytyrën e Allahut”.

Ajo është tekst i shkurtë me pak shkronja, e lehtë për gjuhën dhe e rëndë në peshore. Ebu Seid el Hudrij, radijAll-llahu anhu, përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë:

“Musai tha:’ O Zot, ma mëso një gjë që të të përkujtoj dhe të të lus (adhuroj) me të. O Musai, thuaj La ilahe il-lAllah. Të gjithë robërit e Tu e thonë atë! – tha ai. O Musa, sikur shtatë qiejt dhe çka ka në to përveç Meje, dhe shtatë tokat të vihen në njëren anë të peshores, kurse La ilahe il-Allah në anën tjetër, i ngreh ato La ilahe il-lAllah”.

Kjo fjalë madhështore i posedon dy shtylla:

Shtylla e parë: Mohimi. Me mohim nënkuptojmë mohimin e çdo adhurimit tjetër, përveç Allahut.

Shtylla e dytë: Pohimi. Me pohim nënkuptojmë se vetëm Allahut i takon adhurimi.

Nga kjo qartësohet kuptimi i saj dhe ajo se duhet të urrehet shirku dhe idhujtarët dhe adhurimi t’i përkushtohet vetëm se Allahut. Kjo është kuptimi i fjalës së Ibrahimit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, të cilën ia tha prindit të vet: **“Në të vërtetë, Unë i urrej dhe s’kam të bëj fare me ato që adhuroni ju në vend të Atij, që më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në rrugën e drejtë”.** (Zuhruf 26-27), dhe poashtu ajeti: **“Ai që mohon idhujt (dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë”.** (Bekare 256).

Muslimani kur e shpreh këtë fjalë e paraqet urrejtjen e tij ndaj idhujtarisë dhe idhujtarëve dhe ai adhurimin ia përkushton vetëm se Allahut. Me këtë e realizon Islamit dhe e fiton Xhenetin, mirëpo shprehja e saj vetëm se gojë, pa vepër me atë që aludon ajo fjalë dhe që e përmban ajo fjalë, nuk i bën dobi fare njeriut. Hipokritët e thoshin me gjuhët e tyre, mirëpo nuk e besonin me zemrat e tyre. Kjo i bëri të fitojnë bindje se i vdekuri bën dëm apo dobi, e të shkojnë në varreza dhe të sillen përreth tyre dhe të kërkojnë ndërmjetësim.

Këtij njeriu nuk i bën dobi thënia e fjalës la ilahe il-lAllah, ngaqë ai nuk punoi me kuptimin dhe domethënien e saj, e që nënkupton, urrejtjen e idhujtarisë dhe idhujtarëve dhe adhurimin e Allahut dhe askujt tjetër. Thënia la ilahe il-lAllah nënkupton: lënien e adhurimit të varreve, lënien e afrimit kah të vdekurit, si dhe lënien e adhurimit të idhujve. Nuk ka dallim mes adhurimit të idhujve dhe adhurimit të varreve. Kjo nënkupton fjalën la ilahe il-lAllah.

Për këtë arsye i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, u tha Kurejshëve, thoni la ilahe il-lAllah, e ata thoshin: **“A mendon ai t’i bëjë zotat një Zot (Allah)? Vërtet, kjo është gjë shumë e çuditshme!”.** (Sad 5).

Idhujtarët e kuptuan kuptimin e fjalës la ilahe il-lAllah, mirëpo nuk e shqiptonin ngase nuk dëshiron ti linin zotat e baballarëve të tyre, krahas atyre sot, adhuresve të varrezave, të cilët e bashkojnë idhujtarinë me shqiptimin e thënies la ilahe il-lAllah.

Ka mundësi që ata ta komentojnë këtë fjalë, me atë se, nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, apo me atë se Allahu është Krijues dhe Furnizues dhe të thonë se ai që e pohon këtë besim, e ka realizuar njësimin e Allahut dhe vetëm se ka dëshmuar se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë përveç Allahut. Sipas tyre, nuk ka pengesë që njeriu pasi ta shqipton këtë fjalë, të shkon e të ther kurban për të vdekur dhe ti afrohet atyre me lloje të ndryshme të adhurimeve.

Ata sikurse nuk e kanë kuptuar se, idhujtarët nga të cilët i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, kërkoi të thonë la ilahe il-lAllah, ishin pohues të asaj se Allahu është Krijuesi dhe Furnizuesi, ashtu siç na lajmëron edhe vet Allahu i Madhëruar: **“Nëse ti i pyet ata: “Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?” Ata, me siguri do të thonë: “Ato i ka krijuar i Plotfuqishmi dhe i Gjithëdijshmi”.** (Zuhruf 9), dhe tha: **“Thuaj: “Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?” Ata do të thonë “Allahu”. E ti (o Muhamed) thuaj: “Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?”.** (Junus 31).

Ky kuptim i gabueshëm po të buronte nga njerëzit e thjeshtë, do të kishte mundësi të pranohet, ngase ata janë injorantë dhe munden më vonë të mësohen dhe ta pranojnë të vërtetën shumë më lehtë se sa të tjerët. Mirëpo ajo që çudit, është fakti se kuptimi i gabuar i kësaj fjale buron edhe nga ata që pretendojnë se thirrin në dituri, fetva dhe mësim. Ata është shumë rëndë t'i bindsh dhe tua sqarosh, ngase injoranca e tyre është e kompleksuar, dhe ata nuk e dinë se nuk dinë. Ky lloj i njerëzve është shumë larg pranimi të vërtetë krahas atij që është injorant i thjeshtë dhe i cili e pohon injorancën e vet.

Këta janë dijetarë të devijimit, të cilët e shkatërruan vetveten dhe i shkatërruan edhe të tjerët nga injorantët, të cilët kishin mendim të mirë për ta dhe i pasonin në devijim. Nga ata na paralajmëroi i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, kur tha: **“Frikohem për umetin tim nga dijetarët e devijuar”.**

Ata edhe pse janë dijetar në kuptimet dytësore të fesë, ata janë injorantë në baza të fesë. Ata nuk e kuptojnë kuptimin më madhështor, e që është njohja e njësimi të Allahut me të cilin erdhën të gjithë Pejgamberët. Për këtë arsye ata e luftojnë këtë kuptim dhe i luftojnë ithtarët e saj dhe shkruajnë kundër saj dhe kundër kuptimit të fjalës la ilahe il-lAllah dhe domethënies së saj: **“(Le të thonë kështu, me qëllim) që t'i mbajnë gjynahet e veta të plota në Ditën e Kiametit, si dhe pjesën e gjynaheve të atyre që i çuan në humbje nga padijenja; sa e keqe është barra që do të bartin ata!”.** (Nahl 25).

Nga domethënia e fjalës la ilahe il-Allah dhe nga e drejta e saj mbi atë që e shqipton është edhe falja e namazit, dhënia e zeqatit, agjërimi i Ramazanit, kryerja e Haxhit për atë që ka mundësi të shkon, dhe të vepruarit me adhurime ndaj Allahut dhe të larguarit nga gjynahet.

Sot jemi dëshmitar të disa njerëzve që e shqiptojnë këtë fjalë, mirëpo nuk e falin namazin, apo nuk e japin zeqatin. Kanë ardhur shumë argumente, se ai që nuk e fal namazin nuk është nga muslimanët.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Por, nëse pendohen, falin namazin dhe japin zeqatin, atëherë i lini të qetë!”**. (Teube 5), dhe poashtu : **“Megjithatë, nëse ata pendohen, falin namazin dhe japin zeqatin, atëherë janë vëllezërit tuaj në fe”**. (Teube 11).

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Mes robit dhe kufrit, është lënia e namazit”**.

Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, disa grupe nuk donin t'ia japin zeqatin Ebu Bekrit, dhe Ebu Bekri, radijAll-llahu anhu, dhe sahabët tjerë i luftuan edhe pse ata e shqiptonin la ilahe il-lAllah, ngase zeqati është nga e drejta e fjalës la ilahe il-lAllah.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Nëse ata e shqiptojnë, nga unë e kanë të garantuar gjakun dhe pasurinë e tyre, përveç se atëherë kur duhet me të drejtë”**.

Hasan el Basriu, RahimehUllah, është pyetur se disa njerëz thonë se kush thotë la ilahe il-lAllah hyn në Xhenet. Imami tha: **“Kush thotë la ilahe il-lAllah dhe ia jep hakun dhe detyrimet e saj, hyn në Xhenet.”**

E pyetën njërin nga selefi se a nuk është la ilahe il-lAllah çelësi i Xhenetit? Tha: **“Po, mirëpo çdo çelës i ka dhëmbët e veta. Nëse vjen me çelës që i ka dhëmbët, e hap derën, e nëse vjen me çelës pa dhëmbë, atëherë ajo nuk do të hapet.”**

Allahu i Madhëruar thotë: **“Dije se nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Allahut! Kërko falje për gjynahun tënd”**. (Muhamed 19).

Allahu në këtë ajet na urdhëroi me dituri para thënies dhe veprës, ngase vepra e cila nuk bazohet mbi dituri të saktë, është e devijuar.

Allahu i Madhëruar thotë. **“Ata që u adhuruan në vend të Allahut, nuk do të mund të ndërmjetësojnë për askënd, përveç atyre që dëshmuan për të Vërtetën dhe e dinë mirë (se s'ka Zot tjetër të vërtetë veç Allahut)”**. (Zuhruf 86).

Që nënkupton se ata dëshmuar në njësimin e Allahut duke thënë: **“la ilahe il-Allah, dhe ata “e dinë mirë”, me zemrat e tyre dhe e kuptuan atë që e dëshmuar me gjuhët e tyre.**

03 - DASHURIA E ALLAHUT DHE TË DËRGUARIT TË TIJ, sal-Allah u 'alejhi ue sellem.

O ju njerëz, frikojuni Allahut! Nënshtroni Atij me dashuri dhe me respekt, duke shprehur në shpërblimet e Tij dhe duke u frikuar nga ndëshkimi i Tij. Ai është Allahu, të Cilin zemrat e adhurojnë me dashuri dhe respekt. Nëse nga natyra e zemrës është që ta donë atë që sillet mirë me të, atëherë për çdo mirësi dhe për çdo begati, themi se burimi i tyre është Allahu i Madhëruar: **“Çdo mirësi që keni, është nga Allahu”**. (Nahl 53).

Pra robi, detyrohet ta donë Atë pa kufi dhe ta adhuron vetëm se Atë, i Cili nuk ka shok dhe ortak. Dashuria e robit ndaj Allahut ka shenja të cilat aludojnë në të. Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”**. (Ali Imran 31). Nga shenjat se robi e donë Allahun, është pasimi i të Dërguarit të Tij, sal-Allah u 'alejhi ue sellem. Të punon me atë që urdhëroi dhe të largohet nga ajo që ndaloj: **“Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua”**. Kurse ai i cili pretendon se e donë Allahun, dhe në anën tjetër e kundërshton të Dërguarin e Tij, sal-Allah u 'alejhi ue sellem, ai është rrenacak në atë që e pretendon. Disa nga të parët tanë thanë: **“Disa nga njerëzit pretenduan dashurinë ndaj Allahut, dhe Allahu e zbriti ajetin e dashurisë: “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua”**. Kurse ajeti: **“që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet!”**, është fryti i dashurisë së Allahut dhe dobia e saj, që do të thotë, se ai që e donë Allahun, edhe Allahu ia kthen atë dashuri dhe ia falë gjynahet atij. Allahu thotë: **“O besimtarë! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur”**. (Maide 54).

Në këtë ajet fisnik, Allahu përmendi se dashuria e robit ndaj Zotit të tij i përmban katër shenja:

E para: Të jetë i përulur me besimtarët, që do të thotë, të jetë i butë dhe i mëshirshëm me ta dhe bamirës ndaj tyre.

E dyta: Të jetë i ashpër me femohuesit, që do të thotë, të jetë i rreptë me ta dhe t'i urren fort, ashtu si tha Allahu i Madhëruar: **“janë të ashpër ndaj jobesimtarëve”**. (Fet'h 29).

E treta: Të lufton në rrugë të Allahut, me shpirt, me pasuri, me gjuhë dhe me zemër.

E katërta: Të mos i trembet qortimit të asnjë qortuesi, që do të thotë, se tek ai nuk ndikon qortimi i njerëzve nga ajo që e jep nga xihadi, dhe thirrja në fe, dhe thirrja në të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

Pra, atë nuk e pengon asgjë që ta vazhdon atë rrugë. Po ashtu nga shenja e sinqeritet të dashurisë së robit ndaj Allahut, është t'i japë përparësi asaj që e donë Allahu, para asaj që e donë shpirti i tij dhe anon kah ajo epshi i tij. Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur”**. (Teube 24).

Allahu e urdhëroi të Dërguarin e Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, t'i kërcënohet atij që i jep përparësi dashurisë së pasurisë, familjes, farefisit, tregtisë, shtëpisë, para dashurisë së Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe veprave të cilat i detyroi dhe i donë vet Ai, si xihadi, hixhreti, etj.

Ibën Kethiri, RahimehUllah, në komentin e këtij ajeti thotë: **“Nëse këto gjëra janë: “më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni”**, d.m.th. pritni se çfarë dënimi do t'ju vjen.

Kjo është arsyeja se pse të parët tanë nga ensarët dhe muhaxhirët dhe ata që i pasuan me të mirë, i dhanë përparësi asaj që e donë Allahu, para asaj që e donë shpirti i tyre. Ata e flijuan veten dhe pasurinë për luftë në rrugë të Allahut, i lanë shtëpitë dhe vatanin që ta kënaqin Allahun dhe t'i ndihmojnë të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Allahu tha për ta: **“Pikërisht ata janë besimtarët e sinqertë”**. (Hashër 8). Krahasojeni gjendjen tonë me gjendjen e tyre të sinqertëve.

Shumica nga ne i jep përparësi epshit karshi nënshtrimit ndaj Allahut. Nëse thërritet për në namaz në xhami, i jep përparësi gjumit apo dëfrimit, apo pushimit, dhe nuk del për në namaz dhe nuk i përgjigjet thirrjes së Allahut, po i përgjigjet thirrjes së shejtanit dhe epshit të vet. Nëse thirret për në namaz, duke qenë ai në tregtinë e vet apo në punë, i jep përparësi nevojave të dynjasë para atyre të ahiretit, bën shitblerje për çështje të dynjasë dhe nuk shkon në xhami për namaz dhe i bën mëkat Zotit të tij: **“O besimtarë, kur të thirreni**

për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë!”. (Xhumua 9). Tregtari, i cili e fiton pasurinë nëpërmjet rrugëve të ndaluara, si kamata, ryshfeti dhe gënjeshtria, vetëm se i ka dhënë përparësi dashurisë së pasurisë karshi dashurisë së Allahut dhe e ka harruar fjalën e Allahut: **“Ata që bëhen koprracë me të mirat që ua ka dhënë Allahu, kurrsesi të mos mendojnë se kështu është më mirë për ta! Jo, kjo është më keq për ata! Ajo që kanë grumbulluar do t’u ngarkohet atyre në qafë Ditën e Kiametit. E Allahu është trashëgimia e qiejve dhe e Tokës dhe Allahu e di mirë ç’punoni ju”**. (Ali Imran 180).

Prindi kur urdhërohet t’i detyron fëmijët e tij ta falin namazin dhe të prezantojnë në xhami dhe t’i shpëtojnë nga zjarri i Xhehenemit, ashtu si tha Allahu: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët”**. (Tehrim 6), dhe po ashtu i Dërguari i Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i cili ka thënë: **“Urdhëroni fëmijët tuaj për namaz kur t’i kenë shtatë vjet, kurse detyroni me forcë (rrihni) kur t’i bëjnë dhjetë vjet..”**, dhe ai aspak nuk mërzhitet me këto urdhëresa dhe i len fëmijët të dëfrehen dhe të lozin nëpër shtëpi dhe të mos prezantojnë në namaz dhe në xhami, ai vetëm se i ka dhënë përparësi dashurisë së fëmijëve karshi asaj të Allahut. Lënia e fëmijëve në atë gjendje, dhe mos zemërimi i tij për lënien e namazit, dhe mosinteresimi i tij për atë se fëmija nuk i përfill detyrimet dhe i bën gjynah Allahut, aludon në atë se dashuria ndaj fëmijëve është më e fortë se sa ajo e Allahut.

Kur Ibrahim, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, u urdhërua të flijon të birin për hir të Allahut, të cilin ia kishte pas dhuruar pas shumë viteve, ai nuk hezitoi aspak që t’i përgjigjet thirrjes dhe urdhrin të Allahut. Kur doli në shesh nijeti i tij i singertë, Allahu ia zëvendësoi urdhrin me therjen e një kurbanit nga delet, dhe e përgëzoi me lindjen e një fëmije, me Is’hakun, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe pas tij me lindjen e Jakupit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Kjo e tëra erdhi nga bereqeti i nënshtrimit të urdhrave të Allahut, dhe nga dhënia përparësi dashurisë së Allahut karshi asaj të fëmijëve.

O ju robërit e Allahut, ashtu si detyrohet dashuria ndaj Allahut, detyrohet dashuria edhe ndaj të Dërguarit të Allahut, lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi ty. Ajo është pasuese e dashurisë së Allahut dhe pjesë e patjetërsueshme e saj. Enes ibën Maliku, radijAll-llahu anhu, përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Nuk ka besuar askush nga ju, derisa të bëhem më i dashur për të se sa prindërit, fëmijët dhe mbarë njerëzimi”**.

Shënon imam Buhariu, RahimehUllah, në librin e tij se Omer ibën Hatabi, radijAll-llahu anhu, i tha të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: Për Zotin, ti je më i dashur tek unë se çdo gjë me përjashtim të vetes sime. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i tha: **“Jo, pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, nuk do të jesh besimtarë i mirë përderisa unë të**

mos jem edhe më i dashur se sa vetja jote". Omeri tha: **"Tani o i Dërguari i Allahut je edhe më i dashur se sa vetja ime"**. Ia ktheu Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. **"Tani o Omer (u plotësua besimi yt)"**. Muhamedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, është ai i cili na mësoi mirësinë dhe na udhëzoi kah ajo, dhe na mësoi rrugën e shpëtimit dhe të lumturisë, dhe na paralajmëroi nga sherri dhe shkatërrimi. Besimi në të e bën të detyruar pasimin dhe nënshtrimin, dhe ai që e pretendon dashurinë pa mos e pasuar atë, apo ai që e pretendon dashurinë e tij dhe nuk kapet për traditën e tij dhe nuk e len risinë, ai është rrenacak në atë që e pretendon, ngase dashuria ndaj tij, e bën të detyruar që të veprohet ajo në të cilën ai urdhëroi, dhe e bën të detyruar largimin nga ajo që ndaloi. Allahu tha: **"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut"**. (Nisa 80). Pra ai që e pretendon dashurinë dhe e kundërshton traditën e tij, dhe punon me risi e lajthitje, ai është rrenacak në atë që e pretendon.

Shenjë tjetër që aludon në atë se robi e donë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, është ta donë atë që e donë Allahu dhe i Dërguari i Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Allahu i donë bamirësit, i donë të devotshmit, i donë të penduarit dhe i donë të pastruarit. Kurani dhe Syneti janë të stërmbushura me përmendjen e asaj që e donë Allahu nga besimtarët dhe nga veprat e tyre dhe nga morali i tyre. Enesi, radijAll-llahu anhu, përcjell se i Dërguari e Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **"Te cili gjinden tre gjëra do të shijon ëmbëlsinë e besimit: ta do Allahun dhe Pejgamberin ma shumë se çdo gjë; ta do një njeri vetëm për hir të Allahut dhe të urren të kthehet në kufër ashtu siç urren të hedhet në zjarr"**. Ibën Abasi, radijAll-llahu anhu, thotë: **"Kush donë për Allah, dhe urren për Allah, dhe miqëson për Allah, dhe armiqëson për Allah, me këtë e arrin miqësinë e Allahut. Nuk mundesh të gjesh rob i cili e shijoi ëmbëlsinë e imanit, edhe nëse ai nga namazi dhe agjërimi ka bagazh të madh, derisa të realizohet ajo."**

"Shumica e njerëzve vëllazërinë e bëjnë për dynja dhe për këtë arsye nuk gjejnë asgjë në shpirtrat e tyre". Pra ai që e donë Allahun, donë për hir të Tij, miqëson për hir të Tij, urren për hir të Tij dhe i armiqëson armiqtë e Tij. Ai i cili është kështu, atëherë Allahu do ta miqëson, dhe ai që nuk është kështu, Allahu nuk e miqëson, dhe kur Allahu nuk e miqëson, atëherë e miqësojnë armiqtë e Tij. Allahu i Madhëruar thotë. **"Allahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë. Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë. Sa për ata që nuk besojnë, mbrojtësi i tyre është djalli, i cili i nxjerr ata nga drita dhe i shpie në errësirë. Këta janë banorët e Zjarrit (të Xhehenemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë"**. (Bekare 257).

Nga shenjat që aludojnë në dashurinë e Allahut, është urrejtja e asaj që e urren Allahu nga njerëzit dhe veprat dhe thëniet. Allahu i Madhëruar thotë. **"Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemadhësit e mburracakët!"**. (Lokman 18), dhe thotë: **"Allahu nuk i do punëmbropshtët"**. (Ali Imran 57), dhe thotë. **"Allahu**

nuk e do shkatërrimin". (Bekare 205). Besimtari i cili e donë Allahun detyrohet ta urren atë që e urren Allahu. Allahu thotë: **"O besimtarë, mos i bëni miq armiqtë e Mi dhe tuajët, duke u shprehur atyre dashuri"**. (Mumtehine 1), dhe poashtu thotë. **"O besimtarë, mos i bëni miq ata njerëz me të cilët Allahu është i zemëruar"**. (Mumtehine 13), dhe tha: **"Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre"**. (Muxhadile 22). Në këto ajete, Allahu e detyroi urrejtjen e armiqve të Allahut, nga jobesimtarët e hipokritët dhe mendjemëdhenjtë, edhe po të ishin ata nga më të afërmit e farefisi.

Po ashtu Allahu ua detyroi besimtarëve urrejtjen e gjynaheve, dhe mëkateve, dhe të ligës, e të keqes, ngase Allahu ato i urren. Dijeni se çdo dashuri e cila është e krijuar mbi mëkat ndaj Allahut, do të shndërrohet në armiqtë Ditën e Kiametit. Allahu thotë. **"Atë Ditë miqtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, përveç të drejtëve, që e kanë pasur frikë Allahun"**. (Zuhruf 67), dhe thotë: **"Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: "Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!" Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës"**. (Furkan 27-29). Për këtë arsye njeriu duhet të jetë shumë i kujdesshëm se më kë po shoqërohet, ngase njeriu do të jetë me atë që donë Ditën e Kiametit.

Ibën Kajimi, RahimehUllah, i numëroi dhjetë shkaqe të cilat ta mundësojnë ta arrish dashurinë e Allahut:

- 01.** Leximi i Kuranit dhe meditimi i tij.
- 02.** Afrimi kah Allahu me vepra vullnetare, pasi të kryhen farzet.
- 03.** Vazhdimi i përmendjes së Allahut me zemër, gjuhë dhe vepër.
- 04.** Dhënia përparësi dashurisë së Allahut karshi dashurisë së shpirtit.
- 05.** Meditimi në emrat dhe cilësitë e Allahut. Ai që e njeh Allahun me emrat dhe cilësitë e Tij dhe veprimtarinë e Tij, s'ka dyshim se do ta donë Allahun.
- 06.** Meditimi në begatitë e Allahut. Nuk ka dyshim se meditimi në to nxit në dashurinë e krijuesit të tyre.
- 07.** Përrulja e zemrës para Allahut të Madhëruar.
- 08.** Vetmia me Allahun në kohën kur zbret Allahu, në pjesën e tretë të natës, duke lexuar Kuran apo duke iu lutur për falje dhe mëshirë.

09. Ndeja me njerëz të devotshëm dhe të mirë dhe shoqërimi i tyre.

10. Largimi nga çdo gjë që mundet të ndërhyjnë mes robit dhe Allahut. Kapuni për këto shkaqe me qëllim që ta arrini dashurinë e Allahut të Madhëruar dhe t'ju largoni të kundërtës së saj!

04 - PËRGJIGJUNI ALLAHUT DHE TË DËRGUARIT TË TIJ.

Falënderimi i takon Zotit të botëve, i Cili begatoi besimtarët me dërgimin e peygamberit, Allahu thotë: **“Është e vërtetë se All-llahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t'u lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kur'anin dhe sheriatin, edhe pse, më parë ata ishin krejtësisht të humbur”.** (Ali Imran 164)

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut, i Cili nuk ka të barabartë, duke qenë i sinqertë në adhurim ndaj Tij, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, i dërguar mëshirë për botët, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, mbi familjen e tij, shokët e tij dhe mbi gjithë ata që e pasojnë deri Ditën e Fundit.

O ju njerëz!

Keni frikë Allahun dhe dëgjoni thirrjen e Tij, përgjigjuni urdhrave të Tij dhe largohuni nga ato gjëra që ju ka ndaluar që të jeni të mëshiruar, Allahu i Madhëruar thotë: **“O ju që besuat, respektojini All-llahun dhe të dërguarin e Tij, e mos e braktisni atë se ju po e dëgjoni (Kur'anin). Dhe mos u bëni si ata që thanë: “Dëgjuam”, e në të vërtetë ata nuk dëgjojnë. Krijesat (gjallesat) më të dëmshme të All-llahu janë ata të shurdhëtisë (që nuk dëgjojnë të vërtetën) memecët (që nuk e thonë të drejtën) të cilët nuk logjikojnë. All-llahu do t'i bënte të dëgjojnë ata (shurdhmemecët) po të dinte (të pritej prej tyre) se do të arrinin ndonjë të mirë, po edhe sikur t'i bënte të dëgjojnë, ata do të zbrapseshin dhe do të refuzonin O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes së) All-llahut dhe të të dërguarit kur ai (i dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë) dhe ta dini se All-llahu ndërhyrë ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij, dhe se ju do të tuboheni te Ai”.** (Enfal 20-24)

Në këto ajete Kuranore urdhëron Allahu në respekt ndaj Tij dhe ndaj të dërguarit të Tij, në përgjigje ndaj Tij dhe ndaj të dërguarit të Tij gjatë dëgjimit të urdhrave apo ndalesave të cilat dalin prej Tij dhe prej të dërguarit të Tij. Ka ndaluar nga përngjasimi me jobesimtarët dhe hipokritët në mos respektimin

dhe mos përgjigjen ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij, ngase jobesimtarët kanë refuzuar të dëgjojnë fjalën e Allahut, sikur që thotë Allahut: **“Ata që nuk besuan thanë: “Mos e dëgjoni këtë Kur’an dhe kur të lexohet ai, ju bëni zhurmë (bërtitni) ashtu që ta pengoni”.** (Fusilet 26).

Ndërsa çifutët thanë: **“Dëgjuam (me veshë) e kundërshtuam”.** (Bekare 93). E hipokritët: **“thanë: “Dëgjuam”, e në të vërtetë ata nuk dëgjojnë”.** (Enfal 21).

Ata shtiren se kanë dëgjuar dhe janë përgjigjur por në fakt nuk janë të tillë, ngase ata dëgjojnë me veshët e tyre por nuk dëgjojnë me zemër, më pas Allahu ka treguar se këta kategori të bijve të Ademit janë krijesat më të këqija, Allahu thotë: **“Krijesat (gjallesat) më të dëmshme te All-llahu janë ata të shurdhët (që nuk dëgjojnë të vërtetën) memecët (që nuk e thonë të drejtën) të cilët nuk logjikojnë”.** (Enfal 22).

Pra shurdhë nga dëgjimi i të vërtetës, memec për kuptimin dhe të folurit me të, dhe i ka përshkruar se ata nuk logjikojnë, pra nuk kanë mendje të shëndoshë me të cilat mendojnë për fundin, por mendjet e tyre nuk tejkalojnë meditimin për dynjanë e pranishme dhe kënaqësitë e afërta, ata janë sikur kafshët që nuk kanë dert tjetër pos çfarë të fusin në barkun, as që mendon për të ardhmen e as që përgatitet për jetë tjetër, mirëpo ata janë edhe më të ulët se kafshët, ngase kafshët respektojnë Allahun për atë që i ka krijuar, e ata u krijuan për të adhuruar e mohuan, për këtë Allahu thotë: **“Ata nuk trajtohen ndryshe, por vetëm si kafshë, bile janë edhe më të humbur nga e vërteta”.** (Furkan 44).

Robër të Allahut!

Prej myslimanit është e kërkuar që të dëgjon fjalën e Allahut kur të lexohet, me kuptim dhe dituri rreth kërkesave të tyre, e pastaj pas dëgjimit e kuptimit të fjalës së Allahut dhe fjalës së të dërguarit myslimani duhet të drejtohet drejt të vepruarit me to dhe t'i përgjigjet kërkesave të tyre, përndryshe dëgjimi dhe kuptimi pa vepër do të jenë argument kundër tij ditën e Kiametit, Allahu thotë: **“A nuk u janë lexuar juve ajetet e Mia; e ju nuk i besuat ato?”.** Muminun 105). Gjithashtu thotë: **“Jo, ty të patën ardhur argumentet e Mia, e ti i përgënjeshtrove ato, u bëre kryeneç dhe ishe prej atyre që nuk besuan”.** (Zumer 59).

Ndërsa sot sa herë dëgjojmë dhe lexojmë ajetet e hadithet, dhe kundërshtojmë të punojmë me atë që kemi dëgjuar, duke qenë se atë që dëgjojmë dhe nuk veprojmë me të do të jetë argument kundër nesh ditën e Kiametit, i dërguari sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Kurani është argument për ty ose kundra teje”.**

Të shikojmë sa herë jemi përgjigjur thirrjeve të njëpasnjëshme, të ndryshme të Allahut në Librin e Tij, **“O ju njerëz”, “O bijtë e Ademit”, “O ju që keni besuar”, “O robër të mi”, disa prej të parëve tanë kanë thënë: “Kur të**

dëgjosh fjalën e Allahut “O ju që keni besuar” hape veshin mirë ngase ose është hair me çka urdhëroresh apo sherr nga i cili ndalohesh. Allahu i Madhëruar ka treguar se çfarë urdhëron dhe thërret, është jetë për zemrat mbi të cilën ngritët jeta e plotë e lumtur për trupin në këtë botë dhe tjetrën, Allahu thotë: **“O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes së) All-llahut dhe të të dërguarit kur ai (i dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë)”**. (Enfal 24).

Disa komentues kanë thënë: **(për atë që ju jep jetë)** është për qëllim Kurani. E disa kanë thënë islami, ngase aty ka jetë gjallëri prej kufrit, sikur që thotë: **“a është ai që qe i vdekur kurse Ne e ngjallëm.”** (EnAm 122).

Dhe kanë thënë është për qëllim lufta në rrugë të Allahut ngase aty është krenaria e muslimanëve pas nënçmimit, dhe fuqia e tyre pas dobësisë. Më pas Allahu i kërcënon ata që nuk janë përgjigjur thirrjes së Tij, dhe thotë: **“dhe ta dini se All-llahu ndërhyt ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij, dhe se ju do të tuboheni te Ai.”** (Enfal 24).

Kush nuk i përgjigjet Atij dhe të dërguarit të Tij do ta dënon me lajthitje të zemrës së tij, e nuk do ta pranon të vërtetën më pas, siç thotë: **“Ne i rrotullojmë zemrat dhe të parët e tyre (prej besimit) ashtu sikundër nuk e besuan atë (Kur’anin) për herë të parë, dhe i lëmë të bredhin të hutuar në atë mashtrimin e tyre”**. (Enam 110).

Keni kujdes të mos refuzoni urdhrin e Allahut që të parën herë kur t’ju vije, se Allahu është ai që ndërhyt mes njeriut dhe zemrës së tij, dhe i rrotullon zemrat kah të do, për këtë i dërguari sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem shpesh thoshte: **“O rrotullues i zemrave, përqendro zemrën time në fenë Tënde.”**

Robër të Allahut!

Allahu thotë: **“ti përgëzoji pra robërit e Mi, Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që All-llahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit.”** (Zumer 17-18)

Prej nesh kërkohet që të dëgjojmë dhe të pasojmë, kërkohet të dëgjojmë fjalën e Allahut dhe të dërguarit të Tij, ngase ai që nuk e dëgjon sot, do të ketë keqardhje nesër kur jobesimtarët do të thonë: **“Dhe thonë: “Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit.”** (Mulk 10).

Kërkohet nga ne që të dëgjojmë hutbet, ligjëratat, të prezantojmë në kurse, tribuna që të dëgjojmë atë që na bën dobi e të mësojmë fenë tonë, të dëgjojmë programet fetare të dobishme të cilat transmetohen nëpërmjet radiove që arrijnë në çdo shtëpi e çdo vend, mirëpo shumica nga ne nuk i dëgjojnë, edhe nëse i dëgjojmë nuk i meditojmë. Në tokë nëse nuk bie shiu apo nuk arrin uji

ajo tokë vdes, po ashtu edhe zemrat nëse nuk u arrin shpallja, verbërohen, sëmuren e vdesin.

Nëse njeriu nuk prezanton në hutbe, as që dëgjon këshillë, e as që lexon Kuran, e as hadith nga i dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, si do të jetë gjendja e tij? Prej nga do ta kupton fenë? Si do ti përgjigjet Allahut dhe të dërguarit të Tij?

Përgjigja ndodh vetëm pasi të ketë dëgjuar thirrjen, e Allahu na ka thirrur në Librin e Tij dhe me fjalët e të dërguarit të Tij, Allahu thotë: **“Ai ju thërret (në besim) për t’ju falur mëkatet.”** (Ibrahim 10)

E kush e ka dëgjuar thirrjen e Allahut është i obliguar ti përgjigjet. **“E kush nuk i përgjigjet atij që thërret në rrugën e All-llahut, ai nuk është i pamposhtur në tokë dhe pos Atij, ai nuk ka mbrojtës, të tillët janë në një humbje të hapët.”** (Ahkaf 32)

Ka prej njerëzve që refuzojnë të përgjigjen thirrjes së Allahut në tërësi, këta janë jobesimtarët dhe hipokritët të cilët kanë thënë **“kemi dëgjuar dhe kundërshtuar”**, ka prej njerëzve që pranon atë që është në pajtim me epshin e tij dhe refuzon të kundërtën, ky person është rob i epshit të tij, e nuk është rob i Allahut që pason thirrjen e Zotit, Allahu thotë: **“E nëse ata nuk të përgjigjen ty, atëherë dije se ata ndjekin vetëm dëshirat e veta, e kush është më i humbur se ai që duke mos pasur fakt prej All-llahut, ndjek epshin e vet? S’ka dyshim se All-llahu nuk udhëzon popullin zullumqar.”** (Kasas 50)

Ky është sikur ai i cili beson një pjesë të librit dhe e mohon një pjesë, thirret të prezanton në namazin me xhemat në xhami, ai nuk përgjigjet, thirret ta braktisë kamatën, ryshfetin dhe marrëdhëniet e ndaluara e ai nuk mendon ti le dhe të largohet prej tyre, urdhërohet për punë të mirë dhe ndalohet nga e keqja e nuk është zbatues i tyre, edhe pse ai emërtohet me fe, dhe thotë se është prej myslimanëve, personi i tillë nëse ka shpëtuar nga kufri, nuk do të shpëton nga hipokrizia dhe sjellja e keqe.

Thirrja e Allahut arrin tek çdo person në forma të ndryshme, qoftë nëpërmjet leximit të fjalës së Allahut apo sunetit të Dërguarit sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, nëpërmjet thirrësve në rrugë të Allahut, nëpërmjet atyre që urdhërojnë në të mirë dhe ndalojnë nga të këqijat.

Hutbeja e dytë:

O ju njerëz, dijeni se ekzistojnë pengesa të cilat janë mes robit dhe mes përgjigjes ndaj Allahut dhe të dërguarit të tij, andaj ti keni kujdes ato.

Prej tyre janë: Kryelartësia ndaj pranimit të së vërtetës, ashtu siç ndodhi me Iblisin kur Allahu e urdhëroi atë t’i bëjë sexhde Ademit, refuzoi dhe u bë

kryelartë, e tha: Unë jam më i mirë se ai. I Dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Kryelartësia e refuzon të vërtetën dhe nënçmon njerëzit”**.

Prej pengesave tjera është: Zilia, siç ndodhi nga jehudët kur i Dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem i thirri ata që ti besojnë atij, nuk iu përgjigjën dhe mohuan, me zilinë që kishin pasi që u kishte ardhur e vërteta.

Prej pengesave është edhe: Fanatizmi në mendime, grupe, pasimi i verbër i baballarëve, sikur që kishin vepruar jehudët dhe paganët, Allahu thotë: **“Dhe kur atyre u thuhet: “Besoni atë që e shpalli All-llahu”, ata thonë: “Ne besojmë atë që na u shpall neve”, kurse e mohojmë atë pas tij, edhe pse është vërtetues i atij që e kanë ata dhe është i vërtetë.”** (Bekare 91)

“E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): “Pranoni atë që All-llahu e shpalli”! Ata thonë: “Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë”! Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t’i pasonin)?” (Bekare 170)

Prej pengesave është edhe pasimi i epshit, Allahu thotë: **“E nëse ata nuk të përgjigjen ty, atëherë dije se ata ndjekin vetëm dëshirat e veta, e kush është më i humbur se ai që duke mos pasur fakt prej All-llahut, ndjek epshin e vet? S’ka dyshim se All-llahu nuk udhëzon popullin zullumqar”**. (Kasas 50).

I Dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Nuk ka besuar asnjë prej jush përderisa dëshira e tij të jetë pasuese e asaj me të cilën kam ardhur unë”**.

Prej pengesa është edhe frika nga njerëzit, mos durimi nga dëmi i tyre, Allahu thotë: **“Nëse ne ndjekim rrugën e drejtë së bashku me ty, ne me të shpejtë do të jemi të dëbuar prej vendit tonë”**. (Kasas 57)

Allahu thotë: **“Mos u frikohuni atyre, por frikohuni nga Unë, nëse jeni besimtarë”**. (Ali Imran 175).

I Dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Kush përfiton kënaqësinë e njerëzve duke hidhëruar Allahun, Allahu mbi të do të jetë i hidhëruar edhe njerëzit do të hidhërohen me të”**.

05 - LIGJËSIMI I SELAMIT DHE DOBITË E TIJ.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, i cili na urdhëroi që të kapemi për litarin e Tij dhe na ndaloi prej përçarjes dhe kontradiktave: **“Kush mbahet fort pas (fesë së) Allahut, sigurisht që është i drejtuar në udhë të mbarë”** (Ali Imran 101) Dëshmoj se nuk i takon me të vërtetë adhurimi askujt përveç se Allahut, i cili është një dhe nuk ka shok. Dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, dhe dëshmoj se është njeriu me moral më të lartë dhe me zemër më të mirë dhe më të shëndoshë. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju njerëz frikojuni Allahut dhe veproni me ligjet e fesë së juaj që të jetë i kënaqur Zoti i juaj, të fitoni shpërblimet e Tij dhe t'i shpëtoni dënimit të Tij. Allahu për ju i ligjësoi ligjet më të mira, në të Dërguarin e juaj e la shembullin më të mirë për njerëzimin dhe përhapjen e selamit e bëri një prej ligjeve më të mëdha që i ligjësoi. Selami është përshëndetje e veçantë e muslimanëve dhe e melaqeve dhe e banorëve të xhenetit dhe përshëndetja e besimtarëve atë ditë kur do ta takojnë Zotin e tyre.

Allahu i urdhëroi muslimanët që të përshëndeten në mes veti kur të hynë në shtëpitë e njëri-tjetrit dhe tha: **“O ju besimtarë! Mos hyni në shtëpitë e huaja pa marrë leje e pa i përshëndetur banuesit e tyre”**. (Nur 27), dhe **“Kur të hyni në shtëpi, të përshëndetni njëri-tjetrin me përshëndetje të mirë e të bukur nga Allahu”**. (Nur 61)

Poashtu urdhëroi me dhënien e selamit gjatë takimeve me njëri-tjetrin. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Nëse e takon dikush vëllanë e vet, le t'i jap selam, e nëse në mes tyre ka ndonjë pemë, mur apo gur e pastaj e takon le t'i japë atij selam”**.

Poashtu ligjësohet dhënia e selamit gjatë ardhjes dhe fillimit të uljes, dhe gjatë ngritjes dhe largimit prej mexhlisit. Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu, thotë se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kur ndonjëri prej jush vjen në ndonjë grupim, të përshëndesë me selam, dhe kur dëshiron të largohet, le të përshëndesë prapë me selam. Nuk është i pari më i vlefshëm se i fundit”**.

Sunet është ta përshëndesë kalorësi këmbësorin, këmbësori të ulurin, pakica shumicën, i vogli të rriturin, dhe forma e përshëndetjes për atë që e fillon është: **“Es selamu alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu”**, kurse për atë që i përgjigjet është: **“Ue alejkumu selam ue rahmetullahi ue bereketuhu”**. Kjo është forma më e mirë, por edhe nëse e shkurton ai që e jep vetëm se në **“Es selamu alejkum”**, dhe ai që përgjigjet vetëm se në **“Ue alejkumu selam”** lejohet, por më mirë është që kur t'ia kthen të shton në formë siç thotë edhe Allahu, Subhanehu ue Te'Ala: **“Kur ju përshëndet dikush me respekt, kthejani me një përshëndetje më të mirë ose në të njëjtën mënyrë”**. (Nisa 86)

Ibën Kethiri, RahimehUllah, kur e komenton këtë ajet thotë: **“Kur të përshëndet një musliman përgjigju atij me më mirë duke shtuar në formë ose përgjigju ashtu si të përshëndeti”**. Teprica apo shtimi në formë është e pëlqyer, ndërsa ngjasimi është detyrues që do të thotë se fillimi me selam është e pëlqyer, kurse përgjigja apo kthimi i tij detyrim dhe duhet patjetër të jetë me fjalën **“Selam”**.

Përshëndetjet si, mirëmëngjesi dhe mirëdita, nuk bëjnë pjesë në përshëndetjen me selam. Njeriu duhet patjetër që ta shqipton selamin dhe nuk mjafton shenja me dorë apo me kokë për shkak ndalesës që ka ardhur në hadithin të cilin e përcjell Amru ibën Shuajb, radijAll-llahu anhu, prej gjyshit të tij dhe ky i fundit prej Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i cili ka thënë: **“Nuk është prej nesh ai i cili i ngjason të huajit, mos u ngjasoni çifutëve dhe të krishterëve. Përshëndetja e çifutëve është shenja me gishta, ndërsa përshëndetja e krishterëve është përshëndetja me dorë”**.

Por nëse është i përshëndeturi shurdh apo është larg e kështu me radhë nuk ka problem nëse e përshëndet me shenjë dhe njëkohësisht duke e shqiptuar selamin.

Përshëndetja me selam është prej të drejtave të muslimanëve të ndërsjella dhe duhet që të përshëndeten mes veti. Jobsimtarëve nuk lejohet që t'i përshëndesim me selam, por nëse ata fillojnë me selam, u themi: **“Ue alejkum”**, duke u bazuar në hadithin të cilin e transmeton Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Mos filloni të parët me selam ndaj krishterëve dhe çifutëve, dhe nëse e takoni në rrugë ndonjërin prej tyre detyrojeni atë që tu përmbahet anëve të rrugës”**.

Enesi, radijAll-llahu anhu, përcjell se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Nëse ju përshëndesin juve të krishterët dhe çifutët thuani atyre: “Ue alejkum”**”.

O ju musliman, dijeni Allahu ju mëshiroftë se ka kohëra dhe vende ku nuk ligjësohet në to dhënia e selamit, prej saj:

Kur njeriu është duke e kryer nevojën e vogël apo të madhe, apo është në tualet, pastaj gjatë hutbes së Xhumasë nuk lejohet që të përshëndetet xhemati kur e dëgjojnë hutben, për shkak se ata janë të urdhëruar të mos flasin dhe nëse i përshëndet ndonjëri nuk lejohet që t'ia kthejnë selamin.

Poashtu, gjatë leximit të Kuranit lexuesit nuk i jepet selam kur lexon. Ajo çka e meriton të përmendet dhe t'ia tërheqim vërejtjen është përshëndetja e njerëzve me dorë pas namazeve detyruese dhe vullnetare. Kjo përshëndetje nuk ligjësohet dhe nëse njeriu vazhdon në veprimin e saj kalon në risi. Nëse e vepron atë për ndonjë shkak si kur e takon ndonjë njeri të cilin nuk e ka parë

një kohë të gjatë apo ka nevojë të i flet për diçka, kjo lejohet dhe nuk ka gjë në të.

Përshëndetja me dorë gjatë takimit është sunet i pëlqyer dhe i kërkuar. Bera ibën Azib, radijAll-llahu anhu, përcjell se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Nuk takohen dy muslimanë e përshëndetën me dorë vetëm se iu falen mëkatet, para se të ndahen”**.

Përkulja gjatë përshëndetjes ndalohet edhe atë duke u bazuar në hadithin të cilin e shënon Tirmidhiu, RahimehUllah, në librin e tij se është pyetur Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, se a lejohet përkulja gjatë përshëndetjes? Është përgjigjur se nuk lejohet. Përkulja është një lloj rukue, ndërsa rukua dhe sexhdeja nuk lejohen vetëm se për Allahun.

Sa i takon dispozitës së ngritjes për selam ose për respekt të një njeriu i cili vjen prej rruge apo hyn në ndonjë mexhlis lejohet. Kurse ngritja në shenjë respekti të një njeriu e jo për arsye të përshëndetjes së tij, siç u ngrihet mbretërve, kryetarëve, etj, deri sa ata të ulen, apo siç i urdhërojnë mësuesit nxënësit të ngrihen kur ata hyn në klasë apo kur vjen ndonjë vizitor në klasë, kjo nuk lejohet. Ibën Tejmije, RahimehUllah, thotë: **“Nuk ka qenë tradita e të parëve tanë gjatë periudhës së Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe periudhës së halifeve të drejtë, të i ngrihen në këmbë Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe halifeve pas tij siç është traditë sot ku njerëzit u ngrihen në këmbë njëri-tjetrit”**.

Madje Enes ibën Malik, radijAll-llahu anhu, thotë se nuk ka pasur krijesë më të dashur tek ne se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, mirëpo askush prej sahabëve kur e shihte nuk iu ngritke në këmbë për shkak se ai e urrente atë.

Ndoshta janë ngritur për atë njeri i cili ka ardhur prej rruge që ta presin siç transmetohet se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, është ngritur për Ikramen, dhe u ka thënë Ensarëve kur erdhi Sad ibën Muadhi, radijAll-llahu anhu: **“Ngrihuni dhe priteni udhëheqësin e juaj”**. Prandaj muslimanët duhet t'i pasojnë të parët tanë për të cilët Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë thënë se janë gjenerata më e mirë në historinë e njerëzimit dhe na kanë urdhëruar që t'i pasojmë ata.

O ju robërit e Allahut,

Kur njeriu përshëndet me selam apo i dërgohet selami prej një njeriu tjetër i cili nuk është prezent aty detyrohet që t'ia kthen dhe nëse përshëndetja është nëpërmjet ndonjë ndërmjetësuasi detyrohet të thotë **“Ue sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem”**. Nëse përshëndetja është nëpërmjet ndonjë shkrimi apo letre, kur ta lexon duhet të thotë: **“Ue alejkum selam”**.

O ju musliman, frikojuni Allahut dhe përhapeni selamin mes jush për arsye se ai është shkak i shumë mirësive dhe i ringjalljes së Sunetit dhe i largimit të egërsisë mes njerëzve. Ai është prej fjalëve më të mira dhe të folurit më të bukur dhe Allahu për të tha: **“Kur të hyni në shtëpi, të përshëndetni njëri-tjetrin me përshëndetje të mirë e të bukur nga Allahu”**. (Nur 61)

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut që i bëri besimtarët vëllezër mes veti. Kjo është dhuntia e Allahut ndaj besimtarëve dhe me të vërtetë Allahu zotëron dhunti të madhe.

Dëshmoj se nuk i takon me të vërtetë adhurimi askujt përveç se Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, të cilin Allahu e bëri shëmbëlltyrë për të gjithë besimtarët. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju njerëz, kapuni për veprat e mira dhe virtytet e larta të moralit dhe dijeni se përhapja e selamit mes jush është shkak i shumë fryteve të mëdha, prej saj:

- Është një prej shkaqeve për hyrjen e njeriut në xhenet.

Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“O ju njerëz, përhapeni selamin, ushqeni nevojtarët, mbani lidhjet farefisnore dhe faluni natën kur njerëzit tjerë flenë që të qetë të hyni në xhenet”**.

- Është shkak i cili mbjell dashuri në zemër mes njerëzve.

Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Nuk do të hyni në xhenet derisa të besoni, dhe nuk do të besoni derisa të mos duheni në mes vete. A nuk dëshironi t’ju udhëzoj në një gjë, nëse e bëni atë do të duheni në mes vete? Përhapeni selamin (përshëndetjen) në mes jush”**.

- Selami dhe përshëndetja me dorë janë shkak i faljes së mëkateve.

Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Nuk takohen dy muslimanë e përshëndetën me dorë vetëm se iu falen mëkatet, para se të ndahen”**, dhe me një transmetim tjetër thotë: **“Kur besimtari e takon një besimtar e përshëndet dhe ia japin dorën njëri-tjetrit, iu bien mëkatet siç bien gjethet e pemëve”**.

O ju besimtarë për këto arsye kapuni për të dhe veproni me të që t’i fitoni të gjitha frytet e saj.

06 - RËNDËSIA E NAMAZIT.

Falënderimi i takon vetëm Allahut, i Cili e bëri namazin shtyllë të fesë dhe tha: **“Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz! Kjo është njëmend e vështirë, përveçse për të devotshmit, që janë të bindur se do të takojnë Zotin e tyre dhe se do të kthehen tek Ai.”** (Bekare 45-46) Dëshmoj se adhurimi nuk i takon askujt me të drejtë përveç se Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij dhe se namazi ishte porosia e fundit e tij. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju musliman,

Frikojuni Allahut për fenë e juaj në përgjithësi dhe për namazin e juaj në veçanti. Faleni namazin dhe përkujdesuni për të. Faleni me frikërespekt dhe me qetësi shpirtërore. Faleni atë në xhemat dhe nëpër xhami dhe përkujdesuni për të sinqerisht për arsye se ai është shtyllë e fesë dhe adresa e lumturisë.

Namazi është drita e juaj në tokë, thesari i juaj në qiell dhe ndihma e juaj gjatë vështirësive në jetë. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz!”**. Bekare 45), dhe **“Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe”**. (Ankebut 45) Namazi ishte gëzimi i syve të Muhamedit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe streha e tij gjatë vështirësive dhe pushimi i tij gjatë lodhjeve. Namazi është shtylla e dytë prej shtyllave të Islamit dhe është lidhja direkte mes robit dhe Allahut dhe shenja dalluese mes kufrit dhe imanit.

Namazi në Islam peshon rëndë dhe pozita e tij tek Allahu është e lartë. Për këtë arsye kushtoni rëndësi të madhe dhe kryeni me besnikëri dhe faleni të plotë. Ai që e falë i përkushtuar dhe të plotë do të shpërblehet, kurse ai që vjedh prej tij dhe e falë të mangët dyshohet se a do t'i pranohet. Falësi prej namazit të tij fiton hise aq sa ka qenë i përkushtuar në të kurse namazi që falet shpejt nuk pranohet.

Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut hyri në xhami dhe pas tij hyri një burrë i cili, pasi u fal, shkoi dhe e përshëndeti Pejgamberin, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Ai, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ia ktheu përshëndetjen dhe i tha: **“Kthehu dhe falu prapë sepse nuk je falur”**. Personi u kthye dhe u fal përsëri ashtu siç u fal herën e parë, pastaj u kthye dhe e përshëndeti Pejgamberin, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i cili përsëri i tha: **“Kthehu dhe falu prapë sepse nuk je falur”**. Kjo gjë vazhdoi tri herë. **(Pas gjithë kësaj)** ai tha: **“(Betohem) për Atë i Cili të ka dërguar ty me të vërtetën! Unë nuk mund të falem më mirë se kështu! (Të lutem) më mëso**

pra!” Nga kjo Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, tha: **“Kur të ngrihesh e të vendosësh për të falur namaz shqipto tekbinin (fjalët Allahu Ekber – Allahu është më i Madhi, për fillimin e namazit), pastaj këndo ç’është më e lehtë për ty (që di përmendësh nga Kurani, pastaj përkulu në ruku dhe rri sa të ndihesh i qetësuar (në këtë gjendje), pastaj ngrije kokën dhe qëndro drejt në këmbë, pastaj bjer me fytyrë për tokë në sexhde dhe rri sa të ndihesh i qetësuar (në këtë gjendje), pastaj ulu dhe rri i qetësuar (dhe mos u ngut për në sexhden e dytë). Kështu pra vepro gjatë gjithë faljes tënde (në çdo veprim rri sa të ndihesh i qetësuar në atë gjendje që je)”**.

Ky hadith është argument i qartë se namazi nuk lejohet që të falet shpejtë dhe se në të kërkohet që gjatë çdo lëvizje falësi të jetë i qetë dhe të mos ngutet. Qetësimi në namaz pra është prej shtyllave të namazit dhe pa të namazi nuk është i vërtet.

Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ndaloi që falësi ta vonon namazin e tij deri në namazin tjetër pa arsye dhe në fund prej frike se do t’i ikë namazi të ngrihet dhe ta falë atë shumë shpejt dhe na paralajmëroi se ky lloj i namazit i përngjan atij të hipokritëve. Ai, alejhi salatu ue selem, thotë: **“Ai (namazi i shpejtë) është namazi i hipokritëve, ulet ndonjëri prej tyre derisa të skuqet dielli (afër perëndimit), ku në këtë kohë është mes dy brirëve të shejtanit, pastaj ngrihet dhe i falë shpejtë katër rekate, në të cilat nuk e përmend Allahun vetëm se pak”**.

Edhe mosfalja e namazit në xhemat është një prej vetive të tyre. Prej vetive tjera të tyre janë edhe cilësitë që ua cek Allahu në Kuran: **“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrjnë Allahun, por është Ai që i mashtron ata. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak”**.(Nisa 142) Ibën el Kajimi, RahimehUllah, **thotë se këto gjashtë cilësi në namaz janë prej vetive të hipokritëve: ngritja me përtesë për në namaz, shtirja në faljen e tij vetëm sa për të dukur para njerëzve, vonesa e tij, nxitimi në faljen e tij, mos përmendja e Allahut në namaz shumë dhe mosfalja në xhemat**.

Ebu Abdullah el Esharij, radijAll-llahu anhu, përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, u fal me shokët e tij dhe pastaj u ul me një grup prej tyre. Ndërkohë, hyri një njeri dhe filloi të falet. Në namazin e tij filloi të bëj lëvizje të shpejta. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, tha: **“A e shikoni këtë? Kush vdes kështu, vdes në fe jo të Muhamedit. Ky e fal namazin ashtu siç bën korbi”**.

Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, vjedhjen në namaz e bëri nga krimet më të mëdha të vjedhjes madje më të madhe se atë të pasurisë. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Vjedhësi më i keq është ai i cili vjedh në namaz”**. Të pranishmit të çuditur e pyetën: **“O i dërguari i Allahut! Si vjedh njeriu në namaz?”**. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-

lem, iu përgjigj: **“Nuk e plotëson rukunë dhe sexhden”**. Padyshim se vjedhësi në fe është më i keq se sa vjedhësi i dynjasë.

Një prej gabimeve të mëdha në namaz është edhe të paraprirat e imamit në ruku, sexhde, ulje dhe ngritje. Imam Ahmedi, RahimehUllah, thotë: **“Nuk ka namaz ai që e paraprin imamin”**. Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu, përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“A nuk ka frikë ndokush prej jush, që e ngre kokën para imamit, se mos Allahu ia shndërron kokën në kokë gomari, apo t'ia shndërrojë fizionominë në fizionomi gomari?”**.

Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu, rrëfen se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Imami nuk është caktuar veçse për t'u pasuar, ndaj mos e kundërshtoni atë. Kur ai të thotë “Allahu Ekber”, edhe ju thoni “Allahu Ekber”, kur të bëjë rukunë, edhe ju bini në ruku. Kur të thotë “Semi Allahu limen hamideh”, ju thoni: “Allahume rabena lekel hamd”. Kur të bjerë në sexhde, edhe ju bini në sexhde. Nëse ai falet ulur, edhe ju faluni ulur të gjithë”**.

Imam Ahmedi, RahimehUllah, thotë se fjala e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, **“Kur ai të thotë “Allahu Ekber”, edhe ju thoni “Allahu Ekber”, e ka për qëllim prite imamin deri sa të thotë Allahu Ekber,** kur ta përfundon atëherë ju thoni Allahu Ekber.

Shumë njerëz nuk i dinë këto hadithe dhe shpesh gabojnë në namazin e tyre. Të gjitha veprimet në namaz duhen të veprohen dhe të shqiptohen pasi t'i thotë apo vepron imami dhe nuk lejohet as të vonohemi e as ta paraprijmë. Dihet se xhemati nuk përfiton asgjë nëse e paraprin imamin mirëpo shejtani i mashtron dhe i nxit që ta paraprijnë imamin dhe me këtë t'ua prish namazin e tyre.

O ju musliman, frikojuni Allahut dhe kujdesuni për faljen e namazit. Namazi është porosia e fundit e Muhamedit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, që e porositi Ummetin e tij. Umu Seleme, radijAllahu anha, përcillet se ka thënë: **“I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në sëmundjen e rëndë, për shkak të së cilës ndërroi jetë, thoshte: “Kujdesuni për namazin dhe robëreshat (të cilat i keni nën sundimin tuaj)!”**. Këto fjalë i përsëriste derisa ia dorëzoi shpirtin Allahut të Madhëruar. Namazi është adhurim i cili u urdhërua në qiell, është gjëja e parë për të cilën do të llogaritet njeriu Ditën e Kiametit dhe është gjëja e fundit që do të humbet nga feja, sikur që ka treguar i Dërguari, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“Do të shkëputen hallkat e Islamit një nga një, sa herë që do të shkëputet një hallkë, njerëzit do të kapen për tjetrën, hallka e parë që shkëputet është gjykimi, e fundit është namazi”**.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përrulur në namazin e tyre, të cilët shmangen nga fjalët e kota, të cilët japin zeqatin, të cilët e ruajnë nderin e tyre (nga**

marrëdhëniet e jashtëligjshme), përveçse me gratë e tyre ose me skllavet që kanë në zotërim dhe, për këtë, nuk janë fajtorë, ndërsa ata që kërkojnë përtej kësaj, pikërisht ata janë shkelës (të kufijve), të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marr dhe të cilët i kryejnë rregullisht faljet. Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët, që do ta trashëgojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht”. (Muminun 1-11)

07 - FRYTET E IMANIT.

Falënderimi i plotë i takon Allahut i cili ia jep mirësinë e udhëzimit në besim atij që do, dëshmoj se nuk meriton të adhurohet askush pos Allahut, **“Atij i lutet gjithkush që ndodhet në qiej dhe në Tokë e në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme”**. (Rahman, 29) dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i tij, i përkrahur nga Allahu me ndihmë dhe argumente, paqja e Allahut qoftë mbi të, mbi familjen, mbi shokët e tij dhe mbi gjithë ata që e pasuan atë.

O ju njerëz kini frikë Allahun, kërkonini prej tij përqendrimin në besim, padyshim se besimi është dritë që Allahu e fut në zemrën e njeriut. **“A është njëlloj si ai që Allahu ia ka hapur kraharorin për të pranuar Islamin, duke qenë kështu në dritën e Zotit të vet, (ashtu edhe ai që e ka zemrën të mbyllur ndaj besimit?!) Prandaj, mjerë ata që e kanë zemrën të pandjeshme, kur përmendet Allahu! Njerëz të tillë janë në humbje të qartë”!** (Zumer, 22)

“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë.” (En ‘am, 125)

Besimi është dhunti e Allahut për robin **“Allahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim, nëse ajo që thoni është e vërtetë!”** (Huxhurat, 17). Besimi është bindje dhe vepër, sikurse ka thënë Imam Hasan el Basriu, RahimehUllah: **“Nuk është imani as zbukurim me fjalë e as shpresë e pabazë, por është bindje e ngulitur në zemër dhe që e vërtetojnë veprat”**. Për këtë Ehlu suneti e definojnë imanin se është: thënje me gjuhë, bindje me zemër dhe vepër me gjymtyrë, shtohet me adhurime dhe pakohet me gjynahe, me këtë kuptim imani është garanci për qëndrueshmëri në raste të sprovës, dhe anijë e shpëtimit në tufanin e fitneve dhe valëve të sprovave. Allahu ka ndërlidhur me besim mirësi të shumta të afërta dhe të mëvonshme, i ka përgatitur atij sigurinë dhe udhëzimin në dunja dhe ahiret: **“Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari), pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar.”**(En Am, 82). Sikurse i premtun atij arritje të jetës së lumtur dhe shpërblim të mirë:

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.” (Nahl, 97)

Allahu ka marrë përsipër mbrojtjen e besimtarëve në veçanti: **“Allahu i mbron ata të cilët kanë besuar”**. (Haxh, 38) Ky lloj i besimit, që ka këtë cilësi ka edhe gjashtë kushtet dhe me degë që tejkalon numrin shtatëdhjetë. I dërguari, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Iman është të besosh në Allahun, melaiket, librat, të dërguarit, ditën e Fundit, dhe të besosh në caktimin e tij të mirën dhe të keqen”**. Po ashtu i dërguari, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Imani është shtatëdhjetë e disa degë, më e larta është dëshmia se nuk ka zot tjetër (që meriton të adhurohet) pos Allahut, e më e ulëta është largimi i një pengese nga rruga, edhe turpi është degë e imanit.”** Imani me gjashtë kushtet e tij është i kompletuar nëse përfshinë gjithë atë që duhet të besohet. Nuk mjafton besimi në disa kushte dhe mohimi i tjerëve: **“Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga të dërguarit e Tij, duke thënë: “Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë” dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtëruës për mohuesit. Ndërsa atyre që besojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe nuk bëjnë dallim mes asnjërit prej tyre, Ai do t'u japë shpërblimin (e premtuar). Se Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”** (Nisa, 150-152)

Nga urtësia e Allahut të Lartmadhëruar është që nuk i le robërit e Tij pa i testuar që të dallohet i sinqerti në besimin e tij dhe gënjeshtari dyfytyrësh: **“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë.”** (Ankebut, 2-3)

Këtu shfaqet dallimi mes qëndrimeve të besimtarëve dhe dyfytyrëshave e jobesimtarëve, do të paraqesim një përmbledhje të disa qëndrimeve ashtu siç i ka sqaruar Kurani.

Prej këtyre qëndrimeve është se kur dy grupet thirren për te Allahu dhe i dërguari i Tij që të gjykohen mes tyre në kundërshtimet që kanë, Allahu i Madhëruar për qëndrimin e dyfytyrëshave thotë: **“Ata (hipokritët) thonë: “Ne besojmë në Allahun dhe në të Dërguarin dhe (u) bindemi (atyre).” Pastaj disa prej tyre shmangen, sepse nuk janë besimtarë aspak. Dhe, kur thirren tek Allahu (Libri i Tij) dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë midis tyre, një grup nga ata kthejnë kurrizin. Por, nëse e drejta është në anën e tyre, ata vijnë përulshëm. A mos kanë sëmundje në zemrat e tyre apo dyshojnë? Apo kanë frikë se mos Allahu dhe i Dërguari i Tij do t'u bëjnë padrejtësi?! Jo, por pikërisht ata janë të padrejtët.”** (Nur, 47-50)

Më pas Allahu sqaroi qëndrimin e besimtarëve kur të thërriten në gjykimin e Allahut dh e të dërguarit të Tij, thotë: **“Ndërsa përgjigjja e vetme e besimtarëve, kur thirren tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë midis tyre, është: “Dëgjojmë dhe bindemi”. Pikërisht këta janë të shpëtuarit.”** (Nur, 51)

Ky është qëndrimi i dy palëve kur thërriten që të gjykohen sipas shariatit të Allahut, ky është një qëndrim që ende përsëritet saherë që ndodh një proces ose shfaqet një risi, besimtarët dëshirojnë gjykimin e Allahut dhe të dërguarit të Tij qoftë në favor të tyre apo kur janë fajtor, ndërsa dyfytyrëshit dëshirojnë të gjykojnë me ligjin e Allahut dhe të dërguarit të Tij nëse është në favorin e tyre, e nëse është në kundërshtim me ta ata marrin gjykimin e djallit dhe nuk përfillin gjykimin e Allahut.

Qëndrimi i dy palëve ndaj Kuranit dhe gjatë leximit të tij. Besimtarët kur zbret Kuran dhe kur lexohet u shtohet besimi dhe ata janë të përgëzuar, ndërsa dyfytyrëshit kjo u shton njollosje mbi njollosje dhe presin rast të volitshëm për të ikur nga dëgjimi i tij, Allahu thotë: **“Kur shpallet ndonjë sure, disa prej atyre (që kanë dyshim dhe hipokrizi) thonë: “Kujt prej jush do t’ia shtojë besimin kjo sure?” Përsa u përket besimtarëve, atyre (kjo sure) ua shton besimin dhe ata gëzohen. E sa u përket atyre që kanë sëmundje në zemrat e veta, ajo ua shton edhe më dyshimin që kanë dhe ata vdesin si mohues. Vallë, a nuk e shohin ata se çdo vit vihen në provë një ose dy herë e prapëseprapë as nuk pendohen, as nuk e mbledhin mendjen?! Kur shpallet ndonjë sure (që u tërheq vërejtje), ata shikojnë njëri-tjetrin (duke thënë): “A po ju sheh ndokush?”, pastaj largohen. Allahu i shmang zemrat e tyre, sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë!”** (Teube, 124-127)

Qëndrimi i dy palëve gjatë luftës në rrugë të Allahut, besimtarët dëshirojnë nga Zoti i tyre që ti zbret të dërguarit të tij një sure që do ti urdhëron për luftë kundër jobesimtarëve, duke u kujdesur për xhihadin në rrugë të Allahut dhe arritjen e shpërblimit të madh që Allahu ka përgatitur për luftëtarët, kur erdhi urdhri për luftë shpejtuan të gëzuar, luftuan me pasuritë dhe shpirtrat e tyre.

Kurse dyfytyrëshave kur u vjen urdhri për luftë, i kaplon paniku dhe frika, fillojnë të paramendojnë arsyetime pas arsyetimeve, në mënyrë që të mos marrin pjesë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Besimtarët thonë: “Sikur të ishte shpallur një sure!” Por, kur shpallet një sure e qartë dhe në të përmendet lufta, i sheh ata me zemra të sëmura, si të vështrojnë ty me shikim si të agonisë së vdekjes! Ndërkohë, më e përshtatshme do të ishte për ata bindja dhe fjala e mirë! Madje, kur çështja (e luftës) është vendosur, do të ishte më mirë për ata që të tregohen të sigurtë ndaj Allahut.”** (Muhamed, 20-21)

Poashtu thotë: **“Nuk do të të kërkojnë leje për të mos luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre, ata që besojnë në Allahun dhe Ditën e Kiametit. E Allahu i di mirë ata që ruhen nga gjynahet. Ty do të kërkojnë leje vetëm ata që nuk besojnë në Allahun dhe Ditën e Kiametit dhe që zemrat e tyre dyshojnë. Ata luhaten në dyshimin e vet.”** (Teube, 44-45)

Qëndrimi i dy palëve gjatë presionit të jobesimtarëve ndaj muslimanëve, besimtarëve u shtohet përqëndrimi në fe dhe u forcohet bindja e tyre në premtimin e Allahut dhe të dërguarit të Tij për ndihmë, kurse dyfytyrëshave u shtohet frika, supozojnë për të keqe në Allahun dhe të dërguarin e Tij. Për qëndrimin e dy palëve kohën kur jobesimtarët rrethuan muslimanët ditën e Ahzabit nga brenda e jashtë Medinës, kur shikimet u shtangën dhe zemrat arritën deri në fyt nga gjendja e tmerrshme, për qëndrimin e besimtarëve Allahu thotë: **“Kur besimtarët e vërtetë panë ushtrinë e aleatëve, thanë: “Kjo është ajo që na ka premtuar Allahu dhe i Dërguari i Tij; sigurisht, premtimi i tyre u vërtetua!” Kjo ua forcoi atyre besimin dhe përuljen. Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre.”** (Ahzab, 22-23)

Ndërsa për qëndrimin e dyfytyrëshave thotë: **“Por hipokritët dhe ata me zemra të sëmura e të dobëta, thanë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk na kanë premtuar asgjë, pos mashtrimit”!** Dhe një grup prej tyre tha: **“O banorët e Jethribit²⁵⁴, s’ka qëndrim këtu për ju, andaj kthehuni!”** Një grup tjetër nga ata kërkoi leje prej të Dërguarit, duke thënë: **“Në të vërtetë, shtëpitë tona janë të pambrojtura”!** Por ato nuk ishin të pambrojtura. Ata donin vetëm të iknin.” (Ahzab, 12-13)

Ky është provimi i rëndë i cili shfaq fitoren e besimtarëve dhe dështimin e dyfytyrëshave, kjo është traditë e Allahut në krijesat e tij, e në traditën e Zotit nuk do gjesh ndryshim.

Kjo ishte e tëra, e lusim Allahun, aze ue xhel, që të na dhuroj besim dhe të na mbrojë nga dyfytyrësia. Falënderimi takon Zotit të botëve.

08 - VEPRA E MIRË.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve dhe të qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Ali Imran 102)

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju”. (Nisa 1)

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore”. (Ahzab 70-71)

Vëllezër besimtar,

Frikojuni Allahut dhe dijeni se veprat janë të arriturat e njeriut me të cilat del prej kësaj dynjaje dhe se mbi ato bazohet përfundimi i tij në ahiret. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Të vdekurin e përcjellin tri gjëra: familja e tij, pasuria e tij dhe veprat e tij. Dy kthehen kurse një mbetet me të. Kthehet familja dhe pasuria e tij, kurse me të mbesin veprat e tij”.** Vepra pra është shoqëruesi i njeriut në varr dhe është shkaku kryesor i begatimit të tij në varr ose i dënimit të tij në varr. Përcillet në një hadith se vepra e mirë i vjen pronarit të saj në varr në formën e një burri me rroba të bardha, fytyrë të bukur dhe parfum të mirë, i cili i thotë: **“Gëzohu për atë që do të shohin sytë. Gëzohu për kënaqësinë e Zotit, xhenetin që ka të mira të pashtershme. Kjo është dita jote e cila të është premtuar”.** I vdekuri e pyet: **“Po ti, kush je, pasi nga fytyra ngjan sikur je njeri i mirë?”.** I përgjigjet: **“Unë jam puna jote e mirë. Për Zotin, nuk të kam njohur veçse i shpejtë në bindje të Zotit, i ngadalshëm për të vepruar gjynahe. Zoti të shpërbleu me të mira për këtë”.** Ndërsa vepra e keqe i vjen pronarit të saj në varr në formën e një burri me rroba të zeza, me erë të keqe dhe me fytyrë të shëmtuar, i cili i thotë: **“Të përgëzoj me diçka rrëqethëse! Kjo është dita jote që të është premtuar”.** I vdekuri e pyet: **“Po ti që paralajmëron të keqen, kush je? Fytyra jote qenka simbol i të keqes”.** Ai i përgjigjet: **“Unë jam puna jote e ligë. Ajo që di rreth teje, është se ke qenë i ngadalshëm në kryerjen e detyrave ndaj Zotit dhe i shpejtë për të vepruar gjynahe që zemëronin Zotin. Prandaj Zoti të dënoi me sherr”.**

O ti rob i Allahut, vepra e mirë është ajo që e shpreson njeriu në momentin e vdekjes. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!”.** (Muminun 99-100) Poashtu vepra e mirë është ajo që e shpresojnë banorët e xhehenemit në momentin kur hidhen në të. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Atje, ata do të thërrasin: “O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë”.** (Fatir 37)

Nëse e përsiatim Kuranin do të vërejmë se Allahu në shumë ajete na orienton kah vepra. Ndonjëherë me veprën e ndërlihdh shpërblimin siç thotë në thënien e Tij: **“Atë ditë askujt nuk do t’i bëhet ndonjë padrejtësi dhe ju do të shpërbleheni vetëm sipas asaj që keni bërë”**. (Jasin 54) Ndonjëherë na lajmëron se Ai i mbikëqyrë të gjithë veprat e tona ku edhe thotë: **“Unë e di mirë çfarë bëni ju”**. (Muminun 51), dhe **“Allahu di gjithçka që punoni ju”**. (Ali Imran 153), dhe **“Allahu dëgjon dhe di gjithçka”**. (Bekare 256) Ndonjëherë na lajmëron se na ngarkoi kujdestar të cilët i shënojnë të gjithë veprat e tona dhe i numërojnë të gjitha ato: **“Kurse ndaj jush kanë përcjellësit! Janë shkruar të ndershëm te Allahu. Ata e dinë se çka punoni”**. (Infitar 10-12) Ndonjëherë na lajmëron se Ditën e Kiametit do të ballafaqohemi me atë çka e kemi vepruar prej veprave dhe se ato do t’i shohim dhe do t’i lexojmë: **“Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t’u tregohen veprat e tyre: kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë”**. (Zelzele 6-8), dhe **“Çdo njeriu ia kemi varur në qafë llogarinë për punën e tij dhe Ne, do t’ia paraqesim Ditën e Kiametit librin, që do ta gjejë të hapur (e do t’i themi): “Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”**. (Isra 13-14) Ndonjëherë na lajmëron se njeriu vepron vetëm se për vetveten e jo për të tjerët: **“Kush zgjedh rrugën e drejtë, e ka për veten e vet e kush i largohet asaj, i largohet në dëm të vetvetes dhe askush nuk e merr të keqen e tjetërkujt”**. (Isra 15), dhe **“Kush bën mirë, e bën për dobi të vet, e kush punon keq, punon në dëm të vet”**. (Fusilet 46)

Jeta e kësaj dynjaje është mundësia e vetme ku njeriu mundet të vepron dhe dije se sot ke mundësi vetëm se të veprosh e të mos llogaritësh, ndërsa nesër vetëm se do të llogaritësh dhe nuk do të kesh mundësi të veprosh. Jeta e njeriut është e shkurtë, përfundimi i tij është i panjohur dhe njeriu nuk e di se kur do t’i vijë çasti i fundit të cilin as nuk do të ketë mundësi ta shtyjë e as ta shpejtojë: **“Kur t’i vijë koha e fundit, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për një çast dhe as nuk mund ta shpejtojnë”**. (Araf 34)

O ti njeri, këto ditë të kësaj dynjaje të cilat i jeton janë shans i artë që nuk mund të përcaktohen me çmim. Nëse e di vlerën e këtyre ditëve dhe i shfrytëzon ato në atë që të bën dobi do të investosh në vetveten lumturi të përgjithmonshme. Ndërsa nëse i humb në dëfrim, lojë dhe shkujdesje do të jesh përgjithmonë në humbje. Atyre të cilët e shfrytëzuan jetën e kësaj bote në veprimin e veprave të mira Ditën e Kiametit do t’u thuhet: **“Ju bëftë mirë, hani e pini për atë, që keni bërë në ditët e kaluara!”**. (Haka 24) Ndërsa atyre të cilët e kaluan kohën e tyre të kësaj dynjaje në lojë, dëfrim dhe shkujdesje do t’u thuhet: **“Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to, ndërsa sot do të ndëshkoheni me dënim poshtëruar, sepse keni qenë arrogantë në Tokë pa kurrfarë të drejte dhe nuk i jeni bindur Allahut”**. (Ahkaf 20)

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut që na bëri prej muslimanëve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

Vëllezër musliman,

Njeriun në rrugëtimin për ta larguar nga veprat e mira e pengojnë pengesa të shumta, prej saj: shpirti i cili është i prirë fort për të keqen, pastaj shejtani me ushtrinë e tij, epshet dhe dyshimet, etj. Këto pengesa kërkojnë ballafaqim të fortë dhe mund të madh që të largohen, prandaj kush mbështetet në Allahun dhe kërkon ndihmën e Tij, e pastaj drejtohet që të bën ndonjë vepër të mirë padyshim se Allahu do t'ia lehtëson atë dhe do t'ia largon të gjitha pengesat prej rrugës së tij.

Ndërsa kush i nënshtrohet këtyre pengesave dhe i largohet veprimit të veprave të mira padyshim se do të bie në kurth të këtyre pengesave dhe do ta humb shansin prej dorës së tij me përfundimin e jetës së tij dhe afrimin e exhelit. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“I zgjuar është ai që e kontrollon vetveten dhe punon për jetën pas vdekjes, kurse kokëtul është ai që ndjek dëshirat e epshit të vet dhe (pa kurrfarë merite) shpreson se All-llahu do t'ia falë”**.

Poashtu në rrugën e robit qëndrojnë edhe disa pengesa të tjera të cilat prej frikës së do ta arrijnë e detyrojnë robin që të përshpejton në veprimin e veprave të mira, prej tyre: sëmundja, varfëria, pleqëria, sprovat dhe vdekja. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Nxitoni në vepra (të mira) para se të paraqiten fitnet sikur nata e errët, gdhihet njeriu besimtar dhe ngryset jobesimtar (qafir), ose ngryset besimtar dhe gdhihet jobesimtar. Do ta shesë ndonjëri prej jush fenë e tij për një kotësi të kësaj bote”**.

Në një transmetim tjetër thotë: **“Nxitoni në punë të mira para se të ndodhë ndonjëra nga shtatë gjërat e vështira. Vallë! A mos pritni varfërinë e t'ju shtyjë të harroni punët e ahiretit, apo, pasurinë e cila ju shtynë të azdiseni e të bëheni zullumqar, apo, ndonjë sëmundje që t'ju shkatërrojë shëndetin tuaj, apo, pleqërinë e cila ju humb fuqinë, apo, vdekjen që ju rri në pritje, apo, Dexhallin më e keqja që mund të ndodhë, ose, vallë! Mos po e pritni Ditën e Kiametit e cila është më e vështirë dhe më e hidhur”**.

O ju robërit e Allahut, frikojuni Allahut dhe nxitoni në vepra të mira para se t'ju afrohet exheli: **“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t'ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin”**.
(Munafikun 9)

09 - VIRTYTET E BESIMTARËVE.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, i Cili dhuron atij që do udhëzimin në besim, dhe dëshmoj se nuk meriton të adhurohet askush pos Allahu i Cili është Një dhe pa rival dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i tij, e dërgoi me udhëzim dhe fe të drejtë në prag të Kiametit si përgëzues e kërcënues, thirrës në rrugën e Allahut pishtar ndriçues, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij.

O ju njerëz keni frikë Allahun e Madhëruar dhe dijeni se dhuntia më e madhe të cilën e arrinë njeriu është udhëzimi në besim **(të drejtë)**, luteni Allahun që tua bën të dashur juve imanin dhe ta zbukuron në zemrat e juaja, e të bën ta urreni mosbesimin, shfrenimin e mëkatin. Besimi nuk është vetëm sa për ta dalluar dhe shpresuar, por është bindje që ngulitet në zemrat dhe e vërtetojnë veprat. Imani **(besimi)** është thënie me gojë, bindje me zemër dhe vepër me gjymtyrë, shtohet me adhurime dhe pakohet me gjynahe, i ka gjashtë kushte: Besimi në Allahun, melaiket, librat, pejgamberët, ditën e Fundit dhe në caktimin e tij të mirë apo të keq.

Poashtu imani ka shenjat e tij, i ka shtatëdhjetë e disa degë, më e larta është dëshmia se nuk meriton të adhurohet askush pos Allahut dhe më e ulëta është të larguarit e një pengese nga rruga, edhe turpi është një prej dëgëve të imanit.

Allahu i Madhëruar i thërret besimtarët në shumë ajete Kuranore, i urdhëron dhe i ndalon ata, ngase besimi i shtyn ata të veprojnë urdhërat dhe të largohen nga ndalesat, ngase ai i cili shpreh me gjuhën e tij se është besimtarë, mirëpo nuk vepron atë që ka urdhëruar Allahu, e as që largohet nga ajo që ka ndaluar Ai, ai është gënjeshtar në pretendimin e tij dhe thirrjen si besimtarë.

Allahu thotë: **“Ka disa njerëz që thonë: “Ne i kemi besuar All-llahut dhe jetës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë All-llahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë.”** (Bekare, 8-9)

Besimi është nxitës i veprave të mira dhe virtyteve të larta, Allahu thotë: **“E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të të cilëve kur përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre. Dhe, të cilët falin (rregullisht) namazin dhe nga ajo, me çka Ne i furnizuar, ata japin.”** (Enfal, 2-3)

Besimi i përmirëson veprat dhe i bën ato të jenë të pranuar tek Allahu i Madhëruar, Allahu thotë: **“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”** (Nahl,97)

Dhe e kundërta, nuk pranohet me pabesim asnjë vepër sado që të jenë ato vepra të shumta. Allahu thotë: **“E Ne i kthehemi ndonjë vepre që e bënë ata dhe e bëjmë atë hi e pluhur.”** (Furkan, 23)

Besimtarët janë ata të cilët gjykojnë gjatë hasmërive dhe kundërshtimeve me Librin e Allahut dhe sunetin e të dërguarit : **“Kur thirren besimtarët për gjykim ndërmjet tyre te All-llahu dhe te i dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre është të thonë: “Dëgjuam dhe respektojmë!” Të tillët janë ata të shpëtuarit.”** (Nur, 51)

Ndërsa jobesimtarët dhe munafikët refuzojnë gjykimin e Allahut dhe të dërguarit, refuzojnë të gjykohen me to dhe dëshirojnë të gjykohen tek djajt dhe kanunet njerëzore, Allahu i Madhëruar thotë: **“Ata (hipokritët) thonë: “Ne i kemi besuar All-llahut, të dërguarit të Tij, dhe u jemi bindur. Por pas asaj, një grup prej tyre zbrapsën. Të tillët nuk janë besimtarë. E kur thirren që ndërmjet tyre të gjykojë All-llahu dhe i dërguari i Tij, një grup prej tyre nuk i përgjigjen asaj.”** (Nur, 47-48)

Poashtu Allahu thotë për ta: **“i vure re ata që mendojnë se besuan atë që të zbriti ty, dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë që mes tyre të gjykojë djalli, e duke qenë se janë të urdhëruar që të mos e besojnë atë. E djalli dëshiron t’i humbë në pafundësi. Kur u thuhet atyre: “Ejani (për të gjykuar) te ajo që e zbriti All-llahu dhe te i dërguari!” i sheh se si dyfytirëshit ta kthejnë shpinën.”** (Nisa, 60-61)

O robër të Allahut, në kohën tonë kemi njerëz që dëshirojnë besim vetëm për emër, dëshiron besim pa vepra, besim pa namaz e as zekat, as agjërime e as haxh, bile dëshiron iman pa teuhid e as akide, dëshiron besim me adhurimin e varreve, pllakave të evlijave dhe njerëzve të mirë. Dëshiron iman me gjykimin e kanuneve dhe djajve në zgjedhjen e hasmërive dhe kundërshtimeve, ndërsa për të realizuar besimin e drejtë duhet mohuar besimin në djallin. Allahu thotë: **“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson All-llahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues i dijshtëm.”** (Bekare, 256)

Poashtu për të qenë adhurimi i pranuar duhet që të mos i besohet djallit, Allahu thotë: **“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhuroni vetëm All-llahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre)!”** (Nahl,

36) Poashtu thotë: **“Adhurojeni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send”** (Nisa, 36)

Robër të Allahut, disa gjynahe nuk e shkatërrojnë imanin mirëpo e mangësojnë dhe e dobësojnë atë, duhet që besimtari të largohet nga gjitha mëkatet për të ruajtur besimin e tij, të mos tradhton në marrëdhëniet, as të pëlçet gjatë mosmarëveshjes, nuk gënjen gjatë të folurit, nuk e then premtimin, nuk tradhton në amanet, nuk e then afatin, nuk përgojon dhe nuk mirret me bartjen e fjalëve, largohet nga përfitimi i ndaluar, nuk mirret me kamatë, nuk merr ryshfet dhe nuk keqpërdorë pasurinë e jetimit, ngrit veten nga gjërat e nënçmuara, nuk fyen e as nuk shan, ngase besimtari nuk është akuzues, as mallkues, as sharës as që fol pistë, por e dëshiron për vëllaun e tij besimtarë atë që dëshironë për vete, sillet mirë me kundërshtarin duke vepruar me fjalën e Allahut: **“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj”** (Huxhurat, 10)

Ndjenë dhimbje kur vëllezërit e tij besimtarë kanë dhimbje, vepruar sipas hadithit të të dërguarit sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“Shembulli i besimtarëve në dashurinë dhe mëshirën e ndërsjellë, është sikur shembulli i një trupi, nëse një vetëm një organ i tij ankohet, atëherë i gjithë trupi pason pagjumësi dhe dhimbje”**.

Poashtu prej virtyeteve të besimtarëve është falënderimi në gjendje të rehatshme dhe durimi në gjendje të vështirë, i dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“E quditshme është gjendja e besimtarit, e gjithë çështja e tij është mirësi, e kjo nuk është për askend tjetër pos besimtarin, nëse e godet një gjë që e gëzon falënderon (Allahun) dhe kjo është mirësi për te, dhe nëse e godet një gjë e keqe bën durim dhe kjo është mrësi për te”**.

O ju besimtarë sikurse gjynahet mangësojnë dhe dobësojnë besimin poashtu edhe adhurimet shtojnë dhe përforcojnë imanin. Allahu thotë: **“E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të të cilëve kur përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre.”** (Enfal, 2) Poashtu thotë: **“Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë për ta shtuar ata bindjen në besimin e vet që kishin. Ushtritë e qiejve e të tokës janë vetëm të All-llahut, e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe shumë preciz.”** (Fet’h, 4)

Pra imani shtohet me leximin e Kuranit, me kryerjen e adhurimeve, ndejat me të mirët dhe shtohet me përmendjen e Allahut. Allahu thotë: **“Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen.”** (Rad, 28)

Kujdesuni o robër të Allahut për atë që e përforcon besimin e juaj dhe ngritë shkallët e jauja. Kërkoj mbrojtje nga Allahu prej shejtanit të mallkuar: **“Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t’i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose**

perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, pejgamberëve dhe pasurinë që e do ua jep të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim të robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të singertit dhe të tillët janë ata të devotshmit.” (Bekare, 177)

10 - DISA NGA CILËSITË E BESIMTARËVE NË KURAN.

O ju njerëz frikojuni Allahut dhe meditonit rreth asaj që e përmendi Allahu nga cilësitë e besimtarëve në Kuran me qëllim që të merrni mësim dhe shembuj nga to. Allahu në Kuran cilësitë e besimtarëve i ceki në shumë ajete e ndër to janë edhe ato cilësi që i ceki në fillim të sures Muminun: **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlur në namazin e tyre, të cilët shmangen nga fjalët e kota, të cilët japin zeqatin, të cilët e ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme), përveçse me gratë e tyre ose me skllavet që kanë në zotërim – dhe, për këtë, nuk janë fajtorë, ndërsa ata që kërkojnë përtej kësaj, pikërisht ata janë shkelës (të kufijve), – të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra dhe të cilët i kryejnë rregullisht faljet. Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët, që do ta trashëgojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht”.** (Muminun 1-11)

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, rëndësinë e këtyre ajeteve e qartësoi në një hadith të cilin e përcjell imam Ahmedi, RahimehUllah, i cili thotë se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Mua më zbritën dhjetë ajete dhe kush punon me to hyn në xhenet”**, e pastaj i lexoi ajetet e para të sures Muminun.

Gjithashtu imam Nesai, RahimehUllah, e përcjell një hadith nga Aisha, radijAllahu anha, e cila kur u pyet për moralin e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, tha se morali i tij ishte Kurani dhe i lexoi ajetet: **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët”** e deri te **“dhe të cilët i kryejnë rregullisht faljet”**. (Muminun 1-9), dhe tha: **“Kështu ka qenë morali i të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem”**.

Aisha, radijAllahu anha, dëshiroi të na njofton se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, vepronte me këto ajete dhe u përshkruante me këto cilësi të cilat i përmbajnë këto ajete nga cilësitë e mira.

Allahu i Madhëruar na bëri me dije se besimtarët që pajisen me këto cilësi, ata janë fitimtarët, të lumturit dhe të shpëtuarit, kurse ata që nuk pajisen me këto

cilësi janë të humburit ashtu siç tha edhe vet i Madhëruari. **“Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer, pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera”**. (Tin 4-6) Dhe poashtu tha: **“Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin”**. (Asr 1-3)

Allahu i Madhëruar në këto ajete na tregoi se çdo njeri është në humbje përveç atij që përshkruhet me besim dhe me vepër të mirë dhe thirr në të mirë dhe ndalon nga e keqja dhe bën durim në atë që sprovohet.

Thënia e Allahut: **“të cilët janë të përulur në namazin e tyre”**. (Muminun 2), na bën me dije rëndësinë e faljes së namazit dhe pozitën e tij në Islam dhe se është një prej cilësive të besimtarëve për arsye se namazi është shtyllë e fesë dhe shkak që të mbron nga e shëmtuara dhe të largon nga e liga dhe ta lehtëson veprimin e punëve të mira ashtu siç thotë edhe Allahu: **“Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz”**. (Bekare 45)

Përkujdesja për namazin duhet të jetë primare për muslimanin për arsye se gjëja e parë që do të japë llogari robi Ditën e Kiametit do të jetë namazi. Të përulur në namaz do të thotë që zemra jote të jetë prezente në namaz e nënshtruar para Allahut dhe gjymtyrët e tua të jenë të qeta, pa lëvizje të panevojshme.

Përlulja në namaz është shpirti i tij dhe ajo që kërkohet në të dhe robi nuk merr nga namazi i tij vetëm se aq sa ka qenë prezentë shpirti i tij. Preokupimi i zemrës në namaz me gjëra të kota që nuk kanë lidhje me namazin dhe bërja e lëvizjeve të tepërta të panevojshme është sjellje dhe moral i keq me Allahun. Kthimi i fytyrës në të majtë apo në të djathtë është largim i fytyrës nga Allahu dhe mashtrim i shejtanit i cili tenton që t'i vjedh robit nga namazi i tij dhe kjo është argument i shkujdesjes së zemrës së tij nga namazi.

Thënia e Allahut: **“të cilët shmangen nga fjalët e kota”**. (Muminun 3), e ka për qëllim largimin nga çdo e kotë dhe këtu përfshihet edhe shirku dhe të gjitha llojet e mëkateve dhe poashtu e përfshin atë që nuk ka dobi prej saj nga thëniet dhe veprat.

Prej cilësive të besimtarëve është se ata i shmangen të gjitha llojeve të kotës dhe janë të preokupuar vetëm se me të vërtetën dhe të dobishmen për ta. Ata nuk i dëgjojnë përgojimet dhe bartjet e fjalëve, muzikën dhe instrumentet muzikore, nuk shikojnë në të kotën që u prezantohet nëpërmjet filmave dhe serialeve të ndryshme, nuk ulen nëpër mexhlise e dëfrimit ku në flitet e kota dhe veprohen mëkate e gjynahe dhe nuk i përgjigjen ftesave të atyre që e shpërndajnë të kotën nëpër tokë.

Thënia e Allahut: **“të cilët japin zeqatin”**. (Muminun 4), e ka për qëllim ata që e pastrojnë veten duke vepruar vepra të mira (**fjala zeqatë në aspekt gjuhësor do të thotë pastrim dhe shtim**) dhe duke iu larguar ndalesave dhe duke e dhënë zeqatin e pasurisë së tyre.

Thënia e Allahut: **“të cilët e ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme), përveçse me gratë e tyre ose me skllavet që kanë në zotërim – dhe, për këtë, nuk janë fajtorë, ndërsa ata që kërkojnë përtej kësaj, pikërisht ata janë shkelës (të kufijve)”**. (Muminun 5-7), e ka për qëllim ata që e ruajnë nderin e tyre duke mos rënë në imoralitet dhe homoseksualizëm dhe poashtu iu larguan çdo mjeti i cili të çon deri në shthurje morale.

Për këtë ata iu larguan shikimit të ndaluar, e stolisën veten me petkun e devotshmërisë dhe i larguan gratë nga përzjerja me burra të huaj dhe nga udhëtimi pa mahrem dhe u larguan nga shikimet e filmave të degjeneruar dhe pamjeve të ndaluara. Pastaj Allahu i Madhëruar e qartësoi se atij që nuk i mjafton ajo që ia lejoi Allahu nga kënaqësitë me gratë e veta dhe i tejkalon kufijtë duke i bërë mëkat Allahut, ai do të jetë meritör i ndëshkimit dhe dënimit të Allahut.

Thënia e Allahut: **“të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra”**. (Muminun 8), e ka për qëllim ata që i marrin amanetet duke filluar nga detyrimet fetare, të drejtat në pasuri, fshehtësive, pastaj mjeteve dhe sendeve të ndryshme, janë të detyruar që amanetin ta dërgojnë deri në vend dhe të përkujdesen për të ashtu siç e meriton ai amanet të përkujdeset.

Poashtu punëtorët dhe udhëheqësit janë të detyruar që amanetet e tyre që i kanë marrë tua japin hakun dhe mos t'i bëjnë padrejtësi njerëzve dhe tua kthejnë amanetet atyre që u përkasin: **“Allahu ju urdhëron që amanetet t'juja ktheni atyre që u përkasin”**. (Nisa 58)

Marrja e amanetit do të thotë përkujdesja për të dhe të kthyerit e tij deri tek pronari në gjendje të mirë ashtu edhe siç e ke marrë për arsye se kjo është besëlidhje dhe besëlidhja duhet që të respektohet dhe mos të thyhet: **“Zbatoni besëlidhjen e Allahut, kur ta merrni mbi vete”**. (Nahl 91)

Thënia e Allahut: **“dhe të cilët i kryejnë rregullisht faljet”**. (Muminun 10), na qartëson vlerën dhe rëndësinë e namazit për arsye se Allahu fillon në fillim të sures me cekjen e faljes së namazit dhe i përfundon këto ajete me përmendjen e namazit dhe nxitjes që ai të falet rregullisht.

Përkujdesja për namaz do të thotë falja e tij në kohë duke marrë abdes si duhet dhe duke i plotësuar kushtet, shtyllat, detyrimet dhe duke e falur në kohët e veta dhe në vendet ku ka urdhëruar Allahu që të falet e ato janë xhamitë edhe atë së bashku me xhemat. Kush len diçka nga këto dispozita pa asnjë arsye

fetare nuk bën pjesë në ata që përkujdesen për namazin, madje ai konsiderohet nga ata që e neglizhojnë atë dhe për të cilët Allahu thotë: **“Pas atyre erdhën brezni, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epshet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh”**. (Merjem 59) Dhe poashtu nga ata që Allahu për ta thotë: **“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet”**. (Maunë 4-5)

Allahu i Madhëruar në fund të këtyre ajeteve e cek shpërblimin e atyre që pajisen me këto cilësi të cekura në ajete dhe thotë: **“Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët, që do ta trashëgojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht”**. (Muminun 11)

Përcillet se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kështu, kur të kërkonit prej Allahut (ndonjë gjë), kërkonit Firdeusin, i cili është pjesa e më e mirë dhe më e lartë e Xhenetit Përmbi të (Firdeusin) është Arshi i të Gjithëmëshirshmit (Allahut) dhe prej andej vërshojnë lumenjtë e Xhenetit”**.

Pastaj Allahu i Madhëruar e mbaron ajetin ku e cek se qëndrimi i tyre në Firdeus do të jetë i përjetshëm dhe nuk do të kenë nevojë për frikë se kjo do tu humb apo do të kalojë tek të tjerët dhe se ata do të nxirren nga ai.

E lus Allahun që me mëshirën dhe begatinë e Tij të na bën prej banorëve të Firdeusit.

11 - BESIMI I VËRTËTË DHE SHENJAT E TIJ.

O ju njerëz keni frikë Allahun, dhe bëhuni prej besimtarëve të sinqertë, të cilëve veprat e tyre ua vërtetojnë thëniet, se besimi nuk është shpresë e zbukurim, por është ajo që është ngulitur në zemër dhe e vërtetojnë veprat.

Allahu thotë: **“O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni? Tek Allahu është shumë e urrejtur ta thoni atë që nuk e punoni”**. (Saf 2-3)

Besim i vërtetë është: bindje me zemër, shprehje me gojë dhe të vepruarit me gjymtyrë, shtohet me vepra të mira dhe pakohet me mëkate. Ai i ka gjashtë shtylla, ato janë: Besimi në Allahun, melaqet, librat, të dërguarit, Ditën e Kiametit dhe në caktimin e tij të mirë po të keq. Ai i ka shtatëdhjetë e disa degë, më e larta është fjala La ilahe il Allah **(Nuk ka të adhuruar tjetër (me meritë) pos Allahut)**, e më e ulëta është largimi i një pengese nga rruga, edhe turpi është prej degëve të besimit. Pra ai që me fjalë thotë që është besimtarë, dhe dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është

i dërguari i Allahut, i bën veprat e mira me gjymtyrë, falet, e jep zeqatin, agjëron, e bën haxhin, e adhurime tjera, mirëpo nuk është i bindur me zemër dhe nuk beson me të vërtetë, ky person është dyfytyrësh, prej dyfytyrësisë së madhe që të nxjerr nga feja dhe është më e dëmshme se sa kufri i qartë. Allahu thotë: **“Ka disa njerëz që thonë: “Ne i kemi besuar Allahut dhe jetës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë Allahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë. Në zemrat e tyre kanë sëmurje, e Allahu u shton sëmundje edhe më shumë, e për shkak se ata përgënjeshtrojnë, pësojnë dënim të dhembshëm”.** (Bekare 8-10)

Tek ky, zbulohet realiteti i tij dhe del në shesh dyfytyrësia kur të sprovohet dhe gjatë ballafaqimit me vështirësi, Allahu thotë: **“Ka disa njerëz që thonë: “Ne i kemi besuar Allahut, e kur goditet me ndonjë të keqe për shkak të (rrugës së) Allahut, ai sprovimin prej njerëzve e trajton si dënimin e Allahut”.** (Ankebut 10)

Ky person nuk është i qëndrueshëm, por lëvizë, qëndron me besimtarët nëse ata kanë një lehtësim nga Allahu, dhe qëndron me jobesimtarët kur ata janë në ndikim, dhe mbizotërim të përkohshëm për shkak të ngecjeve që gjenden tek muslimanët, Allahu i madhëruar thotë: **“Ata janë që presin se ç’po ju ngjanë juve. Nëse me ndihmën e Allahut ngadhënjeni, ata thonë: “A nuk ishim me ju?” E nëse jobesimtarëve u takon ndonjë fitim, ata thonë: “A nuk mbizotëruam ne mbi ju (por nuk deshtëm të mposhtim) dhe penguan prej jush besimtarët!”.** (Nisa 141)

E kur të thirret që të gjykohet me Librin e Allahut dhe sunetin e të dërguarit ai nuk përgjigjet, pos nëse çështja është në dobi të tij, sikur që thotë Allahu: **“E kur thirren që ndërmjet tyre të gjykojë Allahu dhe i dërguari i Tij, një grup prej tyre nuk i përgjigjen asaj. Po nëse është që e drejta u takon atyre (në atë gjykim), ata i shkojnë atij të bindur e me respekt”.**

Robër të Allahut, ai i cili beson me zemër dhe e shpreh atë me fjalë, mirëpo nuk e vërteton besimin e tij dhe shprehjen me fjalë, nëse fjala e tij e kundërshton veprën atëherë kjo e prishë dhe kundërshton dëshminë se s’ka Zot tjetër dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij, sikur ai që lutet të vdekurve, ther për të vdekurit, personi i tillë është politeist, mohues i Allahut, nuk i bën dobi shprehja e tij e dëshmisë e as përkatësia e tij në islam, nuk pranohet prej tij asnjë adhurim derisa të pendohet tek Allahu, e të adhuron sinqerisht Allahun.

Allahu thotë: **“Ne ta shpallëm ty librin për hir të së vërtetës, andaj ti adhuroje Allahun duke qenë i sinqertë në adhurimin e Tij! Vini re! Adhurim i sinqertë është vetëm ai për Allahun! Ndërsa ata që në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë (duke thënë): Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër Allahut, s’ka dyshim se Allahu do të gjykojë mes tyre për atë që ata ishin në kundërshtim. E, është e vërtetë**

se Allahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë atë që është rrenës, jobesimtar”.
(Zumer 2)

Po ashtu edhe ai i cili deklaron se është mysliman, dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut, mirëpo nuk i realizon kushtet e fesë, as që falet, as që jep zeqat, as nuk agjëron, nuk e kryen haxhin, ky njeri nuk është mysliman, as që i bën dobi shprehja e dy dëshmimeve, e as përkatësia e tij islame, sepse nuk e ka realizuar atë që kërkohet prej dy dëshmimeve, dhe nuk i ka vepruar farzet e islamit.

Namazi është shtyllë e fesë në të cilën mbahet feja, kur mungon shtylla nuk mund të qëndron islami i vërtetë, zeqati është shoqërues i namazit në Librin e Allahut, shokët e të dërguarit sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem kanë luftuar nën udhëheqjen e Ebu Bekrit ata që ndaluan dhënien e zeqatit, e i konsideroi të dalë nga feja, e luftërat me ata janë quajtur luftëra kundër renegatëve, ndërsa ata thonin La ilahe il Allah Muhameden resulullah.

Ndërsa ai që le diç prej adhurimeve tjera të cilat janë plotësuese të islamit, apo ka bërë mëkat prej mëkateve të cilat janë ndër shirkun dhe nuk janë prej gjërave që prishin fenë, ky person nuk llogaritet jobesimtarë, por llogaritet besimtarë me besim të mangët, e kjo mangësi lëviz varësisht prej mëkatit të cilin e ka vepruar, nëse është mëkat prej mëkateve të mëdha, sikur amoraliteti, vjedhja, vrasja e njeriut, pirja e alkoolit etj, prej mëkateve të mëdha, dhe ai është i njohur për ndalesën e tyre dhe nuk i bën hallall, ky njeri konsiderohet mëkatarë (**fasik**), bie prej tij besnikëria, është i kërcënuar me dënim të Zotit, merret sanksioni i obliguar për të, ky është qëndrimi i ithtarëve të sunetit dhe xhematit. Është besimtarë në besimin e tij, e fasik me mëkatin e tij, e nëse mëkati nuk arrin në gradën e mëkatit të madh, atëherë ai e mangëson besimin e ka gjynah për atë, mirëpo nuk llogaritet fasik, pos nëse vazhdon në të, apo e bën atë haptas, ngase të vazhduarit në mëkat të vogël mund ta shndërron atë në mëkat të madh.

Sikur që besimi mund të tretet apo të mangësohet, varësisht prej të keqes dhe gjërave të shëmtuara, ai po ashtu edhe ritet, shtohet me adhurim, sikur që thotë Allahu: **“E Allahu u shton besimin atyre që u udhëzuan”.** (Merjem 76)

“E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të të cilëve kur përmendet Allahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre”. (Enfal 2)

“E kur zbret ndonjë kaptinë, ka prej tyre që thonë: “Cilit prej jush ia shtoi kjo besimin?” Sa u përket atyre që besuan, atyre u shtohet besimi dhe gëzohen për të”. (Teube 124)

Andaj kujdesuni për gjëra që ju shtojnë besimin, dhe lënien e mëkateve e të këqijave që ua mangësojnë imanin.

Allahu thotë: **“Beduinët thanë: “Ne kemi besuar!” Thuaj: “Ju nuk keni besuar ende, por thuani: Ne jemi dorëzuar, e ende nuk po u hyn besimi në zemrat tuaja. E nëse e respektoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, Ai nuk ju pakëson asgjë nga veprat tuaja, se Allahu është shumë mëkatfalës, shumë mëshirues”. Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut, të dërguarit e Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hir të Allahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Të tillë janë ata të vërtetit”.** (Huxhurat 14-15)

12 - ZBUKURIMI I LEJUAR DHE AI I NDALUAR.

Allahun e falënderoj prej Tij falje dhe ndihmë kërkoj. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë përveç se Allahut dhe se Muhamedi, biri i Abdullahit dhe robi i Allahut, është rob dhe i dërguari i Tij, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të mbi familjen e tij dhe mbi të gjithë ata që i përcjellin me të mira deri Ditën e Kiametit.

Zbukurimi në kufijtë e të lejuarës është çështje e kërkuar për arsye se Allahu është i bukur dhe e do bukurinë. Zbukurimi bëhet në përmisimin e trupit me marrjen e asaj që duhet të merret dhe me lënien e asaj që duhet të lihet.

Ajo çka duhet të merret nga trupi e qartësoi i Dërguari i Allahut, sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem, me një hadith të cilin na e përcjell Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu: **“Pesë sende janë nga natyra e fitres (natyrshmërisë së pastër): Pastrimi i vendeve të turpshme (mënjanimi i qimeve), bërja synet (rrethprerja), shkurtimi i mustaqeve, mënjanimi i qimeve nga nënsqetullat, shkurtimi i thonjve“.**

Këto pesë gjëra janë nga traditat e vjetra të cilat i zgjodhën të Dërguarit dhe në të u pajtuan të gjitha legjislacionet, për arsye se me lënien e këtyre gjërave shëmtohet dhe deformohet trupi dhe i përngjan kafshëve dhe jobesimtarëve dhe është shkak për mbledhjen e fëlliqësirave dhe prezencën e erës së keqe. Me pastrim të vendeve të turpshme nënkuptojmë mënjanimin e qimeve nga pjesët intime të trupit dhe është e lejuar të përdoret çfarëdo forme vetëm që të arrihet qëllimi dhe mos të jetë e dëmshme për trupin, prandaj lejohet shkulpja, prerja rruajtja ose ndonjë formë tjetër.

Me bërjen synet është për qëllim prerja e lafshës që mbulon organin e mashkullit për arsye se mbetja e saj bën që të mblidhen papastërti përreth organit dhe me atë të shkaktohen sëmundje të ndryshme. Me shkurtim të mustaqeve është për qëllim shkurtimi i tyre e jo rruajtja e tyre. Me shkulpje të qimeve të sqetullave është për qëllim mënjanimi i qimeve nga sqetullat dhe

lejohet shkëlqja, rruajtja apo prerja e tyre. Me prerjen e thonjve është për qëllim prerja apo shkurtimi i tyre.

Ajo që ligjësohet të mbetet është mjekra ashtu siç ka ardhur në librat e imam Buharit dhe Muslimit, RahimehUllah, se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Prisni (shkurtoni) mustaqet tuaja dhe lëshoni (rrisni) mjekrat tuaja, ndryshoni nga idhujtarët”**. Me një transmetim tjetër: **“Shkurtoni mustaqet tuaja dhe lëshoni mjekrat tuaja, ndryshoni nga zjarrputistët”**, dhe me një transmetim tjetër: **“Kundërshtoni jobesimtarët, shkurtoni mustaqet dhe lëshoni mjekrat”**.

Të gjitha transmetimit aludojnë se lëshimi i mjekrës është detyrim kurse rruajtja e saj haram, ashtu siç është shkurtimi i mustaqeve detyrim dhe zgjatja e tyre haram, mirëpo shejtani ua zbukuroi shumicës së njerëzve imitim in e jobesimtarëve në këtë vepër dhe kundërshtimin e traditës së të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe filluan t'i rruajnë mjekrat e tyre dhe t'i zgjasin mustaqet e tyre. Poashtu një grup njerëzish e kundërshtojnë traditën e të Dërguarit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, sa i përket ngjyrosjes së mjekrës dhe qimeve të bardha në të.

Prej Synefit është që mjekra mos të ngjyrosset me ngjyrë të zezë po të ngjyrosset me ngjyra tjera dhe ngjyrosja me ngjyrë të zezë është e ndaluar dhe është një lloj mashtrimi për arsye se dëshiron të paraqitesh më i ri në moshë në sytë e të tjerëve.

Disa grave shejtani ua zbukuron rruajtjen e vetullave kurse këtë e ka ndaluar rreptësisht i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe e ka mallkuar atë që e vepron dhe atë që ia vepron ndokujt tjetër ashtu siç ceket edhe në një hadith se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i ka mallkuar të gjithë ato femra që i shkulin vetullat dhe ato që kërkojnë me ua shkëlq të tjerët vetullat. Ato pretendojnë se me shkëlqjen e vetullave zbukurohen a në fakt kjo është ndryshim i krijesës së Allahut dhe kjo është një nga veprat që urdhëron shejtani për t'i vepruar ashtu siç e cekë edhe Allahu në Kuran: **“e pastaj do t'i urdhëroj që të ndryshojnë krijesën e Allahut”**. (Nisa 119) Poashtu shejtani ua zbukuroi disa grave dhe disa të rinjve zgjatjen e thonjve, vepër e cila bie në kundërshtim me traditën e pastër të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ku tradita e tij ka qenë shkurtimi i thonjve.

Të gjitha këto vepra që i veprojnë duke filluar nga rruajtja e mjekrës, zgjatja e mustaqeve, rritja e thonjve, shkëlqja e vetullave, ngjyrosja e mjekrës me ngjyrë të zezë, ata mendojnë se janë nga zbukurimi a në fakt ajo është shëmtim dhe deformim i pamjes së birit të Ademit dhe kundërshtim me natyrshmërinë, mirëpo shejtani ua zbukuroi këto vepra dhe ua bërë t'iu duket sikurse janë të mira ashtu siç tha Allahu në Kuran: **“A është ai, që veprat e veta të këqija i duken të mira (si ai që është i udhëzuar në rrugën e drejtë)?”**. (Fatir 8)

Nga zbukurimi që e ka ligjësuar Allahu dhe i Dërguari i Ti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, është zbukurimi në rroba dhe veshje. Allahu i Madhëruar thotë: **“O bijtë e Ademit, Ne ju dërguam rroba që të mbuloni vendet e turpshme, si edhe për zbukurim; por, petku i devotshmërisë është më i miri. Këto janë disa shenja të Allahut, që ju të merrni këshillë”**. (Earaf 26) Allahu në këtë ajet na bëri me dije se robërve të Tij u dërgoi rroba që të mbulojnë vendet e turpshme si dhe për ta zbukuruar pamjen e jashtme të tyre dhe ua rikujtoi se petku i devotshmërisë i cili ia zbukuron robit pamjen e jashtme dhe të brendshme është petku më i mirë dhe tha. **“por, petku i devotshmërisë është më i miri”**. (Earaf 26) Allahu i Madhëruar në një ajet tjetër tha: **“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni!”**. (Earaf 31), dhe na bëri me dije se besimtarët janë të urdhëruar që t'i veshin rrobat më të bukura dhe më të mira kur të dalin para Allahut në namaz.

Burrave u ndalohet veshja e mëndafshit dhe arit. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, me një hadith thotë: **“Ari dhe mëndafshi janë lejuar për gratë (femrat) e Ummetit tim dhe janë ndaluar për burrat”**. Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu, përcjell se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, një ditë shikon në dorën e njërit prej shokëve të tij një unazë floriri, pasi ia heq nga dora dhe ia hedh në tokë thotë: **“Njëri nga ju ka vendosur në gishtin e tij një rreth prej zjarri dhe ka ardhur këtu në mesin tonë”**. Pasi që shkoi i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i thanë njeriut që ta merr unazën dhe përfiton diçka tjetër nga ai, mirëpo ai u përgjigj: **“Jo pasha Allahun, nuk e marr më kurrë pasi që e gjuajti i Dërguari i Allahut”**.

Sot shumë nga burrat i pasojnë verbërisht traditat e popullit dhe rrethit ku jetojnë dhe në duart e tyre mbajnë unaza nga ari edhe pse i lexojnë apo i dëgjojnë argumentet se ajo në duart e tyre është zjarr i xhehenemit, mirëpo shejtani ua zbukuron këtë vepër të ligë ashtu siç ua zbukuron edhe shumë grave veshjen e rrobave të shkurta apo të ngushta ose të tejdukshme të cilat nuk e mbulojnë trupin dhe i paraqesin pjesët e trupit të tyre. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, me një hadith thotë: **“Ka dy lloje të banorëve të Zjarrit që ende nuk i kam parë: njerëz me kamxhik si bishti i lopës, me të cilin i rrahin njerëzit dhe gratë që janë të veshura, mirëpo të zhveshura, të cilat ecin me një ecje tërheqëse (joshëse, provokuese) dhe me diçka në kokat e tyre që duken si gungat e devesë, të anuara në një anë. Ata nuk do të hyjnë në Parajsë (Xhenet) dhe as që do ta nuhatin aromën e saj, edhe pse aroma e saj mund të nuhatet prej sa e sa larg”**.

Ibën Tejmije, RahimehUllah, rreth kuptimit të fjalës **“të veshura, mirëpo të zhveshura”**, thotë se qëllimi është për ato gra që veshin rroba që ia përshkruan lëkurën ose i paraqet disa pjesë të trupit të saj, ato janë të veshura me rroba mirëpo në realitet të zhveshura. Kjo i shëmbëllen plot nga grave të sotit bashkëkohore të cilat veshin rroba të tejdukshme, të ngushta, të shkurta dhe i paraqesin bukuritë dhe trupat e tyre para burrave të huaj, Allahu na ruajt.

O ju burra, frikojuni Allahut për gratë e juaja për arsye se ju jeni kryefamiljar dhe përgjegjës për to dhe do të llogariteni para Allahut. Dhe o ju gra, frikojuni Allahut se edhe ju do të llogariteni para Allahut.

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve dhe qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit

O ju njerëz, pastrimi dhe zbukurimi i trupit dhe i rrobave janë nga çështjet e kërkuara dhe të preferuara me Islam dhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e përshkroi rrugën e kërkuar në to me fjalë dhe me vepra. Allahu i Madhëruar tha: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekuallueshëm”**. (Ahzab 21) Neve nuk na lejohet që ta përshkruajmë për vetveten apo të importojnë nga jobesimtarët traditat dhe adetet të cilat e kundërshtojnë udhëzimin e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ashtu siç edhe veprojnë shumë nga ata që i përngjasojnë jobesimtarët në traditat, adhurimet dhe adetet e tyre.

Nga udhëzimi i të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ishte që t'i shkurton mustaqet dhe ta lëshon mjekrën dhe Enesi, radijAll-llahu anhu, përcjell dhe thotë se: **“Na ka kufizuar Resulullahu, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në shkurtimin e mustaqeve, në rruajtjen e qimeve nga pjesët intime, në shkuljen e qimeve nga sqetullat dhe në prerjen e thonjve që të mos i lëmë ato më shumë se dyzet ditë”**.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e pëlqente misvakun dhe e përdorte atë edhe kur ishte agjërueshëm, edhe kur merrte abdes, edhe para namazi, edhe kur hynte në shtëpi. I donte shumë parfumet dhe miskun dhe i përdoret shumë ato dhe ndaloi ngrënien e ushqimeve që japin erë të keqe si hudhrën, qepën, etj, para se të shkon muslimani në xhami.

E ligjësoi pastrimin e trupit ditën e Xhuma me qëllim të largimit të erës së keqe nga djersët dhe gjërave tjera, dhe zakonisht ai, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe shokët e tij i vishnin rrobat që thureshin nga pambuku, e ndoshta edhe nga leshi dhe liri. Udhëzimi i tij në veshje ka qenë që të vesh atë që kishte mundësi ta vesh nga rrobat e pambukut nganjëherë, e nga leshi dhe liri herëve tjera. Ibën Kajimi, RahimehUllah, thotë. **“Ata që ia ndalojnë vetvetes atë që ua ka lejuar Allahu nga veshjet, pijet dhe gratë me qëllim asketizmi dhe adhurimi, dhe poashtu në anën e kundërt ata që nuk veshin vetëm se rroba të mira dhe të shtrenjta dhe nuk hanë vetëm se ushqimet më të mira dhe i braktisin rrobat dhe ushqimet e dobëta nga mendjemadhësia dhe kryelartësia, këto dy grupe e kundërshtojnë udhëzimin e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem”**.

Për këtë arsye disa nga selefi thonin se i urrenin rrobat e famës qofshin ato të shtrenjta apo të lira. Përcillet me një hadith se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kush e vesh një rrobë fame në dynja, Allahu do t’ia vesh ditën e Gjykimit një rrobë poshtërimi dhe do të ja kall zjarrin asaj”**. Ky dënim vjen për arsye se veshja e tyre ka qenë për famë dhe mendjemadhësi dhe kryelartësi, si dhe veshja e rrobave të lira nëse vishet me qëllim fame pronari i saj do të dënohet, kurse nëse vishet me qëllim modestie atëherë kjo është e lavdërueshme. E njëjta vlen edhe për rrobat e shtrenjta, nëse ajo vishet me qëllim zbukurimi dhe paraqitjes së begatisë së Allahut atëherë bëhet e lavdërueshme. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, me një hadith të cilin e përcjell ibën Mesudi, radijAll-llahu anhu, thotë: **“S’do të hyjë në Xhenet ai që ka në zemrën e tij mendjemadhësi sa një thermi (apo sa pesha e një milingone)”**. Një burrë reagoi: **“Vërtet që burri ka dëshirë ta ketë veshjen dhe mbathjet e mira”**. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, tha: **“Vërtet, Allahu është i bukur dhe e do bukurinë. Mendjemadhësi është të refuzosh të vërtetën dhe të përçmosh njerëzit”**.

O ju robër të Allahut, shejtani luajti me të bijtë e Ademit sa i takon çështjes së veshjes dhe i bëri të bien në kundërshtime me parimet fetare duke ia bërë një grupit të dashur zhveshjen në emër të qytetërimit dhe përparimit ashtu siç ua zbukuroi mushrikëve tavafin në Qabe duke qenë lakuriq dhe se ajo është adhurim që do të shpërblehen për të dhe se Allahu i urdhëroi që ashtu të veprojnë ashtu siç tha edhe Allahu në Kuran: **“Kur ata bëjnë një vepër të shëmtuar, thonë: “Ne i kemi gjetur prindërit tanë që i bënin, por edhe Allahu na ka urdhëruar kështu”. Thuaj: “Allahu nuk urdhëron të bëhen vepra të pahijshme! Përse thoni për Allahun atë që nuk e dini?”**. (Earaf 28)

Allahu ua ktheu atyre duke ua bërë me dije se zbulimi i vendeve të turpshme është imoralitet të cilën Allahu e urren.

Një grupit tjetër shejtani ua zbukuroi zbulimin e aurretit gjatë lojërave sportive duke e konsideruar këtë si art dhe filluan t’i zbulojnë këmbët dhe vendet e turpshme të tyre.

O ju musliman, frikojuni Allahut dhe kapuni për litarin e Islamit i cili nuk këputet kurrë dhe mos i imitoni jobesimtarët në traditat dhe adetet e tyre për arsye se ato e kundërshtojnë fenë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem.

13 - NXITJE PËR VEPRA TË MIRA.

O ju njerëz keni frikë Allahun dhe dijeni se veprat janë arritja e njeriut me të cilat del nga kjo botë, dhe në ato varet udhëtimi i tij në ahiret, i dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Të vdekurin e përcjellin tre gjëra: Familja e tij, pasuria dhe veprat e tija. Dy prej tyre kthehen dhe mbetet një, kthehet familja dhe pasuria e mbeten veprat”**. (Mutefekun alejhi).

Vepra është shoqëruesi i njeriut në varr, kënaqet nëse vepra ka qenë e mirë dhe ndëshkohet nëse vepra ka qenë e keqe, është cekur në hadith se vepra e mirë i vjen njeriut në varr në formë të njeriut me fytyrë të bukur, me tesha të mira dhe me erë të këndshme e i thotë: **“Përgëzohu”**, i vdekuri i thotë: Kush je ti, fytyra jote është fytyrë e bukur që vjen me hair, e i thotë: Unë jam vepra jote. Ndërsa vepra e keqe i vjen njeriut në formë të njeriut me fytyrë të shëmtuar, me tesha të këqija dhe erë të keqe, e i thotë: Të përgëzoj me diç që do të vjen keq. Kjo është dita që të është premtuar, e i thotë: Kush je ti? Fytyra jote e keqe vjen me të keqe, e i thotë unë jam vepra jote e keqe, ishte i ngadalshëm në respektimin e Allahut e i shpejtë në mëkat ndaj Tij, e Allahu të shpërblen me ndëshkim.

Vepra e mirë është ajo që e shpreson njeriu kur është në agoni të vdekjes, Allahu thotë: **“E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e ta kompensoj atë që lëshova!”**

Kjo është ajo që do ta dëshirojnë banorët e zjarrit kur do të hidhen në te. Allahu thotë: **“O Zoti ynë, nxirrna e të bëjmë vepra të mira, e jo si ato që i bënim”**. (Fatir 37)

Ne nëse meditojmë në Kuranin Fisnik do të gjejmë se Allahu i Lartëmadhëruar na drejton kah veprat në shumë prej ajeteve, ndonjëherë e lidh shpërblimin për vepra si në fjalën e Tij: **“dhe nuk shpërbleheni me tjetër vetëm për atë që vepruat”**. (Jasin 54)

E ndonjëherë Allahu na tregon se Ai i mbikëqyr veprat tona, **“Unë jam i dijshtëm për atë që ju veproni”**

E ndonjëherë na tregon se ka autorizuar për ne melaqe që regjistrojnë veprat tona, Allahu thotë: **“Kurse ndaj jush kanë përcjellësit! Janë shkruar të ndershëm te All-llahu. Ata e dinë se çka punoni”**. (Infitar 10-12)

Ndonjëherë na tregon se veprat do të na tregohen ditën e Kiametit, do ti shohim e do ti lexojmë, Allahu thotë: **“Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre. E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.”** (Zelzele 6-8)

E nga njëherë na tregon se njeriu punon për veten e jo për dikë tjetër: **“Kush bën mirë, ai e ka për vete, e kush bën keq, ai vepron kundër vetes, e Zoti yt nuk bën padrejtë ndaj robërve”**. (Fusilet 46)

Vëllezër të nderuar

Njeriu nuk ka para vetes shans tjetër për të vepruar pos jetës në këtë botë, sot ka punë e nuk ka llogari e nesër do të ketë llogari e nuk do të ketë mundësi për të vepruar, se jeta e njeriut është e shkurtër, nuk e di fundin e tij, nuk e din në çfarë kohe do të vjen, e nëse vjen nuk vonohet për tjetër herë: **“e kur t’u vijë afati tyre, ai nuk mund të shtyhet për asnjë moment, e as të përngutet më parë”**. (Araf 34)

Këto ditë të cilat po i jeton o njeri në këtë botë, është shans për ty që nuk vlerësohet me çmim, që po ta din vlerën e saj do ta ruaje vetëm për gjëra që të bëjnë dobi e që do të sjellin ty lumturi të përhershme, e nëse e humb në lojë e shkujdesje do të sjell dënim të përhershëm, atyre që ruajtën këtë botë me vepra të mira u thuhet ditën e Kiametit: **“Hani e pini shijshëm, ngase në ditët e kaluara ju e përgatitët këtë”**. (Haka 24)

E për ata që kanë humb kohën e tyre me lojë e dëfrim, në gjëra të kota u thuhet: **“Ju i shfrytëzuat të mirat në jetën e Dunjasë dhe i përjetuat ato, sot, për shkak se keni bërë mendjemadhësi në tokë pa të drejtë dhe për shkak se nuk respektuat urdhrat e Zotit, do të shpërbleheni me dënim nënçmues”**. (Ahkaf 20)

Vëllezër të nderuar

Pengesat në veprimin e të mirave janë të shumta që duhet njeriu të mundohet dhe të lodhet, sepse nefsi i njeriut është që anon kah të këqijat. Ai ndihmohet nga shejtani dhe ushtria e tij, prej epsheve dhe dyshimeve.

Ai që kërkon mbrojtje nga Allahu dhe drejtohet në punë të mirë Allahu atë e ndihmon që të mos e mundin këto pengesa, humben e zhduken para atij. E kush i nënshtrohet epshit dhe është dembel për të bërë punë të mira, ato e mundin dhe i humb atij shansi nga dora e vet, duke mbaruar jeta e tij e ardhja e vdekjes. I dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“I mençur është ai i cili e ulë veten dhe punon për pas vdekjes, e i paaftë është ai që vetja e tij e pason epshin dhe shpreson shumë te Allahu”**.

Pastaj ka mundime dhe pengesa në veprimin e punëve të mita që duhet njeriu të fillon që herët para se të arrijnë tek ai, si sëmundja, varfëria, pleqëria, vdekja. I dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Shpejtoni në vepra të mira, ngase do të shihni sprova si nata e errtë, në mëngjes zgjohet si besimtarë e zë mbrëmja si jobesimtarë, në mbrëmje është besimtarë e në**

mëngjes jobesimtarë, e shet fenë për interes të kësaj bote”. (E Transmeton Muslimi)

Pra keni frikë o robër të Allahut shpejtoni në vepra të mira para se të vijë vdekja. Allahu thotë: **“O ju që besuat, as pasuria juaj e as fëmijët tuaj të mos u shmangin prej adhurimit të All-llahut”.** (Munafikun 9)

14 - KUJDESI NGA SHOQËRIMI ME TË KËQIJTË.

Falënderimi i takon Allahut, i Cili urdhëroi të shoqërojmë të mirët dhe ndaloi nga shoqërimi i të këqijve, Allahu thotë: **“Përkufizoje veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote”.** (Kehf 28) Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër **(me të drejtë)** pos Allahut Një, i Cili nuk ka të barabartë, që u sqaroi robërve të Tij rrugët e mirësisë që të ecin në to dhe u sqaroi rrugët e këqija që të largohen prej tyre. Dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, i cili porositi në zgjedhjen e shoqëruesit të mirë dhe tërhoqi vërejtjen nga shoqëruesi i keq, paqja dhe bekimi i Allahu qoftë mbi të, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe ata që ecën rrugës së tij, u kapën për sunetin e tij deri në Ditën e Kiametit.

O ju robër të Allahut

Keni frikë Allahun dhe dijeni se njeriu në këtë botë nuk mund të jetojë vetmas, i izoluar prej njerëzve, ngase është i nevojshëm që të përzihet me ta e të shoqërohet. Kjo përzierje patjetër se ka gjurmët e saja qofshin të mira apo të këqija, varësisht prej llojit të atyre me të cilët ulet e shoqërohet. Prej këtu janë bashkuar tekstet e Kuranit dhe sunetit të cilat porosisin në zgjedhjen e shoqëruesit të mirë dhe largimit nga shoqëruesi i keq. Allahu thotë: **“Kur sheh ata se janë thelluar (me tallje) në çështjet Tona, largohu prej tyre derisa të kalojnë në bisedë tjetër. Nëse djalli të bën të harrosh (e rri me ta), pasi të bie ndër mend, mos rri me popullin mizor.”** (En’am 68)

I Dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Shembulli i shokut të mirë dhe shokut të keq, si shitësi i parfumit dhe farkëtarit, Sa i përket shitësit të miskut, ai ose do të, të japë diç nga misku ose së paku do të dalësh nga ai me aromë të mirë. Ndërsa farkëtari ose do t'i djegë rrobat tuaja, ose së paku do të dalësh nga ai duke ndier një erë te neveritshme”.** (Mutefekun alejhi)

Vendose këtë hadith çdo herë në mendjen tënde kur ti shoqërohesh me njerëzit në tregje e në tubime, në shtëpitë apo në shkolla, në zyre dhe në çdo vend ku

njerëzit përzihen, zgjedh të mirët prej njerëzve që të jenë shokë, dashamirës, partnerë, të sjellshëm e këshilltarë, ky hadith madhështor tregon se shoku i mirë në të gjitha rastet për të është i mirë, i bereqetshëm, i dobishëm dhe përfitues, sikur shitësi i parfumit nga i cili përfiton ose duke dhuruar, shitë, apo së paku në kohë të ndejës me të do të jesh i kënaqur, me gjoks të hapur nga era e parfumit, shoku i mirë të urdhëron për bamirësi, të ndalon nga e keqja, të flet me dituri të dobishme, me fjalë të sinqerta dhe urtësi të madhe, ti tregon të metat e tua dhe të tërheq nga gjëra që nuk kanë të bëjnë me ty, që mundon veten duke të mësuar, që të shpjegon ty, të përmirëson e korigjon, kur je shkujdesur të përkujton, kur je mospërfillës apo lodhesh mas të këqijave, të tërheq vërejtjen, të mbron nderin tënd në prezencë dhe mos prezencën tënde.

Ata janë njerëz me të cilët nuk është fatkeq shoqëruesi, mbi ta zbret mëshira e merr pjesë në të, së paku çka mund të kesh dobi prej shokut të mirë është dobia që nuk është e panjohur, e ajo është se të ndal nga të këqijat e mëkatet, e garon në punë të mira, dobitë e shokut janë shumë që nuk numërohen, mjafton që njeriu të ketë parasysh shokun e tij, se ai është në fenë e shokut të vet.

Nga shoqërimi me të mirët përfitojnë edhe kafshët, siç ka ndodhur me qenin i cili ka qenë me banorët e shpellës, e kaploi edhe atë bereqeti, edhe atë e goditi gjumi ashtu siç i goditi ata në atë gjendje të çuditshme, e u bë të përmendet.

Ndërsa shoqërimi me të këqijtë është helm vdekjeprurës, vuajtje e fundosur. Ata i japin guxim dhe nxisin në veprimin e mëkateve dhe gjërave të shëmtuara dhe ua hapin dyert e të këqijave atyre që ulen dhe shoqërohen me ta, ia lirojnë atij rrugët e mëkateve, pra nga shoku i keq, nëse nuk merr pjesë me të në të vepruar ke marrë një pjesë të tij për pajtimin me atë që ka vepruar, apo heshtje për dëmin e bërë.

Sikur farkëtari mbi qymyrin e nxehur e ti je ulu afër tij, të djeg trupin, teshën dhe të mbush me erë të keqe. Në ndejat me të tillët bie në përgojim, bartje fjalësh, gënjeshtër, fyerje, fjalë shfrenimi, në dëfrim e lojë, në dëshirë të mëkatarëve për tu fundosur në gjëra të kota, shoqërimi me ta është e dëmshme nga të gjitha aspektet. Sa popuj janë shkatërruar për shkak të tyre, sa i kanë drejtuar shokët kah shkatërrimi duke qenë të ditur apo duke mos ditur?

Ja tani dy raste me përfundim të keq që kanë ndodhur për shkak të shoqërimin të këqijve.

Rasti i parë: Është përmendur se Ukbeh ibn Ebi Muait ulej me të Dërguarin sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem në Meke dhe nuk e dëmtonte e fyente, ndërsa Kurejshitët kur uleshin me të e dëmtonin, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. E Ibn Ebi Muiti kishte një shok të tij jobesimtar në Sham, e Kurejshitët menduan se ky ka pranuar Islamin, kur shkoi në Sham ai cili kishte kuptuar

për sjelljen e tij me të Dërguarin, iu hidhërua shumë dhe refuzoi ti flet deri sa ta fyen të Dërguarin sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e ky e realizoi atë që kërkoi shoku i tij jobesimtar, e fundi i tij ishte se u vra si jobesimtarë në betejën e Bedrit, Allahu zbriti fjalën e tij për këtë rast: **“Atë ditë zullumqari do t'i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: “I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit!” O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik. Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej asaj, e djalli është ai që njeriun e humb dhe e lë të vetmuar”**. (Furkan 27-29) Ky ajet është gjithëpërfshirës për ata që shoqërojnë zullumqarët, që e devijojnë nga rruga e Allahut, ai do të pendohet Ditën e Kiametit për shoqërimin me ta dhe refuzimin e rrugës së udhëzimit me të cilën ka ardhur i dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem.

Rasti i dytë: E transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Seid ibn Musejjib e ky nga babai i tij të ketë thënë: “Kur i erdh vdekja Ebu Talibit, erdhi i dërguari i Allahut sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e aty ishte Abdullah ibn Ebi Umeje dhe Ebu Xhehli. E i tha atij: O mixha im, thuaj La ilahe il Allah, fjalë me të cilën do të argumentojë për ty tek Allahu. Ata dy thanë: A po e braktisë fenë e AdbulMusalibit, i dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ia përsëriti, e fjalën e fundit e tha: Jam në fenë e AbdulMusalibit dhe refuzoi të thotë: La ilahe il Allah, e i dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem tha: Do të kërkoj falje për ty deri sa të ndalohem, e Allahu i zbriti: **“Nuk është e drejtë për Pejgamberin e as për besimtarët të kërkojnë falje për idhujtarët, edhe nëse janë të afërt të tyre, pasi që ta kenë të qartë se me të vërtetë ata (idhujtarët) janë banues të xhehennemit”**. (Teube 113)

Dhe zbriti ajetin për Ebu Talibin **“Eshtë e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu udhëzon kë të dojë dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit”**. (Kasas 56)

Pra ky rast është kërcënim i madh nga shoqërimi me të këqijtë, në Ditën e Kiametit shoku shokut të këtij lloji do ti thotë: **“Ah, të kishim qenë larg mes vete sa Lindja me Perëndimin; sa shok i keq je ti”**. (Zuhruf 38)

Pra keni kujdes o ju robër të Allahut veten tuaj dhe shoqërohuni me bamirësit, të devotshmit, përzihuni me njerëzit e mirë dhe të përqendruar, largohuni dhe largoni fëmijët tuaj nga shoqërimi me të këqijtë, të shfrenuarit, posaçërisht në këtë kohë ku janë të pakët bamirësit dhe përplasen valët e fitneve. Rreziku është i madh, i përkushtuari për fenë është i huaj në mesin e njerëzve, dhe ka ndodhur ajo që i dërguari sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem ka lajmëruar me fjalën e tij: **“Islami ka filluar si i huaj, do të kthehet i huaj ashtu siç ka filluar, xheneti qoftë për të huajt, i thanë e kush janë të huajt o i dërguari i Allahu. Tha: “Ata të cilët bëjnë mirë kur njerëzit prishin”** në një transmetim tjetër, **“përmirësojë atë që njerëzit tjerë prishin”**.

Kërkoj mbrojtje nga djalli i mallkuar: **“Nuk presin tjetër ato (grupe) përveç katastrofës, t’u vijë befaz duke mos e hetuar fare. Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit, përveç atyre që ishin të singhtë në miqësi. (Atyre besimtarëve, që ishin shoqëruar për hir të Zotit, u thuhet): “O adhuruesit e Mi, sot nuk ka as frikë për ju, e as që do të jeni të pikëlluar!” (Robërit e Mi) të cilët besuan argumentet Tona dhe ishin muslimanë. Hyni në xhennet, ju dhe gratë tuaja, të gëzuar! Atyre u shërbejnë me enë e gastare nga ari, aty do të kenë çka t’u dëshirojë shpirti dhe t’u kënaqet syri. Ju do të jeni aty përgjithmonë. E ky është xhenneti që u është dhënë për atë që keni punuar. Aty keni shumë pemë prej të cilave do të hani”.** (Zuhruf 66-73)

15 - RREZIKU I PADREJTËSISË.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon vetëm Allahut që ia ndaloi Vetes bërjen e padrejtësisë dhe po ashtu e bëri të ndaluar në mesin e robërve të Tij. Falënderimi i takon vetëm Allahut që iu kërcënua zullumqarëve me mallkim dhe me dënim të dhembshëm në dynja dhe ahiret.

Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë vetëm se Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, që është Një dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. I cili na parandaloi nga veprimi i padrejtësisë dhe na lajmëroi se mes duasë së të dëmtuarit dhe Allahut nuk ka pengesw. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju vëllezër besimtarë,

Frikohuni Allahut dhe largohuni padrejtësisë. Çdo ditë dëgjoni për përfundimet e zullumqarëve dhe shikoni me sytë e juaj se çfarë ndëshkime u dërgon Allahu atyre dhe familjeve të tyre duke ua shkatërruar pasuritë, shtëpitë dhe duke ua zhdukur gjurmët sikur se të mos kishin qenë prezentë asnjëherë më herët. Këto pamje le të mbeten mësim për ju, i lumtur është ai i cili merr mësim prej të tjerëve.

Padrejtësia ndahet në tre lloje:

Lloji i parë: Padrejtësia mes robit dhe Zotit të tij, e ajo është shirku. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe”.** (Llukman 13) Këtë lloj padrejtësie Allahu e falë vetëm se me

pendim të sinqertë. Në rast se robi vdes pa u penduar prej këtij mëkati Allahu nuk do t'ia falë asnjëherë në ahiret. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij”**. (Nisa 48), dhe **“Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhenetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës”**. (Maide 72)

Lloji i dytë: Padrejtësia që ia bën njeriu vetvetes me veprimin e mëkateve duke e përjashtuar këtu shirkun.

Në këtë rast njeriu është vet shkaktar për fitimin e zemërimit dhe dënimit të Allahut ndaj tij. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato”**. (Tehrim 6) Ky lloj i padrejtësisë është nën vullnetin e Allahut, nwse të donë ia falë robit të Tij e nëse donë e dënon. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë”**. (Nisa 48)

Lloji i tretë: Padrejtësia mes njerëzve, duke ia cenuar njëri tjetrit shenjtërinë e gjakut, nderit dhe pasurisë. Ky lloj i padrejtësisë nuk falet, përveç se kur donë ta falë ai që i është bërë padrejtësi. Në rast se i dëmtuari nuk dëshiron që t'ia fal dëmbërësit, atëherë i jepet mundësia të kërkon që dëmbërësi të dënohet në dynja dhe ahiret.

Imam Muslimi, RahimehUllah, në librin e tij e shënon një hadith prej Ebu Hurejrës, radijAll-llahu anhu, se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Do të hakmerreni Ditën e Kiametit mes veti (dëmbërësi do t'i kthejë padrejtësitë me dhurimin e të mirave tek i dëmtuari dhe do t'i marrë të këqijat), derisa edhe kafshët do të hakmerren mes veti, delja pa brirë do të hakmerret ndaj deles me brirë”**.

Imam Buhariu dhe Muslimi, RahimehUllah, në librat e tyre e shënojnë një hadith tjetër prej Ebu Hurejrës, radijAll-llahu anhu, se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kush i ka bërë një padrejtësi vëllait të vet në nderin e tij a diku tjetër, le t'i kërkojë falje atij për sot, para asaj kur nuk do të ketë dinarë e as dërhëmë: por nëse nuk do të ketë vepra të mira, atëherë do t'i merren mëkatet e të dëmtuarit dhe do t'i jepen atij (që ka bërë zullum)”**.

Imam Muslimi, RahimehUllah, po ashtu e shënon një hadith tjetër prej Ebu Hurejrës, radijAll-llahu anhu, se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“A e dini kush është i falimentuar (mufli)?”** I thanë: **“I falimentuar te ne është ai i cili nuk ka as para, as mall”**. Tha: **“I falimentuar i umetit tim është ai që vjen në Ditën e Gjykimit me namaz,**

me zekat, me agjërim dhe vjen me mëkatin e sharjes së një personi, me shpifje të një tjetri, me ngrënien e pasurisë së një tjetri, me gjakderdhjen e një personi, me rrahjen e një tjetri, kur t'u jepen atyre prej veprave të mira të këtij dhe nëse harxhohen mirësitë e tij para se t'u paguhen borxhet, atëherë do të merren prej mëkateve të tyre dhe do t'i ngarkohen këtij, pastaj ky do të hidhet në zjarr”.

O ju musliman, nuk lejohet marrja e pasurisë së muslimanit përveç se me lejen dhe me dëshirën e plotë të tij. Shenjtëria e pasurisë së muslimanit është e barabartë me shenjtërinë e gjakut dhe nderit të tij, prandaj nuk të lejohet marrja e pasurisë dhe banimi në shtëpinë e tij pa lejen dhe dëshirën e tij. Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Kush bën zullum (dhunë, padrejtësi) sa një pëllëmbë tokë, do të jetë i ngarkuar me shtatë (do ta bartë në qafë në Ditën e gjykimit)”.**

Disa prej njerëzve mendojnë se gjykimi i sunduesit apo gjyqtarit në favor të tij kundër vëllait të vet musliman ia jep të drejtën që t'ia merr pasurinë apo t'ia largon vetes përgjegjësinë e marrjes së asaj pasurie.

Kjo është gabim. Gjyqtari është njeri i cili mund të gabon dhe t'ia qëllon, por ti në rast se e din se nuk je merituar për atë pasuri detyrohesh që të largohesh prej saj. Ky është i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i cili u thoshte njerëzve: **“Vërtet unë jam njeri, ju në konfliktet tuaja më drejtoheni mua. Është e mundshme që ndonjëri prej jush është më i aftë që t'i shtrojë argumentet e veta dhe unë të gjykoj në dobi të tij, sipas asaj që kam dëgjuar. Andaj kujt t'ia shqiptoj të drejtën e vëllait të tij, vërtet ia kam shkëputur një pjesë të zjarrit (të Xhehenemit)”.**

Ky hadith është prej argumenteve më të qarta se gjykimi i gjykatësit nuk e bën të ndaluarën hallall dhe nuk mundet të jetë arsye për zullumqarin që nëpërmjet këtij gjykimi ta arsyeton marrjen e pasurisë së huaj. Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Kush e padit tjetrin në të kotë dhe e dinë atë, do të jetë Allahu i zemëruar me të derisa ta largon atë padit”.**

Zullumqari i cili fshihet pas kësaj **“perdeje”** po t'ia kishte marrë ndokush pasurinë e tij me të njëjtin pretekst do t'i vinte shumë keq, do të ndjente në vete dhembje, do të kërkonte prej gjyqtarit që përsëri ta rishikon çështjen e tij dhe do ta rriste zërin twrw ditën e natën kundër atij që i ka bërë padrejtësi.

Prandaj, o ju robër të Allahut frikojuni Allahut dhe frikojuni padrejtësisë dhe të gjitha llojeve të saj dhe dijeni se padrejtësia Ditën e Kiametit do të shumëfishohet: **“Sigurisht, të padrejtët do ta shohin se në çfarë mundimi do të kthehen (pas vdekjes)”.** (Shuara 227) Përfundimi i zullumqarëve është i keq, dënimi i tyre në ahiret është me zjarr të xhehenemit dhe Allahu u kërcënohet me mallkim dhe me dënim të dhembshëm. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Mallkimi i Allahut qoftë mbi të padrejtët”.** (Hud 18) dhe **“Ne**

kemi përgatitur për mohuesit keqbërës një zjarr, që do t'i rrethojë nga të gjitha anët (si çadra). Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t'u jepet një ujë si xehja e shkrirë, që do t'ua përcëllojë fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo e sa strehim i keq është ai (zjarri)!” (Kehf 29)

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve dhe qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ti njeri i padrejtë e dëmbërës, mos mendo se Allahu nuk do të hakmerret dhe nuk do të ndëshkon për ato padrejtësi e dëme që ua ke bërë njerëzve, të cilët nuk gdhihen në mëngjes vetëm se të zemëruar prej teje dhe nuk flenë natën vetëm se duke bërë dua kundër teje. Dije se dua ja e të dëmtuarit ngrihet mbi qiej dhe mes saj dhe mes Allahut nuk ka hixhab: **“Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad, banorë të Iremi me pallate shumëshyllëshe, të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?! Dhe me fisin Themud, që gdhendi shkëmbinjtë në luginë (për të bërë shtëpi)? Dhe me Faraonin, njeriun e hunjve (ku torturonte njerëzit)? Të gjithë këta shkelën çdo kufi në vendet e tyre, duke shtuar atje shturjen dhe korrupsionin, prandaj Zoti yt lëshoi mbi ata kamxhikun e dënimit. Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!”**. (Fexhër 6-14)

Mjerë për ata që bëjnë padrejtësi ata janë të humbur në dynja, ndërsa në ahiret i pret dënim i dhembshëm. Do të kërkojnë ndihmë që t'ju lehtësohen vuajtjet, mirëpo nuk do t'ju përgjigjet askush. Për ta nuk do të ketë pushim, nuk do të ketë rehati, nuk do të ketë ndihmës dhe mëshirë, për ta do të ketë vetëm se dënim dhe dënim. Do të pendohen prej veprave të tyre dhe do t'ju rrjedhin lot si lumenj kur do t'ju kujtohen padrejtësitë dhe dëmet që ua bënë njerëzve, mirëpo ky pendim do të jetë i shumë vonuar.

O ju musliman,

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Mos mendo kurrsesi që Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen (nga tmerret që do të shohin), dhe, duke vrapuar me kokë lart, nuk do të mund t'i lëvizin sytë, ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrazëta (nga tmerri). Ti (o Muhamed) paralajmëroji njerëzit për Ditën që atyre do t'u vijë dënimi e keqbërësit do të thonë: “O Zoti ynë, na lër edhe për pak kohë! Ne do t'i përgjigjemi thirrjes Tënde dhe do t'i pasojmë të dërguarit!” Por atyre do t'u thuhet: “Vallë, a nuk betoheshit më parë se s'do të kishte zhdukje për ju? Ju banuat në vendbanimet e atyre që e kishin ngarkuar veten me gjynahe dhe e kishit të qartë se si kishim vepruar me ta. Dhe Ne ju kishim treguar shumë shembuj.” Ata kurdisin dredhitë e tyre, por Allahu i di dredhitë e tyre.**

Edhe sikur prej dredhive të tyre të shembeshin malet, ata nuk do t'ia dalin mbanë. As mos mendo se Allahu nuk do t'ua mbajë premtimin e Vet të dërguarve. Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Zoti për shpagim. Ditën, kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt, të gjithë do të dalin para të Vetmit dhe Ngadhënjësit Allah. Dhe atë ditë do t'i shohësh keqbërësit të lidhur në pranga; rrobat do t'i kenë prej katrani e zjarri do t'ua mbështjellë fytyrat, (Kështu do të jetë) në mënyrë që Allahu të shpërblejë cilindo për atë që ka punuar. Allahu është vërtet i shpejtë në llogari. Ky (Kuran) është shpallje e qartë për njerëzit, me qëllim që ata të marrin paralajmërim nëpërmjet tij, që ta dinë se Allahu është Një Zot i Vetëm dhe që të këshillohen njerëzit e mençur!” (Ibrahim 42-52)

16 - RREZIKU I PËRNGJASIMIT ME JOBESIMTARËT.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu s'ka kush e devijon dhe kë e largon nga rruga e vërtet Ai s'ka kush e udhëzon.

Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë vetëm se Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, që është Një dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju musliman, frikojuni Allahut dhe krenohuni me Fenë e juaj.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, i pasuroi dhe i begatoi muslimanët me zbritjen e një legjislacioni të plotë e gjithëpërfshirës, edhe atë të vlefshëm për çdo kohë dhe çdo vend dhe për çdo interes, fetar dhe jetësor, dhe arritjen e lumturisë së kësaj dynjaje dhe ahireti e bëri të varur për kapjen e këtij legjislacioni dhe punën me ligjet e tij. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Kush do ta pasojë udhëzimin Tim, as nuk do të humbë, as nuk do të bjerë në mjerim”.**(Taha 123), dhe **“Kur t'ju vijë udhërrëfimi Ynë, ata që do t'i përmbahen atij, nuk do të kenë frikë dhe nuk do të dëshpërohen”.**(Bekare 38) Ky shariat (**legjislacion**) është rruga e drejtë e atyre që u begatuan prej Pejgamberëve, të sinqertëve, dëshmorëve dhe njerëzve të mirë, dhe çdo gjë që e kundërshton këtë rrugë është rruga e atyre që u mallkuan (**çifutët**) dhe që e devijuan rrugën e drejtë (**krishterët**).

O ti musliman, në çdo rekat prej namazit tënd kur e lexon suren Fatiha, e cila është shtyllë prej shtyllave të namazit, i lutesh Zotit tënd që të udhëzon në rrugë të drejtë dhe të largon prej rrugës së të mallkuarve dhe të devijuarve. Meditoje këtë lutje, qëllimet e saj dhe frytet e saj. Do të vëresh se gjëja e parë në çka thërret kjo lutje është ndjekja e rrugës së Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe kapja për ligjet e tij në adhurime, në marrëdhënie mes njerëzve, në etikë dhe në moral të përgjithshëm dhe të veçantë.

Poashtu, do të vëresh se kjo lutje thërret në kundërshtimin e jobesimtarëve në adhurime, në marrëdhënie mes njerëzve, në etikë e në moral, për arsye se përngjasimi me ta në pamje të jashtme trashëgon dashuri ndaj tyre në brendësi. Për këtë arsye kanë ardhur shumë citate prej Kuranit dhe prej Sunetit që urdhërojnë në kundërshtimin e përngjasimit me jobesimtarët, duke e larguar muslimanin prej asaj çka nuk i bën dobi, për shkak se veprat e jobesimtarëve janë të gjitha të kota, rruga e tyre është e devijuar dhe përfundimi i tyre është shkatërrimi.

Në të gjitha veprat e jobesimtarit dhe çështjet e tij patjetër ka ndonjë të metë e cila e pengon atë që nëpërmjet tyre të i plotësohet ndonjë dobi. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Vepra e atyre, që nuk besojnë Zotin e tyre, i shëmbëllen hirit, të cilin e shpërndan era në një ditë të stuhishme. Ata nuk do të kenë asnjë dobi nga veprat që kanë punuar. Kjo është humbja e madhe”**. (Ibrahim 18), dhe **“Sa për ata që nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë e të cilin i etshmi e kujton për ujë, por, kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë”**. (Nur 39) Edhe pse Allahu na paralajmëroi prej rrugëve të cilat na çojnë drejt përngjasimit të jobesimtarëve prapë se prapë e vërejmë se disa prej muslimanëve i pasojnë ata verbërisht edhe me atë vërtetohet fjala e Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i cili thotë: **“Do të pasoni rrugën e atyre që ishin para jush, pëllëmbë për pëllëmbë, hap pas hap pas gjersa edhe nëse hynë në birucën e hardhucës do t'i pasoni”**. I thamë: **“O i Dërguari i Allahut të krishterët dhe jehudët?”**. **“Tha e kush pos tyre?”**.

Në një transmetim tjetër thotë: **“Nuk do të bëhet Kiameti gjersa Umeti im të pasoj rrugët e atyre që kanë qenë para nesh pëllëmbë pas pëllëmbë, hap pas hap pas”**. I thamë: **“A janë persianët dhe romakët?”** Tha: **“E kush tjetër përveç tyre”**.

Pra, Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, na lajmëroi se prej Umetit të tij do të ketë njerëz të cilët do t'i pasojnë çifutët, krishterët dhe mushrikët dhe për këtë arsye e ndaloi përngjasimin me ta. Shkuarja e disave prej muslimanëve pas hapave të jobesimtarëve nuk do të thotë se i tillë është krejt Umeti, për shkak se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Do të vazhdon një grup prej Umetit tim në të vërtetën deri në Ditën e Kiametit dhe ata janë xhemati”**.

Dhe poashtu na lajmëroi se: **“Allahu nuk e bashkon Umetin tim në humbje”**. Me këtë na bën me dije se patjetër në këtë Umet do të ketë njerëz të cilët do të jenë të kapur për udhëzimin e tij, i cili është feja Islame e pastër, dhe se do të ketë prej atyre të cilët do ta lajthitin rrugën dhe do të shkojnë pas hapave të çifutëve dhe krishterëve dhe se kjo është devijim të cilin ia zbukuron njeriut shejtani.

Urtësia e ndalesës së përngjasimit të jobesimtarëve dhe urdhërimi i kundërshtimit të tyre është e qartë, për arsye se përngjasimi me ta në pamje të jashtme e trashëgon përngjasimin me ta në të brendshmen, e cila pastaj çon deri në pajtueshmëri me ta në besim, moral dhe vepra. Kurse kundërshtimi i tyre në pamje të jashtme e bën të detyrueshme kundërshtimin e tyre në të brendshmen.

Në ditët e sotme është rritur numri i muslimanëve të cilët i pasojnë jobesimtarët në veshjen e tyre, në të folurit e tyre, në pamjen e tyre, edhe atë burra dhe gra. Prej veprave që aludojnë në përngjasimin e jobesimtarëve është rruajtja e mjekrës dhe zgjatja e mustaqeve dhe zgjatja e flokëve ashtu siç i zgjasin jobesimtarët. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, urdhëroi në zgjatjen e mjekrës dhe shkurtimin e mustaqeve dhe urdhëroi në përkujdesjen e tyre, dhe urdhëroi në kundërshtimin e jobesimtarëve ku prej traditës së tyre ishte zgjatja e mustaqeve dhe rruajtja e mjekrave.

Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në disa hadithe thotë: **“Prisni (shkurtoni) mustaqet tuaja dhe lëshoni (rrisni) mjekrat tuaja, ndryshoni nga idhujtarët”**. (Buhariu nr. 5892 dhe Muslimi nr. 259)

“Shkurtoni mustaqet tuaja dhe lëshoni mjekrat tuaja, ndryshoni nga zjarrputistët”. (Muslimi nr. 260)

“Kundërshtoni jobesimtarët, shkurtoni mustaqet dhe lëshoni mjekrat”. (Buhariu, Muslimi).

Pra shkurtimi i mustaqeve dhe zgjatja e mjekrës është prej cilësive të natyrës së pastër dhe udhëzimit të Pejgamberëve, dhe është kundërshtim i armiqve të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Për fat të keq injoranca dhe pasimi i verbër e bëjnë që e keqja të zbukurohet dhe e mira të shëmtohet.

Shumë prej muslimanëve sot i shkurtojnë mjekrat dhe zgjatjen e saj e konsiderojnë prapambeturi dhe të shëmtuar, dhe harrojnë se posedimi dhe zgjatja e saj është prej cilësive të burrave dhe pjesë e bukurisë së tyre. Muslimanët janë të urdhëruar ta pasojnë të Dërguarin e tyre dhe mos t'i pasojnë ata që e kundërshtojnë traditën e tij, për arsye se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, është një shëmbëlltyrë e mrekullueshme për tërë njerëzimin: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shëmbull të mrekullueshëm**

për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun”. (Ahzab 21)

Prej çështjeve tjera që aludojnë në përngjasimin e jobesimtarëve është të folurit dhe të mësuarit e gjuhëve të tyre pa nevojë. Shumë muslimanë sot i mësojnë gjuhët e jobesimtarëve dhe me atë së bashku i mësojnë edhe traditat dhe moralin e tyre dhe në shumicën e rasteve gjuha bie shkaktar që një musliman të shkon pas hapave të tyre.

Vërejmë se nuk i kushtohet rëndësi të veçantë mësimi të gjuhës arabe e cila është gjuha e Kuranit dhe e Sunetit dhe nëpërmjet të cilës muslimani e mëson fenë e tij. Mësohet gjuha angleze, gjermane, spanjolle, etj, për interesa të dynjasë, mirëpo kur vjen në pyetje gjuha arabe, gjuha e Kuranit, atëherë konsiderohet si gjuhë e prapambetur, gjuhë e shkretinës. Allahu na mbrojt prej devijimit pas udhëzimit.

Prej çështjeve tjera të cilat aludojnë në përngjasimin e jobesimtarëve është imitimi i tyre në çështjet e adhurimeve, si imitimi i tyre në ndërtimin dhe meremetimin e varrezave, zbukurimi i tyre dhe vizatimi i pikturave të ndryshme. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Allahu i ka mallkuar çifutët dhe të krishterët; (sepse ata) kanë shndërruar varrezat e pejgamberëve të tyre në xhami”**.

Në një hadith tjetër thotë: **“Ata janë njerëz, që kur të vdes robi i mirë apo burri i mirë në mesin e tyre, ndërtojnë mbi varrin e tij faltore dhe pikturojnë pikturat e tilla. Ata janë krijesat me të dëmshme të Allahut”**.

Kjo është një prej shkaqeve e cila i çoi disa prej muslimanëve në veprimin e shirkut dhe të mëkateve të mëdha.

Prej imitimit të tyre në adhurime e kemi edhe imitimin e festave të tyre politeiste, si festa e ditëlindjeve të kryetarëve dhe mbretërve, të cilën festë e imituan disa prej muslimanëve dhe filluan ta festojnë ditëlindjen e Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, edhe pse ditëlindja e tij nuk dihet saktë. Këto festa politeiste emërtohen edhe si dita e dashurisë, dita e nënës, dita e drurit, dita e pastërtisë, etj, dhe të gjitha kanë depërtuar tek muslimanët prej anës së jobesimtarëve.

Në Islam ekzistojnë vetëm se dy festa: Fitër Bajrami dhe Kurban Bajrami. Festa tjera nuk pranohen dhe konsiderohen si risi në Fe, prandaj muslimani duhet të jetë i kujdesshëm që të mos bie kurban i atyre që vetes i thonë musliman dhe i festojnë festat e jobesimtarëve. Këta njerëz janë injorantë të mëdhenj dhe nuk e njohin realitetin e Islamit, mirëpo nëse e njohin realitetin e Islamit dhe dispozitat e tij rreth festave dhe këtë e veprojnë me qëllim atëherë kjo është një musibet edhe më i madh.

O ju musliman,

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“As hebrenjtë, as të krishterët nuk do të jenë të kënaqur me ty, derisa të pranosh besimin e tyre. Thuaju: “Vetëm udhërrëfimi i Allahut është i drejtë!”**. (Bekare 120)

17 - MENDJEMADHËSIA DHE DËMI I SAJ.

Mendjemadhësia është sëmundje e zemrës, dhe cilësi e ligë dhe e qortuar fortë. Sot plot nga njerëzit përshkruhen me këtë cilësi, nga e cila na paralajmëroi fortë Allahu dhe i Dërguari i Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Disa nga të parët tanë thanë: Gjynahu i parë i cili ju bë Allahut ka qenë nga mendjemadhësia. Allahu tha: **“Kur u thamë engjëjve: “Përluni në sexhde para Ademit”, ata u përlën, përveç Iblisit, i cili nuk deshi, u tregua mendjemadh”**. (Bekare 34).

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e qartësoi kuptimin e mendjemadhësisë me një hadith, të cilin na e përcjelli Ibën Mesudi, radijAllahu anhu, ku thotë: **“Nuk do të hyjë në xhenet ai, që në zemrën e tij ka një grimcë mendjemadhësie”**. Një burrë tha: Dikush dëshiron, që rrobat dhe sandalet t'i ketë të bukura? I Dërguari i Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, tha: **“Allahu është i bukur dhe e do të bukurën. Mendjemadhësia është refuzimi i të vërtetës dhe sjellja me arrogancë ndaj njerëzve”**.

Refuzimi i të vërtetës: mospranimi i saj dhe refuzimi me mëndjemadhësi i atij, që e thotë atë .

Sjellja me arrogancë ndaj njerëzve: duke i poshtëruar dhe përbuzur.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e qartësoi se zbukurimi në formë dhe rroba është nga çështjet e dashura tek Allahu dhe nuk është nga mendjemadhësia. Mendjemadhësia është cilësi e brendshme, ku gjurmët e saj paraqiten në sjelljet e njeriut, dhe e nxit atë në mospranimin e së vërtetës dhe në nënçmimin e njerëzve. Iblisi kur u paraqit mendjemadh para Ademit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e pengoi mendjemadhësia e tij që t'i bie në sexhde, dhe me atë ta refuzon urdhrin e Allahut. Mendjemadhësia ishte sepse që jobesimtarët i nxiti t'i kundërshtojnë Pejgamberët e Allahut kur u erdhën me argumente të qarta: **“Kështu, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërteta. Pa shiko, cili ka qenë fundi i shkatërrimtarëve!”**. (Neml 14).

Mendjemadhini mendjemadhësia e pengon t'i lutet Zotit të vet dhe ta adhuron Atë. Allahu thotë: **“Zoti juaj ka thënë: “Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar!”** (Gafir 60).

Mendjemadhësia është ajo që i pengon disa nga pasanikët apo disa nga ata që ju është dhënë pushtet, ta falin namazin apo namazin me xhemat nëpër xhami. I sheh se xhamitë i kanë afër shtëpive të tyre, dhe e dëgjojnë ezanin për çdo kohë, dhe mendjemadhësia nuk e len të shkon në xhami, dhe të del para Allahut së bashku me të tjerët, ngase e sheh veten se është më i madh se të tjerët.

Mendjemadhësia është ajo që i pengon disa të mos punojnë komfor traditës së të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ashtu si e përcjell imam Muslimi nga Seleme ibën Ekva, radijAll-llahu anhu, i cili tregon se një njeri ka ngrënë te Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, me dorën e majtë, e i Dërguari i Allahut i tha: **“Ha me dorën e djathtë!”** Ai tha: **“Nuk mundem!”** Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, tha: **“Si nuk mundesh! Nuk e pengoi asgjë përveç mendjemadhësisë!” Pas kësaj, njeriu nuk e afroi dorën e majtë te goja”**.

Mendjemadhësia është ajo që i pengon disa nga marrja e mësimit të dobishëm, ashtu siç e cekin edhe disa nga të parët tanë se këtë dituri nuk e merr mendjemadhi.

Të bërit mendjemadh para të vërtetës dhe para krijesave, e bën të detyrueshëm ndëshkimin e llojlojshëm, edhe atë të shpejtë dhe të vonshëm.

Nga ndëshkimet më të mëdha është se mendjemadhit i largohet zemra e tij nga udhëzimi. Allahu tha: **“Do t’i largoj prej shenjave të Mia ata që sillen me arrogancë në Tokë”**. (Earaf 146), dhe tha: **“Kështu ua vulos Allahu zemrat mohuesve”**. (Earaf 101). Kurse në librat e hadithit ka ardhur se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë se: **“Në ditën e gjykimit mendjemëdhenjtë do të grumbullohen e do të mblidhen, për t’u bërë sa një grimcë e vogël, ku poshtërimi i rrethon nga të gjitha anët”**.

Sufjan ibën Ujejne, RahimehUllah, thotë: **“Kush e ka bërë gjynahun për shkak epshit, shpreso për të pendim, ngase Ademi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ra në gjynah për shkak epshit, dhe Allahu ia fali, kurse, kush e ka bërë gjynahun për shkak mendjemadhësisë, frikoju se për të ka mallkim, sepse Iblisi ra në gjynah për shkak mendjemadhësisë, dhe u mallkua!”**

Si mos t’i kushtohet rëndësi të veçantë sëmundjes së mendjemadhësisë kur i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë se: **“Nuk do të hyjë në xhenet ai, që në zemrën e tij ka një grimcë mendjemadhësie”**.

Mendjemadhësia është bërë pengesë për të hyrë në Xhenet, ngase ajo, ndërhyr mes robit dhe mes moralit të besimtarëve! Mendjemadhi nuk mundet t'ia donë besimtarëve atë që e donë për vete, dhe nuk mundet të jetë modest, dhe t'i largohen zilisë, urrejtjes dhe zemërimit, dhe ta mposht mllefin dhe ta pranon këshillën. Kurse lloji më i keq i mendjemadhësisë është ai që e pengon njeriun ta pranon të vërtetën dhe t'i nënshtrohet asaj!

O ju robër të Allahut! Njeriu duhet ta largon mendjemadhësinë nga vetja e tij, duke u njoftuar me prejardhjen dhe krijimin e tij, dhe nevojën e tij dhe fukarallëkun e tij, si dhe të njoftohet me Zotin e tij dhe madhësitinë e Tij.

Njeriut i mjafton të shikon në bazën e krijimit të tij, e cila ishte nga asgjëja; fillimisht nga dheu, e pastaj nga sperma, e pastaj nga gjaku i ngjizur, e pastaj nga mishi, e pastaj u bë gjë që përmendet, pasi që nuk dëgjonte, e nuk shihte, e nuk ndjente dhe nuk lëvizte! Vetëm se e filloi me vdekjen e tij para jetës, me dobësinë e tij para forcës, me fukarallëkun e tij para pasurisë, e pastaj vdes dhe bëhet dhe, dhe dënohet apo begatohet në varrin e tij, dhe pastaj ringjallet, dhe llogaritet dhe shpërblehet për veprat e tij! Allahu i Madhëruar tha: **“Mallkuar qoftë njeriu! Sa mosmirënjohës që është ai! Prej çfarë gjëje e krijon Allahu atë? Prej pikës së farës e krijon dhe i jep përmasa të rregullta. Më pas ia lehtëson rrugën (e lindjes) e pastaj e vdes dhe i cakton një varr, dhe, kur të dojë, Ai e ringjall. E megjithatë, njeriu ende nuk i ka plotësuar ato që i ka urdhëruar Ai!”**. (Abese 17-23).

18 - ZILIA DHE DËMI I SAJ.

Zilia është cilësi e qortuar dhe e ligë. Allahu na paralajmëroi se është nga cilësitë më të mëdha të sherrit, dhe na paralajmëroi që të mos përshtekemi me këtë cilësi dhe t'i pastrojmë shpirtat nga ajo.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, paralajmëroi duke thënë: **“Mos ia keni zili njëri-tjetrit”**.

Me një hadith tjetër: **“Kanë rënë te ju sëmundjet e popujve para jush, zilia dhe urrejtja”**.

Me një hadith tjetër: **“Ruajuni zilisë! Ajo i djeg të mirat, ashtu si i djeg zjarri drunjtë apo barin”**.

Zilia është cilësia e njerëzve më të këqij. Është cilësi e Iblisit, i cili ia kishte zili Ademit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ngase Allahu e krijoi me duart e Veta, melekët i ranë në sexhde dhe e bëri të jetë banor i Xhenetit. Nga zilia që e kishte, nuk e respektoi urdhrin e Allahut t'i bie Ademit, sal-lAllahu 'alejhi ue

sel-lem, në sexhde, dhe për këtë u largua nga mëshira e Tij, mirëpo, arriti me dredhitë e tij ta largon Ademin, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, nga Xheneti.

Zilia ishte shkaku që e nxiti njërin nga bijtë e Ademit ta vret të vëllain padrejtësisht, kur Allahu i dhuroi begati dhe ia pranoi atij kurbanin. Allahu na e qartësoi lajmin e tyre në Kuran dhe na paralajmëroi nga kjo sëmundje dhe nga gjurmët e saj!

Zilia është cilësi e çifutëve. Allahu e paraqiti në shumë vende në Kuran se, çifutët ia kishin zili të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, për profecinë dhe për pozitën e lartë të cilën ia dhuroi Allahu. Për këtë arsye e mohuan, edhe pse e dinin mirë se ai ishte i Dërguar i Allahut. Ata ia kanë zili edhe këtij umeti për atë që ia dhuroi Allahu nga udhëzimi dhe besimi. Allahu thotë: **“Shumë nga ithtarët e Librit, prej zilisë që kanë në vete, dëshirojnë që t’ju kthejnë nga besimi në mosbesim, tani që e vërteta është e qartë për ata”**. (Bekare 109).

Zili do të thotë të urresh arritjen e një begatie apo të mire deri te tjetri, dhe ti, të shpresosh që ajo të largohet nga ai.

Zilia len gjurma të këqija. Nga ato gjurma; kundërshtimi i Allahut në përcaktimin e Tij, dhe akuzimi i Allahut në ndarjen e riskut mes robërve të Tij, ngase, ziliqari e sheh se, tjetri nuk është më meritore se ai për atë që ia dha Allahu nga furnizimi,.

Nga ato gjurma; ziliqari e mohon urtësinë e Allahut në drejtimin e çështjeve. Allahu jep dhe merr për një urtësi madhështore, kurse ziliqari e mohon atë urtësi.

Nga ato gjurma; zilia e trashëgon urrejtjen mes njerëzve dhe ziliqari e urren tjetrin për shkak zilisë së tij. Kjo bie ndesh me detyrshmërinë e vëllazërisë mes besimtarëve. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, tha: **“Mos e urreni njëri-tjetrin, mos ia keni zili njëri-tjetrit, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit (gjatë zemërimit), as mos i shkëputni marrëdhëniet tuaja dhe bëhuni robër të Allahut, vëllezër të mirëfilltë”**.

Nga dëmet e zilisë; zilia e nxiti ziliqarin të tenton që t’ia largon begatinë atij që e ka zili në çfarëdo mënyre, qoftë ajo edhe me vrasjen e tij, ashtu si na lajmëroi Allahu për dy bijtë e Ademit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe tha: **“Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: “Ty gjithsesi do të të vras”. Tjetri tha: “Allahu pranon vetëm prej të devotshmit”**. (Maide 27). Në fund, e bëri krimin më të madh duke e vra të vëllain, dhe duke e derdh gjakun i pari në tokë, kështu që ai do të merr një pjesë të gjynahut mbi supet e veta për çdo shpirt që do të vritet padrejtësisht deri Ditën e Kiametit. Sebepi i gjithë kësaj dhe ajo që e nxiti ishte zilia.

Nga dëmet e zilisë: e pengon ziliqarin ta pranon të vërtetën kur vjen nga ana e atij që e ka zili. Kjo e bën të vazhdon në të kotën, ku në të është shkatërrimi i tij, ashtu si u bë edhe me Iblisin, ku nga zilia nuk i ra në sexhde Ademit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe nuk e respektoi urdhrin e Allahut, dhe si ndëshkim, u largua nga mëshira e Allahut dhe u mallkua përgjithmonë.

Nga dëmet e zilisë: e nxit ziliqarin të bie në përgojim dhe bartje të fjalëve, duke e përgojuar dhe duke bartë fjalë dhe duke shpifur për atë që e ka zili. Përgojimi dhe bartja e fjalëve, janë dy cilësi të liga dhe mëkate të mëdha!

Nga dëmet e zilisë: zilia e nxit ziliqarin të bën atë që është e ndaluar me fe. Ziliqari, i verbëruar nga zilia e tij, ka mundësi që vëllain e vet musliman ta dëmton në tregti, apo në

shitblerje, apo në fejesë dhe martesë, apo në punë. E tëra kjo, e bën që të mirat e tij dhe shpërblimet të digjen, ashtu siç tha edhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“Ruajuni zilisë! Ajo i djeg të mirat, ashtu si i djeg zjarri drunjtë apo barin”**.

Nga dëmet e zilisë: e bën që ziliqari të jetë përherë në brengë dhe pikëllim kur i sheh begatitë që Allahu ia zbret robërve të Tij, kurse ai, nuk e donë atë dhe e urren, dhe s'mundet t'i përballon, dhe përfshihet nga brenga dhe pikëllimi.

Nga dëmet e zilisë: zilia është sebeb i shkatërrimit të shoqërisë. Për këtë arsye i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, tha: **“Kanë rënë te ju sëmundjet e popujve para jush, zilia dhe urrejtja”**.

O ju robërit e Allahut!

Kush nga ju e gjen në vete se ka zili, le të shpejton në largimin e saj duke e rikujtuar se zilia është dëm për veten e tij, dhe për fenë e tij, dhe për dynjanë e tij, dhe se ai s'mundet t'i bën dëm atij që e ka zili më shumë se atë që e ka caktuar Allahu për të. Le ta rikujton se çështjet janë në dorën e Allahut dhe se e tij mbetet të kërkon nga Allahu begatit dhe mirësitë e Tij. Allahu thotë. **“Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave Allahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët: meshkujt do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar e po ashtu edhe femrat do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar. Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij. Vërtet, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë”**. (Nisa 32).

19 - QARTËSIMI I SHKAQEVE TË LUMTURISË.

Plot nga njerëzit, mendojnë se lumturia dhe shpëtimi, janë në gjërat kalimtare të kësaj dynjaje. Një grup nga ta, lumturinë e paramendojnë në arritjen e pasurisë, dhe në arritjen e pushtetit dhe fuqisë, dhe të kënaqurit me epshe dhe pasimin e tyre. Një grup tjetër, lumturinë e paramendon në të garuarit e tyre mes veti, në shpikje dhe ndërtim, dhe të ngriturit e tyre mbi të tjerët. Duke u bazuar mbi këtë teori, ata, e shpenzuan jetën e tyre dhe kohën e tyre, dhe të gjitha fuqitë i harxhuan, me qëllim që t'i arrijnë ato gjëra, të cilat sipas teorisë së tyre, janë mjetet e lumturisë dhe shpëtimit në dynja!

Kjo u bë preokupimi i tyre kryesor dhe brenga më e madhe, derisa në mendjen e tyre nuk la vend për mendime të tjera. Kjo u bë tema e ndejave të tyre dhe sfera e të garuarit mes veti.

Karuni, u shkatërrua dhe u ndëshkua për shkak pasurisë me të cilën e furnizoi Allahu. Në dorë i kishte çelësat e thesareve të pasurive të dynjasë, mirëpo ajo nuk i bëri dobi.

Faraoni, u shkatërrua dhe ndëshkua për shkak pushtetit dhe mbretërisë, dhe thoshte: **“O populli im! Vallë, a nuk më përket mua sundimi i Egjiptit dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin pranë meje?”**. (Zuhruf 51).

Popujt e mëhershëm, si populli i Adit, Themudit, etj, u shkatërruan për shkak ndjekjes së kënaqësive dhe epsheve: **“Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad, banorë të Iremit me pallate shumëshyllëshe, të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?! Dhe me fisin Themud, që gdhendi shkëmbinjtë në luginë (për të bërë shtëpi)? Dhe me Faraonin, njeriun e hunjve (ku torturonte njerëzit)? Të gjithë këta shkelën çdo kufi në vendet e tyre, duke shtuar atje shturjen dhe korrupsionin, prandaj Zoti yt lëshoi mbi ata kamxhikun e dënimit. Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!”**. (Fexhër 6-14).

Në sferën e ndërtimtarisë dhe shpikjes, shumë popuj bashkëkohorë, filluan ta humbin rehatinë dhe sigurinë, për shkak kërcënimeve që ua bëjnë popujt e tjerë, apo ia bëjnë njëri-tjetrit, me qëllim të paraqitjes të fuqisë së tyre, njëri karshi tjetrit. Filluan të garojnë mes veti në armatim dhe fuqi, pra, në mjete shkatërrimi e jo në mjete që japin siguri dhe rehati. Njerëzit filluan të jetojnë në frikë, se do të ndodhë në çdo moment luftë dhe çorodi në tokë.

O ju robërit e Allahut! Kjo vjen atëherë kur nuk ka iman. Nëse nuk merret si bazë besimi i drejtë, atëherë do të shkatërrohet dynjaja, lumenjtë, ndërtimet, etj., dhe vepra s'ka asnjë dobi. Allahu thotë: **“Vepra e atyre, që nuk besojnë Zotin e tyre, i shëmbëllen hirit, të cilin e shpërndan era në një ditë të stuhishme. Ata nuk do të kenë asnjë dobi nga veprat që kanë punuar. Kjo është humbja e madhe”**. (Ibrahim 18), dhe thotë: **“Thuaj: “A doni t'ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndër kohë që**

mendonin se po bënin vepra të mira?” Këta janë ata, që nuk kanë besuar në shpalljet e Zotit të tyre dhe në takimin me Të. Punët e tyre do të fshihen, andaj Ne nuk do të vëmë kurrfarë peshe për ta (për veprat e tyre), në Ditën e Kiametit”. (Kehf 103-105).

Atë që e përjetojnë jobesimtarët nga pasuria, pozita, fuqia, pushteti, shpikjet e ndërtimtaria, Allahu e quajti si kënaqësi e shkurtër, e përkohshme, e cila do të kalon shumë shpejt, dhe atë do ta vijon humbja dhe zjarri i Xhehenemit. Allahu tha: **“Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!”**. (Ali Imran 196-197).

Madje, Allahu gjykoji mbi jobesimtarët, duke i përfshirë këtu mbretërit, pushtetarët, dijetarët, mendimtarët e tyre, se ata të gjithë janë krijesat më të këqija dhe më të liga. Allahu tha: **“Krijesat më të këqija tek Allahu janë ata që mohojnë dhe që nuk do të besojnë”**. (Enfal 55), dhe tha: **“Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e Xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija”**. (Bejine 6).

Shumë njerëz mahniten me bukuritë e kësaj dynjaje, dhe lidhen tepër fortë për të dhe e harrojnë ahiretin. Allahu thotë: **“Ata që nuk besojnë, janë të joshur nga jeta e kësaj bote, prandaj tallen me besimtarët. Por njerëzit që i frikësohen Allahut, do të jenë mbi ata – në Ditën e Kiametit. Allahu begaton pa kufi kë të dojë”**. (Bekare 212), dhe thotë: **“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu”**. (Ali Imran 14).

Jobesimtarët dhe disa nga muslimanët, të cilët besimin e kanë të dobët, sot, kur i shohin jobesimtarët se kanë përparuar në disa sfera të shkencës dhe kur ua shohin disa bukurisë të dynjasë se i kanë në duart e tyre, mahniten me ta dhe i madhësojnë shpirtrat e tyre. Kurse kur e shohin dobësinë e muslimanëve dhe ngecjen e tyre në shkencë, mendojnë se sebepi i kësaj ngecjeje qëndron në islamin. Kjo, e bën që islami dhe muslimanët të përbuzen në shpirtrat e tyre. Ata nuk e dinë se sebepi i ngecjes së muslimanëve nuk është islami, po janë vetë muslimanët, të cilët u larguan nga feja e Allahut dhe u larguan nga kuptimi i drejtë i tij, i cili nxit në marrjen e shkaqeve dhe përfitimin e fuqisë. Islami është fe e fuqisë dhe e krenarisë, mirëpo kërkon njerëz që ta bartin atë.

I garantuar është të bankrotuarit e jobesimtarëve dhe humbja e tyre, në dynja dhe ahiret, ngase tek ata mungojnë elementet e lumturisë dhe shpëtimit, ku më të dalluarat janë, besimi në Allahun dhe në ditën e Kiametit.

Allahu për besimtarët garanoi se do të jenë të shpëtuar: **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët të cilët janë të përlurur në namazin e tyre, të cilët shmangen nga fjalët e kota, të cilët japin zeqatin, të cilët e ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme), përveçse me gratë e tyre ose me skllavet që kanë në zotërim – dhe, për këtë, nuk janë fajtorë, ndërsa ata që kërkojnë përtej kësaj, pikërisht ata janë shkelës (të kufijve), – të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra dhe të cilët i kryejnë rregullisht faljet. Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët, që do ta trashëgojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht”.** (Muminun 1-11).

Nga shkaqet e shpëtimit dhe lumturisë është edhe pendimi nga gjynahet dhe veprat e mira: **“Porse, ai që pendohet, beson dhe bën vepra të mira, do të jetë i shpëtuar”.** (Kasas 56).

Nga shkaqet e shpëtimit dhe të lumturisë është edhe të kapurit për përmendjen e Allahut: **“dhe përmendni shumë Allahun që të fitoni”.** (Enfal 45).

Nga shkaqet e shpëtimit dhe të lumturisë është edhe zbukurimi i shpirtit me cilësi të mira dhe largimi nga cilësitë e liga: **“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë”.** (Shems 9-10).

Nga shkaqet e shpëtimit dhe të lumturisë është edhe shpenzimi i pasurisë në rrugë të Allahut dhe largimi nga koprracia: **“I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!”.** (Eala 14-15), dhe tha: **“dhe shpenzoni për bamirësi në të mirën tuaj. Ata që e ruajnë veten nga lakmia e saj, pikërisht ata janë të fituarit”.** (Tegabun 16).

O ju besimtarë! Do të vjen ajo ditë ku do të dallohet ai që fitoi dhe ai që humbi. Ajo ditë, është dita ku do të peshohen veprat: **“Peshimi (i veprave), atë ditë do të jetë i drejtë. Ata që u rëndon peshorja me vepra të mira, do të jenë të shpëtuar; kurse ata që e kanë të lehtë peshoren me vepra të mira, do të humbin veten e tyre, për shkak se mohuan shpalljet Tona”.** (Earaf 8-9).

E keni mundësinë të përgatiteni për këtë peshore! Shtoni nga veprat e mira dhe pastroni shpirtin. Mendoni se si të rëndohet peshorja e juaja me vepra të mira, dhe dijeni, se veprat shpërblehen sipas përfundimit! Ashtu si veproni, ashtu do të veprohet edhe me juve!

20 - ZARARET E GJUHËS!

O ju besimtarë, kini frikë Allahun! Ruani gjuhët e juaja, sepse të folurit e juaj ruhet! Allahu thotë: **“dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë)”.** (Kaf 18), dhe thotë: **“Ju**

përcillnit me gjuhët tuaja dhe flisnit me gojët tuaja diçka, për të cilën nuk kishit dijeni. Ju këtë e merrnit për gjë të lehtë, por para Allahut kjo ishte një shkelje e madhe”. (Nur 15).

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, urdhëroi me heshtje, përveç se kur në atë fjalim ka dobi dhe mirësi, dhe tha: **“Kush beson në Allahun dhe Ditën e Kiametit, le të flet për mirë ose le të hesht!”**.

Allahu i Madhëruar tha: **“S’ka kurrfarë të mire në shumë prej bisedave të tyre të fshehta, përveç rastit kur ndokush kërkon që të jepet sadaka ose të kryhet një vepër e mirë apo paqësim ndërmjet njerëzve. Atij që e bën këtë për të fituar kënaqësinë e Allahut, Ne do t’i japim një shpërblim të madh”**. (Nisa 134).

Një njeri i tha të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“O i Dërguar i Allahut, më trego një vepër me të cilën do të hy në Xhenet!”** I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i tha: “Frenoje këtë, duke ia bërë me gishte për gjuhën! Pastaj iu kthye dhe i tha: **“E çfarë tjetër i tërheq njerëzit për hunde në xhehenem, përveç asaj që korrin me gjuhët e tyre?!”**.

Me korrjen e gjuhës nënkuptojmë shpërblimin e të folurit të ndaluar dhe ndëshkimet e tij. Njeriu me fjalët dhe me veprat e veta mbjell të mira dhe të liga, e pastaj e korrë Ditën e Kiametit atë që e ka mbjellë. Ai që mbjelli të mira nga fjalët apo veprat, vetëm se ka korrë mirësi dhe begati, kurse ai që mbjelli të liga nga fjalët apo veprat, vetëm se korri humbje dhe pendim!

Nga gjynahet e gjuhës bën pjesë shirku, i cili, është gjynahu më i madh tek Allahu. Poashtu, në gjynahet e gjuhës bën pjesë edhe të folurit për Allahun pa dituri, dhe kjo, vjen paralele me shirkun. Poashtu bën pjesë gjynahu i dëshmisë së rrejshme, dhe magjia, dhe shpifja, dhe gënjeshtria, dhe përgojimi, dhe bartja e fjalëve, etj. Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Një” burrë mund të nxjerrë një fjalë që zemëron Zotin e madhëruar, fjalë të cilës nuk i kushton vëmendje, por që ajo fjalë e bën të rropatet në zjarrin e xhehenemit për shtatëdhjetë mijë vite”**.

Tek të parët tanë të ndershëm, ekzistonte frikë e madhe nga zararet e gjuhës!

Ebu Bekri, radijAll-llahu anhu, e kapte gjuhën e tij dhe thoshte: Kjo është ajo nga e cila vinë të gjitha të këqijat!

Ibën Abasi, radijAll-llahu anhu, e kapte gjuhën e tij dhe thoshte: Mjerë për ty! Fol mirë do të fitosh, ose hesht nga e keqja do të shpëtosh, ose përndryshe do të pendohesh. I thanë: **“O i biri Abasit, pse po e thua këtë?!”** U përgjigj: **“Më është përcjellë se njeriu më së shumti që zemërohet nga organet e trupit**

të tij është gjuha! Përveç se atij që ka folur me të mirësi apo me të e ka përhapur të mirën!”

Abdullah ibën Mesudi, radijAll-llahu anhu, betoj në Allahun, të Cilit nuk i takon adhurimi askujt përveç se Atij, se s'ka mbi tokë gjë që është më nevojtare për burgim të gjatë sesa gjuha!

Hasan el Basriu, RahimehUllah, thoshte: **“Gjuha është prijësi i trupit. Nëse gjuha gabon edhe trupi do të gabojë, por nëse gjuha është e ndershme edhe trupi do të jetë i ndershëm.”**

O ju musliman!

Të folurit e tepërt për të cilën nuk ka nevojë, e detyron ngurtësimin e zemrës, ashtu si ka ardhur me një hadith: **“Mos e teproni në të folurit pa e përmendur Allahun. Të folurit e tepërt pa mos e përmendur Allahun është ngurtësi për zemrën, kurse njeriu më i largët prej Allahut është ai me zemër të ngurtë!”**.

Omeri, radijAll-llahu anhu, thoshte se kush e tepron në të folurit i shtohen gabimet, e kujt i shtohen gabimet i shtohen gjynahet, e kujt i shtohen gjynahet Xhehenemi është më meritore për të!

Muhamed ibën Axhlan, RahimehUllah, thotë: **“Të folurit janë katër: ta përmendesh Allahun, të lexosh Kuran, të pyesësh për dituri dhe t'ia përcjellësh tjerëve, ose të folsh për atë që të intereson nga çështjet e dynjasë!”**

Të folurit, pra, nuk është urdhëruar në përgjithësi, e as heshtja nuk është urdhëruar të jetë në përgjithësi, po patjetër duhet që njeriu të flet gjëra të dobishme për dynjanë dhe ahiretin e tij, dhe të hesht nga sherri për dynjanë dhe ahiretin e tij. Gjuha është përkthyesi dhe zëdhënësi i zemrës, dhe ne jemi të urdhëruar në përqendrimin e zemrës dhe gjuhës. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Nuk përqendrohet imani i robit përderisa nuk përqendrohet zemra e tij, dhe nuk përqendrohet zemra e tij përderisa nuk përqendrohet gjuha e tij!”**. Dhe me një hadith tjetër: **“Në çdo ditë që lind dielli, organet e trupit i flasin gjuhës dhe i thonë: “Kij frikë Zotin! Nëse ti i përmbahesh rrugës së drejtë, i përmbahemi dhe ne. Por nëse devijon, kemi devijuar edhe ne”**.

Zararet e gjuhës janë të shumta dhe të llojlojshme, dhe nga to:

E para: Të folurit për atë që nuk i bën dobi!

Ka ardhur me një hadith: **“Nga islami i mirë i një njeriu është largimi nga ajo që nuk i intereson”**.

E dyta: Zhytja në biseda të kota!

Ajo është të folurit për harame, dhe të folurit mbi to që i përhapin njerëzit nëpër shoqëri **(për qëllim është të zhyturit në të kotë duke biseduar për haramet që i bën një popull apo shoqëri, dhe të marrit me zakonet e tyre e një populli të caktuar. Si p.sh, ka gra apo edhe burra që flasin nëpër telefon me ora të tëra, duke rrëfyer se çfarë bëjnë gratë apo burrat në perëndim, si e kalojnë jetën, çfarë bëjnë gjatë vikendit, apo pushimeve.. Flasin për lidhjet jashtëmartesore, për pirjen e drogës, alkoolit, jetën e natës etj.. Një zarar i tillë është i ndalur në fenë e Allahut – sh. p).**

Të folurit për to nëpër mexhlise i gëzon hipokritët dhe të ligët, dhe e përhapin degjenerimin dhe shthurjen në moral tek besimtarët. Allahu thotë: **“Ata që duan të përhapen shpifjet e turpshme (ose imoraliteti) ndër besimtarët, i pret një dënim i dhembshëm në këtë botë dhe në tjetrën; Allahu i di të gjitha e ju nuk i dini.”** (Nur 19).

Muslimani për detyrë e ka nëse e di për një gabim apo për një të metë nga vëllai i vet, ta mbulon atë dhe vëllaun ta këshillon. Kurse përhapja e të metave të tij apo gabimeve të tij

nëpër mexhlise apo ndeja, kjo është cilësia më e fëlliqur dhe vepra më e qortuar. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Mos i dëmtoni robërit e Allahut dhe mos i nënçmoni e mos tentoni të shpalosni turpin e tyre, sepse ai që tenton të shpalos turpin e vëllait të vet, Allahu tenton t’ia shpalos turpin derisa ta turpërojë në shtëpinë e tij”.**

E treta: Të folurit me fjalë vulgare, me sharje dhe me ofendime!

Disa njerëz e kanë për traditë mallkimin e njerëzve, apo vendeve, apo kafshëve, dhe të folurit e tij me mallkime është më e lehta që i del nga goja, dhe ndoshta me ato fjalë i drejtohet shokut, apo gruas, apo burrit, apo ndonjë personit të dashur tek ai! I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Mallkimi i muslimanit është si vrasja e tij!”**, dhe tha me një hadith tjetër: **“Besimtari nuk është shpifës, as mallkues, as fyes e as vulgar”.**

Një grua e mallkoi devenë e saj dhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dha urdhër që t’i merr gjërat nga deveja dhe ta len atë, dhe i tha: **“Mos të na shoqëron një deve e mallkuar!”.**

Ka nga ata që kur ka mospajtime me vëllain e vet musliman, e shfrytëzon gjuhën e tij për ta ofenduar dhe sharë, dhe e etiketon me cilësi të këqija që nuk i posedon, dhe i shkreti nuk e din se mbi vete ka marrë një barrë të rëndë dhe se do të japë llogari. Allahu urdhëroi që nëse ndonjëri i flet me fjalë të liga dhe fyese, tjetri t’ia kthen me fjalë më të mira sesa ato të ligat dhe fyset. Allahu thotë: **“Të keqen ktheje me të mirë.”** (Fusilet 34).

E katërta: Bërja e shakave të tepërta!

Teprimi në shaka dhe të vazhduarit në të është e ndaluar, sepse e rrëzon respektin dhe e detyron urrejtjen, Kurse shakaja e lehtë apo të bërit shaka ndonjëherë nuk është problem, sepse shpirtin e bën të ndjehet mirë. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, bënte shaka, mirëpo në to nuk e thoshte vetëm se të vërtetën!

E pesta: Tallja dhe përçmimi me njerëzit dhe përcejllja e të metave dhe huluntimi pas gabimeve të tyre!

Kjo e tëra është e ndaluar, ashtu si Allahu na mëson dhe thotë: **“Mjerë për çdo përqeshës – shpifës”**. (Humeze 1), e që nënkupton mjerë për atë që merren me njerëz dhe të metat e tyre dhe ua ulin vlerën dhe peshën njerëzve, qoftë ajo me thënie apo me vepra!

E gjashta dhe e shtata: Përgojimi dhe bartja e fjalëve

Këto janë nga gjynahet e mëdha. Me përgojim nënkuptojmë ta përmendësh vëllain tënd në mos prezencën e tij, për të keq apo për një gjë që e urren ai. Kurse me bartje të fjalëve nënkuptojmë, bartjen e fjalëve mes njerëzve me qëllim shkatërrimi. Allahu atë që përgojon e përngjason me atë që e ha të cofëtën.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Ruajuni gibeit (përgojimit), sepse gibeiti është më i keq se zinaja. Njeriu që bën zina dhe pendohet, Allahu ia falë. Kurse atij që bën gibeit Allahu nuk do t’ia falë derisa t’ia falë njeriu të cilin e ka përgojuar”**.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, lajmëroi se ai që bartë fjalë ndëshkohet në varrin e tij, dhe lajmëroi se nuk do të hyn në Xhenet. Përcillet me një hadith se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Nuk hyn në Xhenet ai që bart fjalë”**.

Ai që bart fjalë shkatërron mes njerëzve, dhe mbjell në zemrat urrejtje dhe armiqësi, dhe shkatërron shtëpi dhe shoqëri. Allahu tha: **“Por ti mos iu bind çdo betari të përçmuar, shpifaraku, që përhap thashetheme, penguesi vepërash të mira, shkelësi dhe keqbërësi”**. (Kalem 10-12).

O ju musliman! Ruajuni gjuhët e juaja dhe matni thëniet e juaja! Njeriu para se të flet i posedon ato fjalë, mirëpo nëse i nxjerr ato fjalë jashtë, atëherë ato fjalë e posedojnë atë!

Allahu i Madhëruar thotë: **“Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet. Dy engjëj i rrinë atij nga e djathta dhe e majta, dhe, për çdo fjalë që ai**

thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë)".
(Kaf 16-18).

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore”. (Ahzab 70-71).

21 - RYSHFETI.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve dhe të qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Ali Imran 102)

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkonte të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju”. (Nisa 1)

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore“. (Ahzab 70-71)

Vëllezër musliman,

Ai i cili merr ndonjë përgjegjësi prej çështjeve të muslimanëve detyrohet ta kryen atë me përsosmëri për shkak se është amanet që do të jap për të llogari Ditën e Kiametit. Muslimani detyrohet të jetë korrektë në punë dhe ta shfrytëzon maksimumin e tij në kryerjen e detyrave që i ka marrë përsipër. kërkohet prej tij, të jetë i ashpër për përdorimin e forcës por edhe i butë pa treguar dobësi.

Nuk duhet t’i favorizon të fortit e t’i nënçmon të dobët, por tek ai i forti duhet të jetë i dobët deri sa ta nxjerr hakun prej tij dhe i dobëti të jetë i fortë deri sa ta marrë hakun për të.

Omeri, radijAll-llahu anhu, i ka thënë njërit prej punëtorëve të tij: **“Kur je i ulur në mexhlis shikojni njerëzit rreth teje njësoj dhe ata që i ke përpara teje dhe ata të cilët i gjykon, në mënyrë që paria mos të lakmojë**

padrejtësinë tënde, ndërsa të dobëtit të humbasin shpresën në drejtësinë tënde. Largoju zemërimin, brengës, tiranisë, shqetësimin të njerëzve dhe debateve të ashpra. Allahu obligon gjykimin me drejtësi, e për këtë ekziston shpërblimi dhe kujtimi i bukur në këtë botë. Qëllimet që janë të sinqerta dhe anojnë kah drejtësia, qofshin edhe kundër tij, Allahu do t'i mjaftojë ndaj njerëzve tjerë. Ai i cili zbukurohet me atë që nuk i takon, Allahu do ta poshtërojë. Allahu nga robërit pranon vetëm veprat e sinqerta.”

O ti punëtor, dije se prej teje është blerë koha për t'i shërbyer muslimanët dhe si shkëmbim paguhesh dhe për çdo muaj merr rrogë të plotë. Poashtu prej teje është blerë puna të cilën ti e kryen në këtë kohë, prandaj për çdo minutë që kalon jashtë punës që je i detyruar merr pasuri të palejuar.

Çdo punë që e kryen jashtë asaj që je i detyruar ti e ke tradhtuar amanetin dhe për këtë do të japësh llogari para Allahut. Çdo pasuri që e merr prej njerëzve përballë punës që e kryen, kurse ti në anën tjetër për këtë punë merr rrogë të caktuar, është ryshfet, korrupsion dhe pasuri haram.

Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibën Hibani dhe Hakimi, RahimehUllah, në librat e tyre e shënojnë një hadith prej ibën Omerit, radijAll-llahu anhu, **“se Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e ka mallkuar dhënësin dhe marrësin e ryshfetit”**. Poashtu, imam Taberaniu e ka nxjerr një hadith prej ibën Omerit i cili thotë se Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Ai që e jep dhe ai që e merr ryshfetin janë në zjarr”**. Imam Ahmedi e shënon një hadith prej Theubanit, radijAll-llahu anhu, i cili na përcjell **“se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e ka mallkuar mitëdhënësin, dhe mitëmarrësin dhe ndërmjetësuesin mes tyre”**. Imam Taberaniu na përcjell një hadith nga ibën Abbasi: **“Ryshfeti në pushtet është kufër, dhe marrje e padrejtë e pasurisë së njerëzve.”**

Hakimi, RahimehUllah, shënon një hadith nga ibën Abbasi se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kush mbi vete merr përgjegjësinë për dhjetë veta dhe gjykon si ju përgjigjet atyre, do të vijë Ditën e Gjykimit i prangosur. Nëse është i drejtë, nuk merr ryshfet dhe nuk sillet si tiran, Allahu do ta lirojë.”**

“Nëse gjykon jo sipas asaj që Allahu ka shpallur, merr ryshfet dhe tregohet i njëanshëm, dora e majtë i lidhet me të djathtën, dhe do të hedhet në xhehenem, ndërsa thellësia e tij arrin pesëqind vjet.”

O ju robër të Allahut,

Ryshfeti është mëkat i ndaluar me konsensusin e të gjithë dijetarëve Islam, qoftë për gjykatësin apo nëpunësin që punon në institucionet shtetërore apo private. Islami e ndalon ryshfetin për shkak se është ngrënie e pasurisë me të

kotë. Përhapja e ryshfetit në shoqëri do të thotë përhapje e padrejtësisë dhe dëmit në shoqëri, për shkak se e pengon atë që është më meritues ta merr të drejtën e tij dhe bën që t'i jepet përparësi atij që nuk e meriton. Kjo është krim dhe armiqësi. Asnjëherë ryshfeti nuk është përzier me një punë e që nuk e ka prishur, ose ka hyrë në ndonjë sistem e që nuk e ka rrënuar, ose ka depërtuar në zemër e që nuk e ka shkatërruar.

Nuk është përhapur ryshfeti në një popull përveç se e ka zëvendësuar të vërtetën me mashtrim, amanetin me tradhti, sigurinë me frikë, drejtësinë me padrejtësi dhe e ka bërë të lejuar ndëshkimin e Allahut mbi atë popull. Me ryshfet i jepet përparësi dembelëve e përtacëve dhe largohen punëtorët e të përpiktit. Të vërtetën e shëndrrojnë në të pa vërtet dhe të pa vërtetën e shëndrrojnë në të vërtet. Për shkak të ryshfetit sa të drejta janë privuar dhe sa nderi është rrënuar, pandershmëria ka përparuar, ndërsa i ndershmi është nënçmuar? Ryshfeti është sëmundje infektuese dhe shkatërruese.

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve dhe të qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

Vëllezër besimtarë,

Sa të devotshëm u janë privuar të drejtat e tyre për shkak se nuk kanë dhënë ryshfet dhe sa prej të shëmtuarve e mëkatarëve u është dhënë përparësi kërkesave të tyre për shkak se kanë paguar ryshfet dhe me këtë vepër e kanë njollosur shoqërinë me fëlliqësinë e ryshfetit dhe e kanë merituar ndëshkimin dhe mallkimin e Allahut. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i mallkoi tre veta: mitëdhënësin i cili e jep ryshfetin, dhe mitëmarrësin i cili e pranon ryshfetin dhe ndërmjetësuesin mes tyre i cili ndërmjetëson që të realizohet kjo marrëveshje. Ky mallkim vjen si pasojë e gjurmëve të kobshme që i le në mesin e një shoqërie, prandaj disa prej dijetarëve dhënie e ryshfetit e konsiderojnë si mëkat më të madh se sa t'i paguash të holla një lavireje që të bësh me të imoralitet.

Islami e ndalon çdo lloj të ryshfetit pa marrë parasysh se si emërtohet ai, dhuratë apo shpërblim apo nder apo bakshish, e kështu me radhë. Emërtimet nuk e ndryshojnë esencën, sepse punëtori duhet të kryen detyrën e vet për të cilën paguhet dhe merr rrogë.

O ju musliman frikohuni Allahut dhe largohuni prej kësaj sëmundje, mohojeni këtë vepër të shëmtuar dhe jepjani hakun punës.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht! Dhe mos u bëni mitëdhënës te gjykatësit për t'ua**

përvetësuar në mënyrë të paligjshme dhe me vetëdije njerëzve një pjesë të mallit”. (Bekare 188)

22 - RREZIKU I KAMATËS.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve dhe të qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Ali Imran 102)

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju”. (Nisa 1)

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore”. (Ahzab 70-71)

O ju njerëz, frikohuni Allahut dhe kini kujdes prej depërtimit të kamatës në tregtitë e juaja dhe prej përzierjes së pasurisë tuaj. Ngrënia e kamatës dhe përdorimi i saj është prej mëkateve më të mëdha dhe Allahu ngrënësit dhe atij që punon me të iu kërcënua me zjarr të xhehenemit dhe me luftë prej Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“O ju që keni besuar! Ta keni frikë Allahun dhe hiqni dorë nga kamata, nëse jeni besimtarë të vërtetë. Nëse nuk e bëni këtë, atëherë iu është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse pendoheni, atëherë ju takon kapitali fillestar. Në këtë mënyrë, nuk dëmtoni askënd e as nuk dëmtoheni vete”.**(Bekare 278-279) Xhabiri, radijAll-llahu anhu, thotë: **“I Dërguari, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka mallkuar atë që e ha kamatën, ai që ushqen kamatën (e jep atë), ai që e evidencon atë si dhe ata që janë në cilësinë e dëshmitarëve në kontratën ku ekziston kamata.”** Dhe tha: **“Të gjithë këta janë të barabartë”.** Nuk është paraqitur kamata dhe imoraliteti në mesin e një popull përveç se është paraqitur tek ata varfëria, sëmundjet e ndryshme dhe zullumi prej sulltanit. Kamata i shkatërron pasuritë dhe ua heq bereqetin: **“Allahu ia heq çdo përfitim kamatës, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë”.** (Bekare 276.

Allahu e theksoi me ashpërsi kërcënimin ndaj ngrënësit të kamatës dhe e konsideroi ngrënien e saj si të shëmtuarën më të fëlliqur dhe mëkatën më të madh, të cilit Allahu i shpalli luftë. Pastaj, qartësoi se ngrënësi i kamatës do të përjeton dënim në dynja dhe në ahiret. Prej dënimeve të dynjasë është asgjësimi i bereqetit të pasurisë, humbja, shkatërrimi i saj, etj, saqë pronari i asaj pasurie do të bëhet njeriu më i varfër në shoqëri. Shpeshherë dëgjoni për zhdukjen e pasurive të mëdha me djegien e saj, fundosje ose me shkatërrimin e saj prej vërshimeve të mëdha, saqë banorët e atyre vendeve bëhen më fukaratw në mesin e njerëzve. Në rast se mbetet pasuria e fituar me kamatë në duart e pronarëve të saj, ajo pasuri nuk do t'i bën aspak dobi për shkak se është pa bereqet dhe për të Ditën e Kiametit do të jep llogari dhe do ta pret dënim i dhembshëm. Njeriu që e ha kamatën dhe punon me të është krijesa më e urryer tek Allahu dhe tek krijesat e Tij. Cilësi e këtij njeriu është se vetëm merr e nuk jep, mbledh e nuk shpërndan, nuk shpenzon e nuk jep sadaka, është koprrac e dorështrënguar, zemrat nuk e dojnë dhe shoqëritë e refuzojnë. Kjo është prej dënimeve që e kaplojnë në dynja, kurse dënimi në ahiret do të jetë edhe më i rëndë dhe më i gjatë.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, e qartëson në Kuran se çka e pret ngrënësin e kamatës ditën kur do të ngrihet prej varrit për të dhënë llogari dhe thotë: **“Ata që marrin fajde, do të ringjallen (në Ditën e Gjykimit) si ai që djalli e ka çmendur me prekjen e vet”**. (Bekare 275) Edhe atë se njerëzit kur do të ringjallen do të dalin me shpejtësi prej varreve të tyre dhe do të nxitojnë për në Mahsher siç thotë edhe Allahu në Kuran: **“Ditën, në të cilën do të dalin nga varrezat duke vrapuar, sikur të ishin duke nxituar drejt një altari”**. (Mearixh 43) Prej tyre do të veçohet ngrënësi i kamatës i cili ngrihet dhe rrëzohet për toke, gjendja e tij i përngjanë atyre që bëjnë mundje njëri me tjetrin dhe të cilët ngrihen dhe rrëzohen gjatë dyluftimit, për shkak se ngrënia e kamatës barkun ia ka fryrë dhe ia ka bërë të rëndë dhe çdo herë që tenton të ngrihet e t'i bashkëngjitet të tjerëve rrëzohet për toke, kështu që vonohet dhe nuk mundet t'i zë të tjerët. Kjo, si dënim dhe nënçmim për ngrënësin e kamatës Ditën e Kiametit.

Semure ibën Xhundub transmeton se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kam parë natën e (Miraxhit) dy melekë. Erdhën dhe më nxorën në tokën e shenjtë. Pastaj u nisëm dhe arritëm te një lum prej gjaku. Në këtë (lum) qëndronte një njeri. Ai qëndronte në mes të lumit, e në (breg të lumit) qëndronte një tjetër, përpara të cilit gjendeshin gurë. Sa herë që njeriu në mes të lumit rrihte të dilte, tjetri (nga bregu i lumit) e gjuante me gurë në gojë dhe e kthente në vendin ku qëndronte. Kështu vepronte sa herë që rrihte të dilte, e gjuante me gurë në gojë dhe njeriu kthehej përsëri aty ku qëndronte. Pyeta: Kush është ky? (Meleku) M'u përgjigj: Ai që gjendet në mes të lumit është njeriu që ka ngrënë kamatën”**.

Ebu Hurejre, radijAll-llahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kamata është shtatëdhjetë lloje mëkatesh, më e lehta është sikur njeriu të martohet me nënën e vet”**.

O ju musliman,

Kamata është e ndaluar në të gjitha fetë qiellore. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë për çifutët: **“Ne ua ndaluar atyre disa ushqime të mira, të cilat ishin të lejuara për ta, për shkak të prapësive që bënë, për shkak se ata pengonin shumë njerëz nga udha e Allahut, për shkak se merrnin kamatë, megjithëse kjo ishte e ndaluar për ta dhe për shkak se përvetësonin padrejtësisht pasurinë e njerëzve”**. (Nisa 160-161)

Edhe përskaj këtij kërcënimi të ashpër për ngrënësin e kamatës, shumica e njerëzve vazhdojnë të mbledhin pasuri në mënyrë të paligjshme dhe nuk u intereson mënyra se si kanë arritur deri tek ajo pasuri. E rëndësishme tek ata është vetëm mbledhja e pasurisë dhe shtimi i saj. Të ndaluar e konsiderojnë çdo gjë çka nuk mundën ta arrin apo të mbërrin deri tek ata, ndërsa e lejuar sipas parimeve të tyre është çdo gjë që ata mundën ta arrin edhe atë në çfarë do mënyre. Kjo aludon në mungesën e drojës ndaj Allahut në zemrat e tyre dhe në mosnjohjen e fesë së tyre. Në rast se gjendja e shoqërisë arrin në këtë nivel, atëherë prite dënimin. Nuk ka mirësi në atë jetë që bazohet mbi këtë sistem dhe nuk ka mirësi në atë pasuri që fitohet në mënyrë të paligjshme. Pasuria e grumbulluar në mënyrë të paligjshme i përngjanë kënetës e cila është e formuar prej ujit të fëlliqur të pisët dhe çdo njëri që kalon andej apo gjendet në afërsi të saj dëmtohet prej erës së saj që e nuhat.

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve dhe të qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

Vëllezër besimtarë,

Sot në mesin e njerëzve janë përhapur shumë biznese e tregti me kamatë të qartë. Muslimani duhet të jetë vigjilent ndaj këtyre transaksioneve dhe këmbimeve që të mos bie nën ndikimin e atyre që punojnë me të. Prej llojeve të kamatës që janë përhapur kohëve të fundit është:

Kamata e shtyrjes apo vonesës.

Ky lloj quhet edhe **“Kamata e borxhit”** dhe nënkupton shtimin e kushtëzuar, të cilin e merr huadhënësi nga huamarrësi për shkak të kohës që i ka lënë në dispozicion huamarrësit të paguajë borxhin. Dhe çdo herë që e vonon huamarrësi kthimin e borxhit i rritet borxhi. Ky lloj i kamatës ka qenë prezent

dhe shumë i përhapur tek arabët para Islamit dhe kjo është **“Riba el-Xhahilije”** që do të thotë: **“Kamata e injorancës”** të cilën e cek Allahu në Kuran: **“O ju që keni besuar! Ta keni frikë Allahun dhe hiqni dorë nga kamata, nëse jeni besimtarë të vërtetë. Nëse nuk e bëni këtë, atëherë iu është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse pendoheni, atëherë ju takon kapitali fillestar. Në këtë mënyrë, nuk dëmtoni askënd e as nuk dëmtoheni vetë. Nëse e dini se borxhliu është ngushtë, shtyjani afatin (e shlyerjes së borxhit) derisa ta përmirësojë gjendjen. Por është më mirë për ju që t’ia falni borxhin, veç sikur ta dinit”**. (Bekare 278-280)

Poashtu prej llojeve të kamatës që janë përhapur kohëve të fundit është:

Borxhi me fajde apo dobi.

Ky lloj kamate nënkupton dhënien e borxhit, mirëpo me kusht që t’ia kthen borxhin me një sasi të rritur si kompensim për pasurinë që ka huazuar, konform kushteve të caktuara.

Poashtu në rast se huadhënësi e kushtëzon huamarrësin me ndonjë lloj dobie për borxhin e dhënë, si: të banoj huadhënësi një kohë të caktuar në shtëpi të huamarrësit pa qira, ose t’ia shfrytëzon makinën e tij për një kohë të caktuar, ose t’i dhuron dhurata, ose çdo lloj dobie tjetër, kjo është kamata. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Çdo borxh që tërheq me vete ndonjë dobi është kamata”**. (1)

Dijetarët janë unanim rreth kuptimit që ka të bëj ky hadith.

Poashtu prej llojeve të kamatave është edhe deponimi i të hollave me fajde apo interes nëpër banka, ku banka i pranon ato të holla prej myshteritit dhe punon me to, ndërsa si shpërblim myshteritit çdo muaj i jep përqindje të cilën e quan dobi, por në fakt kjo është kamata.

Poashtu prej llojeve të kamatës është edhe këmbimi i të hollave mes veti që duhet patjetër të bëhet dorë më dorë në vendin dhe çastin e aktit dhe nuk të duhet të ndahen të dy palët prej vendit të aktit para se t’i kapë çdonjëri të hollat e veta në dorë. E njëjta vlen edhe për blerjen e arit dhe argjendit me të holla prej letre ku duhet patjetër të bëhet dorë më dorë në vendin dhe çastin e aktit dhe nuk të duhet të ndahen të dy palët prej vendit të aktit para se ta kapë çdonjëri mallin e vet në dorë.

Ka edhe shumë pamje dhe lloje të tjera të kamatës për të cilat nuk ka hapësirë të mjaftueshme të flasim këtu. Prandaj muslimani duhet të jetë i kujdesshëm dhe t’i largohet të gjitha pamjeve dhe llojeve të kamatës dhe mos të bie kurban i atyre që nuk u intereson fare kjo çështje dhe për çdo gjë që nuk e kupton le t’i drejtohet dijetarëve, për shkak se çështja është shumë e madhe dhe rreziku edhe më i madh.

E lus Allahun të na bëjë dobi mua dhe juve me udhëzimin e Kuranit dhe Sunetit të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Kjo ishte ajo çka dëshiroja ta them. Prej çdo mëkati kërkoj falje tek Allahu për vete dhe për ju dhe për të gjithë muslimanët. Kërkoni falje prej Tij se me të vërtetë Ai është Gjithëfalësi dhe Mëshirëploti.

(1) - Hadithi është i dobët dhe më e sakta është ajo çka e cekin juristët Islam se kjo është një prej rregullave në jurisprudencën Islame dhe dijetarët janë unik në atë se hadithi është i dobët mirëpo kuptimi i hadithit është i saktë.

23 - SËMUNDJA E ZEMRËS DHE SHËRIMI I SAJ.

Falënderimi i takon vetëm se Allahut i Cili na mundësoi që ta shijojmë ëmbëlsinë e imanit. Atë e falënderoj dhe lavdëroj dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkoj. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin birin e Allahit dhe robin e Allahut.

O ju robërit e Allahut, frikojuni Allahut i Cili ju krijoi dhe përsosi dhe ju formësoi në formën më të bukur që Ai dëshiroi: **“O ti njeri, po ç’të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është bujar e i urtë? I cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi. Të formësoi në formën që Ai dëshiroi!”**. (Infitar 6-8)

O ti njeri, mos harro se je i përbërë nga shumë organe dhe se çdo organ i jot është krijuar për një punë të veçantë dhe nëse të sëmuret ai organ do të privohet nga funksioni i tij pjesërisht apo tërësisht. Nëse sëmuret dora do të privohet nga goditja, nëse sëmuret syri do të privohet nga shikimi, nëse sëmuret zemra nga mëkatet do të privohet nga puna e veçantë për të cilën është krijuar e ajo, është dituria, urtësia, njohja dhe dashuria e Allahut dhe adhurimi i Tij. Sëmundja e zemrës është sëmundje që shërohet me vështirësi dhe është sëmundje e fshehtë të cilën nganjëherë pronari i saj aspak nuk e vëren dhe për këtë e neglizhon, dhe nëse e vëren i vjen shumë rëndë që të bën durim në shërimin e saj për arsye se për shërim të saj nevojitet kundërshtimi i epshit. Zemra është mbreti i organeve dhe burimi i lumturisë apo i vuajtjeve të tyre dhe burimi i përmisimit apo i shkatërrimit të tyre.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Me të vërtetë në trup ndodhet një copë mishi, nëse ajo përmisohet i gjithë trupi përmisohet e nëse ajo priset i gjithë trupi shkatërrohet, ajo copë e mishit është zemra”**.

Ky hadith është argument se përmisimi i veprave të robit varet nga përmisimi i zemrës dhe shkatërrimi i veprave të robit varet nga shkatërrimi i zemrës. Zemra e përmisuar pra, është zemra e pastër dhe e vetmja e cila i bën dobi robit tek Allahu: **“Në Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!”**. (Shuara 88-89)

Zemrat janë tre lloj:

Lloji i parë: Zemra e pastër, e cila është e mbrojtur nga çdo sëmundje dhe e keqe dhe në të ekziston vetëm se dashuria ndaj Allahut dhe frikërespekti ndaj Tij.

Lloji i dytë: Zemra e vdekur, e cila në të nuk ka jetë dhe ajo zemër nuk e njeh Zotin e saj dhe as nuk e adhuron Atë dhe këtë lloj zemre e udhëheqin epshtet dhe pasionet, edhe pse e zemërojnë dhe irritojnë Allahun, dhe nuk i përgjigjet këshillës por e ndjek çdo shejtan të rebeluar.

Lloji i tretë: Zemra e sëmur, e cila në të ka jetë po ka edhe sëmundje.

Zemra e parë është e gjallë, e butë. Zemra e dytë është e thatë e vdekur, kurse zemra e tretë është zemër e sëmurë dhe sëmundja e saj varet nga veprat e saj se sa janë ato të mira dhe se sa janë ato të liga.

Jeta, vdekja dhe sëmundja e zemrës varen nga veprat që i vepron njeriu dhe nga shkaqet që e bëjnë zemrën të gjallë është nënshtrimi ndaj urdhërave të Allahut, leximi i Kuranit, meditimi i tij dhe preokupimi me përmendjen e Tij. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”**. (Rad 28), dhe ka thënë: **“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten”**. (Enfal 2), dhe poashtu ka thënë: **“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur”**. (Hadid 16)

Nga shkaqet që i japin jetë zemrës është edhe ndeja me njerëz të mirë, shoqërimi i tyre dhe ndjekja e tyre, pastaj dëgjimi i këshillave, ligjëratave, përkujdesja për namazin me xhemat dhe namazin e Xhumasë, meditimi dhe përsiatja në krijesat e Allahut dhe çka në to nga urtësia. Allahu i Madhëruar thotë: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt”**. (Bekare 186)

Nga shkaqet bë e bëjnë zemrën të vdesë është mospranimi i të vërtetës pas njohjes së saj. Allahu i Madhëruar thotë: **“Kur ata u larguan (nga e vërteta), Allahu i largoi zemrat e tyre (nga rruga e drejtë); Allahu nuk e shpie në rrugë të drejtë popullin jobesimtar”**. (Saf 5), dhe tha: **“pastaj largohen. Allahu i shmang zemrat e tyre, sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë!”**. (Teube 127), dhe poashtu tha: **“O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyr midis njeriut dhe zemrës së tij”**. (Enfal 24)

Pronari i zemrës së vdekur është më i ulët se sa kafshët dhe shembulli i tij vendin e ka në Xhehenem. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ne kemi paracaktuar për Xhehenemin shumë xhinde dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit”**. (Earaf 179)

Kjo zemër shndërrohet në një zemër të degjeneruar dhe të vulosur dhe pronari i saj nuk ka mundësi të përfiton nga ajo, për arsye se ai e refuzoi të vërtetën dhe u kënaq me të kotën dhe e kota iu bë ushqimi i tij, devijimi rruga e tij dhe zjarri vendbanimi i tij.

Shkaqet e sëmundjes së zemrës janë të shumta dhe nga ajo ngrënia e pasurisë haram. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, me një hadith thotë: **“Vërtet Allahu i madhëruar është i mirë dhe nuk pranon përveç se të mirën, dhe vërtet Allahu u ka urdhëruar besimtarëve atë që u ka urdhëruar të dërguarve.”** I Madhëruari ka thënë: **“O ju të dërguar, hani gjërat e mira dhe punoni mirë”**.

I Madhëruari ka thënë: **“O ju besimdrejtë, hani gjërat e mira me të cilat u kemi furnizuar”**. Pastaj e përmendi njeriun, i cili ka udhëtuar gjatë me flokë të shpupuritura dhe të pluhurosura dhe i cili i shtriu duart e tij kah qielli: **“O Krijues, o Krijues!” Kurse ushqimi i tij është haram, dhe pija e tij haram, dhe veshmbathja e tij haram, dhe është ushqyer me haram. E si do t'i pranohet lutja e tij!”**.

Sot ngrënia e pasurisë haram është shtuar me të madhe në shoqërinë tonë ashtu siç shihet edhe haptazi dhe kjo është një nga shkaqet e degjenerimit dhe devijimit në moral.

Nga shkaqet e sëmundjes së zemrës është edhe veprimi i mëkateve. Mëkatet ndikojnë në zemra dhe i sëmurin ato. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat”**. (Mutafifin 14) Përcillet me një hadith se robi kur bën një mëkat i bëhet një pikë e zezë dhe nëse pendohet i largohet pika e nëse jo atëherë ajo pikë shtohet dhe zemrës i kanoset rrezik më i madh.

Nga shkaqet e sëmundjes së zemrës është edhe dëgjimi i asaj që nuk lejohet të dëgjohet nga fjalët e ndaluara, nga muzika dhe nga instrumentet muzikore. Kjo bela është shtuar me të madhe në shoqërinë tonë e sidomos kohëve të fundit ku dëmet e këtij mëkati janë bërë të shumëllojshme dhe janë shtuar rrugët e përhapjes së tij nëpërmjet internetit, radios, televizionit, etj. Paraqitja e këtij mëkati në shoqëri ka lënë pasoja të mëdha e sidomos në sjelljen e grave, fëmijëve dhe madje edhe të burrave. Muzika dhe këngët janë nga mjetet më të rrezikshme të Iblisit ku nëpërmjet tyre e shkatërron zemrën dhe Allahu i Madhëruar thotë: **“Bëj për vete, me zërin tënd, kë të mundesh nga ata!”**. (Isra 64), dhe ceket se qëllimi i thënies **“me zërin tënd”** në ajet është për qëllim muzika.

Nga shkaqet e shkatërrimit të zemrës është edhe shikimi i ndaluar. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, me një hadith thotë: **“Shikimi në të ndaluarën është shigjetë e helmuar nga shigjetat e Iblisit”**.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më mirë për ta! Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për atë që bëjnë ata. Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara)”**. (Nur 30-31) Shikimi i ndaluar trashëgon pasion në zemër të cilën edhe e sëmur.

Nga shkaqet e sëmurjes së zemrës poashtu është edhe shikimi dhe leximi i librave dhe revistave të fëlliqura të cilat përmbajnë tematike të fëlliqura dhe foto të ndyta të cilat i lexojnë burrat dhe gratë dhe madje edhe fëmijë, Allahu na ruajt.

O ju robërit e Allahut, nuk ka shërim për sëmundjet e zemrës përveç se me ilaçe të cilat i ka zbritur Allahu në librin e Tij dhe në Sunetin e të Dërguarit të Tij. Allahu i Madhëruar thotë: **“O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët”**. (Junus 58), dhe **“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje”**. (Isra 82)

Për këtë arsye kapuni për Librin e Allahut dhe traditën e të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, t'i shëroni zemrat e juaja nga sëmundjet e saj. Në to ka mëshirë, shërim, dritë, udhëzim, shpirt, jetë, mbrojtje nga shejtani dhe vesveset e tij. Secili nga ne le ta largon veten nga vendet ku ka harame dhe fitne dhe të largohet nga çdo mjet i cili e çon deri tek ato dhe poashtu largoni fëmijët e juaj dhe shtëpitë e juaja nga mjetet e degjenerimit nëse dëshironi shërim për zemrat e juaja dhe hajr për shoqëritë e juaja dhe shpeshtojeni thënien e kësaj lutjeje që e thonte i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“O Ti që i rrotullon zemrat! Bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde!”**.

24 - ISLAMI DHUNTIA MË E MADHE.

Falënderimi i plotë i takon Allahut i Cili krijoi njeriun në formën më të bukur, e nderoi dhe dukshëm e mbivlerësoi atë ndaj shumë krijesave. E falënderoj Allahun për begatitë e Tij të vazhdueshme mbi njerëzit. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar të denjë përveç Allahut i cili është një, pa rival.

Ai [Subhanehu ue Te'Ala] urdhëroi ruajtjen e begative me falënderim dhe ndaloi përbuzjen e tyre. Dëshmoj se Muhamedi [sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem] është rob dhe i dërguar i Allahut që e dërgoi Allahu [Subhanehu ue Te'Ala] për t'i përsosur vlerat e moralit, t'i udhëzojë njerëzit kah rruga më e drejtë. Dërgimi i tij ishte mëshirë për botët, argument i të gjithë krijesave, salavatet dhe selamet e Allahut qofshin mbi të aq herë sa ndërrohet dita me natën, mbi familjen dhe shokët e tij mirëbërës dhe të pastër.

Njerëz! Keni frikë Allahun dhe falënderoni Atë për begatinë e Islamit. Para jush keni një fe madhështore që e zgjodhi Allahu [Subhanehu ue Te'Ala] për ju dhe më këtë ju nderoi me fenë e babait tuaj Ibrahimit [sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem]. Kjo fe përmban gjithë atë që përmbanin fetë e pejgamberëve para Muhamedit, është pra, rezyme dhe fund i tyre. Allahu [Subhanehu ue Te'Ala] thotë: **“Ai u përcaktoi juve fe atë që i pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thirrni ata. All-llahu veçon për të (për besim të drejtë) atë që do dhe e udhëzon atë që i drejtohet Atij.”**(Shura – 13)

Pejgamberi juaj është më i miri që e njohu e tërë njerëzia, ai është më i epërmi i pejgamberëve dhe vula e të tyre. Nëpërmjet tij Allahu [Subhanehu ue Te'Ala] e plotësoi begatinë e tij, i largoi errësitat e injorancës, politeizmit, padrejtësisë dhe armiqësisë, Allahu [Subhanehu ue Te'Ala] thotë: **“Është e vërtetë se All-llahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t'u lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kur'anin dhe sheriatin, edhe pse, më parë ata ishin krejtësisht të humbur.”** (Ali imran – 164)

Zoti juaj ju porositi që të kapeni për këtë fe dhe të pasoni këtë pejgamber, Allahu [Subhanehu ue Te'Ala] thotë: **“Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni”** (En'am – 153)

Muslimanë! Para nesh kemi rrugën e lumturisë të hapur, e pse pra të mos e ndjekim? Para nesh kemi rrugën e fitores dhe shpëtimit të qartë, e përse largohemi nga ajo dhe e lëmë pas dore dhe pasojmë rrugën e prapambetjes, dëshpërimit dhe humbjes. A nuk e vëreni se feja juaj tenton që t'ju udhëzojë në rrugën e drejtë e ju largoheni prej saj. A mos vallë keni lexuar në mësimet e kësaj feje diçka që ju largon nga punët e mira dhe virtytet e larta dhe i keni lënë pas dore? Jo, assesi, feja e Allahut e cila do të mbetet rruga e lumturisë deri në ditën e kiametit, nuk ka virtyt që nuk nxitë në përfitimin e tij, e as që ka ves e që nuk tërhoqi vërejtjen nga shëmtimi i tij dhe sqaroi përfundimin e keq. E ç'po ngjan me ne që ecim jo në rrugën e udhëzimit dhe imitojmë jobesimtarët në gjëra që i ndaloi Islami? Shumica e kanë nënvlerësuar çështjen e fesë dhe të drejtat e saj. Obligimet i lanë pas dore, vetes së tyre i dhanë guxim që t'i shkelin urdhrat e Allahut. Fenë e zëvendësuan me etikën e jobesimtarëve, zakonet e tyre e **“Sa këmbim i shëmtuar është ai i jobesimtarëve!”** (Kehf – 50)

Muslimanë! Besimtari i vërtetë nuk pajtohet që fenë e tij ta zëvendësojë me diçka tjetër sado që mundohen jobesimtarët dhe sado që mashtrojnë ata, apo e mundojnë atë. Ai mbetet i palëkundshëm para çdo sprovimi, i kapur fortë për besimin e tij. Ky është Bilali, muezini i Pejgamberit [sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem] dënimi ndaj tij aq shumë vështirësohet saqë e hedhin të shtrirë në shpinë në nxehtësinë e tokës së Mekes e mbi gjoksin e tij vendojnë një gurrë të madh duke kërkuar prej tij që të braktisë fenë, mirëpo më gjithë këtë ai mbetet i palëkundshëm duke thënë: një dhe vetëm një. Hubjeb ibën Rebië, i thotë atij Museleme el Kedhabi[1]: thuaj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut – e ai e thoshte këtë, pastaj vazhdonte: thuaj: dëshmoj së Muselemeja është pejgamber i Allahut, e ai thoshte: nuk të respektoj në këtë. Muselemeja ia copëtonte trupin dalëngadalë e ai refuzoi të dëshmojë për pejgamberinë e tij derisa ndërroi jetë duke shpresuar tek Allahu shpërblim. Abdullah ibën Hudhafe Sehmijin e robëron mbreti krishterë dhe i thotë atij: më paso mua të bëj ortak në pasurinë time, ai refuzonte duke thënë: nuk dua zëvendësim për fenë e Muhamedit. Mbreti urdhëroi që të sjellin një kazan në të cilin vlonte hekuri për të gjuajtur Abdullahin. Abdullahi kur u gjend para këtij kazani filloi të qajë e mbreti mendoi se ai do të ndryshonte mendimin dhe e pyeti: do të braktisë fenë e Muhamedit apo do të dënohesh? Ai ia ktheu: nuk qajë për vetveten, por dëshirova që të kisha jeta aq sa kam qime në flokë dhe t'i shpenzoja të gjitha në rrugë të Allahut dhe të hy në xhenet pa dhënë llogari. Ammar ibën Jasiri babai dhe nëna e tij Sumeja u torturuan që të lënë fenë islame, mirëpo duruan mundimet, u kapën për fenë islame e Pejgamberi [sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem] kur kalonte pranë tyre u thoshte: durim oj familja e Jasirit se vendtakimin e keni në xhenet. Habbab ibën Erti u dënua për shkak besimit të tij. Politeistët e gjuajtën në zjarr të cilin e fiku shpina e tij, e ai me durim të plotë nuk u lëkund nga ideali islam.

Muslimanë! Këto janë vetëm disa shembuj që shfaqin qëndrueshmërinë e plotë të muslimanëve me gjithë torturat që i përjetuan, përveç kësaj shtojë edhe

faktin që ata kontribuuan për të mirën e kësaj feje dhe përhapjen e saj duke dhënë shpirtat dhe pasuritë e tyre. Qindra prej tyre ranë dëshmorë nëpër beteja të ndryshme, e për ta kjo ishte lakmi dhe mburrje. Ata lanë për këtë ideal shtëpitë dhe pasuritë e tyre, ata me këtë kërkonin kënaqësinë e Allahut dhe pajtimin e tij, ata ndihmuan Allahun dhe të Dërguarin. Tërë këtë për shkak se ata kuptuan mirësinë e kësaj feje dhe lumturinë e vërtetë.

Dashuria ndaj kësaj feje u skalit në zemrat e tyre aq sa feja për ta bëhet më e mirë se sa shpirtat e tyre, fëmijët e tyre, pasuritë dhe vendbanimet e tyre, derisa njëri prej tyre ka thënë: nëse të paraqitet ndonjë sprovë, jepe pasurinë tënde para shpirtit, e nëse sprova kërkon më tepër jepe shpirtin përpara fesë tënde.

Robër të Allahut! Ç'mund të themi për shumë njerëz të cilët emërtohen me emrin e Islamit që mësimet e kësaj feje i konsiderojnë të pavlefshme deri në pikë të fundit dhe që për zëvendësim i marrin mësimet e kufrit **(mosbesimit)?!**

Ç'është me ta që po refuzojnë gjykimin e Islamit dhe për ligj të tyre zgjedhin sistemet dhe kanunet e kufrit? Ç'po ndodh me shumë muslimanë të cilët ju përngjajnë me jobesimtarët në pamjen, veshjen, fjalët e tyre, madje edhe në mënyrën e të ushqyerit?! Rruajnë mjekrat e tyre, lëshojnë tepër mustaqet, lëshojnë flokë të gjata, zgjasin thonjtë, vendojnë unaza të arit, ushqehen me dorë të majtë? Ç'është me këtë musliman dhe atë që është rritur në ambient të teuhidit **(besimit të pastër në Allahun)** dhe nën flamurin la ilahe il-lallah e që shkon në vendet e jobesimtarëve, i shoqëron ata në pirjen e alkoolit, ngrënien e mishit të dërrit dhe veprimin e gjërave tjera të fëlliqura e pastaj kthehet te ne duke e injoruar fenë dhe vlerat tona, mundohet që vendet tona t'i shndërroj në pjesë të vendeve të jobesimtarëve?!

Njeriu i këtyllë është dëm i madh për popullin e tij. Ai ka shkuar në vendet e jobesimtarëve për të studiuar lëmi të ndryshme për të cilat ka nevojë vendi i tij, mirëpo kthehet pa fe dhe pa moral madje as që mëson diçka të dobishme. Shumë prej perëndimorëve kur shohin këta njerëz ndalen dhe ngurojnë në pranimin e Islamit sepse mendojnë se mu këta janë ata që përfaqësojnë Islamin kështu që bëhen prej atyre që pengojnë nga rruga islame.

Musliman! Feja juaj është madhështore, ajo përmban mirëqenien e njerëzimit.

Nëse për ju është e lirë, ajo nuk është e tillë për ata që shohin me sy të realët dhe që kërkojnë shkaqet e lumturisë: **“Po nëse ju i ktheni shpinën, Ai do t’ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju.”** (Muhamed-38)

Feja juaj kërkon që të jeni të sinqertë, durimtarë, që ndihmoni këtë rrugë dhe pengoni armiqtësinë ndaj saj, e nëse jo atëherë do t’ju ikë nga dora dhe do të shkoi te tjerët kështu që do të humbni këtë botë dhe tjetrën: **“Po nëse ju i**

ktheni shpinën, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju.” (Muhamed-38)

Kërkoj mbrojtje tek Allahu nga shejtani i mallkuar: **“O ju që besuat! Kush largohet prej nga feja e vet (i bën dëm vetes) s’ka dyshim se All-llahu do të sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin), (një popull) që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve, që lufton në rrugën e All-llahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo (cilësi e atij populli) është dhuratë e All-llahut që i jep atij që do. All-llahu është dhurues i madh, i dijsëm.”**
(Maide – 54)

[1] - Kedhab d.m.th. gënjeshtarë, u quajt kështu sepse ai pretendonte pejgamberinë pas Muhamedit, sh.p.

25 - VEÇORITË E MUAJIT RAMAZAN.

Falënderimi i takon vetëm se Allahut, i Cili na ligjësoi muajin e Ramazanit. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të vërtet vetëm se Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, që është Një dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju musliman, frikojuni Allahut dhe falënderoni Atë. Dijeni se prej urtësisë së madhe të Tij është ta veçon kë të donë prej krijesave të Tij dhe ta dallon njërën krijesë nga tjetra. Disa nga njerëzit i bëri të dallohen nga të tjerët dhe disa vende i bëri të dallohen nga vendet tjera dhe poashtu disa periudha i bëri të dallohen nga periudhat tjera dhe Allahu prej tyre e veçoi dhe dalloi muajin e Ramazanit prej muajve tjerë dhe në Kuran tha: **“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)”**.
(Bekare 185)

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i qartësoi edhe më gjerësisht veçoritë e muajit Ramazan me një hadith të cilin na e përcjell Selman el Farisij, radijAll-llahu anhu, dhe i cili thotë: “I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, na ligjëroi në ditët e fundit të muajit Shaban dhe tha: **“O ju njerëz, po afrohet një muaj i madh dhe i bekuar. Në këtë muaj është një natë që është më e mirë se njëmijë muaj. Gjatë këtij muaji Allahu e ka bërë agjërimin të detyrueshëm dhe faljet gjatë natës të lavdërueshme. Ai që e kryen një punë të mirë vullnetare gjatë këtij muaji, është si të ketë kryer një punë të detyrueshme në çdo kohë tjetër. Ai që kryen një vepër të**

detyrueshme është si të ketë kryer 70 punë të detyrueshme në çdo kohë tjetër. Ky është muaji i durimit dhe shpërblimi i durimit është xheneti. Ky është muaji i barazisë dhe bujarisë dhe bamirësisë. Në këtë muaj furnizimi i besimtarit rritet. Kushdo që i jep ushqim një agjëruesi këtë muaj, kjo do të bëhet shkak që atij t'i falen mëkatet, do të shpëtojë nga zjarri dhe ai do ketë shpërblimin e tij pa i hequr personit që ushqehet asnjë pjesë të shpërblimit të tij”.

Njerëzit i thanë: **“O i Dërguar i Allahut, nuk mundet çdokush prej nesh të ushqejë ndonjë agjërues”**. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, u përgjigj: **“Allahu e shpërblen atë që ushqen një agjërues me hurmë, ujë ose qumësht. Fillimi i këtij muaji është mëshirë, mesi falje kurse fundi shpëtim nga zjarri. Atë që jep nga pasuria e vet, Allahu e mëshiron dhe e shpëton nga zjarri. Shtoni në këtë muaj katër gjëra: me dy fitoni pëlqimin e Allahut kurse me dy tjera jeni të detyruar. Dy të parat janë: dëshmia se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë përveç se Allahut dhe kërkimi për faljen e mëkateve, kurse dy të fundit janë: kërkoni prej Allahut xhenetin dhe mbështetuni në mbrojtjen e Tij nga zjarri. Kush i jep ujë agjëruesit, Allahu i jep atij prej lumit tim dhe nuk ndien etje derisa të hyjë në xhenetin e Allahut”**.

O ju robërit e Allahut, në këtë hadith janë të qartësuara gjerësisht veçoritë e muajit Ramazan dhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e ka përshkruajtur këtë muaj si të madh dhe të bekuar. Këto dy cilësi i japin një veçori të posaçme muajit Ramazan kundruall muajve tjerë. Çdo çast i këtij muaji përshkruhet se është i madh dhe i bekuar. I bekuar në kohë, i bekuar në vepër dhe i bekuar në shpërblim. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, lajmëroi se në të është një natë që është më e mirë se njëmijë muaj. Ajo natë është nata e Kadrit dhe muaji Ramazan veçohet me të për arsye se ajo natë nuk gjendet në muajt e tjerë. Ajo natë është më e mirë se çdo natë tjetër dhe në Kuran përshkruhet me cilësi të mëdha.

Ajo është nata kur zbriti Kurani: **“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit”**. (Kadër 1) Ibën Abasi, RahimehUllah, e cek se Kurani ka zbritur i kompletuar në qiellin e parë të dynjasë, i cili njihet me emrin Bejtul Iz'zeh, dhe kjo ka ndodhur natën e Kadrit. Ajo natë është nata e bekuar ashtu siç e përshkruan Allahu në Kuran: **“Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar”**. (Duhan 3) Ajo është nata kur zbresin melekët me mirësi: **“Melekët dhe Shpirti (Xhibrili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë”**. (Kadër 4) Ajo është nata kur vendoset përcaktimi vjetor: **“Në atë (natë të zbritjes së Kuranit) vendoset çdo punë e urtë”**. (Duhan 4) Ajo natë e tëra është paqe: **“Paqe është ajo deri në lindjen e agimit”**. (Kadër 5) Ajo natë e madhe me begatitë dhe mirësitë e saj është një nga veçoritë e muajit Ramazan.

Prej veçorive tjera që i qartësoi Muhamedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në këtë hadith është se gjatë këtij muaji Allahu e ka bërë agjërimin të

detyrueshëm dhe faljet gjatë natës të lavdërueshme. Agjërimi gjatë ditës në këtë muaj është një prej shtyllave të Islamit dhe me përfshirjen e një prej shtyllave të Islamit gjatë këtij muaji ky muaj veçohet prej muajve tjetër. Poashtu veçohet edhe me faljen e teravive, i cili është një prej namazeve të lavdërueshme, dhe falja e tij nuk ligjësohet jashtë këtij muajit.

Prej veçorive tjera që i qartësoi Muhamedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në këtë hadith është se shtohen sevapet në këtë muaj. Puna vullnetare në sevap është si sevapi i një pune të detyrueshme në çdo kohë tjetër dhe puna e detyrueshme në sevap është si të ketë kryer 70 punë të detyrueshme në çdo kohë tjetër. Nuk dihet se sevapet shtohen në një muaj tjetër si në muajin e Ramazanit dhe kjo veçori e bën këtë muaj të veçohet prej muajve tjerë.

Prej veçorive tjera të këtij muaji është se ky muaj është muaj i durimit. Muslimani bën durim nga largimi i epsheve dhe bën durim në vështirësitë e adhurimeve. Durimi është një nga nënshtrimet më të rënda për shpirtat dhe për këtë arsye shpërblimi i tij është xheneti: **“Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë”**. (Zumer 10)

Prej veçorive tjera të këtij muaji është se ky muaj është muaj i bujarisë. Bujaria e Allahut në këtë muaj shfaqet me faljen e robërve të Tij dhe lirimin e tyre prej zjarri të xhehenemit. Kurse bujaria mes robërve shfaqet me barazinë mes tyre, ushqimin e të varfërve, ushqimin e agjëruessve dhe me butësinë mes tyre.

Prej veçorive tjera të këtij muaji është se ky muaj është muaj i mëshirës mes njerëzve dhe muaj i zbritjes së mëshirës prej Mëshiruesit. Pasaniku e mëshiron të varfrin, i forti e mëshiron të dobëtin, sunduesi e mëshiron atë që është nën pushtetin e tij, kurse ata që mëshirojnë Allahu i mëshiron.

Poashtu prej veçorive të këtij muaji është shumëllojshmëria e mirësive në të. Fillimi i tij është mëshirë, mesi i tij është falje kurse fundi i tij lirim prej zjarri.

O ju robërit e Allahut, është e pamundur që një muaj t'i posedon këto cilësi dhe veçori dhe njeriu mos të gëzohet me ardhjen e tij. Për këtë arsye i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e luste Allahun që t'ia mundëson ta arrin muajin Ramazan dhe kur hynte muaji Rexheb thonte: **“O Zot, bekona në muajin Rexheb dhe Shaban dhe mundësona ta arrijmë muajin Ramazan”**. Kurse të parët tanë e lusnin Allahun gjashtë muaj që t'ua mundëson që ta arrijnë muajin Ramazan, e pasi që e arrinin e lusnin edhe gjashtë të tjera që tua pranon muajin Ramazan. Shkaku i kësaj lutjeje ishin adhurimet e shumta dhe mirësitë e shumëllojshme që i jepte ky muaj.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat. Agjërimi zgjat disa ditë, por, nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e**

tjera pas. Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të. Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini. Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është I sëmure ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t'jua lehtësojë dhe jo që t'jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimin dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimin), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë". (Bekare 183-185)

26 - DOBITË DHE ETIKA E AGJËRIMIT.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu s'ka kush e lajthit dhe kë e largon nga rruga e vërtet Ai s'ka kush e udhëzon.

Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të vërtet vetëm se Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, që është Një dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju muslimanë,

Frikojuni Allahut dhe falënderoni Atë që na mundësoi ta presim muajin e Ramazanit shëndoshë e mirë. Dijeni se agjërimi është një ndër adhurimet më të dobishme dhe gjurmët e tij në pastrimin e shpirtit dhe në përmisimin e moralit janë shumë të mëdha.

Prej dobive të agjërimin është se ai në shpirtin e muslimanit mbjell frikërespekt dhe devotshmëri ndaj Allahut, Subhanehu ue Te'Ala: **“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”** (Bekare 183)

Prej dobive të agjërimin është se ia mëson njeriut përballjen dhe durueshmërinë, dhe kjo vjen si rezultat i durimit të tij prej largimit nga epshet dhe pasionet.

Prej dobive të agjërimit është se ia mundëson njeriut të del fitimtar kundrejt epshit të tij. Shpirti i njeriut fort anon kah epshet dhe pasionet dhe kur shpirtit i plotësohet dëshira që gjithmonë ta merr atë çka e dëshiron, atëherë njeriu është në rrezik të madh prej devijimeve që përfundimi i tyre padyshim se është i keq. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Shpirti (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im.”** (Jusuf 53)

Prej dobive të agjërimit është se e dobëson lëvizjen e shejtanit në trupin e njeriut, për shkak se ai lëviz në trupin e birit të Ademit ashtu si lëviz gjaku i tij në trup. Kur njeriu ia mundëson vetes të gjitha gjërat që i dëshiron epshi i tij, ia hap derën shejtanit të depërton më lehtë dhe ta mbisundon mendjen dhe shpirtin e njeriut.

Prej dobive të agjërimit është se ai ia rikujton njeriut begatitë e Allahut ndaj tij. Kur e kaplon etja dhe uria i rikujtohet se Allahu ia lehtëson atij furnizimin e ushqimeve dhe pijeve dhe e sheh se sa ka nevojë krijesa për Krijuesin dhe me këtë e rrit falënderimin ndaj Tij.

Prej dobive të agjërimit është se ai e nxit njeriun në bamirësi ndaj fukarave dhe nevojtarëve. Agjëruesin kur e kaplon uria dhe etja i rikujtohet gjendja e fukarave dhe kjo e nxit në bamirësi dhe lëmoshë ndaj tyre.

Prej dobive të agjërimit është se e mposht kryelartësinë dhe mendjemadhësinë ndaj njerëzve. Kur agjëron i pasuri dhe fukaraja, mbreti dhe dijetari, fisniku dhe tradhtari, atëherë robët i rikujtohet se nuk e dallon njërën prej tjetrit, përveç se devotshmëria dhe se njerëzit të gjithë janë robër të Allahut dhe për të gjithë vlejné të njëjtat dispozita.

Prej dobive të agjërimit është se i bashkon muslimanët dhe i afron njërën me tjetrin. Ata agjërojnë në të njëjtën kohë, e hanë iftarin në të njëjtën kohë dhe kjo ndikon në afrimin e tyre dhe largimin e përçarjeve dhe mosmarrëveshjeve.

Prej dobive të agjërimit poashtu është se e lehtëson veprimin e adhurimeve. Kush e vëren gjendjen e agjëruesve në Ramazan, adhurimet e tyre dhe mirësitë që i veprojnë ata, do të bindet se agjërimi është një prej shkaqeve kryesore të udhëzimit dhe e kupton thënien e Allahut, Subhanehu ue Te'Ala: **“Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju”** (Bekare 184), dhe thënien e Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“Agjërimi është mburojë.”**

Dhe në fund prej dobive të agjërimit është se e mbron trupin prej sëmundjeve dhe zemrën prej moraleve të shëmtuara.

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve dhe qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju agjërues, Djeni se agjërimi ka disa etika që duhet të respektohen.

Agjërues është ai person të cilit gjymtyrët e tij agjërojnë prej mëkateve dhe gjuha e tij prej gënjeshtre, përgojimi dhe shpifjes. Barku i tij prej ushqimi dhe pijeve dhe organi i tij prej epsheve. Flet fjalë që nuk e dëmtojnë agjërimin e tij, vepron vepra që nuk janë në kundërshtim me fenë e tij. Fjalët dhe veprat e tij i përngjajnë erës së cilën e nuhat ai që ulet afër personit i cili është i parfymosur me miskë. Çdo njëri dëshiron t'i afrohet për shkak se ndeja me të është kënaqësi e madhe, dhe se aty nuk përgojohet, nuk barten fjalë dhe nuk dëmtohet askush. Ky është agjërimi i kërkuar prej muslimanit, e jo vetëm se largimi prej ushqimit dhe pijeve.

Prej etikës së agjërimin është që agjëruesi mos ta tepron me ushqim gjatë natës, por të han aq sa ka nevojë trupi i tij. Çdo ngrënie e tepërt trashëgon dembeli dhe përtaci dhe e largon agjëruesin prej qëllimit të vërtet të Ramazanit.

Prej etikës së agjërimin është vonimi i syfyrit me qëllim që të fillon me agjërim me hyrjen e imsakut. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Dhe hani e pini derisa të dallohet fija e bardhë (bardhësia) e agimit nga fija e zezë (errësira e natës), pastaj plotësojeni agjërimin derisa të bjerë mbrëmja”** (Bekare 187)

Prej etikës së agjërimin është përsheptimi i iftarit nëse vërtetohet se dielli ka perënduar qoftë me pamje ose me dëgjimin e ezanit të akshamit.

Disa njerëz bien në disa gabime gjatë muajit të Ramazanit edhe atë duke mos fjetur një pjesë të madhe të natës, e pastaj e hanë syfyrit dhe bien në gjumë një orë ose më shumë para namazit të sabahut. Ky lloj njerëzish bien në disa gabime, prej tyre:

01 - Ata e fillojnë agjërimin para kohës kur detyrohet agjërimi (d.m.th. para se të hyn koha e imsakut).

02 - Ndoshta nuk e falin namazin e sabahut me xhemat dhe kështu i bëjnë mëkat Allahut duke e neglizhuar atë që ua ka obliguar.

03 - Ndoshta nuk e falin namazin e sabahut në kohën e duhur, dhe e falin pasi që të lind dielli. Kjo është një rrezik i madh për to për shkak se Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: “Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet” (Maunë 4-5), dhe “Pas atyre erdhën brezni, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epsheet e veta” (Merjem 59)

Pakujdesshmëria dhe braktisja që ceken në dy ajetet e lartpërmendura aludojnë në atë që nuk e fal namazin në kohën e tij të duhur.

O ju robërit e Allahut,

Frikojuni Allahut dhe mos e ndërtoni fenë e juaj në një anë duke e shkatërruar anën tjetër. Islami është i ndërtuar prej pesë shtyllave: Dëshmia se nuk i takon adhurimi askujt me të vërtet vetëm se Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij, pastaj falja e namazit, dhënia e zeqatit, agjërimi i Ramazanit dhe shkuarja në Haxh, prandaj praktikoni fenë e juaj dhe mos u përçani në të.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat. Agjërimi zgjat disa ditë, por, nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera pas. Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të. Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini.”** (Bekare 183-184)

27 - PËRGËZIMI ME ARDHJEN E MUAJIT RAMAZAN.

Falënderimi i takon vetëm Allahut i cili e bëri muajin e Ramazanit zotëri të gjithë muajve dhe shumëfishues të mirësive dhe veprave. Atë e falënderoj dhe lavdëroj dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkoj. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi imamin e agjëruesve dhe shëmbëlltyrën e shpenzuesve dhe modelin e të devotshmëve Muhamedin birin e Abdullahit dhe robin e Allahut.

O ju musliman, frikojuni Allahut dhe falënderoni shumë Atë nëse ua mundëson që ta arrini muajin e Ramazanit dhe kërkonit prej Tij që t'ju begaton e ta shfrytëzoni këtë muaj në agjërime, namaze vullnetare dhe adhurime tjera. Ramazani është sezon i madhërishtëm dhe mejdan i gjerë në veprimin e mirësive dhe faljen e gjynaheve. Njiheni vlerën e tij dhe madhëroni çështjen e tij dhe pajiseni vetveten në këtë muaj me vepra të mira dhe mirësi.

Agjërimi i muajit Ramazan është një prej shtyllave të Islamit dhe detyrë e çdo muslimani. Allahu urdhëroi në agjërimin e tij dhe ia detyroi çdo robi të Tij duke thënë: **“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi”**. (Bekare 183), dhe **“Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë!”**. (Bekare 185) Detyrohet çdo musliman i rritur dhe me mendje të shëndoshë ta agjëron muajin e Ramazanit. Nëse është i sëmurë me sëmundje që ka shërim dhe nuk mundet t'i përballojë agjërimin apo është udhëtar në rrugë të gjatë lirohet prej

agjërimit dhe ato ditë i zëvendëson me ditë tjera: **“Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar”**. (Bekare 185) Nëse është në pleqëri të thellë apo i sëmurë me sëmundje që s'ka shërim dhe nuk mundet t'i përballon agjërimit, atëherë ai nuk agjëron dhe për çdo ditë e ushqen nga një të varfër dhe nuk i zëvendëson ato ditë me ditë tjera: **“Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi”**. (Bekare 184) Ibën Abasi, radijAll-llahu anhu, thotë: **“I është lehtësuar të moshuarit në vite që nuk mundet t'i përballon agjërimit të mos agjëron dhe ta ushqen nga një të varfër për çdo ditë”**.

Gruaja me menstruacione dhe lehona nuk u lejohet të agjërojë dhe ato ditë që nuk i agjërojë i zëvendësojnë me ditë tjera. Aisha, radijAllahu anha, kur është pyetur, se: Pse gruaja me menstruacione e bën kaza agjërimit dhe nuk e bën kaza namazin, ajo është përgjigjur, se kështu ka qenë praktika e grave gjatë kohës kur ishte gjallë i Dërguari, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem.

Fëmija i cili ende nuk e ka arritur moshën e pjekurisë nuk është i detyruar të agjëron, mirëpo nëse ka mundësi t'i përballon agjërimit e urdhërojmë që të agjëron me qëllim që të kalitet dhe ta stërvit shpirtin në adhurim dhe agjërimi i tij i pranohet si vullnetar.

O ju robërit e Allahut, me agjërim nënkuptojmë abstenim apo përmbajta nga ushqimet, pijet dhe marrëdhëniet bashkëshortore për hir të Allahut, prej insakut e deri në perëndimin e diellit. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Tani është e lejuar për ju që, gjatë netëve të agjërimit, të shkoni me bashkëshortet tuaja. Dhe hani e pini derisa të dallohet fija e bardhë (bardhësia) e agimit nga fija e zezë (errësira e natës), pastaj plotësojeni agjërimit derisa të bjerë mbrëmja. Mos iu afroni atyre (bashkëshorteve) gjatë kohës kur mbylleni për adhurim në xhami! Këta janë kufijtë e Allahut, prandaj mos iu afroni atyre! Kështu, pra, Allahu ua shpjegon njerëzve urdhëresat e veta, që ata të ruhen nga të këqijat”**. (Bekare 187)

Allahu na qartësoi në këtë ajet se fillimi i agjërimit është prej agimit e deri në perëndimin e diellit. Për këtë arsye Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, nxiti që të vonohet syfyri dhe të përshpejtohet iftari me qëllim që të përfundon syfyri me agim dhe të fillon iftari me perëndimin e diellit dhe me këtë t'i përshtatet urdhrin të Allahut dhe dispozitave të Tij. Nuk është prej traditës së Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ngrënia e syfyrit herët dhe vonesa e iftarit pas perëndimit të diellit. Poashtu nuk lejohet ngrënia e syfyrit pas agimit dhe ngrënia e iftarit para se të perëndon dielli dhe ai që e vepron këtë me qëllim nuk i pranohet agjërimi.

Agjërimit e prish ngrënia dhe pija me qëllim dhe çdo gjë që ka të njëjtat efekte si ushqimi dhe pija, si barnat, gjilpërat me vitamine, etj. Poashtu e prish të

vjellët qëllimisht, por nëse ndonjë vjell pa qëllim, kjo nuk e prish agjërimin. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kujt i përzihet dhe vjell nuk është i detyruar ta plotësojë atë ditë më vonë”** dhe **“Kush vjell me qëllim, duhet ta plotësojë (agjërimin) më vonë”**.

Prej gjërave që e prishin agjërimin është edhe nxjerrja e gjakut me hixhame ose pastrim gjaku. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“E ka prishur agjërimin ai që bën hixhamen dhe atij që i bëhet hixhamja”**.

Prej gjërave që e prishin agjërimin është edhe dalja e spermës për shkak të ledhatimit apo puthjes, masturbimi, menstruacionet dhe lehonja.

Poashtu prej gjërave që e prishin agjërimin është edhe marrëdhëniet bashkëshortore gjatë ditës së agjërimit. Ai i cili e bën këtë vepër duhet ta zëvendëson atë ditë me ditë tjetër dhe të shpague. Shpagimi është lirimi i një robi, nëse nuk ka mundësi agjërimi i dy muajve njëri mbas tjetrit, nëse nuk mundet atëherë ushqimi i gjashtëdhjetë të varfërve. Përrjashtohet nga ajo që përmendëm rasti kur bashkëshortët janë udhëtarë dhe kryejnë marrëdhënie duke qenë agjërueshëm, sepse agjërimi për udhëtarët nuk është i detyruar, për ata kërkohet që ta kompensojnë këtë ditë pas Ramazanit.

O ju musliman, gjërat e lartpërmendura që e prishin agjërimin janë perceptuese dhe ai që i vepron detyrohet me kaza. Ekzistojnë edhe gjëra morale që e dëmtojnë agjërimin duke ia humbur shpërblimin apo pakësuar dhe vepruesi i saj nuk detyrohet me kaza. Prej tyre është përgojimi, bartja e fjalëve, sharja, ofendimi, shpifja, shikimi në atë që e ka ndaluar Allahu të shikojmë, dëfrimi me muzikë dhe instrumente muzikore, etj.

Ebu Hurejre, radijAll-llahu anhu, thotë se Muhamedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Agjërimi mbron nga morali i keq sepse ai që agjëron nuk flet gjëra të turpshme dhe nuk bërtet. Nëse (eventualisht) e shanë ndokush ose e sulmon, le të thotë: “Unë agjëroj, unë agjëroj”**.

Ebu Hurejre, radijAll-llahu anhu, thotë se Muhamedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Zoti nuk ka nevojë për njeriun që e braktisë ushqimin e pijen e nuk e braktisë fjalën e keqe dhe veprën e ligë”**.

Nëse agjëruesi hanë apo pinë me harresë nuk i prishet agjërimi. Ebu Hurejre, radijAll-llahu anhu, thotë se Muhamedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kush harron gjatë agjërimit e pinë dhe han, le ta vazhdojë agjërimin sepse Zoti e ka ushqyer dhe i ka dhënë të pijë.”**

Agjëruesit i lejohet të nuhat erën e parfumeve, kjo nuk ndikon në agjërimin e tij. Poashtu i lejohet të flladitet me ujë duke e shpërlarë gojën ose duke e larë kokën ose duke e larë tërë trupin ose duke hyrë në një vend të ftohët për arsye se kjo i ndihmon gjatë agjërimit. Nëse i depërton pluhuri apo avulli apo ndonjë

insekt në gojë nuk i prishet agjërimi për arsye se kjo ndodh pa dëshirën e tij. Nëse dikush ka rrjedhje gjaku nga hundët apo nga dhëmbët edhe kjo nuk e prish agjërimin, pasi kjo nuk është në dorën e njeriut, është diçka e paqëllimshme. Nëse dikush e nxjerr dhëmbin dhe del gjak edhe kjo nuk e prish agjërimin.

O ju musliman, ruani agjërimin e juaj prej gjërave që e prishin agjërimin. Veproni vepra të mira, shpeshtoni lutjet, përmendjen e Allahut dhe leximin e Kuranit në këtë muaj dhe jeni të sinqertë në të gjitha veprat e juaj dhe kërkoni prej Allahut që t'ua pranon veprat.

28 - DHJETË DITËT E FUNDIT TË MUAJIT RAMAZAN.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon vetëm Allahut i cili i bëri disa periudha dhe vende të vlefshme dhe të dobishme për robërit e Tij. Atë e falënderoj për të gjitha të mirat që na i dhuroi. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të vërtet vetëm se Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, që është Një dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju muslimanë, keni frikë Allahun dhe dijeni se jeni në prag të dhjetëshit të begatshëm të fundit të muajit të Ramazanit. Këto ditë Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, këto ditë veçoi me vlera dhe shpërblime të mëdha dhe mirësi të shumta.

Prej veçorive të këtyre ditëve është se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në këto ditë ishte më bujar në adhurime se sa në ditët e tjera.

Imam Muslimi në Sahihin e tij shënon se Aisha, radijallahu anha, ka thënë: Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ishte më bujar në adhurime në dhjetë ditët e fundit se sa në të tjerat.

Aisha, radijallahu anha, në një hadith tjetër na rrëfen se kur hynim në dhjetëshin e fundit Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, këto ditë, i shtonte punët e mira më shumë se në ditët e tjera”.

Poashtu thonte se: **“Kur hynte dhjetëditëshi i fundit, Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, shtrëngonte izarin, falte namaz gjithë natën dhe për këtë zgjonte edhe pjesëtarët e familjes.”**

Prej haditheve të lartpërmendura del në pah se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në dhjetëshin e fundit iu përkushtonte adhurimeve dhe u largonte prej detyrimeve të tjera. Mejdani i adhurimeve të tij në këto ditë ishte i gjerë duke filluar prej namazit, leximit të Kuranit, pendimit, istigfarit, lëmoshës e të tjerave.

Prej veçorive të këtyre ditëve poashtu është edhe falja e namazit të natës dhe zgjatja e tij duke qëndruar më gjatë në ruku dhe sexhde. Është mirë që të zgjohet familja dhe fëmijët që të marrin pjesë së bashku me muslimanët në paraqitjen e këtij rituali dhe të marrin pjesë të gjithë në shpërblime dhe të edukohen në adhurime dhe në madhërimin e këtyre ceremonive fetare. Këtë çështje e neglizhojnë shumica e muslimanëve. I lejojnë që fëmijët e tyre të lozin nëpër rrugë dhe të edukohen prej rrugaçëve dhe nuk i marrin me vete në xhami. Rrinë deri natën vonë duke bërë muhabet dhe kur vjen koha për të falur namaz nate, flenë, duke u shpëtuar në këtë formë një sevap mjaft i madh, të cilin nuk mund ta gjejnë më gjatë atij viti. Nuk ka dyshim se ata i vë në lojë shejtani, i cili është betuar të largojë njerëzit nga bindja e Allahut. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, i thotë shejtanit: **“Sepse, ti ndaj robërve të Mi (të sinqertë) nuk ke kurrfarë force (as fizike e as mendore), përveç atyre të humburve që të vijnë nga pas.”** (Hixhr 42)

Disa thonë se namazi i natës është namaz vullnetar dhe mua më mjafton që të kujdesem vetëm se për farzin. Atyre u përgjigjemi se kujdesi jot për faljen e farzit është i mirëpritur dhe i kërkuar dhe ne e dimë se vetëm për atë do të japim llogari, mirëpo prej nga e di ti se namazet të cilat i fal i ke të plota apo të pranuar. Ne kemi nevojë për namaze vullnetare që t'i plotësojnë mangësitë e namazeve detyruese Ditën e Kiametit.

Ebu Hurejra, radijallahu anhu, thotë: “E kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, duke thënë: **“Gjëja e parë për të cilin do të jap llogari njeriu në Ditën e Gjykimit është namazi, andaj nëse namazin e ka në rregull, ka shpëtuar, e nëse namazin nuk e ka në rregull është shkatërruar. Nëse namazi i tij i është i mangët (jo i plotë), Allahu do të thotë:”Shikoni se mos ka robi im nafile, e plotësoni me nafile atë që e ka lënë mangu me farze. E pastaj do të jap llogari për veprat tjera”.**

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, çdo adhurimit detyrues ia shtoi edhe atë vullnetar vetëm e vetëm t'i bën dobi robit të Tij. Namazin e bëri detyrues dhe ia shtoi atë vullnetar, agjërimin e bëri detyrues dhe ia shtoi atë vullnetar. Poashtu haxhin e bëri detyrues dhe ia shtoi atë vullnetar, dhe kështu me radhë. Edhe në rast se adhurimeve ua jep të gjitha të drejtat e tyre që i meritojnë, prapëseprapë je i urdhëruar ta pasosh Muhamedin, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ndërsa ai e falte namazin e natës vazhdimisht, e mos të pyesim për dhjetëshin e fundit.

Aisha, radijallahu anha, i tha një njeriut: **“Mos e le namazin e natës, ngase i Dërguari i Allahut, alejhi salatu ue selem, nuk e linte, e kur sëmurej ose bëhej dembel, falej ulur”**.

O ju muslimanë,

Prej veçorive të këtyre ditëve është se në to kërkohet Nata e Kadrit për të cilën Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj”**. (Kadër 3)

Imam Nahaiju, RahimehUllah, thotë: **“Vepra në këtë natë është më e mirë se vepra në një mijë muaj të tjera”**.

Ndërsa një mijë muaj o ju robër të Allahut janë tetëdhjetë e tri vite e katër muaj. Vepra e vepruar në rast se përputhet në Natën e Kadrit është më e mirë se vepra që vepron në tetëdhjetë e tri vite e katër muaj tjera.

Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Ai që fal namazin e natës Natën e Kadrit me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen gjynahet që ka bërë”**.

Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e kërkonte këtë natë me shpresë se do të përfitonte të mira prej kësaj nate dhe ai është shembull për këtë umet. Është e pëlqyer që të kërkohet ajo natë gjatë dhjetë netëve të fundit të muajit. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kërkojeni natën e Kadrit në dhjetë netët e fundit të Ramazanit”**.

Është më e mundshme të jetë njëra prej netëve me numër tek duke u bazuar në hadithin e Aishes, e cila ka thënë se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kërkojeni natën e Kadrit në netët tek të dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit”**.

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut për begatin e Imanit dhe Islamit dhe Kuranit. Falënderimi i takon vetëm Allahut që na mundësoi ta presim muajin e Ramazanit Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju agjërues,

Prej veçorive të këtyre ditëve të begatshme është edhe Itikafi.

Itikaf do të thotë: **“Të qëndrosh në xhami për t'u veçuar në adhurimin e Allahut”**.

Itikafi është prej adhurimeve të bazuara në Kuran dhe në hadithe të sakta.

Aisha, radijallahu anha, transmeton se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, bënte Itikaf në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit derisa ndërroi jetë. **“Më pas në xhami bënin Itikaf gratë e tij”**.

Qëllimi i këtij adhurimi është që njeriu të qëndron në xhami që ta kërkon Natën e Kadrit dhe ta adhuron Allahun me namaz dhe lexim të Kuranit, me dhikër dhe dua dhe istigfar dhe nuk duhet të dal prej xhamisë vetëm se atëherë kur është e nevojshme.

Ngjallja e këtij adhurimi i cili është lënë pas dore në këtë kohë është më e mirë se Umreja. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në këtë muaj nuk e ka bërë Umren, ndërsa Itikafin nuk e linte derisa e takoi Zotin e tij. I shohim njerëzit garojnë mes veti në bërjen e Umres, ndërsa Itikafi është më me vlerë.

Kush nuk mundet të hyjë në Itikaf le të kujdeset për adhurimet e tjera detyruese dhe vullnetare, si shkuarja në xhami më herët dhe ndeja në të për lexim të Kuranit dhe dhikër dhe adhurim: **“Çfarëdo mirësie që bëni për shpirtin tuaj, me siguri që do ta gjeni tek Allahu. Ajo do të jetë më e mirë dhe më e shpërblyer”**. (Muzemil 20)

O ju muslimanë, Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj. Engjëjt dhe Shpirti (Xhibrili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.”** (Kadër 1-5)

29 - GJENDJA E NJERËZVE PAS RAMAZANIT.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu s'ka kush e devijon dhe kë e largon nga rruga e vërtet Ai s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të vërtet vetëm se Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, që është Një dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju musliman, ishit në muajin e mirësisë dhe begatisë, agjëronit ditën, u faleshit natën dhe u afroheshit kah Zoti i juaj me adhurime të ndryshme duke e shpresuar shpërblimin e Tij dhe duke kërkuar mbrojtje prej dënimit të Tij. Pastaj përfunduan këto ditë dhe e kaluat një periudhë të jetës së juaj e cila nuk do të kthehet më asnjëherë. Kështu janë ditët e jetës, periudha që do t'i kaloni ditë pas dite në rrugën e juaj për në ahiret. Ato e shkurtojnë jetën e juaj, u afrojnë kah exheli dhe ua ruajnë veprat të cilat i vepruat që të jepni llogari atë ditë kur të gjithë do të japin llogari: **“(Kini frikë) ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së keqes së tij, të ketë largësi të madhe”**. (Ali Imran 30)

Muaji i Ramazanit ishte shans i juaj që t'i ktheheni pendimit dhe veprave të mira. Të edukoheni në veprimin e adhurimeve dhe largimin nga ndalesat dhe të bëheni të durueshëm dhe në fund të dilni fitimtar kundrejt epshit të juaj i cili është fort i prirë për të keqe. Dijeni se ju nuk u ndatë nga ky muaj vetëm se i bëtë adhurimet gjëja më e dashur e zemrave tuaja dhe mëkatet gjëja më e urrejtur e shpirtrave tuaj. U edukuat me moral të lartë dhe u zgjuat prej shkujdesjes dhe e kuptuat vlerën e jetës dhe të adhurimeve.

Tani pasi që kaloi ky muaj mos iu ktheni mëkateve për arsye se Zoti i Ramazanit është edhe Zot i muajve të tjerë. Mos e shkatërroni atë që e ndërtuat me duart e juaja prej veprave të mira se prej shenjës së pranimit të veprës së mirë është pasimi i saj me të mirë. Kthimi në mëkate pas pendimit prej saj është krim dhe mëkat më i madh se sa para saj. Para jush e keni peshoren ku maten të mirat dhe të shëmtuarat e juaja: **“Ata, që u rëndohet peshorja (e punëve të mira), janë të shpëtuar. Sa për ata që do të kenë peshore të lehta, mu ata do të jenë (njerëzit) që kanë humbur vetveten, duke qëndruar përherë në Xhehenem”**. (Muminun 102-103)

Edhe pse kaloi Ramazani para jush e keni një sezon i cili përsëritet çdo ditë dhe çdo natë. Ai është namazi të cilin Allahu ia detyroi robërve të Tij pesë herë në ditë, të qëndrojnë para Tij, t'i luten dhe të shpresojnë mëshirën e Tij. Prandaj përgjigjuni thirrjes së Allahut se ajo dhe besimi janë shkaqe për faljen e mëkateve dhe mbrojtje prej dënimit. E kush nuk i përgjigjet thirrjes së Allahut për të nuk ka siguri dhe mbrojtje dhe ai është në humbje të thellë.

Poashtu para jush e keni edhe një sezon që përsëritet çdo javë e ajo është namazi i xhumasë dhe me të Allahu, Subhanehu ue Te'Ala,e veçoi këtë Umet. Në këtë ditë gjendet një orë nëse e takon një rob musliman duke u falur dhe kërkon prej Allahut diç, Allahu ia jep atë.

Poashtu para jush keni sezone të ndryshme ku në to ka adhurime të ndryshme ditën dhe natën. Depot e Allahut janë të plota. Ai është pasanik nuk ka nevojë për ne, por ne kemi nevojë për Atë dhe mëshirën e Tij në Ramazan dhe jashtë tij.

Si është gjendja e atyre që në këtë muaj i nënshtroheshin adhurimeve dhe pas kalimit të tij u ndërrua gjendja e tyre. U pyetën disa prej selefit për këtë lloj njerëzish dhe thanë: **“Sa njerëz të shëmtuar janë këta, nuk e njohin Allahun vetëm se në Ramazan.”**

Xhamitë në Ramazan ishin të mbushura me njerëz në pesë kohërat e namazit, ndërsa pas kalimit të tij gjurmët e tyre u zhdukën prej xhamive. Sikurse ata nuk kanë nevojë më për Allahun dhe se për ta obligimet u anuluan, ndërsa haramet u lejuan. Kërkoj mbrojtje tek Allahu prej devijimit pas udhëzimit, dhe prej kufrit pas imanit. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe mos i çoni dëm veprat tuaja!”**. (Muhamed 33)

Sikurse veprat e mira i shlyejnë të shëmtuarat poashtu të shëmtuarat i humbin veprat e mira. Thuhet se mëkati pas pendimit është më i shëmtuar se sa shtatëdhjetë para saj. Përcillet se një prej selefit para vdekjes qante dhe kur u pyet për shkakun tha: **“Qaj për ato natë që nuk fala namaz në to dhe për ato ditë që nuk munda të agjëroj në to”**. Këtë besimtar e vriste ndërgjegjja para vdekjes se nuk mundi të fal namaz nafile natën dhe të agjëron agjërim vullnetar ditën dhe parashtrohet pyetja se vallë si duhet të jetë ndërgjegjja e atyre që nuk i kryejnë farzet për Allahun?

Këtë muaj duhet që ta përcjellim me kërkim të faljes dhe me shpresë dhe lutje për praninë të veprave. Selefi i luteshin Allahut gjashtë muaj që të arrijnë muajin e Ramazanit, e kur e arrinin vepronin vepra të mira, pastaj luteshin gjashtë muaj që t'i pranojë Allahu veprat e tyre që i kanë bërë gjatë këtij muajit. Çdo kohë e tyre ishte Ramazan, ndërsa sot shumica e njerëzve Ramazanin e përcjellin duke bërë mëkate duke i lënë detyrimet dhe duke vepruar ndalesa.

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve dhe qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju robër të Allahut, Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, na urdhëroi që ta përfundojmë muajin e Ramazanit me tekbire dhe me falënderim ndaj Allahut për plotësim e begatisë: **“Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë.”** (Bekare 185)

Ndërsa Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, na nxiti që pasi ta kryejmë agjërimin e muajit Ramazan ta pasojmë atë me agjërim të gjashtë ditëve të muajit Sheual. Imam Muslimi, RahimehUllah, shënon në librin e tij një hadith prej Ebu Ejub el Ensarij, radijallahu anhu, i cili thotë se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kush e agjëron muajin e Ramazanit e**

pastaj ia bashkon edhe gjashtë të Sheualit është sikurse të kishte agjëruar tërë vitin”.

Në përsëritjen e agjërimit pas Ramazanit ka shumë dobi. Prej saj e kemi dobënë se agjërimi i këtyre gjashtë ditëve pas Ramazanit është si namazi nafile pas farzit, i plotëson mangësitë dhe të metat. Shumica e njerëzve në agjërimin e tyre obligativ kanë mangësi dhe me agjërim vullnetar plotësohen ato mangësi dhe të meta.

Prej dobive tjera është se përsëritja e agjërimit pas Ramazanit është shenjë e pranimit të agjërimit të muajit Ramazan. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, kur ia pranon robit veprat e begaton pas saj me punë të mira, siç thonë disa se e mira shpërblehet me një të mirë pas saj. Ndërsa kush vepron një vepër të mirë e pastaj e pason me vepra të shëmtuara kjo është shenjë se ajo e mirë e tij është e refuzuar dhe nuk pranohet.

Prej dobive tjera është se agjërimi i muajit Ramazan i shlyen mëkatet e mëparshme dhe përsëritja e agjërimit pas Bajramit është falënderim për ato begati me të cilat e begatoi Allahu robin e Tij gjatë muajit Ramazan.

Prej begative poashtu është se përsëritja e agjërimit pas Bajramit aludon në dëshirën e robit që të agjëron dhe se ai nuk është lodhur dhe mërëzitur prej agjërimit të Ramazanit.

Zëvendësimi i begative të Allahut me mëkate pas kalimit të muajit të Ramazanit është mohim i atyre begative. Kush pretendon që t'i kthehet mëkateve pas Ramazanit agjërimi i tij është i refuzuar dhe dera e mëshirës e mbyllur. Këto muaj dhe vite dhe ditë janë të caktuara dhe kalojnë shumë shpejtë, ndërsa Zoti i tyre është i Gjallë nuk vdes, Ai është gjithnjë prezent në çdo kohë dhe çdo vend me diturinë e Tij. Prandaj frikojuni Allahut dhe vazhdoni të veproni vepra të mira dhe të largoheni prej të shëmtuarës, se do të vjen një ditë kur do të dalin veprat në shesh: **“Kush bën mirë, e bën për dobi të vet, e kush punon keq, punon në dëm të vet. Zoti yt nuk u bën padrejtësi robërve të Tij.”** (Fusilet 46)

Merita e Allahut mbi ju është e vazhdueshme dhe sezonet e faljes janë të një pas njëshme për atë të cilin Allahu e begatoi. Pasi që na kaloi ky muaj i mëshirës jemi në prag të muajit të Haxhit. Në Ramazan kush agjëroi dhe fali nafile u mëshirua nga ana e Allahut. Poashtu në Haxh kush e kryen Haxhin pa grindje dhe sharje kthehet në shtëpi i falur prej mëkateve si atë ditë kur e ka lindur nëna e tij.

Pra nuk kalon asnjë ditë prej jetës së muslimanit vetëm se në të ka mundësi që të vepron vepra të mira të cilat e afrojnë kah Allahu. Prandaj o ju musliman, falënderoni Allahun për këto begati dhe shfrytëzoni ato në nënshtrime ndaj Allahut dhe mos i humbni ato me mohim dhe shkujdesje.

30 - MUAJT E HAXHIT DHE VLERA E TYRE.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon vetëm Allahut i cili na dhuroi begati të shumta dhe pasi që kaloi muaji i Ramazanit na mundësoi t'i presim muajt e Haxhit dhe ta vizitojmë shtëpinë e Allahut. Atë e falënderoj për të gjitha të mirat që na i dhuroi. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të vërtet përveç Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, që është Një dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij.

Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju njerëz,

Frikojuni Allahut dhe falënderoni për atë që jua ligjësoi prej legjislacioneve të madhërishme, dhe për atë që ju veçoi prej muajve të dobishëm, të cilat ju përsëriten çdo ditë, çdo javë e çdo vit dhe sjellin me vete çdo të mirë dhe e largojnë prej jush çdo të keqe.

Namazi: largon nga e shëmtuara dhe imoraliteti, është frikërespekt dhe nënshtrim ndaj Allahut, dhe është ndihma më e madhe e besimtarit në bartjen e përgjegjësive të dynjasë dhe ahiretit. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit”.** (Bekare 153)

Zeqati: është bamirësi dhe shtrirje dore për fukarenjtë dhe nevojtarët, nxitje për ata që duhet përfituar zemrat e tyre të dobëta në besim, ndihmesë për lirim e robërve dhe të mbyturve në borxhe, dhe pastrim i pasurisë dhe i shpirtrave të njerëzve. Zeqati pra, është trofe për besimtarin e jo gjobë dhe humbje. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t'i pastrosh ata dhe t'ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ata. Allahu dëgjon dhe di gjithçka”.** (Teube 103)

Zeqati po ashtu është shkak i shtimit të pasurisë dhe shkak i zbritjes së bereqetit në të dhe mbrojtje e saj prej çdo fatkeqësie. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Dhënia e zeqatit nuk e pakëson pasurinë”.**

Besimtari pra, e konsideron zeqatin trofe për shkak se beson thellësisht në premtimin e Allahut, në krahasim me dyfytërëshin i cili e konsideron si gjobë për shkak se nuk i beson Allahut dhe premtimit të Tij.

Agjërimi: është lënie e ushqimit dhe epsheve për të cilat shpirti fort anon nga ato, duke iu nënshtruar Allahut me këtë adhurim dhe duke shpresuar shpërblimin e Tij. Po ashtu nuk duhet të harrohet roli edukator i agjërimit i cili nxit në moral të mirë dhe largon prej moralit të shëmtuar. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Nuk është agjërimi abstenim (vetëm) prej të ngrënit dhe të pirit, por agjërimi është zbrapsje nga e kota (fjalë dhe punë) dhe e ndyra. E nëse dikush të ngacmon apo sillet ashpër me ty, thuaji: Unë po agjëroj, unë po agjëroj!”**.

Haxhi: është luftë në rrugë të Allahut. Besimtari për të shpenzon pasurinë, e lodh trupin e tij dhe për hir të Tij e len familjen e vatanin. Me shkuarjen në Haxh besimtari i përgjigjet thirrjes së Allahut e cila erdhi nëpërmjet gjuhës së mikut të Tij, Ibrahimit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, kur i tha Allahu atij:

“Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta, që të dëshmojnë dobitë e tyre dhe të përmendin Emrin e Allahut në ditët e caktuara mbi kafshët (për kurban), të cilat ua ka dhuruar Ai. Hani nga ato (mishin) dhe ushqeni nevojtarin e varfër! Pastaj, haxhinjtë le të pastrojnë trupin e tyre, le t'i kryejnë zotimet e tyre dhe le t'i vijnë rrotull Shtëpisë së lashtë”. (Haxh 27-29)

O ju robër të Allahut,

Tani jemi në muajt e Haxhit të cilat Allahu i bëri sezon nga ku fillojnë ritet e haxhillëkut. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!”** (Bekare 197)

Allahu na lajmëron se koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar, e ato janë: Sheval, Dhul Kade dhe dhjetë ditët e para të Dhul Hixhes. Të caktuara janë për shkak se njerëzit i njohin prej kohës së Ibrahimit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe Ismailit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe nuk ka nevojë për qartësimin e saj sikur se nevojitet qartësimi i kohës së agjërimit dhe namazit.

Thënia: **“Kush vendos të kryejë haxhillëkun”** e ka për qëllim se kush e bën nijetin për Haxh në këto muaj qoftë në fillim të saj, në mes apo në fund, i bëhet obligim kryerja e tij qoftë edhe vullnetar Haxhi i tij, dhe nuk lejohet refuzimi i kryerjes së tij.

Thënia: **“le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet”** na qartëson se si duhet të jetë etika e haxhiut dhe cilave vepra duhet t’i largohet gjatë të qenit e tij në ihram. Haxhiu duhet të jetë i vetëdijshëm se Haxhi është adhurim i madh dhe se duhet t’i largohet mëkateve dhe ndalesave të cilat mund t’ia zvogëlojnë shpërblimet ose t’ia shkatërrojnë Haxhin. Prej ndalesave, janë marrëdhëniet seksuale dhe çdo vepër apo thënie që nxit në të, sharjet dhe grindjet të cilat nxisin në sherr dhe armiqësi dhe e largojnë haxhiun prej përmendjes së Allahut. Qëllimi i Haxhit është nënshtrim dhe afrim kah Allahu me adhurime dhe largim prej mëkateve që Haxhi i tij të pranohet. Përcillet prej Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, të ketë thënë se haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër përveç se xhenetin.

Pasi që afrimi nga Allahu nuk realizohet përveçse duke u larguar prej mëkateve e duke vepruar vepra të mira, Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, urdhëroi në vepra të mira gjatë Haxhit pasi që ndaloi prej atyre të shëmtuarave duke thënë: **“Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di”**.

Nëpërmjet këtij ajeti Allahu nxit në vepra të mira veçanërisht gjatë ditëve të Haxhit në ato vende të bekuara si Arafati e Muzdelifa, duke mos e harruar edhe Qabenë ku veprat në të shumëfishohen më tepër se në vendet tjera. Përcillet prej haditheve se një namaz në Qabe është më me vlerë se njëqind mijë namaze në xhamitë tjera.

Prej grindjeve dhe polemikave të ndaluara gjatë Haxhit janë edhe ato të cilat ndodhnin mes fiseve në periudhën e injorancës në sezonin e Haxhit dhe në kompleksin e Haremit, duke u krenuar mes veti me paraardhësit dhe fiset e tyre kështu që kohën e Haxhit e shndërronin nga adhurimi në polemika e debate.

Në kohën tonë u paraqitën disa njerëz të cilët dëshirojnë që ta ringjallin këtë traditë injorante dhe ta shndërrojnë Haxhin në rite djallëzore duke bërë shirk e mëkate dhe duke i dëmtuar haxhinjtë e duke e synuar shkatërrimin e shtëpisë së Allahut. Këta njerëz nuk kanë aspak respekt ndaj shtëpisë së Allahut, ndaj vlerës së ditëve të Haxhit dhe ndaj muslimanëve që i braktisën familjet e tyre për ta kryejnë shtyllën e pestë të Islamit dhe ta fitojnë xhenetin e Allahut.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet”**. (Bekare 197)

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, për Qaben thotë: **“Vërtet, ata që nuk besojnë dhe pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut dhe nga Xhamia e Shenjtë, të cilën Ne e kemi bërë të njëjtë për të gjithë njerëzit, si për vendasin ashtu edhe për atë që vjen nga tjetër vend dhe, ata që synojnë ta përdhosin (Xhaminë), me të keqe, Ne do t’i bëjmë të shijojnë dënim të dhembshëm”**. (Haxh 29)

O Zot, kush i dëmton haxhinjtë dhe vizitorët e Qabesë dhe synojnë shkatërrimin e saj bëri që ta shijojnë dënimin Tënd më të dhembshëm, të cilin ia premtove çdo njërit që synon shkatërrimin e saj, se Ti ke mundësi të veprosh çka do. O Zot, Ti i cili i dërgove shpendët të vinin tufë-tufë kundër ushtrisë së elefantit dhe i gjuanin ata me gurë nga balta e gurëzuar dhe ata i bëre si gjithë i grimcuar **(i përtypur)**, shijojnë të njëjtin dënim atyre që synojnë të bëjnë të njëjtën vepër të shëmtuar, se Ti neve na mjafton dhe sa mbështetës i mirë që je.

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve dhe qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju njerëz,

Frikojuni Allahut dhe shfrytëzoni kohën tuaj në vepra të mira që të shpëtoni dhe mos u bëni si ata të cilët kohën e tyre e kaluan në gjëra të kota, e pastaj të pendoheni kur t'ju vjen vdekja. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e ta kompensoj atë që lëshova! Kurrresi, (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) deri në ditën kur ringjallen”**. (Muminun 99-100)

O ju robërit e Allahut, merita e Allahut mbi ju është e vazhdueshme. Pas muajit të Ramazanit i bëri muajt e Haxhit mëshirë për njerëzit dhe i nxiti që ta vizitojnë shtëpinë e Allahut, sikurse e bëri që ai i cili e agjëron Ramazanin me bindje të plotë t'i falen mëkatet e kaluara, po ashtu e bëri që kush shkon në Haxh dhe i largohet sharjes, polemikave dhe ndalesave të Haxhit të kthehet në shtëpi i falur prej mëkateve sikur se atë ditë kur e ka lindur nëna e tij.

Shenja e pranimit të veprës së mirë është kur ajo pasohet me vepër të mirë, ndërsa shenja e mos pranimit të saj është kur ajo pasohet me vepër të shëmtuar. Nuk ka më mirë se kur veprën e keqe e pason një e mirë dhe atë e fshin, por ende më mirë është kur veprën e mirë e pason një e mirë tjetër.

Hasan Basriu, RahimehUllah, thoshte: “Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, asnjë veprës së besimtarit nuk i ka përcaktuar afat, përveç se vdekjes, e pastaj lexoi: **“Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë ty e vërteta (vdekja)”** (Hixhr 99)

O ju musliman,

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, na porositë: **“Koha e haxhillëkut është në muajt të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë**

që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur! Nuk është gjynah të kërkonit nga Zoti juaj ndonjë të mirë. E, kur të ktheheni nga Arafati, përmendni Allahun në vendet e shenjta! Përmendni Atë që ju ka udhëzuar në rrugën e drejtë, sepse ju më parë ishit të humbur! Mandej, kthehuni, siç kthehen të gjithë të tjerët dhe kërkonit ndjesë prej Allahut! Se Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë. Pasi t'i kryeni ritet e haxhillëkut, përmendni Allahun ashtu siç i kujtoni prindërit tuaj, madje edhe më tepër! Disa njerëz thonë: “Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë!” Por, për këta, s’ka asnjë të mirë në botën tjetër. Por ka dhe të tjerë që thonë: “Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit) Këtyre do t’u jepet shpërblim për atë që kanë bërë. Allahu është i shpejtë në llogari”. (Bekare 197-202)

31 - TEUHIDI I ADHURIMIT NË RITET E HAXHIT.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu s’ka kush e devijon dhe kë e largon nga rruga e vërtet Ai s’ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të vërtet vetëm se Allahut, Subhanehu ue Te’Ala, që është Një dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju njerëz,

Frikojuni Allahut dhe dijeni se qëllimi i krijimit tuaj nuk është tjetër përpos adhurimi i Tij. Allahu, Subhanehu ue Te’Ala, thotë: **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë”**. (Dharijat 56)

Allahu me këtë mesazh i porositi të gjitha krijesat: **“O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat); i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Prandaj mos sajoni me vetëdije zota të barabartë me Allahun”**. (Bekare 21-22)

Adhurimi pa teuhid (**njësism**) i përngjanë namazit pa abdes. Sikurse papastërtia që e prish abdesin ashtu shirku i vepruar nga ana e robit e shkatërron teuhidin. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, për këtë shkak i drejtohet krijesës më të dashur duke i thënë: **“Me të vërtetë, të është shpallur ty (o Muhamed), si dhe atyre që kanë qenë para teje: “Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit”.** (Zumer 65)

Shirku (**politeizmi**) është arsyeja kryesore për mospranimin e veprave dhe adhurimeve, prandaj urdhri për adhurimin e Allahut shumë herë vjen i shoqëruar me ndalesën prej shirkut, sikurse në thënien e Allahut, Subhanehu ue Te'Ala: **“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)”.** (Nisa 36) Ky ishte edhe mesazhi i të gjithë Profetëve drejtuar popujve të tyre: **“O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij!”.** (Earaf 59)

O ju robër të Allahut,

Allahu na e detyroi Haxhin, prandaj le të përsiatim në të, manifestimin e teuhidit dhe largimin prej shirkut, që të mbetet shembull praktik që do ta përpilojmë në të gjitha adhurimet tona.

Në rend të parë nëse përsiatim themelimin e Qabesë do të vërejmë se ajo është themeluar mbi teuhid, siç na njofton edhe Allahu, Subhanehu ue Te'Ala: **“Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: “Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrinë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përlulur”.** (Bekare 125)

Allahu i urdhëroi ata të dy që ta pastrojnë Qabenë prej të gjitha papastërtive, e posaçërisht prej shirkut. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“O besimtarë! Në të vërtetë, idhujtarët janë të papastër (për shkak të besimit të kotë), prandaj të mos i afrohen më Xhamisë së Shenjtë pas këtij viti”.** (Teube 28), dhe **“Kujtoje kur Ne vendosëm për Ibrahimin vendin e Faltores (duke e urdhëruar): “Mos më shoqëro asgjë (në adhurim) dhe pastroje Shtëpinë Time (nga idhujtaria), për ata që vijnë rrotull saj (në shenjë adhurimi) dhe për ata që rrinë në këmbë, përkulen dhe bien në sexhde duke u falur”.** (Haxh 26)

Kjo shtëpi pra, është themeluar mbi teuhid dhe detyrohet të mbetet ashtu deri në Ditën e Kiametit, nuk lejohet që t'i afrohet asnjë jobesimtar (mushrik) ose të depërtojë ndonjë lloj i shirkut përreth saj.

Prandaj Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, kur e çliroi Mekën hyri në Qabe dhe përreth saj i gjeti treqind e gjashtëdhjetë idhuj të cilët filloi t'i shkatërrojë dhe të përsërisë ajetin: **“E vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua. Sigurisht, e pavërteta është e paracaktuar të zhduket!”.** (Isra 81) Pastaj urdhëroi që të nxirren prej Qabesë dhe të digjen, ndërsa Profeti, sal-lAllahu

'alejhi ue sel-lem, hyri në brendësinë e saj dhe filloi t'i fshijë vizatimet e pikaturuara në mure duke u bazuar në fjalën e Allahut: **“Dhe pastroje Shtëpinë Time (nga idhujtaria), për ata që vijnë rrotull saj (në shenjë adhurimi) dhe për ata që rrinë në këmbë, përkulen dhe bien në sexhde duke u falur”**. (Haxh 26)

Qabeja është Kibla e muslimanëve, në të kryhet Haxhi dhe Umreja, është vend takim i zemrave dhe trupave të tyre, prandaj detyrohet të jetë burim i teuhidit (**njësimit**) dhe i besimit të pastër ku do të adhurohet Allahu me sinqeritet, dhe të largohet prej saj çdo lloj i idhujtarisë dhe risive. Prandaj edhe erdhi urdhri që të kryhet Haxhi dhe Umreja vetëm për Allahun: **“Kryeni Haxhin dhe Umren për hir të Allahut!”**. (Bekare 196)

O ju robër të Allahut,

Prej manifestimeve të teuhidit të adhurimit në Haxh është **ngritja e zërave** pas veshjes së Ihramit duke iu përgjigjur ftesës së Haxhit vetëm për hir të Allahut, dhe duke e publikuar njësimin e Tij në falënderim, begati e sundim: **“Lebbejke Allahume Lebbejk, Lebbejke La sherike Leke Lebbejk, innel Hamde ven ni’emete leke uel Mulk La sherike Lek”** (Të përgjigjem o Zot, Ti je i pashoq, vetëm Ty të përgjigjem, falënderimi të takon vetëm Ty. Të gjitha begatitë dhe i tërë sundimi të takon Ty, Ti je i pashoq).

Po ashtu prej manifestimeve të teuhidit (**njësimit**) të adhurimit në Haxh është përmendja e Allahut në ditën e Arafatit me lutjen: **“La ilahe il-lAllahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul Hamdu ue Huve ala kul-li shejin Kadir”** (S’ka të adhuroar përveç Allahut Një dhe të pashoq, Atij i takon sundimi dhe Lavdërimi, Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send).

Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thoshte: **“Lutja më e mirë është ajo e ditës së Arafatit, ndërsa fjala më e mirë që e kam thënë unë dhe Profetët para meje “La ilahe il-lAllahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul Hamdu ue Huve ala kul-li shejin Kadir”** (S’ka të adhuroar përveç Allahut Një dhe të pashoq, Atij i takon sundimi dhe Lavdërimi, Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send).

Kjo lutje është kumtesë e njësimit të adhurimit në këtë shoqëri madhështore dhe në këtë ditë të bekuar, dhe preferohet të shqiptohet sa më shpesh me qëllim që haxhiu ta kupton thelbin e saj dhe të vepron sipas asaj çka e aludon ajo, që në fund t'i kryen ritet e Haxhit me sinqeritet dhe t'i largohet çdo llojit të shirkut e risive.

Po ashtu prej manifestimeve të teuhidit (**njësimit**) të adhurimit në Haxh është Tavafi përreth Qabesë. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“dhe le t'i vijnë rrotull Shtëpisë së lashtë”**. (Haxh 29)

Tavafi përreth Qabesë është i veçantë për të dhe nuk lejohet veprimi i tij ndokund tjetër në gjithë rruzullin tokësor. Haxhiu prej këtu e kupton se Tavafi përreth varreve, drunjve, gurëve e tyrbeve, nuk është adhurim i lejuar nga Allahu, por është adhurim i urdhëruar nga shejtanët qofshin ata njerëz apo xhind.

Po ashtu prej manifestimeve të teuhidit (**njësimit**) të adhurimit në Haxh është madhërimi i Allahut me puthjen dhe fërkimin e Gurit të Zi. Haxhiu e puthë atë gur me bindje të thellë se është prej riteve të Haxhit dhe se me këtë vepër i nënshtrohet Allahut dhe Profetit të Tij. Mu për këtë arsye Omer ibën Hatabi, radijAll-llahu anhu, kur e puthi Gurin e Zi tha: **“Pasha Allahun, unë e di se ti je gur, nuk bën dobi e as dëm, dhe mos ta kisha parë Profetin, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem,duke të puthur asnjëherë nuk do të të puthja”**.

Muslimani prej kësaj vepre e kupton se nuk lejohet puthja dhe fërkimi për bereqet të asnjë objekti apo guri, duke e përjashtuar këtu puthjen dhe fërkimin e Gurit të zi për arsye se kjo është prej riteve të Haxhit, ndërsa puthja dhe fërkimi i varreve, tyrbeve e drunjve për bereqet është prej veprave që e kundërshtojnë fenë e Allahut dhe nuk janë prej riteve të Tij.

Po ashtu prej manifestimeve të teuhidit (**njësimit**) të adhurimit në Haxh është që haxhiu pasi ta kryen Tavafin t'i fal dy rekate pas Mekami Ibrahim duke u bazuar në thënien e Allahut, Subhanehu ue Te'Ala,: **“Kujtoni kur Ne e bëmë Qabenë vend grumbullimi dhe sigurie për njerëzit, duke thënë “Bëjeni vendin e Ibrahimit si vend faljeje!”**. (Bekare 125)

Preferohet që në rekatën e parë pas Fatihës të lexon suren el Kafirun, ndërsa në të dytin suren el Ihlas. Urtësia e leximit të këtyre dy sureve qëndron në faktin se ato në vete përmbajnë njësimin e Allahut me njohje dhe pohim (**teuhid rububije**) dhe njësimin e Allahut me adhurim (**teuhid uluhije**). Surja e parë përmban mospranimin e fesë së mushrikëve dhe njësimin e Allahut me adhurim, ndërsa surja e dytë përmban njësimin e Allahut me cilësitë e përkryera dhe dëlirjen e Tij prej cilësive të mangëta.

Po ashtu prej manifestimeve të teuhidit (**njësimit**) të adhurimit në Haxh është sa'ji (**ecja**) mes kodrinave të Safës dhe Meruas duke u bazuar në thënien e Allahut, Subhanehu ue Te'Ala: **“Kodrinat Safa dhe Merua (në Mekë) janë pjesë e Simboleve të Allahut, prandaj ai që viziton Qabenë për haxh ose për umre, s'ka kurrfarë gjynahu nëse sillet mes tyre. Kush bën vepra të mira vullnetare, ta dijë se Allahu është njëmend Falënderues dhe i Gjithëdijshëm”**. (Bekare 158)

Prej këtij riti të Haxhit muslimani mëson se Sa'ji nuk kryhet në vend tjetër përveç se në Safa dhe Merua, për arsye se këto janë rite të Haxhit, ndërsa saji i kryer në ndonjë vend tjetër është mashtrim nga ana e shejtanit dhe nuk është adhurim i Allahut.

Po ashtu prej manifestimeve të teuhidit (**njësimit**) të adhurimit në Haxh është ajo çka e ligjësoi Allahu në ditën e Bajramit dhe në ditët e caktuara (**të Teshrikut**) prej përmendjes së Tij: **“Dhe madhëroni Allahun në (tre) ditët e caktuara (të Teshrikut)”**. (Bekare 203)

Përmendja e Allahut në këto ditë qartësohet në veprat e mëdha që kryhen gjatë atyre ditëve duke filluar prej qëndrimit në Mina, pastaj gjuajtjes së gurëve, prerjes së Kurbanit, faljes së pesë kohërave të namazit në atë vend të bekuar dhe në ato ditë të bekuara. Muslimani kur i gjuan gurët thotë **“Allahu Ekber (Allahu është më i madhi)”**, e kjo është përmendje e Allahut, po ashtu kur e ther Kurbanin e përmend Allahun, ashtu siç na njofton Allahu në Kuran: **“Për çdo popull, Ne kemi caktuar një ritual, që ata të përmendin emrin e Allahut gjatë flijimit të kafshëve, që Ai ua ka dhuruar për ushqim”**. (Haxh 34)

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, po ashtu thotë: **“Devetë dhe gjedhët i kemi bërë për ju si një nga ritet e Allahut për flijim dhe ju keni dobi nga ato. Prandaj, përmendeni emrin e Allahut mbi ato, ndërsa i radhisni në këmbë (për t'i therur). Kur ato të bien në tokë, hani prej (mishit të) tyre dhe ushqeni edhe atë që lyp, edhe atë që nuk lyp. Kështu pra, Ne i kemi vënë ato në shërbimin tuaj, që ju të jeni mirënjohës. Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj, që ju ta madhëroni Allahun sepse ju ka udhëzuar. Dhe, jepu lajmin e mirë, punëdrejtëve!”**. (Haxh 36-37)

Muslimani prej këtyre ajeteve kupton se therja e Kurbanit është adhurim dhe se therja e tij nuk lejohet t'i kushtohet dikujt tjetër veç Allahut, se kjo është shirk.

Po ashtu prej manifestimeve të teuhidit (njësimit) të adhurimit në Haxh është se Allahu i ka porositur haxhilerët që ta përmendin Atë shumë gjatë kryerjes së riteve të Allahut dhe pas përfundimit të saj. I ndaloi prej përmendjes së parive dhe njerëzve të mëdhenj me ndikim, të gjallë apo të vdekur, dhe i porositi që të mos krenohen me fise dhe gjenezë. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Nuk është gjynah të kërkoni nga Zoti juaj ndonjë të mirë. E, kur të ktheheni nga Arafati, përmendni Allahun në vendet e shenjta! Përmendni Atë që ju ka udhëzuar në rrugën e drejtë, sepse ju më parë ishit të humbur! Mandej, kthehuni, siç kthehen të gjithë të tjerët dhe kërkoni ndjesë prej Allahut! Se Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë. Pasi t'i kryeni ritet e haxhillëkut, përmendni Allahun ashtu siç i kujtoni prindërit tuaj, madje edhe më tepër! Disa njerëz thonë: “Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë!” Por, për këta, s'ka asnjë të mirë në botën tjetër. Por ka dhe të tjerë që thonë: “Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)” Këtyre do t'u jepet shpërblim për atë që kanë bërë. Allahu është i shpejtë në llogari. Dhe madhëroni Allahun në (tre) ditët e caktuara (të Teshrikut). Por, edhe ata**

që nguten dhe rrinë vetëm dy ditë (në Mina), nuk bëjnë gjynah; nuk bën gjynah as ai që rri më shumë, nëse i frikësohet vërtet Allahut. Ta keni frikë Allahun e ta dini mirë se vetëm tek Ai do të tuboheni!”. (Bekare 198-203)

Haxhi pra, nuk qenka thjesht një udhëtim vëzhgues e turistik dhe manifestim i riteve, por është përvojë dhe mësim praktik për besimin e pastër dhe largimin e besimeve të kota të kohës së injorancës.

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve dhe qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju që Allahu jua mundësoi ta kryeni Haxhin dhe e mësuat prej riteve të tij besimin e pastër, dhe i vërejtët të tjerët qofshin prej vendit tuaj apo prej ndonjë vendi tjetër se kanë gabime që bien ndesh me besimin e pastër, mësojuani atyre besimin dhe përmirësoni gabimet e tyre për arsye se detyra e të dijshtimit është mësimi i të paditurit dhe mos harroni se ju jeni përgjegjës para Allahut i cili thotë: **“Nuk është mirë që besimtarët të shkojnë në luftë të gjithë njëherësh, por prej çdo bashkësie, një grup të mbetet mbrapa, që të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të këshillojë popullin e vet, mbasi të kthehet nga lufta, që t’i frikësohet Allahut”.** (Teube 122), dhe **“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit”.** (Ali Imran 104)

Besimtari pra, së pari shpreson në përmirësimin e vetes e pastaj në përmirësimin e të tjerëve. Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Nuk ka besuar ndonjëri prej jush deri sa nuk e do për vëllanë e tij musliman atë çka e do për vetvete”.**

O ju robër të Allahut,

Frikojuni Allahut, kujdesuni për fenë e juaj në përgjithësi dhe për besimin e juaj në veçanti, për shkak se ajo është baza dhe themeli. Kjo fe është e ndërtuar mbi dy parime: sinqeritetin në adhurim dhe pasimin e Profetit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe këto dy parime nuk mund të njihen përveç se me përsiatje të Kuranit dhe Sunetit dhe me pasimin e tyre.

32 - PËRGATITJA PËR HAXH.

Hutbeja e parë

Lavd-falënderimi i takon vetëm Allahut i cili e bëri Haxhin shtyllë të Islamit. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë përveçse Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, që është Një, Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër **(të denjë për adhurim)**. Ai është Sunduesi, i Shenjti **(i pastër nga çdo e metë)** Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij **(në adhurim)**. Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që çdo gjëje i jep trajtë. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e perlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju muslimanë,

Frikojuni Allahut me frikërespekt të vërtetë, adhurojeni Atë me përkushtim të sinqertë duke qenë në fenë e pastër, faleni namazin e jepeni zeqatin se kjo është feja e drejtë.

Këto ditë të bekuara muslimanët përgatiten për udhëtim kah Qabeja për ta kryer Haxhin, disa prej tyre Haxhin e detyruar (Haxhin e Islamit) e disa prej tyre Haxhin vullnetar. Pa dyshim se ky udhëtim i gjatë disa ditësh kërkon prej haxhiut përgatitje materiale, fizike e shpirtërore, me qëllim që kjo pajisje t'i mjaftojë gjatë kohës së Haxhit që të mos varet prej të tjerëve. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria”**. (Bekare 197)

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, na urdhëroi me pajisje të mjaftueshme e cila përbëhet prej marrjes së ushqimit të mjaftueshëm me vete, lënia e ushqimit të mjaftueshëm për familjen deri sa të kthehemi dhe posedimi i mjetit të transportit i cili na çon deri në Qabe dhe na kthen deri në vatanin tanë. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabesë) është detyrim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo”** (Ali Imran 97)

Më herët disa prej haxhilerëve kur niseshin për në Haxh nuk pajiseshin me mjetet e duhura që u nevojiteshin, kështu që rrugës jetonin në kurriz të të tjerëve duke u bërë barrë e parazit i tyre. Prandaj Allahu i ndaloi prej kësaj vepre dhe i urdhëroi ata që të pajisen me aq sa u mjafton që t'i largohen varshmërisë prej të tjerëve. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Pajisuni me gjërat që ju nevojiten (për rrugë) dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!”**. (Bekare 197)

Kur njerëzit paragjykonin se tregtia dhe përfitimet në sezonin e Haxhit janë të ndaluara Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, e zbriti ajetin: **“Nuk është mëkat për**

ju të kërkoni begati nga Zoti juaj (të bëni ndonjë tregti gjatë haxhit)”.
(Bekare 198)

Allahu në dy ajetet e lartpërmendura na bëri me dije se haxhiu duhet t'i merr dy llojet e furnizimeve, atë të udhëtimit për dynja me ushqim e me pije të mjaftueshme deri në fund të udhëtimit, dhe atë të udhëtimit për ahiret duke vepruar vepra të mira dhe duke u larguar prej mëkateve. Allahu pastaj na e bëri me dije se tregtia dhe kërkimi i rrëskut të lejuar nuk bie ndesh me Haxhin dhe ritet e tij, në rast se ajo tregti nuk e preokupon dhe e largon haxhiun prej veprimit të adhurimeve. Kjo aspak nuk bie ndesh edhe me mbështetjen në Allahun (**tevekulin**), dhe nuk duhet harruar faktin se haxhiu është i detyruar që kur të niset për në Haxh t'i len familjes furnizim të mjaftueshëm deri sa të kthehet dhe nuk lejohet që t'i len pa furnizim ose t'ua pakëson atyre furnizimin për ta kryer Haxhin e tij. Në këtë rast haxhiu nuk ka shpërblim, por ka mëkat. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Mjafton si mëkat për dikë, nëse dëmton ata që duhet t'i ushqejë”.**

Haxhiu po ashtu duhet t'i pastron borxhet e tij që ua ka njerëzve. Në rast se nuk ka pasuri të mjaftueshme për shpenzimet e Haxhit dhe larjes së borxheve, i jepet përparësi larjes së borxheve dhe nuk lejohet që të shkojë në Haxh.

Haxhiu po ashtu gjatë Haxhit duhet të shpenzon pasurinë e tij të fituar hallall, që Haxhi i tij të pranohet dhe mëkatet t'i falen. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Vërtet Allahu është i mirë dhe nuk pranon përveç të mirës, dhe vërtet Allahu u ka urdhëruar besimtarëve atë që u ka urdhëruar të dërguarve.** Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, ka thënë: **“O të dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira! Vërtet, Unë e di mirë çfarë bëni ju!”.** Dhe ka thënë: **“O ju besimdrejtë, hani gjërat e mira me të cilat u kemi furnizuar”.** Pastaj e përmendi njeriun, i cili ka udhëtuar gjatë me flokë të shpupuritura dhe të pluhurosura, dhe i cili i shtriu duart e tij nga qielli: **“O Zot, o Zot! Kurse ushqimi i tij është haram, dhe pija e tij haram, dhe veshmbathja e tij haram, dhe është ushqyer me haram. E si do t'i pranohet lutja e tij!”.**

Pasuria e shpenzuar për në Haxh në rast se është e fituar në mënyrë të lejuar atëherë bën pjesë në pasurinë që shpenzohet për në rrugë të Allahut. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira, Allahu me të vërtetë i do bamirësit”.** (Bekare 195) Një prej sahabëve e dhuroi devenë e tij për në rrugë të Allahut dhe një grua kur desh ta përdorë po të njëjtën deve për udhëtim për në Haxh Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem i tha: **“Përdore atë për në Haxh, se Haxhi bën pjesë në rrugë të Allahut”.**

Një grup dijetarësh u argumentuan me këtë hadith se ai i cili nuk e ka kryer Haxhin e detyruar i lejohet që të merr prej të hollave të zeqatit dhe ta kryen

këtë shtyllë të Islamit, se ai bën pjesë në grupin e atyre që u jepet zeqati: **“për në rrugë të Allahut”**. (Teube 60)

Haxhiu po ashtu detyrohet që të pendohet me sinqeritet prej të gjitha mëkateve, në rast se ka bërë padrejtësi kundrejt njerëzve të kërkon falje prej tyre dhe t'ua kthen hakun që ua ka marrë padrejtësisht. Po ashtu detyrohet që t'i largohet mëkateve dhe gjynaheve, të kujdeset për faljen e namazeve, t'i kryen të gjitha detyrimet dhe ta merr rrugën drejt shtëpisë së Allahut i penduar dhe i pastër prej padrejtësive ndaj robërve të Allahut. Haxhiu pra, nuk duhet që të hyjë në shtëpinë e Allahut i njollosur me mëkate ose t'i vepron ato gjatë kohës së Haxhit. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Haxhi është në muajt e caktuar e kush bën (ia fillon të zbatojë)haxhin në këta muaj, nuk duhet afruar gruas, nuk bën të merr nëpër këmbë dispozitat e sheriatit, as nuk duhet shkaktuar grindje”**. (Bekare 197).

Përcillet se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kush kryen haxhin për Allahun dhe nuk kryen marrëdhënie seksuale (gjatë kohës sa është në Ihram) dhe nuk shkel dispozitat, kthehet nga Haxhi i pastër prej mëkateve sikur atë ditë kur e ka lindur nëna”**. Kjo për haxhiun hap një faqe të re të jetës së tij, të pastër nga mëkatet dhe gjynahet.

Haxhi konsiderohet i pranuar me bashkimin e dy çështjeve në të:

Çështja e parë: Ardhja e njerëzve në Haxh me punë të mira, prej saj, bamirësia ndaj njerëzve dhe sjellja e mirë. Kur u pyet Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, për bamirësinë, u përgjigj: **“Bamirësia është moral i mirë”**.

Imam Ahmedi, RahimehUllah, në Musnedin e tij shënon një hadith prej Xhabir ibën Abdullah, radijallahu anhu, se Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër përveç xhenetit”**. – Të pranishmit pyetën: **“Çka është bamirësia e Haxhit”, o i Dërguar i Allahut? – U përgjigj: “Dhënia ushqim nevojtarit dhe përhapja e selamit”**.

Është pyetur Seid ibën Xhubejr, radijallahu anhu, se cili haxhi është më i miri? – Përgjigja e tij ishte: **“Ai i cili i ushqen të varfrit dhe e ndal gjuhën e tij prej mëkateve”**.

Në përgjithësi, njerëzit më të mirë janë ata të cilët i bëjnë dobi të tjerëve dhe bëjnë durim prej torturave të tyre, ashtu si i përshkroi Allahu të devotshmit në Kuran: **“Të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit”**. (Ali Imran 134)

Çështja e dytë: Një ndër veprimet më të mëdha të mirësisë në Haxh, është përmendja e shumtë e Allahut, Subhanehu ue Te'Ala. Allahu urdhëroi në përmendjen e Tij të shumtë gjatë kryerjes së riteve të Haxhit, veçanërisht kur

haxhiu është në gjendje të Ihramit, për shkak se pajisja më e mirë është ajo e devotshmërisë e cila i përmbledh në vete të gjitha karakteristikat e mirësisë.

Haxhiu detyrohet që nijetin ta ketë të sinqertë për Allahun, synimi i tij prej Haxhit mos të jetë fitimi i autoritetit para njerëzve dhe në ambiciet e tij prej Haxhi mos të ketë aspiratë prej aspiratave të dynjasë. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Kryeni Haxhin dhe Umren për hir të Allahut!”**. (Bekare 196)

Haxhiu para se të udhëton duhet që t'i shkruan porositë e amanetet, borxhet e tij dhe ato që i kanë borxh atij, për shkak se rruga është e gjatë dhe nuk dihet se çka mund të ndodh gjatë kohës së Haxhit, prandaj në rast se nuk kthehet i gjallë apo kthehet me vonesë, porositë i kryen familja e tij dhe shpëton nga përgjegjësia.

O ju robër të Allahut,

Frikojuni Allahut dhe përgatituni për në Haxh ashtu si i ka hije. Plotësoni ritet e juaja, pastroni nijetin, bëhuni modest, silluni mirë me vëllezërit e juaj haxhilerë, mos i torturoni, mos i ofendoni, dhe bëhuni të durueshëm në të gjitha vështirësitë e lodhjet e Haxhit, për shkak se Haxhi është prej xhihadit ndërsa xhihad pa mundime e lodhje nuk ka.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!”**. (Bekare 197)

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut për begatinë e Imanit dhe Islamit dhe Kuranit. Falënderimi i takon vetëm Allahut që na mundësoi ta presim muajin e Haxhit. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju muslimanë,

Frikojuni Allahut dhe mos e ndërtoni fenë tuaj në një anë duke e shkatërruar anën tjetër. Disa njerëz Haxhit dhe Umres i kushtojnë rëndësi të veçantë e në anën tjetër i anashkalojnë shtyllat e tjera të Islamit. Aspak nuk kujdesen për përmirësimin e besimit i cili është bazament i fesë, prandaj i sheh se si i drejtohen me lutje të vdekurve dhe afrohen kah ata me lloje të ndryshme të adhurimeve, ose e anashkalojnë faljen e namazit e cila është shtyllë e fesë ndërsa braktisja e saj është kufër dhe dalje prej fesë. Po ashtu nuk kujdesen

për dhënien e zeqatit e cila është shtylla e tretë e Islamit, nuk e agjërojnë Ramazanin i cili u detyrua prej anës së Allahut për besimtarët dhe këtij lloji të njerëzve nuk i pranohet Haxhi e as Umreja, deri sa nuk kujdesen për shtyllat e tjera të Islamit. Feja pra, nuk është vetëm Haxh, Haxhi është pjesë e fesë dhe shtyllë prej shtyllave të Islamit.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“A e besoni një pjesë të librit, e tjetrën e mohoni. Si mund të jetë ndëshkimi ndaj atij që punon ashtu prej jush, pos poshtërim në jetën e kësaj bote, e në Ditën e Gjykimit ata hidhen në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pakujdesshëm ndaj asaj që vepron ju. Të tillë janë ata që e vlerësuan jetën e kësaj bote mbi botën tjetër, andaj atyre as nuk do t’u lehtësohet dënimi, e as që do të ndihmohen ata”**. (Bekare 85-86)

Pas kryerjes së Haxhit, haxhiu detyrohet të përqendrohet në fe, t’i largohet mëkateve, të vepron vepra të mira, për arsye se veprat shpërblehen sipas përfundimit. Dera e pendimit është e hapur deri sa nuk vjen exheli, ndërsa ardhja e tij pritet çdo moment dhe nuk e di askush se ku dhe kur do të vdesë: **“Asnjë njeri nuk di ç’do të fitojë nesër dhe askush nuk di se në ç’vend do të vdesë”**. (Llukman 34)

33 - DISA VEÇORI TË HAXHIT DHE KUSHTET E TIJ.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu s’ka kush e humbë dhe kë e largon nga rruga e vërtetë Ai s’ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë përveç Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, që është Një dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju muslimanë,

Haxhi është një prej shtyllave të Islamit dhe bazament i fortë i tij. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt. Në të ka shenja të qarta (që janë): vendi i Ibrahimit (mekami Ibrahim); (fakti që) kush hyn në të është i sigurt; dhe vizita (për Haxh) e kësaj**

Faltoreje është detyrë për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd". (Ali Imran 96-97)

Prej kuptimit të ajetit dijetarët kanë konstatuar se Haxhi është detyrim mbi çdo musliman dhe ai i cili e mohon këtë dispozitë është qafir me pajtim të dijetarëve. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, i drejtohet të dashurit të Tij Ibrahimit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, duke i thënë: **"Thirri njerëzit për haxhillëk"** (Haxh 27)

Muhamedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **"Islami është i ngritur mbi pesë bazamente: Dëshmia se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, pastaj falja e namazit, dhënia e zeqatit, agjërimi i Ramazanit dhe shkuarja në Haxh, për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën"**.

Qëllimi i thënies **"për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën"**, është: kush ka ushqim të mjaftueshëm të merr me vete dhe t'i lë familjes deri sa të kthehet dhe të posedon mjet transporti i cili do ta çojë deri në Qabe dhe do ta kthejë deri në vatanin e tij.

Në ligjësimin e Haxhit gjejmë urtësi, dhe urtësinë e ligjësimin të saj na e qartëson Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, ku thotë: **"Që të dëshmojnë dobite e tyre dhe të përmendin Emrin e Allahut në ditët e caktuara mbi kafshët (për kurban), të cilat ua ka dhuruar Ai. Hani nga ato (mishin) dhe ushqeni nevojtarin e varfër! Pastaj, haxhinjtë le të pastrojnë trupin e tyre, le t'i kryejnë zotimet e tyre dhe le t'i vijnë rrotull Shtëpisë së lashtë"**. (Haxh 27-29)

Dobia e Haxhit pra, i kthehet vetëm haxhiut e jo Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, për shkak se: **"Allahu nuk ka nevojë për askënd"**. (Ali Imran 97) Ai nuk është nevojtarë për haxhilerë, por ata kanë nevojë për Atë.

Urtësia e vonimit të detyrimit të Haxhit krahas namazit, zeqatit dhe agjërimit qëndron në faktin se namazi është shtylla e fesë e cila përsëritet çdo ditë e natë nga pesë herë, zeqati është shtyllë e cila ceket shumë herë si shok i pa ndashëm i namazit, ndërsa agjërimi për shkak se përsëritet çdo vit. Haxhi është bërë i obliguar në Islam në vitin e nëntë pas hixhretit, kurse Muhamedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, nuk e ka kryer Haxhin më shumë se një herë edhe atë në vitin e dhjetë pas hixhretit, ndërsa gjatë jetës së tij i ka kryer katër Umre.

Synimi i Haxhit dhe Umres është adhurimi i Allahut në ato vende ku i ka caktuar që të adhurohet. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **"Qëllimi i gjuajtjes së gurëve dhe sajit mes Safës dhe Merues nuk është tjetër veç se të përmendet Allahu, Subhanehu ue Te'Ala"**.

Haxhi pra, është obligim me njëzëshmëri të muslimanëve dhe shtyllë prej shtyllave të Islamit. Është detyrim individual një herë në jetë për atë që ka mundësi dhe detyrim kolektiv i muslimanëve për çdo vit, ndërsa ai i cili shton më shumë se Haxhin e detyruar i llogaritet si vullnetar.

Umreja po ashtu është detyrim sipas mendimit të shumë dijetarëve, dhe si argument e marrin hadithin e Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, kur është pyetur se a ka xhihad për gratë? Përgjigja e tij ka qenë: **“Po, për gratë ka xhihad, mirëpo pa luftë: Haxhi dhe Umreja”**.

Pasi që është vërtetuar se Umreja për gratë është detyrim, atëherë kjo dispozitë për burrat është edhe më e kërkuar. Një njeri e pyeti Pejgamberin, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, për babanë e tij i cili ishte plak e i lodhur dhe nuk kishte mundësi të shkojë në Haxh e as në Umre. Përgjigja e tij ishte: **“Kryeje Haxhin dhe Umren në vend të tij”**.

Haxhi dhe Umreja janë detyrim i çdo muslimani një herë në jetë dhe duhet të përshpejton në kryerjen e tyre sipas mundësive, ndërsa çdo vonesë pa arsye është mëkat. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thuhet të ketë thënë: **“O ju njerëz, ju është bërë Haxhi detyrim, prandaj kryeni”**. – E pyeti njëri prej të pranishmëve: **“A çdo vit?”** – U përgjigj: **“Po të kisha thënë se po, atëherë do t’ju bëhej detyrim për çdo vit e ju nuk do të kishit mundësi ta përballoni”**.

Imam Ahmedi shënon një hadith ku Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Përshpejtoni në kryerjen e Haxhit se asnjëri prej jush nuk e di se çka do t’i ndodhë në të ardhmen”**.

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve dhe qiejve. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju njerëz,

Kushtet e Haxhit janë pesë: Islami, mendja e shëndoshë, pjekuria, liria dhe mundësia. Kur plotësohen këto kushte obligohet përshpejtimi i kryerjes së tij.

Haxhi dhe Umreja të bëra nga ana e fëmijës janë të pranuar mirëpo si vullnetare. Ibën Abasi, radijallahu anhu, na përcjell se një grua e ngriti fëmijën e saj dhe ia tregoi Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe i tha: Për këtë fëmijë a ka Haxh? Iu përgjigj. **“Po, Haxhi i tij është i pranuar (si vullnetar) dhe ti ke shpërblim”**.

Në mesin e dijetarëve ka pajtim se Haxhi i fëmijës i kryer para moshës madhore nuk e zëvendëson Haxhin e detyruar (**Haxhin e Islamit**), por detyrohet që kur ta arrijë moshën madhore ta kryen edhe një herë në rast se ka mundësi.

Kur fëmija është në moshën e papjekurisë, përgjegjësi i tij detyrohet që ta bëjë nijetin në vend të tij, gjatë kryerjes së tavafit dhe sajit dhe gjatë qëndrimit në Mina, Arafat dhe Muzdelife duhet ta shoqëron, gurët t'i gjuan në vend të tij dhe ta largon prej të gjitha ndalesave të Haxhit. Në rast se fëmija është në moshën kur kupton dhe i dallon gjërat (**por ende para pubertetit**) nijetin e Haxhit e bën vetë, por me lejen e përgjegjësit, ritet e Haxhit i kryen vetë ndërsa ato rite të cilat nuk ka mundësi t'i kryejë vet i kryen përgjegjësi i tij dhe detyrohet t'i largohet të gjitha ndalesave të Haxhit sikurse i rrituri.

I aftë për kryerjen e Haxhit është ai i cili ka mundësi fizike e materiale, i përballon rrugës dhe mjetit të udhëtimit, i mjaftojnë të hollat gjatë shkuarjes dhe kthimit, po ashtu ka pasuri të mjaftueshme për anëtarët e familjes deri sa të kthehet, rruga deri në Haxh është e sigurt për jetën dhe pasurinë e tij dhe nuk duhet të niset pa i la borxhet (**ose të merr leje prej borxhliut që të shkon në Haxh**) dhe të kërkon falje prej atyre që u ka bërë padrejtësi. Në rast se ka pasuri mirëpo fizikisht është i dobët për shkak pleqërisë apo sëmundjes prej të cilës nuk shpresohet shërim, detyrohet që ta dërgon ndokënd që ta kryen Haxhin në vend të tij qoftë prej të njëjtit vend apo ndonjë vendi tjetër. Ibën Abasi, radijallahu anhu, na përcjell se një grua e pyeti Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, se babai i saj është plak i cili nuk e ka kryer Haxhin e detyruar dhe nuk mundet t'i përballojë udhëtimit, a mundet që ta kryej Haxhin në vend të tij? – Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, iu përgjigj: **“Kryeje Haxhin në vend të tij”**.

Kusht për atë që e kryen Haxhin për ndonjë tjetër është ai ta ketë kryer Haxhin e Islamit për vete, duke u bazuar në atë që na e përcjell Ibën Abasi, radijallahu anhu, se ai e kishte dëgjuar një njeri të ketë thënë: **“O Zot, i përgjigjëm ftesës Tënde për në Haxh në vend të Shubrumes”**. – Ibën Abasi i tha: **“A e kryer Haxhin për vete”?** – Iu përgjigj: **“Jo, nuk e kam kryer Haxhin e Islamit për vete”**. – Ibën Abasi i tha: **“Atëherë bëje së pari për vete e pastaj mundesh që ta bësh për ndonjë tjetër”**.

Zëvendësit (**bedelit**) duhet t'i jepen të holla për rrugë, për ushqim dhe për nevojat tjera që i nevojiten gjatë Haxhit, nuk lejohet qiraja për Haxh dhe nuk lejohet ta merr Haxhin si mjet për përfitim të hollave. Synimi i zëvendësit duhet të jetë dobia e atij vëllait musliman që e kryen Haxhin për të, pastaj vizita e vendeve të shenjta, vizita e Qabesë, kështu që Haxhi duhet të kryhet vetëm për Allah e jo për dynja. Nëse Haxhin e kryhen për të holla, Haxhi i tij nuk është i pranuar dhe po ashtu nuk i pranohet edhe atij i cili e ka dërguar për në Haxh.

Prandaj duhet te kemi kujdes se kë e dërgojmë si zëvendësim në Haxh, për shkak se Haxhi është adhurim ndërsa adhurimet nuk kryhen përveçse për Allah.

34 - IBADETI NË MUAJIN DHUL HIXHE.

Hutbeja e parë

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu s'ka kush e devijon dhe kë e largon nga rruga e vërtet Ai s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të vërtet vetëm se Allahut, Subhanehu ue Te'Ala, që është Një dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju musliman,

Frikojuni Allahut, mos harroni se jeni duke jetuar në një botë kalimtare ku statusi i juaj në të është ai i mysafirit dhe se tek Allahu është kthimi i vërtet. Tani jemi në prag të muajit Dhul Hixhe, muaj madhështor i cili në vete përmban shumë begati e merita dhe adhurime të llojllojshme. Dhjetë ditët e para të këtij muaji Allahu i theksoi në Kuran duke thënë: **“Betohem për muzgun e agimit dhe për dhjetë netët (e para të muajit Dhul Hixhe)!”**. (Fexhër 1-2)

Imam Buhari, RahimehUllah, në librin e tij shënon një hadith prej Ibën Abasit, radijAll-llahu anhu, se Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Nuk ka vepër më të vlerësuar dhe me sevap më të madh, sesa një vepër e mirë që bëhet gjatë dhjetë ditëve të Dhul Hixhes”**. Dikush e pyeti: **“As pjesëmarrja në xhihad?”** Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, u përgjigj: **“As pjesëmarrja në xhihad, përveç një burri i cili del me veten dhe pasurinë e tij dhe nuk kthehet me asnjërin”**.

Në një transmetim tjetër: **“Nuk ka ditë ku veprat e mira janë më të dashura tek Zoti, sesa këto dhjetë ditë”**. Shokët e tij, të çuditur e pyetën: **“Edhe se pjesëmarrja në xhihad, o i dërguar i Allahut?!”** Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ua ktheu: **“Përveç një burri i cili ka dalë me veten dhe pasurinë e tij dhe nuk kthehet me asnjërin”**.

Këto dy hadithe, janë tregues se dhjetë ditët e Dhul Hixhes, janë ditët më të mira të vitit pa përjashtim, madje janë më të mira edhe se dhjetë ditët e fundit të ramazanit.

Por, dhjetë netët e fundit të ramazanit janë më të mira, pasi në to gjendet nata e Kadrit e cila është më e mirë se njëmijë muaj. Kështu, kuptohen më mirë hadithet dhe vlerat e secilit sezon.

Po ashtu hadithet na mësojnë se veprat që kryhen në dhjetë ditët e para të këtij muaji janë më të dashura tek Allahu se sa veprat e ditëve të tjera të çdo muaji, dhe se këto ditë janë më të mira se lufta në rrugë të Allahut, duke e bërë përjashtim këtu luftën në të cilën burri del me veten dhe me pasurinë e tij dhe nuk kthehet me asnjërin. I vetmi ky lloj i luftës në rrugë të Allahut është më me vlerë se sa dhjetë ditët e para të muajit Dhul Hixhe.

Allahu në këto ditë e preferoi agjërimin duke e përjashtuar këtu ditën e dhjetë, për shkak se ajo është dita e Kurban Bajramit. Hafsa, radijAllahu anha, tregon se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, katër gjëra nuk i linte kurrë: **“Agjërimin e ashuras (ditës së dhjetë të Muharremit), agjërimin në dhjetë ditët e Dhul Hixhes, agjërimin e tri ditëve të çdo muaji dhe faljen e dy rekateve përpara sabahut”**.

Në këto ditë po ashtu preferohet shpeshimi i përmendjes së Allahut, falënderimi i Tij, madhërimi i Tij dhe është mirë që të ngrihet zëri gjatë përmendjes së Allahut nëpër tregje. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“të përmendin Emrin e Allahut në ditët e caktuara”** (Haxh 28)

Imam Buhariu, RahimehUllah, në librin e tij shënon prej Ibën Omerit dhe Ebu Hurejrës, (radij-Allahu 'anhum), se këta dy dilnin në tregje, e madhëronin Allahun me tekbire dhe njerëzit e madhëronin se bashku me ta.

Tekbiret janë sunet të thuhën gjatë tërë ditëve të dhjetëditëshit të parë të Dhul Hixhes dhe ditëve të bajrameve, në çdo kohë. Kurse në mëngjesin e ditës së Arafatit, pas namazit të sabahut e deri në ditën e katërt të Bajramit pas ikindisë është sunet pas çdo namazi t'i këndojmë tekbiret pas namazeve të detyruara (**farze**). Forma e tekbireve është: **“Allahu Ekber, Allahu Ekber, la ilahe il-lAllahu uallahu Ekber. Allahu Ekber ue lilahil hamd”**.

Pasi që secili njeri nuk mundet të shkojë në Haxh, Allahu ia zëvendësoi robit Haxhin me këto ditë të bekuara e të vlefshme, dhe e mësoi se veprimi i punëve të mira në to ia tejkalon në shpërblim edhe luftës në rrugë të Allahut. Në këto ditë bie dita e Arafatit e cila është dita më e mirë. Ibën Hibani, RahimehUllah, në librin e tij shënon një hadith prej Xhabirit, radijAll-llahu anhu, se Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Dita më e mirë është dita e Arafatit”**. Agjërimi i kësaj dite është shkak për faljen e mëkateve të vogla të vitit të kaluar dhe atij që vijon. Është pyetur Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-

lem, për agjërimin e ditës së Arafatit dhe ka thënë: **“Agjërimi i Ditës së Arafatit i shlyen mëkatet e vitit të kaluar dhe vitit të ardhshëm”**. Po ashtu thoshte, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“Për agjërimin e ditës së Arafatit shpresoj që Allahu të mi falë mëkatet e vitit të kaluar dhe vitit të ardhshëm.”**

Kjo ditë pëlqehet të agjërohet nga ai i cili nuk është në Haxh, ndërsa haxhiu nuk duhet ta agjërojë për arsye se atë ditë duhet të jetë i fortë që ta adhurojë Allahun më tepër, ta përmend më tepër, të lutet më tepër, se ajo ditë është ditë e faljes së gjynaheve dhe lirim prej zjarri.

Imam Muslimi, RahimehUllah, e përcjell një hadith prej Aishes, radijAllahu anha, se Muhamedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Nuk ka ndonjë ditë që lirohen më së shumti nga zjarri i xhehenemit se dita e Arafatit, Allahu u afrohet atyre, pastaj lavdërohet me ata para melaqeve dhe thotë: “Çfarë dëshirojnë ata?!”**

Ibën Abdulberri, RahimehUllah, thotë: **“Kjo aludon se ata janë të falur nga mëkatet, për shkak se Allahu nuk lavdërohet me gabimtarët dhe mëkatarët, përveç pas pendimit dhe faljes”**.

Gjithashtu, Ibën Hibani, RahimehUllah, transmeton se Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Nuk ka ndonjë ditë që është më me vlerë tek Allahu se dita e Arafatit. Allahu i Lartësuar zbret në qiellin e kësaj bote dhe lavdërohet me banorët e tokës ndaj banorëve të qiellit”**. Kurse në një transmetim tjetër thuhet: **“Allahu i Lartësuar lavdërohet me ata që qëndrojnë në Arafat tek melaqet dhe thotë: “O melaqet e Mi, shikoni robërit e Mi, më kanë ardhur të pakrehur, të pluhurosur (nga rruga) dhe duke sakrifikuar”**.

Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thoshte: **“Lutja më e mirë është ajo e ditës së Arafatit, ndërsa fjala më e mirë që e kam thënë unë dhe Profetët para meje është “La ilahe il-lAllahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul Hamdu ue Huve ala kul-li shejin Kadir” (S’ka të adhuroar përveç Allahut Një dhe të pashoq, Atij i takon sundimi dhe Lavdërimi, Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send)**.

Në këtë muaj të begatshëm bie edhe dita e Kurban Bajramit, e cila njihet edhe si dita e Haxhit të Madh. Në këtë ditë haxhilerët e plotësojnë Haxhin e tyre, i therin kurbanët, i gjuajnë gurët, i rruajnë ose i shkurtojnë flokët, e kryejnë Tavafin në Qabe, ecin mes Safës dhe Meruas, ndërsa muslimanët të cilët nuk janë në Haxh anekënd botës e falin namazin e Bajramit dhe e përmendin Allahun.

Në këtë muaj të begatshëm bien edhe ditët e ashtuquajtura **“të caktuara”**, të cilat janë ditët e qëndrimit në Mina. Imam Muslimi, RahimehUllah, e përcjell një

hadith prej Profetit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i cili ka thënë: **“Ditët e qëndrimit në Mina janë ditë të ngrënies, pirjes dhe përmendjes së Allahut”**.

Këto ditë janë ditët e numëruara, të caktuara, të cilat i thekson Allahu në Kuran: **“Dhe madhëroni Allahun në (tre) ditët e caktuara (të Teshrikut)”**. (Bekare 203)

Këto tre ditë janë pas ditës së Bajramit, preferohet në to përmendja e Allahut, duke filluar prej tekbireve të caktuara pas çdo namazit të detyruar, pastaj përmendja dhe madhërimi i Allahut gjatë prerjes së kurbanit, gjatë gjuajtjes së gurëve, gjatë ngrënies dhe pirjes, e kështu me radhë.

Në përgjithësi muaji i Dhul Hixhes është muaj i adhurimeve të llojllojshme, muaj i begative të ndryshme, është muaj prej muajve të Haxhit ku ndalohen luftërat dhe në këtë muaj kryhet Haxhi në Qabe.

Prandaj o ju musliman, falënderoni Allahun për këtë begati të madhe, shfrytëzoni mirësitë e saj dhe mos u bëni prej të shkujdesurve.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Nuk është gjynah të kërkonit nga Zoti juaj ndonjë të mirë. E, kur të ktheheni nga Arafati, përmendni Allahun në vendet e shenjta! Përmendni Atë që ju ka udhëzuar në rrugën e drejtë, sepse ju më parë ishit të humbur! Mandej, kthehuni, siç kthehen të gjithë të tjerët dhe kërkonit ndjesë prej Allahut! Se Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë. Pasi t’i kryeni ritet e haxhillëkut, përmendni Allahun ashtu siç i kujtoni prindërit tuaj, madje edhe më tepër! Disa njerëz thonë: “Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë!” Por, për këta, s’ka asnjë të mirë në botën tjetër. Por ka dhe të tjerë që thonë: “Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)” Këtyre do t’u jepet shpërblim për atë që kanë bërë. Allahu është i shpejtë në llogari. Dhe madhëroni Allahun në (tre) ditët e caktuara (të Teshrikut). Por, edhe ata që nguten dhe rrinë vetëm dy ditë (në Mina), nuk bëjnë gjynah; nuk bën gjynah as ai që rri më shumë, nëse i frikësohet vërtet Allahut. Ta keni frikë Allahun e ta dini mirë se vetëm tek Ai do të tuboheni!”** (Bekare 198-203)

Hutbeja e dytë

Falënderimi i takon vetëm Allahut për begatinë e Imanit, Islamit dhe Kuranit. Falënderimi i takon vetëm Allahut që na mundësoi ta presim muajin e Haxhit. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju musliman,

Frikojuni Allahut dhe dijeni se agjërimi i ditëve të Caktuara (**tre ditëve pas Bajramit**) është i ndaluar. Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Ditët e qëndrimit në Mina janë të ndaluara për agjërime. Ato janë ditë të ngrënies dhe pijes”**.

Në një transmetim tjetër: **“Dita e Arafatit, dita e Bajramit dhe ditët e Teshrikut (Dita e dytë, e tretë dhe e katërt e Bajramit) janë festa tona dhe ato ditë janë ditë të ngrënies dhe pijes”**.

Në ndalesën e agjërimit të këtyre ditëve gjejmë urtësi të madhe. Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, duke i ditur vështirësitë e haxhiut që i përjeton gjatë udhëtimit, lodhjet e tij gjatë periudhës së qëndrimit në Ihram, pastaj luftën shpirtërore dhe atë trupore gjatë kryerjes së riteve të Haxhit, ia ligjësoi atij qëndrimin në Mina, ditën e Bajramit dhe tre ditë pas saj, që të jetë për haxhiun pushim, të hajë e të pijë në to, për shkak se ai është mysafir i Allahut dhe është në gostinë e Tij.

Haxhilerëve i bëjnë shoqëri edhe muslimanët anekënd botës të cilët nuk janë pjesëmarrës në Haxh, për shkak se ata iu bashkëngjiten në dhjetë ditët e para të muajit, me agjërime, me lutje, me përmendje të shpeshtë të Allahut, me tekbiere, dhe me therje të kurbanit ditën e Bajramit. Të gjithë morën pjesë në faljen e Bajramit, në ritet e tij, atë ditë u ushqyen dhe pushuan prej lodhjeve të agjërimit, kështu që të gjithë muslimanët morën pjesë në gostinë e Allahut.

Këto ditë muslimanët hanë dhe pinë prej furnizimit të Tij, e falënderojnë për të mirat e Tij, prandaj edhe ndalohen prej agjërimit të këtyre ditëve.

E lus Allahun, Subhanehu ue Te'Ala, të na mundëson agjërimin e këtyre ditëve, po ashtu lehtësimin e veprimit të adhurimeve dhe faljen e mëkateve.

35 - VLERA E XHIHADIT DHE LLOJET E TIJ.

Falënderimi i takon vetëm se Allahut, Atë e lavdërojmë dhe vetëm nga Ai falje dhe ndihmë kërkojmë. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë përveç Allahut dhe paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi imamin e Pejgamberëve dhe shëmbëlltyrën e shpenzuesve dhe modelin e të devotshmëve Muhamedin birin e Abdullahit dhe robin e Allahut

O ju njerëz, frikojuni Allahut dhe dijeni se xhihadi është kulminacioni i Islamit dhe se gradat e luftëtarëve në rrugë të Allahut janë ato më të lartat në mesin e banorëve të Xhenetit. Ashtu siç janë gradat dhe pozitat e tyre të larta në ahiret poashtu gradat dhe pozitat e tyre janë të larta edhe në dynja. Allahu i

Madhëruar thotë: **“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!”**. (Ankebut 69)

Allahu i urdhëroi besimtarët që të luftojnë ashtu si duhet luftuar: **“O besimtarë! Përkuluni dhe përruluni në sexhde (para Allahut)! Adhuroni Zotin tuaj dhe bëni vepra të mira për të arritur shpëtimin! Luftoni në rrugën e Allahut, ashtu si duhet luftuar”**. (Haxh 77-78) Ashtu si i urdhëroi t’i frikohen me frikërespekt të vërtet duke e adhuruar e jo duke i bërë gjynahe, duke e përmendur e jo duke e neglizhuar, duke e falënderuar e jo duke e mohuar, i urdhëroi të luftojnë ashtu si duhet luftuar edhe atë duke e luftuar robi nefsën e vet me qëllim që t’i nënshtrohet zemra, gjuha dhe gjymtyrët Zotit të tij dhe kjo e tëra të jetë për Allahun dhe me Allahun.

Xhiahadi ndahet në katër lloje: xhiahadi i nefsit, xhiahadi i shejtanit, xhiahadi i jobesimtarëve dhe xhiahadi i hipokritëve dhe i mëkatarëve. Krijesa më e përsosur tek Allahu është ai që i plotëson të gjitha gradat e xhihadit. Krijesat dallohen njëra me tjetrën tek Allahu ashtu si dallohen në gradat e xhihadit. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ishte krijesa më e përsosur dhe më fisnike te Allahu për arsye se i plotësoi të gjitha llojet dhe gradat e xhihadit dhe luftoi në rrugë të Allahut ashtu si duhet luftuar nga momenti i shpalljes së tij si i Dërguar i Allahut e deri në vdekjen e tij. Kur i zbriti fjala e Allahut: **“O ti, i mbështjellë (o Muhamed)! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje, petkat e tua pastroji”**. (Mudethir 1-4), u ngrit dhe thirri në fenë e Allahut ditë e natë, fshehurazi e në publik, kurse kur i zbriti ajeti: **“Ti prediko haptazi atë që të është urdhëruar”**. (Hixhr 94), u ngrit dhe thirri haptazi duke mos u mërzhitur aspak për pasojat.

Kur u urdhërua që të lufton jobesimtarët e respektoi urdhrin e Allahut, i luftoi personalisht në njëzet e ca beteja duke qenë e para nga to beteja e Bedrit dhe e fundit beteja e Tebukut.

Çdo musliman duhet që të lufton me një nga llojet e xhihadit, me zemër apo me gjuhë, me pasuri apo me dorë. Muslimani në këtë jetë sillet mes tre armiqve që duhet patjetër t’i lufton, nefsën, shejtanin dhe mëkatarët nga jobesimtarët dhe hipokritët dhe gjynahqarët.

Xhiahadi i nefsit është ai bazë kurse të tjerët janë degë e tij.

I Dërguari i Allahut. sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Muxhahid është ai që bën xhihad kundër nefsit (vetes) së tij duke iu bindur Allahut, dhe Muhaxhir është ai që largohet nga ajo që e ka ndaluar Allahu”**.

Ai që nuk lufton me nefsën e tij që ta vepron atë me të cilën urdhërohet dhe të largohet nga ajo që ndalohet, nuk mundet ta lufton armikun e tij të jashtëm. Tentimi për sundim nga ana e këtyre tre armiqve mbi robin e Allahut është një

sprovë dhe bela për të dhe për këtë arsye robit i është dhënë kohë dhe armë që t'i ballafaqohet armiqve të tij.

Xhiahadi i nefsit pra, bëhet me detyrimin e mësimit të udhëzimit dhe të vepruarit me të dhe thirrja në të dhe durimi në të dhe të ndaluarit e tij nga epshet dhe pasionet e ndaluara.

Xhiahadi i shejtanit bëhet me përgënjeshttrimin e premtimeve të tij dhe me mosrespektimin e urdhërave të tij dhe me të vepruarit e ndalesave të tij. Shejtani e premtun lumturinë dhe e zbukuron të ligën, frikëson nga varfëria dhe urdhëron në imoralitet dhe largon nga devotshmëria. Allahu i Madhëruar thotë: **“Me të vërtetë, djalli është armik për ju, andaj vështrojeni si armik!”**. (Fatir 6) Urdhri për ta marrë si armik aludon në atë se robi është i lirë ta lufton atë për arsye se ai nuk lodhet nga armiqësia e robit ditë e natë.

Kurse për sa i përket xhihadit të mëkatarëve dhe gjynahqarëve, ai është tre lloj:

Me dorë sipas mundësive, e nëse nuk mundet kalon në atë me gjuhë, e nëse nuk mundet atëherë lufton me zemër duke e urretur të keqen me zemër dhe duke u larguar nga përzierja me të ligtit ashtu si edhe tha i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“Kush nga ju sheh një të keqe – le ta ndryshojë me dorë, e nëse nuk mundet këtë ta bëjë – atëherë me gjuhën e tij, e nëse nuk mundet këtë ta bëjë – atëherë me zemrën e tij, porse ky është imani më i dobët”**.

Mohimi me zemër detyrohet në çdo situatë nëse në veprimin e tij nuk ka dëm, kurse ai që nuk e vepron është me iman të dobët duke u bazuar në hadithin e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“porse ky është imani më i dobët”**.

Muslimani duhet së pari të fillon me veten e pastaj me familjen e pastaj me fëmijët e tij dhe me ata që janë nën përkujdesjen e tij, t'i urdhëron në të mirën dhe t'i ndalon nga e keqja ashtu si thotë edhe Allahu i Madhëruar: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët”**. (Tehrim 6) I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Secili nga ju është bari dhe secili nga ju është përgjegjës për kopenë e tij”**.

Pra përgjegjësi i shtëpisë është bari i asaj që gjendet në të dhe për këtë arsye o ju robërit e Allahut, frikojuni Allahut. Shumica e shtëpive tuaja janë të mbushura me gjynahe dhe mëkatarë kurse ju banoni në mesin e tyre dhe nuk flisni e as nuk mendoni për përmisim. Ju vetëm se e neglizhuat përgjegjësinë tuaj dhe e humbët kopenë tuaj. Frikojuni dënimeve dhe qëndrimit para Allahut ditën kur do të pyetni për kopenë tuaj. Betohem në Allahun se nëse njëri nga fëmijët e juaj u dëmton diçka nga pasuria juaj nuk do rrini pa folur dhe nuk do

ta lejonit që të luan me pasurinë e juaj dhe çështjen do ta merrnit më me seriozitet. Mirëpo, kur ndonjëri i tejkalon kufijtë e fesë suaj atëherë çështja në shikimet e juaja është e lehtë për arsye se dynjaja tek disa është më e shtrenjtë se sa feja e tij, Allahu na ruajt.

Kurse sa i përket xhihadit të munafikëve, ai bëhet me gjuhë edhe atë duke iu kundërpërgjigjur dyshimeve të tyre dhe duke ua hedhur poshtë shpifjet e tyre të cilat i shpërndajnë në mesin e muslimanëve me qëllim shkatërrimi dhe çoroditje. Kjo, për arsye se hipokritët e munafikët jetojnë në mesin e muslimanëve e paraqesin Islamin dhe e fshehin kufrin e tyre dhe dëmi i tyre është shumë i rrezikshëm dhe dëmi për muslimanët është shumë i madh. Ata përherë tentojnë dhe nxisin në shkatërrim, ndarjen e rreshtave dhe mbjelljen e armiqësisë në mesin e muslimanëve. Kjo është arsyeja se pse Allahu ka urdhëruar në luftimin e tyre edhe atë me argumente dhe me qartësime dhe me paralajmërimin e muslimanëve nga sherri i tyre dhe përshkrimin e cilësive të tyre të fëlliqura derisa ta njohin muslimanët realitetin e tyre dhe të jenë të kujdesshëm nga ta.

Kurse sa i përket xhihadit të jobesimtarëve, ai bëhet me zemër dhe gjuhë dhe pasuri dhe me shpirt. Detyrohet çdo musliman që t'i lufton jobesimtarët me pasuritë e tyre dhe me shpirtrat e tyre për arsye se Allahu urdhëroi në të në shumë ajetet Kuranore. Ai që nuk mundet të lufton me trup nuk bie nga ai xhihadi me pasuri dhe ai që nuk mundet të lufton me pasuri nuk bie nga ai xhihadi me trup.

Xhihadi i jobesimtarëve ndahet në dy lloje:

Xhihadi mbrojtës: Kur armiku dëshiron t'i sulmon muslimanët atëherë ai detyrohet të luftohet me të gjitha mundësitë që posedohen me qëllim që të mbrohet feja, pasuria dhe nderi dhe kjo është luftë detyruese imponuese.

Xhihadi kërkues: Kur muslimanët i sulmojnë jobesimtarët në tokat e tyre për ta ngritur fjalën e Allahut dhe për ta frikësuar armikun. Ky lloj i xhihadit është me karakter zgjedhës dhe është detyrim kolektiv e jo individual sikurse lloji i parë. Qëllim nga luftimi i jobesimtarëve është që të mos adhurohet askush tjetër përveç se Allahut, të gjitha lutjet e adhurimet t'i përkushtohen vetëm se Atij, Haxhi dhe Kurhani të jenë vetëm se për Allahun dhe të jetë feja e tëra për Allahun dhe padyshim se fjala e Allahut është ajo më e larta.

Kohëve të fundit janë paraqitur disa grupe që e mohojnë xhihadin dhe thirrjen në të mirë dhe ndalimin nga e keqja dhe e përkufizojnë fenë në adhurime dhe dhikër dhe **“dalje”** nëpër tokë për davet. Në anën tjetër është paraqitur një grup i shkrimtarëve dhe autorëve të cilët e mohojnë xhihadin kërkues dhe pretendojnë se xhihadi përkufizohet vetëm se në atë mbrojtës. Kjo do të thotë se muslimanët nuk duhet të flasin për Islamin dhe t'i lënë jobesimtarët në kufrin e tyre derisa të fillojnë t'i sulmojnë muslimanët në tokat e tyre. Kjo

padyschim se është ide e fëlliqur nga armiqtë e Islamit të cilët dëshirojnë ta sulmojnë këtë fe dhe mos ta lejojnë përhapjen e tij në tokë, po ta lejojnë përhapjen e kufrit dhe sherrit dhe të përkufizohet Islami vetëm se në disa vende të caktuara. Me këto ide ata dëshirojnë që kur të rriten brezat e ardhshëm të fëmijëve të muslimanëve dhe të ballafaqohen me këtë ide mashtruese ta harrojnë luftën në rrugën e Allahut.

Për këtë arsye dijetarët e Islamit duhet tërhequr vërejtjen nga ky rrezik dhe ta kundërshtojnë me të madhe këtë ide dhe ta qartësojnë rrezikun e saj dhe t'i qartësojnë mirë dispozitat e xhihadit dhe llojet shkaqet dhe dobitë e tij. Kjo, duke ua mësuar rregullat nga librat e dijetarëve të të parëve tanë dhe autorëve të njohur Islam dhe largimin nga librat e të ashtu quajturve dijetarë që nuk i njohin dispozitat e sheriatit dhe janë të ndikuar nga idetë e dyshimta.

Ata shkrimtarë dhe autorë bashkëkohorë janë të ndikuar nga idetë e perëndimit dhe orientalistëve të cilët thonë se xhihadi në Islam është vetëm se mbrojtës. Kjo padyshim se është fëlliqësirë e orientalistëve dhe injorancë nga vet autorët muslimanë dhe duhet të tërhiqet vërejtja nga ato ide dhe nga rreziku i saj për arsye se ajo është mohim i xhihadit i cili është kulminacioni i Islamit dhe rruga e përhapjes dhe thirrjes në të.

36 - VLERA E BESIMIT NË FSHEHTËSINË – GAJBIN DHE KUPTIMI I TIJ.

Falënderimi i takon vetëm se Allahut që na bëri musliman dhe na dalloi nga jobesimtarët. Falënderimi i takon vetëm se Allahut i Cili na dhuroi mendjen dhe na dalloi nga kafshët. Lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi Muhamedin, të birin e Abdullahit dhe robin e Allahut.

O ju njerëz, frikojuni Allahut dhe dijeni se imani është cilësia dalluese e fitimtarëve nga atyre të humburve në mesin e bijve të Ademit. Allahu i Madhëruar thotë: **“Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin”.** (Asr 1-3).

Katër cilësi janë shpëtuese nga humbja e vërtet: Imani, vepra e mirë, këshilla në të vërtetën dhe këshilla në durim.

Nuk arrihet deri tek imani me shpresa apo me pretendime dhe prejardhje por imani është ajo që ngulitet në zemër dhe e vërtetojnë veprat. Imani është besim

me zemër, të shprehurit me gjuhë dhe vepër e gjymtyrëve, shtohet me nënshtrime dhe dobësohet me gjynahe.

Një nga veçoritë më të mëdha të imanit është imani në fshehtësitë (**gajbin**). Allahu i Madhëruar thotë: **“Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne”**. (Bekare 2-3).

Me besim në fshehtësinë – gajbin e nënkuptojmë atë që ti nuk e sheh mirëpo i beson thellësisht duke iu mbështetur lajmeve të sakta të arritura nga ana Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Muslimani beson në Allahun, melekët e Tij, librat e Tij, të Dërguarit e Tij, beson në Ditën e Kiametit dhe i beson caktimit të Allahut, në të mirën dhe të keqen e tij. Poashtu i beson të gjithë asaj që e ka paralajmëruar Allahu dhe i Dërguari Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, nga ngjarjet e mëhershme dhe ato që do të ndodhin më vonë, nga lajmet e të Dërguarve dhe popujve të mëhershëm, dhe nga ajo që do të ndodhë nga shenjat e Kiametit si paraqitja e Dexhallit, zbritja e Isait, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dalja e Jexhuxhëve dhe Mexhuxhëve, dalja e kafshës, lindja e diellit nga perëndimi dhe nga shenjat e tjera për të cilat na ka lajmëruar i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, se do të ndodhin para Kiametit. Muslimani poashtu i beson asaj që do të ndodhë në jetën e varrit nga dënimi dhe begatia në varr, beson në ringjalljen, llogarinë, peshoren, Xhenetin dhe Xhehenemin.

Ai për këtë qëllim përgatitet dhe vepron dhe çështjet nuk i neglizhon. Allahu i Lartësuar thotë: **“Me të vërtetë, për ata që largohen nga rruga e Allahut, ka dënim të ashpër, ngaqë e kanë harruar Ditën e Llogarisë”**. (Sad 26), dhe **“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!”** (Hashër 18).

Kush e stolis veten me këtë besim dhe në të është i bindur fort nuk e lejon që dynjaja ta preokupon e ta largon nga ky besim që pastaj të radhitet në mesin e atyre që për ta Allahu thotë: **“Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar”**. (Eala 16 -17).

Allahu iu kërcënua rreptë atyre që e posedojnë këtë cilësi dhe tha: **“Atëherë, ai që ka shkelur gjithçka dhe ka parapëlqyer jetën e kësaj bote”**. (Naziat 37-38).

Besimtari nuk e lejon që dynjaja të ndikon në ahiretin e tij po ai dynjanë e shfrytëzon si arë ku në të mbjell dhe shpreson të korrurat t'i merr më vonë, për arsye se ai e din se kjo dynja është kalimtare dhe se ahireti është vendbanimi i tij i përhershëm. Pra Allahu besimtarit ia bashkon të mirat e dynjasë me ato të ahiretit, kurse jobesimtarit ia humb dynjanë dhe ahiretin. Allahu i Madhëruar

thotë: **“Disa njerëz të tjerë e adhurojnë Allahun me kusht: Nëse u ecën mbarë, janë të kënaqur, por, nëse i godet fatkeqësia, ata kthehen në mohim e kështu humbasin këtë botë dhe tjetrën. Pikërisht kjo është humbja e qartë”**. (Haxh 11).

Abdurrahman ibën Zejd ibën Eslem, radijAll-llahu anhu, thotë se këto janë cilësi të hipokritit, të cilit kur i përmissohet dynjaja merret me adhurime e kur i shkatërrohet dynjaja atëherë i ndryshohet zemra dhe nuk i afrohet adhurimeve kurse kur e kaplon ndonjë sprovë apo vështirësi atëherë e len fenë dhe i kthehet mosbesimit.

Nga besimi në fshehtësitë është që besimtari të vepron me sheriatin e Muhamedit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem,dhe t'i nënshtrohet atij edhe pse nuk e takuar asnjëherë. Disa nga sahabët i thanë të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: “A ka popull i cili ka shpërblime më shumë se ne. I besuam Allahut dhe të pasuam ty. Ai, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, u përgjigj: **“Çka ju pengon nga kjo? Të Dërguarin e Allahut e keni në mesin e juaj i cili ju vjen me shpallje nga ana e Allahut. Po pas jush do të vijnë popuj që do t’ju sillen Libri mes dy pllakave i besojnë atij dhe veprojnë me të. Ata kanë dyfish më shumë shpërblime se sa ju”**.

Në një hadith tjetër përcillet se ai që kapet për fenë e tij gjatë periudhës së sprovave e ka shpërblimin e pesëdhjetë sahabëve. Ebu Thalebe el Hashenij, radijAll-llahu anhu, e pyeti të Dërguarin e Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, rreth ajetit: **“O besimtarë! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t’ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë. Tek Allahu do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmërojë për atë që keni punuar”**. (Maide 105) dhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i tha: **“Urdhëroni të mirën dhe ndaloni nga e keqja, derisa ju të shihni të ndiqen epshet dhe të preferohet dynjaja (më shumë se ahireti) dhe secili njeri do të mashtrohet nga mendimet e tij personale. Kujdesuni për veten tuaj dhe largohuni nga njerëzit e zakonshëm sepse ta dini që pas jush do të ketë ditë durimi, në ato ditë kush kapet për fenë Allahut është njëlloj sikur të mbajë prushin në dorë. Kush është i aftë ta bëjë këtë (të durojë) do të ketë shpërblimin e 50 personave”**.

Sahabët pyetën: O i Dërguari i Allahut, shpërblimin e 50 nga ne apo nga ata? Ai, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, iu përgjigj: **“Shpërblimin e 50 nga ju”**.

Ebu Hurejra, Allahu qoftë kënaqur nga ai, përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë. **“Ai që kapet për traditën time gjatë periudhës kur shkatërrohet Umeti im e ka shpërblimin e dëshmorit”**.

Besimi në fshehtësinë – gajbin poashtu e përfshin edhe atë që i nënshtrohet Allahut dhe veprën e ka të sinqertë për Allah pa marrë parasysh a vepron në mesin e njerëzve apo në vetmi. Allahu i Madhëruar thotë: **“Vërtet, për ata që i**

frikësohen Zotit të tyre pa e parë Atë, do të ketë falje dhe shpërblim të madh". (Mulk 12, dhe **"që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer (nga Allahu)"**). (Kaf 33).

Këto cilësi janë të krejtësisht të kundërta me ato të munafikut i cili paraqitet se e adhuron Allahun në publik kurse kur vetmohet e mohon Zotin e tij. Allahu thotë: **"Kur takohen me besimtarët, ata thonë "Besojmë" – por, kur mbesin vetëm me djajtë e tyre, thonë: "Në të vërtetë, ne jemi me ju; ne vetëm po talleshim"**". (Bekare 14).

Besimi në të fshehtën e dallon njeriun që logjikon dhe ka mendje nga njeriu shtazarak i cili nuk beson përveç se atë që e percepton dhe e sheh. Ky i përngjason besimit të kafshëve i cili nuk e dallon me diçka njeriun nga kafshët dhe nuk i bën kurrfarë dobie. Allahu i Madhëruar thotë: **"Dhe, kur panë dënimin Tonë, ata thanë: "Tani ne nuk besojmë në askënd tjetër veç Allahut dhe i mohojmë idhujt që ia shoqëronim Atij (në adhurim)". Por besimi i tyre nuk u solli kurrfarë dobie, kur panë dënimin Tonë. I tillë është ligji i Allahut, që ka vepruar gjithmonë midis robërve të Tij. Të humbur kanë qenë jobesimtarët"**. (Gafir 84 -85).

Faraoni kur e pa se po fundoset tha: **"Besoj se s'ka zot tjetër përveç Atij që i besojnë bijtë e Izraelit; dhe unë jam ndër myslimanët"**. (Junus 90), kurse Allahu iu përgjigj: **"Vallë, tani (po beson), ndërkohë që më parë ishe i padëgjueshëm dhe ngatërrestar?!"**. (Junus 91).

Ky është ligji i Allahut mbi secilin i cili pendohet kur e sheh se i vjen dënimi i tij mirëpo atëherë është vonë dhe pendimi i tij nuk pranohet. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë:

"Me të vërtetë, Allahu i Lartësuar ia pranon pendesën robit përderisa nuk i ka ardhur shpirti në fyt". Pra robit kur i vjen shpirti në fyt dhe i afrohet meleku i vdekjes më atëherë për të nuk ka pendim, pendimi i tij nuk pranohet.

O ju robërit e Allahut, për këtë arsye frikojuni Allahut dhe dijeni se Allahu i Lartësuar thotë: **"O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtrojë kurrsesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë djalli për Allahun. Me të vërtetë, djalli është armik për ju, andaj vështrojeni si armik! Ai vetëm i josh ithtarët e vet, që të bëhen shokë të zjarrit të përflakur"**. (Fatir 5-6).

37 - BESIMI NË SHENJAT E KIAMETIT.

Falënderimi i takon vetëm se Allahut që na bëri musliman dhe na dalloi nga jobesimtarët. Falënderimi i takon vetëm se Allahut i Cili na dhuroi mendjen dhe na dalloi nga kafshët. Lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi Muhamedin, të birin e Abdullahit dhe robin e Allahut.

O ju njerëz, frikojuni Allahut dhe dijeni se besimi në Ditën e Kiametit është një nga gjashtë shtyllat e imanit pa të cilën shtyllë nuk plotësohet imani i njeriut.

Pasi që asaj Dite i paraprijnë shenja që aludojnë në afrimin e saj, neve na mbetet që t'i mësojmë ato për arsye se besimi në to është i patjetërsueshëm dhe është nga bazamentet e ideologjisë së një muslimani. Allahu i Madhëruar thotë: **“U afrua Ora dhe u çà Hëna”**. (Kamer 1), dhe **“A mos vallë mohuesit presin, që t'u vijë befasisht vetëm Ora (e Kiametit)? Ndërkohë, shenjat e saj kanë ardhur”**. (Muhamed 18).

Imam Bagaviu, RahimehUllah, thotë se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ishte një nga shenjat e Kiametit.

Allahu i Madhëruar thotë: **“E si do ta dije ti që ndoshta Dita e Kiametit është afër”**. (Shura 17), dhe **“A mos presin ata diçka tjetër, përveç Orës (së Kiametit), që do t'u vijë papritmas e pa e ndier fare?!”**. (Zuhruf 66).

Për shkak se ndodhia e kësaj Dite është afër, Allahu e konsideroi atë sikurse të nesërmen: **“Çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen!”**. (Hashr 18), dhe **“Ata e mendojnë atë (dënim) të largët, kurse Ne e shohim të afërt”**. (Mearixh 6-7).

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Unë dhe Dita e Kiametit jemi dërguar si këta dy gishta”**.

Ibën Omeri, Allahu qoftë i kënaqur nga ta, përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Mosha juaj në krahasim me moshën e popujve të kaluar është si koha e mbetur prej kësaj dite në krahasim me atë që ka kaluar prej saj”**. Me një transmetim tjetër thuhet: **“Afati juaj në krahasim me afatin e popujve të mëparshëm është sa koha midis namazit të ikindisë dhe perëndimit të diellit”**.

Pasi që çështja e shenjave të Kiametit është e rëndësishme edhe përkujdesja për to është më e madhe në krahasim më çështjet e tjera, kjo është edhe arsyeja se pse i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e shpeshonte sqarimin e shenjave të saj dhe sprovave që do të ndodhin mes saj dhe e paralajmëronte Umetin e tij që të përgatitet për këtë Ditë. Koha se kur do të ndodhë kjo Ditë e dinë vetëm se Allahu, kurse për të mirën e njeriut ajo u fsheh nga dituria e tij me qëllim që ai të jetë në përgatitje të vazhdueshme ashtu siç u fsheh nga ai edhe momenti i vdekjes së tij me qëllim që ai

vazhdimisht të jetë në përgatitje dhe veprim dhe t'i largohet dembelisë dhe përtacisë.

Imam Safariniju, RahimehUllah, thotë se shenjat e Kiametit ndahen në tre lloje:

01. Shenja të cilat janë paraqitur dhe kanë kaluar dhe ato janë shenja të largëta.

Këto shenja janë ato që janë paraqitur në të kaluarën dhe janë ndërprerë, si dërgimi i Muhamedit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe vdekja e tij, çlirimi i Bejtul Makdesit, vrasja e udhëheqësit të muslimanëve Othman ibën Afanit, radijAll-llahu anhu, paraqitja e rrenacakëve të cilët pretendojnë se janë të Dërguar, tërmetet e shumta, e shumë shenja tjera të cilat janë paraqitur nëpër citatet e Sunetit.

02. Shenja të cilat janë të mesme dhe ato janë të cilat janë paraqitur dhe nuk janë ndërprerë madje ato shtohen dhe numri i tyre është shumë i madh.

Nga to e kemi fjalën e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ku thotë: **“Nuk do të bëhet Kiameti derisa i ulëti dhe i poshtëri (dhe ata që i përngjasojnë) nuk bëhen njerëz më të lumtur të dynjasë (kryetar e sundimtar të popujve)”**

Poashtu nga shenjat e saj janë ajo që ka ardhur në hadith: **“Do të vijë një kohë ku ai që kapet për Fe dhe bën durim në të, të i ngjan atij që është kapur për gacë.”**

Nga shenjat tjera janë edhe se para Kiametit do të ketë njerëz injorantë dhe lexues të Kuranit gjynahqar, pastaj humbja e amanetit të cilën i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e komentoi me atë që i jepet detyra dhe nuk është i aftë e as i kualifikuar ta kryen, pastaj ngritjen e diturisë, përhapjen e injorancës, shtimi i imoralitetit dhe pirjes së alkoolit, zvogëlimi i numrave të burrave dhe shtimi i numrave grave derisa një burrë të jetë për pesëdhjetë gra, e shumë shenja të tjera.

03. Shenjat e mëdha të cilat paraqiten para se të ndodhë Kiameti.

Nga ato shenja është dalja e Mehdiut, dalja e Dexhallit, zbritja e Isait, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dalja e Jexhuxhëve dhe Mexhuxhëve, shkatërrimi i Qabesë, paraqitja e tymit, ngritja e Kuranit, lindja e diellit nga perëndimi, dalja e kafshës, paraqitja e zjarrit, etj.

Sidoqoftë, çështja është shumë e rrezikshme kurse ne jemi në një shkujdesje të madhe. Një numër i madh i këtyre shenjave janë paraqitur dhe nuk kanë mbetur vetëm se paraqitja e shenjave të mëdha. Kërkoj nga Allahu që të na

përqendron dhe përforcon në fenë e Tij dhe të na mundëson të vdesim si musliman dhe të na mbron nga të gjitha fitnet ato të dukshmet dhe të fshehtat.

Këto lajmërimet për të ardhmen padyshim se janë nga shenjat e profecisë dhe nga mrekullitë e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, të cilat ia ka mësuar Allahu dhe kjo ndikon në përforsimin e imanit të njeriut.

Në lajmërimin e tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka mëshirë për njerëzit me qëllim që të paralajmërohen dhe të përgatiten për ahiretin e tyre. Luftërat, problemet, sëmundjet e shumta, përhapja e mëkateve dhe gjynaheve, vdekjet e papritura, sprovat e ndryshme, mosrespektimi i prindërve, mosrespektimi i drejtave të fëmijëve, e shumë vepra tjera janë nga shenjat e Ditës së Kiametit. Për këtë arsye o ju robërit e Allahut, frikojuni Allahut dhe dijeni se dynjaja nuk është e përhershme, mos jetoni në të të qetë e në rehati po veproni dhe angazhohuni. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e porositi ibën Omerin, radij-Allahu 'anhum, dhe i tha: **“O biri i Omerit” Jeto në dynja sikur të jesh i vetmuar (i huaj) ose si udhëtar dhe llogarite veten tënde prej banorëve të xhenetit.”**

38 - DIVORCI DHE DISPOZITAT E TIJ.

Falënderimi i takon vetëm se Allahut i Cili na mundësoi që ta shijojmë ëmbëlsinë e imanit. Atë e falënderoj dhe lavdëroj dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkoj. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin birin e Abdullahit dhe robin e Allahut.

O ju njerëz, frikojuni Allahut dhe falënderoni për mirësitë e mos i mohoni të mirat e Tij. Allahu i Madhëruar thotë: **“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra”.** (Nisa 1), dhe poashtu thotë: **“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”** (Rum 21) Lidhja e burrit me gruan nëpërmjet martesës ligjore dhe lidhja familjare janë ndër begatitë më të mëdha të Allahut mbi të birin e Ademit duke i pasur parasysh dobitë e mëdha mbi të cilat bazohet kjo lidhje. Nga ato dobi numërojmë se:

– Martesa është shkak për mbrojtjen e syrit dhe mbrojtjen e nderit nga ajo që e ka ndaluar Allahu, ashtu siç tha edhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“O ju të rinj! Kushdo prej jush që ka mundësi për martesë, le të martohet, sepse kjo është mënyra më e mirë për uljen e shikimit dhe**

mënyra më e mirë për mbajtjen e dëlirësisë. Ndërsa kush nuk ka mundësi të martohet, atëherë të agjërojë, sepse agjërimi është ndrydhës (i epshit)”

- Martesa është shkak për fitimin e qetësisë shpirtërore dhe miqësisë dhe shoqërisë mes dy bashkëshortëve, ashtu siç tha edhe Allahu i Madhëruar: **“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre”.** (Rum 21), dhe poashtu tha: **“Është Ai që ju krijoi nga një njeri i vetëm (Ademit), prej të cilit krijoi edhe bashkëshorten e tij (Havanë), që të gjente qetësi tek ajo.”** (Eraf 189)

– Martesa është shkak për trashëgimi, ku nëpërmjet tyre shtohet ruhet raca njerëzore dhe shtohet numri i tyre në përgjithësi dhe numri i muslimanëve në veçanti dhe Allahu për këto dobi dhe dobitë tjera të martesës ka garantuar se mbi to bazohen mirësi të shumta. Allahu i Madhëruar thotë: **“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju, si dhe skllëverit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm! Nëse janë të varfër, Allahu, do t’i begatojë ata me dhuntinë e Tij; Allahu është i Gjerë në mirësi dhe i Gjithëdijshëm.”** (Nur 32)

Allahu i Madhëruar nxiti në qëndrimin dhe mirëmbajtjen e martesës dhe ndaloi në çdo gjë që e dëmton atë dhe për këtë urdhëroi bashkëshortët në respektimin e marrëdhënieve bashkëshortore edhe nëse ndodh që njëri me tjetrin të urrehen mes veti: **“Jetoni e silluni mirë me to! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duronit!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t’ju sjellë shumë të mira.”** (Nisa 19)

Imam Buhariu dhe Muslimi, RahimehUllah, në librat e tyre e shënojnë një hadith prej Ebu Hurejrës, radijAll-llahu anhu, se i Dërguari i Allahut, sal-llallahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Dëgjoni porosinë time, ndaj grave bëhuni të kujdesshëm, sepse ato janë të krijuara nga brinjët. Pjesa më e lakuar e brinjës është maja e saj . Po deshe ta drejtosh, ai do të thyhet, e po e le ashtu siç është, do të ngele i lakuar. Prandaj dëgjoni porosinë time, ndaj grave bëhuni të kujdesshëm.”**

Në një transmetim tjetër të imam Muslimit: **“Thyerja e brinit është divorci.”**

Burri nëse ndjen se gruaja nuk i respekton të drejtat e tij dhe se ajo largohet nga ai, atëherë ai duhet t’i merr hapat e duhura dhe të përshtatshme me qëllim që ta shëron problemin me urtësi ashtu siç ka urdhëruar edhe Allahu në Librin e Tij: **“Sa i përket grave që ju i druheni mosbindjes dhe sjelljes së keqe nga ana e tyre, këshillojini, (e, nëse kjo s’bën dobi) mos i pranoni në shtrat dhe (në fund) i rrihni ato (lehtas). Por, nëse ato ju binden, atëherë mos i ndëshkoni më. Allahu, me të vërtetë, është i Lartësuar dhe i Madhëruar!.”** (Nisa 34)

Nga ajeti na qartësohet se nëse burri i druhet mosbindjes dhe mosrespektimit të gruas ndaj detyrave që i ka ndaj burrit të saj, ai duhet fillimisht që gruan ta këshillojë me argumente nga Kurani dhe Syneti, ta inkurajon dhe ta kërcënon, me qëllim që të përmissohet morali i saj e nëse e sheh se këshilla nuk jep rezultat të mirë atëherë kalon në metodën e dytë e ajo është largimi nga shtrati. Qëllimi nga kjo metodë është që burri të largohet nga shtrati i përbashkët një periudhë të shkurtër dhe këtë gruaja nuk ka mundësi ta përballon dhe i vjen rëndë dhe mundet ta nxit që të përmissohet dhe t'i bindet urdhrave të burrit të saj. Nëse edhe kjo metodë nuk jep rezultat atëherë kalon në metodën e fundit dhe më të rëndën e ajo është rrahja e tyre mirëpo e lehtë. Të rrahurit e saj lehtë shpresohet se do ta përmissin dhe do t'i bindet urdhrave të burrit të saj.

Të gjitha këto hapa dhe metoda të përmissimit i merr burri pa mos ndërhyrë askush nga jashtë. Nëse vazhdojnë mosmarrëveshjet mes tyre atëherë Allahu na urdhëroi që të ndërmmjetëson ndokush me qëllim përmissimi mes tyre. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse i druheni ndarjes midis burrit e gruas, atëherë caktoni një ndërmmjetës nga ana e burrit dhe një nga ana e gruas. Në qoftë se ata dëshirojnë paqësim, Allahu sjell marrëveshje midis tyre”**. (Nisa 35) Allahu pra na urdhëroi kur mosmarrëveshja mes tyre ta arrin kulminacionin të formojmë një komision të përbërë nga dy anëtarë, një nga familja e burrit dhe një nga familja e gruas, me qëllim të studimit të problemit dhe të largimit të gjitha pengesave dhe të gjykimit të drejtë mes tyre, duke e këshilluar fajtorin në mesin e tyre apo duke i këshilluar bashkëshortët mes veti. E gjithë kjo procedurë vetëm e vetëm të mbetet akti i martesës dhe të vazhdon jeta martesore. Nëse në vazhdimin e jetës martesore mes dy bashkëshortëve ekziston rrezik apo për njërin nga bashkëshortët ekziston rrezik dhe nuk ka aspak dobi nga ajo martesë dhe nuk shpresohet të ketë atëherë Allahu e ligjësoi ndarjen mes tyre apo divorcin.

Divorci pra është faza e fundit dhe në kësaj raste është mëshirë nga ana e Allahut për arsye se lirohet i dëmtuari dhe i jepet një shans tjetër që ta merr diçka më të mirë. Allahu thotë: **“E nëse ata ndahen, Allahu me begatinë e Tij, çdonjërin prej tyre e bën të pavarur. Se Allahu është Dorëgjërë dhe i Urtë”**. (Nisa 130)

Nëse ndodh që burri nuk e dëshiron gruan e vet dhe nuk e divorcin po tenton që nga divorci i saj të përfiton materialisht, këtë e ndaloj Allahu dhe e urdhëroi ta divorcin me të shpejtë duke mos marrë asgjë nga ajo: **“dhe mos i pengoni ato me qëllim që t'ua merrni një pjesë nga dhuratat që ua keni dhënë”**. (Nisa 19) Kjo do të thotë se o ti burrë mos e dëmto gruan tënde në jetën bashkëshortore me qëllim që ajo ta kthen mehrin që ja ke dhënë ose diçka nga pasuria e saj duke e dëmtuar atë apo duke i marrë nga pasuria me të padrejtë me qëllim që ti atë ta divorcosh.

Ibën Abasi, RahimehUllah, thotë: **“Qëllimi i ajetit është ta ketë burri një grua nga e cila nuk e dëshiron shoqërimin e saj dhe ai ia ka borxh asaj**

mehrin dhe që të mos ia paguan mehrin dëshiron ta dëmton duke e kërcënuar me lënien e mehrin nëse dëshiron që të divorcohet. Mirëpo nëse gruaja nuk ka mundësi që t'i kryhen detyrimet e saj ndaj burrit dhe e urren burrin e saj dhe dëshiron të ndahet nga ai, i lejohet që t'ia fal mehrin apo ti jep nga pasuria e saj diçka dhe i lejohet atij që ta pranon nga ajo.” Allahu i Madhëruar thotë: **“Burrave nuk u lejohet të marrin gjë nga ajo që iu kanë dhënë atyre, vetëm nëse të dyja palët frikësohen se nuk do t'i zbatojnë kufijtë e Allahut. Pra, nëse të dy frikësohen se nuk do të mund t'u përmbahen kufijve të Allahut, atëherë nuk është gjynah për asnjërin, nëse gruaja i jep diçka burrit (për t'u ndarë nga ai)”. (Bekare 229)**

Allahu pra e bëri divorcin të jetë zgjidha e fundit pas dështimit të çdo zgjidhjeje tjetër. Ai i përngjason ilaçit i cili përdoret në raste nevojë dhe në mënyrë të veçantë të cilën e përkroi Ligjvënësi. Nëse përdoret pa mos pasur nevojë për të apo përdoret jo në mënyrën e duhur dhe të përkruar nga Ligjvënësi, ai dëmton sikurse dëmton ilaçi i cili përdoret në një vend jo të duhur.

Allahu për këtë arsye divorcit i përshkroi dispozita të urta të cilat ndikojnë që të pakësohet numri i divorceve dhe ai që kapet për këto rregulla nuk do të pendohet, nuk do të dëmtohet dhe do t'i shmanget gjurmëve të këqija që i sjell ky problem. Burrit ia lejoi që në rast nevojë ta ndan gruan e vet, mirëpo pasi që t'i plotëson kushtet e duhura që janë të caktuara si, ndarja të ndodhë pasi të jetë pastruar gruaja nga menstruacionet, pastaj brenda kësaj periudhe dmth, pasi që është pastruar nga menstruacionet të mos ketë bërë marrëdhënie seksuale, dhe ta len deri sa t'i kryhet Ideti apo koha e pritjes (**el id'dah- është periudha që duhet të presë një grua e ndarë apo e ve, për të pasur të drejtën për t'u rimartuar**). Nëse brenda kësaj periudhe dëshiron që ta kthen i lejohet ta kthen, kurse nëse i kalon asaj Ideti para se ta kthen atëherë ajo më nuk është gruaja e tij dhe nëse dëshiron të bashkohet duhet patjetër që ta ripërtërin aktin e nikahut.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Ndarja mund të bëhet dy herë. Më pas, gruaja ose të mbahet me të mirë, ose të lejohet të ikë me të mirë”**. (Bekare 229) Allahu na bëri me dije se nëse burri e ndan gruan një apo dy herë mundet të zgjedh se a dëshiron ta mban apo jo deri sa ajo është në periudhën e Idetit me qëllim që të kujdeset për të me mirësi dhe dashuri dhe poashtu mundet ta zgjedh që të ndahet nga ajo pasi që ta kalon periudhën e Idetit dhe nëse ndahet nga ajo ndarja e tyre të jetë e drejtë duke mos i bërë padrejtësi dhe duke mos e dëmtuar njëri tjetrin.

Allahu i Madhëruar thotë: **“O Profet! Nëse i ndani gratë, ndajini ato para kohës së tyre të pritjes”**. (Talak 1), që do të thotë se ju ndahuni nga gratë e juaja ato duke qenë të pastra nga menstruacionet dhe gjatë kësaj periudhë mos të kishit bërë marrëdhënie mes jush.

Pra Allahu e ndaloi ndarjen duke qenë gruaja me menstruacione dhe ndarjen e cila është bërë pas pastrimit nga menstruacionet po në këtë periudhë kanë bërë marrëdhënie mes tyre dhe poashtu e ndaloi që ta ndan gruan tri herë për arsye se pastaj nuk ka mundësi ta rikthen.

Me këtë na qartësohet se Sheriati e lejoi divorcin në raste kur ka nevojë për të dhe i vëndoi ligje me të cilin e bëri që të mos ndodhë vetëm se në raste të rralla dhe atëherë nuk do të dëmtohet ndonjëri nga bashkëshortët.

Ka nga njerëzit të cilët e marrin si lojë çështjen e divorcit dhe ka nga ata që ndahen për ndonjë arsye më të vogël dhe qysh në momentin e parë të grindjes mes tyre të ndahen dhe me këtë ta dëmtojnë veten dhe fëmijët e tyre. Ka nga ata që martohen pastaj e ndan gruan e vet, pastaj martohet dhe prapë ndahet edhe atë pa asnjë arsye të mjaftueshme. Këta lloj i njerëzve duhet ta dinë se vepra e tyre nuk është aspak e mirë për arsye se divorci është i urrejtur tek Allahu dhe i dashur tek shejtani dhe muslimani e urren atë që e urren Allahu. Ata që me gjuhët e tyre shpesh e përmendin divorcin dhe ndarjen nga gruaja le t'i frikohen Allahut për arsye se me divorc nuk ka lojë dhe nuk lejohet edhe në lojë t'i thuhet gruas se ti je e ndarë nga unë për arsye se edhe atëherë ndodh divorci edhe pse vjen në formë të lojës dhe talljes. Kjo është një lojë e fëlliqur e shejtanit me të birin e Ademit i cili e nxiti shpesh që të ndahet nga ajo deri sa të arrin ta divorcin tri erë e pastaj të pendohet fortë për arsye se më nuk do të ketë mundësi ta rikthen përveç se nëse ajo martohet me tjetër dhe ai më vonë e ndan dhe i hapet mundësia burrit të parë të saj ta rikthen.

Shkaqet e ndodhjes së divorcit janë të shumta dhe nga ato shkaqe i numërojmë:

– Zgjedhja e gabueshme e bashkëshortëve mes veti për martesë. Njëri me tjetrin martohen kurse nuk dinë për jetën e tyre asgjë e as për fenë e as për moralin e njëri tjetrit dhe pas martese zbulohen shumë realitete dhe fshehtësira dhe këto bien shkak për ndarjen e tyre. Për këtë arsye mirë është në fillim njeriu të interesohet për partnerin e jetës së vet, për jetën e tij, moralin e tij dhe për fenë e tij.

– Harxhimet e tepërta për martesë dhe mehri i lartë bien shkak që burri ta urren gruan e vet. Për këtë arsye pëlqehet që mehri të jetë sa më i lirë dhe i ulët. Përcillet nga Aisha, radijAllahu anha, se i Dërguari i Allahut, sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Gratë më me bereqet janë ato që e kërkojnë mehrin më të ulët”**.

– Mosrespektimi i të drejtave që ua ka caktuar Allahu mes njëri tjetrit është një nga shkaqet e divorcit. Allahu thotë: **“Jetoni e silluni mirë me to”**. (Nisa 19)

– Mjetet e informimit, interneti, rrjetet sociale dhe filmat e ndryshëm janë nga shkaqet kryesore bashkëkohore që i shkatërrojnë shtëpitë dhe familjet. Armiqtë

e Islamit tentojnë që nëpërmjet mjeteve të informimit ta rebelojnë gruan duke ia përshkruajtur poligaminë si diçka të prapambetur, përngjasimin me mëkatat dhe jobesimtarët t'ia zbukurojnë deri në atë gradë sa të pretendojnë se kjo është liria e saj dhe e drejta e saj, mosrespektimin e burrit t'ia shndërrojnë në fitore dhe kënaqësi dhe daljen nëpër rrugë dhe punë pa lejen e burrit si e drejta e saj personale kurse xhelozinë e burrit ndaj saj ta përshkruajnë se është çmenduri dhe injorancë.

– Dalja e gruas për punë dhe përzierja e saj me burra të huaj është një nga shkaqet e divorcit. Gruaja me daljen e saj nga shtëpia dhe lënien e punëve të shtëpisë dhe moskujdesi i saj ndaj fëmijëve bëjnë që familjet të shkatërrohen dhe mosmarrëveshjet mes tyre të shtohen. Ndodh që burri detyrohet ta përgatiti bukën vet dhe të kujdeset për fëmijë edhe pse kjo është detyrë e gruas e jo e burrit dhe mundet të bie shkak që të fillojnë grindjet me s tyre dhe të përfundojnë me ndarje.

39 - RREZIKU I PIJEVE ALKOOLIKE DHE NARKOTIKËVE.

Falënderimi i takon vetëm se Allahut, Atë e lavdërojmë dhe vetëm nga Ai falje dhe ndihmë kërkojmë. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë përveç Allahut dhe paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi imamin e Pejgamberëve dhe shëmbëlltyrën e shpenzuesve dhe modelin e të devotshmëve Muhamedin birin e Allahut dhe robin e Allahut.

O ju njerëz, frikojuni dhe falënderoni Allahun i cili e nderoi njeriun nga krijesat tjera ashtu siç e cek edhe në Librin e Tij: **“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar”.** (Isra 70).

Nga ajo që e nderoi Allahu njeriun është mendja. Ajo e bën të dallohet nga kafshët dhe ia mundëson të dallon mes të mirës dhe të keqes dhe të dëmshmes dhe të dobishmes. Njeriu nëse e humb mendjen atëherë nuk do të ketë dallim mes tij dhe kafshës. Madje, kafsha do të jetë në një gjendje më të mirë se sa njeriu për arsye se nga kafsha ka mundësi të përfitohet diçka kurse nga njeriu i cili e humb mendjen e tij nuk ka mundësi të përfitohet asgjë. Me mendje njeriu i mediton argumentet e Allahut dhe me mendje shpik dhe zbulon dhe prodhon.

Mendja është ajo e cila e nxit njeriun të stoliset me gjëra të mira dhe të largohet nga ato të ligat, të bën mirë dhe të largohet nga bërja e dëmit. Allahu i qortoi ata që nuk mendojnë dhe i gradoi në një gradë më të ulët se atë të kafshëve dhe tha: **“A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.”** (Furkan 44)

Allahu ndaloi nga përdorimi i gjërave që e dëmtojnë mendjen dhe caktoi kufij dhe dënime për ata që i tejkalojnë ato. Mendja është një nga pesë gjërat e patjetërsueshme në të cilën janë unik të gjitha fetë qiellore se ajo duhet të ruhet, për arsye se me ruajtjen e saj mbrohen edhe dobitë dhe interesat njerëzore. Ai që e ka të humbur mendjen e dëmton veten duke e futur në rrezik dhe duke e sulmuar tjetrin e me këtë e rrezikon edhe sigurinë e shoqërisë dhe në të frikë dhe terror. Allahu i Madhëruar thotë: **“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni! Vërtet, djalli me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?”** (Maide 90 – 91)

Allahu i qartësoi dëmet e alkoolit dhe të gjërave tjera të cekura në ajet se ato janë nga veprat e ndyra të shejtanit, se ajo shkakton në shoqëri çorodi dhe armiqësi dhe urrejtje mes anëtareve të saj dhe i largon nga përmendja e Allahut, ku nëpërmjet saj ngjallen zemrat, dhe i largon nga falja e namazit, që largon nga e liga dhe imoraliteti. Të gjitha këto janë dëme të mëdha dhe rreziqe të shumta.

Alkool konsiderohet çdo gjë e cila e mbulon apo e deh trurin pa marr parasysh se nga çfarë lënde është prodhuar dhe me çfarë emri e kanë emërtuar. Përcillet me një hadith se do të vjen një kohë kur njerëzit do ta emërtojnë me emra të tjerë mirëpo emrat nuk e ndryshojnë realitetin. E njëjtë me alkoolin apo më mirë të themi se më e rrezikshme se alkooli është çdo gjë që e dobëson dhe e vyshk trupin e njeriut dhe ia dëmton shqisat. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka ndaluar nga çdo gjë që e deh trurin dhe e dobëson trupin.

O ju musliman, armiq të juaj gjithmonë planifikojnë shkatërrimin e juaj dhe dëmtimin e juaj nëpërmjet çdo mjeti, ashtu siç edhe Allahu e cek në Kuran: **“Ata dëshirojnë që të vuani. Urrejtja shfaqet në gjithçka që del prej gojës së tyre, kurse ajo që fshehin në zemrën e tyre, është edhe më e madhe.”** (Ali Imran 118)

Nga planifikimet më të fëlliqura të tyre dhe nga armët më të rrezikshme që i përdorin në këtë kohë është arma e narkotikëve. Ata i mbjellin narkotikët dhe i prodhojnë dhe i eksportojnë në vendet e juaja dhe i përhapin në mesin e juaj në mënyra të llojllojshme dhe të fshehta, duke e ndihmuar përhapjen e saj shejtanët njerëz nga tregtarët e shkatërrimit të cilët i shesin këto narkotik në

vendet dhe shtëpitë e muslimanëve. Ata, përhapësit e narkotikëve, e meritojnë dënimin më të rreptë për arsye se përhapin nëpër tokë shkatërrim dhe dëm dhe detyrohet çdo njëri që i njihet t'i lajmëron në organet kompetente që të mbrohen nga shërri i tyre. Kjo është nga bashkëpunimi në mirësi dhe devotshmëri dhe nuk lejohet mbrojtja e tyre dhe ndërmjetësimi për ta.

O ju musliman, narkotikët janë më të rrezikshme se sa alkooli për arsye se ato e shkatërrojnë mendjen dhe karakterin dhe ia humb xhelozinë njeriut. Të përbashkët me alkoolin e kanë dehjen kurse dëmet i ka më të mëdha se sa ajo. Disa nga dijetarët i kanë cekur se në të janë njëqind e njëzet dëme në fe dhe dynja.

Nga dëmet e narkotikëve në fe janë: Ajo e largon njeriun nga përmendja e Allahut, ia humb turpin dhe moralin dhe shkakton lënien e namazit dhe bërjen e mëkateve.

Nga dëmet e saj trupore janë: Ajo e dëmton trurin, shkakton sëmundje të ndryshme, e djeg gjakun, e ngushton shpirtin, e dëmton mëlçinë, e dobëson të shikimin, jep vesvese dhe i dobëson ambiciet, e dëmton sistemin nervor dhe shkakton çmenduri, etj.

Narkotikët pra, janë arma më e fortë të cilën e përdorin armiqtë për ta shkatërruar një shoqëri njerëzore. Ato janë një ndër rreziqet më të mëdha të cilat i kanosen shoqërive me shkatërrim dhe zhdukje e mos të flasim për sëmundjet ngjitëse të cilat vijnë si rezultat i saj.

Përhapësit e saj me qëllim të fshehjes së saj përdorin metoda të llojllojshme duke ia ndryshuar pamjen, formën dhe emrin me qëllim që të mos dallohet se është narkotik dhe tentojnë që atë ta përhapin në mesin e njerëzve. Për këtë arsye mos i lejoni fëmijët e juaj të shoqërohen me njerëz të tillë dhe kujdesuni për edukimin e tyre në mënyrë të drejtë dhe mësojani rrezikun e saj dhe dëmet që i shkakton në shoqëri.

O ju musliman, i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e mallkoi atë që e pinë alkoolin, atë që e prodhon, që e përhap dhe që e ndihmon përhapjen e tij dhe lajmëroi se ai që është dhënë pas alkoolit është si adhuresi i idhujve. Ai që e bën hallall duke qenë i vetëdijshëm për ndalesën e tij bën kufër, kurse ai që e pinë duke e patur bindjen se ai është i ndaluar konsiderohet si veprues i një mëkati të madh dhe nga ai kërkohet pendim i sinqertë.

Nuk lejohet përdorimi i tij për kënaqësi apo për shërim. Kur u pyet i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, për alkoolin i cili përdoret si ilaç tha: **“Ai është sëmundje e nuk është ilaç.”**

Njerëzit sot shpesh arsyetohen se e përdorin për ilaç apo se mjeku u ka preferuar ta përdorin për shërim mirëpo arsyetimi i tyre nuk pranohet aspak

dhe ata i bëjnë gjynah Allahut pa të drejtë. Për çdo sëmundje ka zbritur ilaç i lejuar dhe për këtë arsye nuk ka nevojë që ai të kërkohet aty ku Allahu nuk është i kënaqur me ne.

40 - NDALESA E PIRJES SË DUHANIT.

Falënderimi i takon vetëm se Allahut që na bëri nga muslimanët dhe na begatoi me Islam dhe iman dhe Kuran. Atë e lavdërojmë dhe vetëm nga Ai falje dhe ndihmë kërkojmë. Dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt me të drejtë përveç Allahut dhe paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi imamin e Pejgamberëve dhe shëmbëlltyrën e shpenzuesve dhe modelin e të devotshmëve Muhamedin birin e Abdullahit dhe robin e Allahut.

O ju njerëz frikojuni Allahut dhe falënderoni Atë që ju pasuroi me hallall dhe ju largoi nga harami dhe ua bëri të lejuara gjërat që janë në dobinë e juaj për fenë dhe dynjanë dhe ju largoi nga ajo e keqja për arsye se ajo ua dëmton fenë dhe dynjanë e juaj. Ushqimi me gjëra të lejuara len gjurma të mira në shëndetin e njeriut dhe sjelljen e tij për arsye se ai ushqehet me ushqim të lejuar kurse të ushqyerit me haram len gjurma të këqija në trupa dhe sjellje për arsye se ato janë ushqyer me gjëra të ndaluara.

Nga gjërat e ndaluara me të cilat kohëve të fundit janë sprovuar shoqëritë e muslimanëve është edhe duhani. Ky ves i keq është përhap aq shumë sa që ka filluar ta pinë edhe të vegjlit edhe të mëdhenjtë kurse pirja e tij t'i rrezikon shëndetet e njerëzve. Për të çuditur është gjendja e atyre që e pinë!! Nuk turpërohen aspak para masës nga pirja e duhanit haptazi dhe nxjerrjen e tymit nga goja duke e drejtuar atë drejt fytyrave të njerëzve dhe duke mos e respektuar shenjtërinë e mexhlisit. Nëse e sheh se ndonjëri i pështynë tjetrit në fytyrë ose ia shfryn hundët përpara, si do të jetë reagimi dhe dëmi dhe mohimi i kësaj vepreje?! Nxjerrja e tymit nga goja dhe drejtimi i tij kah fytyrat e njerëzve është vepër më e ligë dhe më e pamoralshme, mirëpo çështja është ashtu si ka ardhur në një hadith ku i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Nëse nuk të vjen turp vepro çka të duash.”**

O ju robërit e Allahut, sa janë ngritur zërat për mohimin e pirjes së tij dhe sa paralajmërime mjekësore i kanë cekur rreziqet e tij dhe sa fetva nga dijetarët e kanë cekur ndalesën e tij dhe sa libra dhe broshura janë shkruajtur dhe botuar dhe përhapur që e sqarojnë dëmin e tij?! Megjithatë ata që e pinë duhanin nuk i përgjigjen këtyre thirrjeve dhe nuk i pranojnë ato këshilla për arsye se janë bërë rob të duhanit dhe nuk munden ta largojnë këtë ves nga vetvetja. Vetëm se imani dhe përpjekja e sinqertë dhe trimëria burrërore janë

cilësi që kush i posedon mundet ta largon mirëpo këto cilësi sot mungojnë te shumica e njerëzve.

Pirja e duhanit është e dëmshme për trupin dhe fenë dhe pasurinë dhe shoqërinë. Në vazhdim do t'i cekim ato dëme një nga një.

Dëmi i tij në trup:

Dëmi i tij në trup vjen për arsye se e dobëson trupin në përgjithësi dhe e dobëson zemrën dhe shkakton sëmundjen e kancerit dhe sëmundjen e tuberkulozit dhe e nxit kollin dhe i nxin dhëmbët dhe e nxit dëmtimin e tyre. Poashtu e dëmton gojën dhe fytyrën edhe atë me dëmtime serioze. Për më tepër mundeni t'i ktheheni librave mjekësore dhe këshillave të tyre.

Dëmi i tij në fe:

Pirja e duhanit është shkak që njeriut t'i rëndohen adhurimet dhe nënshtrimet e në veçanti agjërimi dhe ndeja në xhami dhe prezenca në mexhlisët e diturisë. Çdo gjë që e pengon njeriun të arrijë deri te e mira ajo është e keqe dhe e dëmshme. Duhani është shkak për atë që e pinë të përzihet me njerëz me moral të ligë dhe të degjeneruar dhe të largohet nga njerëzit e mirë dhe të hajrit. Te sa të rinj ka qenë shkak duhani që të futen nëpër lokale të fëlliqura dhe të përzihen me njerëz të ligë në moral dhe me atë të ndikohen dhe të devijojnë në moral dhe sjelljet e tyre të ndryshojnë.

Dëmi i duhanit në pasuri:

Pyete atë që e pinë duhanin se sa të holla i shpenzon në ditë?! Ndoshta është i varfër dhe nuk i mjafton ushqimi për një ditë e një natë, megjithatë i jep përparësi duhanit para gjërave tjera të rëndësishme. E pengon veten e ndoshta edhe fëmijët e tij që të kënaqen me gjëra të lejuara e të mira dhe atë kënaqësi e zëvendëson me duhan i cili as nuk pasuron, e as nuk të largon nga uria. Kjo është gjendja e të varfrit.

Kurse i pasuri shpenzon të holla të shumta për blerjen e duhanit ndërsa dihet se shpenzimi i tepërt nuk lejohet dhe se ata që shpenzojnë tepër janë vëllezërit e shejtanit.

Dëmi i pirjes së duhanit në shoqëri:

Ai që e pinë duhanin vetëm se i jep pasqyrë të keqe shoqërisë ku jeton dhe i jep pasqyrë të keqe atij që e shoqëron duke e nxjerrë duhanin drejt fytyrave të njerëzve dhe duke i dëmtuar shëndetet e tyre. Çështja u zgjerua edhe më tepër deri sa njerëzit filluan t'i dëmtojnë të tjerët me pirjen e duhanit nëpër zyre, qendra tregtare, makina, autobusa, etj. Ceket me një hadith se i Dërguari i Allahut, sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kush e dëmton një**

musliman vetëm se më ka dëmtuar dhe ai që më ka dëmtuar vetëm se e ka dëmtuar Allahun.”

Madje pirja e duhanit i pengon edhe melekëve. Përcillet në një hadith të vërtetë: **“Melekët dëmtohen nga ajo që dëmtohen njerëzit.”**

Nga dëmet e duhanit për shoqërinë është shkaktimi i zjarreve dhe djegieve të shtëpive dhe objekteve ku shpesh ndodh që njerëzit i harrojnë cigaret dhe me më vonë vjen deri te djegia dhe me atë shkaktohen humbje të mëdha në të holla dhe shpeshherë edhe në njerëz. Poashtu nga dëmet shoqërore është hedhja e cigareve nëpër rrugë duke i bërë ato të papastra dhe shpesh ndodh që ato cigare të bien në duart e fëmijëve dhe ata të fillojnë nga fëmijëria e tyre të thithin tymin e duhanit i cili padyshim se do lenë pasoja të mëdha në jetën e tyre dhe në shëndetin e tyre.

Këto ishin disa nga dëmet në shoqëri, në pasuri, në fe dhe në trup të cilat vijnë si rezultat i pirjes së duhanit. A ka mundësi ata që e pinë duhanin të na e cekin një dobi apo disa nga dobitë e pirjes së duhanit karshi këtyre dëmeve të pirjes së tij? Çudi e madhe se si i kanë humbur mendjet e tyre?

Ti i cili je sprovuar me pirjen e duhanit, të thërrasim me një këshillë të sinqertë të përshpejtosh në pendim nga ky ves i keq dhe ta lësh për hir të Allahut dhe për hir të shëndetit tënd. Kush e len një vepër për Allah, Allahu ia zëvendëson me diçka më të mirë. Pastaj mos harro diçka o ti i cili e pinë duhanin, se ti do të bëhesh një shëmbëlltyrë e keqe për fëmijët e tu nëse je prind, për nxënësit e tu nëse je mësues dhe me këtë i bën padrejtësi vetes po edhe të tjerëve. Nëse e len do të bëhesh një shembull i mirë për të tjerët, për këtë arsye bëhu shembull i mirë dhe jo i keq.

Kthimi në të vërtetën është më i miri se sa mbetja në të kotën dhe vazhdimësia në të. Mos e lejo veten të mashtrojnë pasimi i verbër dhe mendjelehtit e të vazhdosh të pish duhanin.

O ju musliman, ashtu si ndalohet pirja e duhanit ndalohet edhe shitja e tij dhe tregtia me të dhe importi i tij. Pasuria e fituar nga ajo është haram dhe tregtia me të është e pavlerë. I Dërguari i Allahut, sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Kur Allahu ia ndalon një popullit ngrënien e diçkaje ia ndalon poashtu edhe vlerën e tij.”**

Ai i cili e shet këtë duhan vetëm se i ka bërë dy gjynahe të mëdha:

I pari: E ka përhap këtë gjynah në mesin e muslimanëve dhe u ka shërbyer material të keq.

I dyti: Shitësi i duhanit ushqehet nga pasuria e fituar haram dhe mbledh pasuri haram kurse njeriu Ditën e Kiametit është përgjegjës për atë që e han dhe atë që e tubon nga pasuria.

41 - RREZIKU I DËGJIMIT TË MUZIKËS.

Falënderimi i takon vetëm se Allahut i Cili i krijoi robërit e Tij që ta adhurojnë. Dhe i urdhëroi që ta përmendin Atë shumë në të gjitha kohërat dhe i ndaloj prej çdo gjëje që i largon prej përmendjes së Tij dhe namazit. Dëshmoj se adhurimi nuk i takon askujt me të drejtë përveç se Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij dhe se namazi ishte porosia e fundit e tij. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira, deri në Ditën e Gjykimit.

O ju njerëz frikojuni Allahut dhe dijeni se prej gjërave që më së shumti e largon njeriun prej përmendjes së Allahut dhe i preokupon robërit prej adhurimeve është dëgjimi i muzikës dhe i instrumenteve muzikore. Kohëve të fundit muzika dhe instrumentet muzikore i kanë pushtuar shumicën e shtëpive muslimane dhe kanë arritur që të depërtojnë edhe në ato shtëpi ku armiku asnjëherë nuk ka ëndërruar se do të hyn.

Plot prej burrave edhe grave me besim të dobët dhe me vetëdije të ulët fetare janë sprovuar me muzikën dhe instrumentet muzikore dhe pas hapave të tyre kanë ecur edhe të rinjtë e këtij Umeti prej djemve dhe vajzave të cilët kohën e tyre e kalojnë në dëgjimin e muzikës prej radiove dhe kasetave. Kësaj dukurie negative i bashkëngjiten edhe gazetatat dhe revistat e ndryshme të cilat nëpër faqet e tyre i përhapin fotot dhe emrat e këngëtarëve dhe këngëtareve me qëllim që njerëzit t'i njohin më mirë dhe më lehtë ta shesin mallin e tyre të helmuar dhe të pisët.

Kjo ka bërë që një numër i madh i të rinjve musliman t'i njohin të gjithë emrat e këngëtarëve dhe të këngëve të tyre, t'i njohin imtësitë e jetës private të tyre dhe të familjeve të tyre, mirëpo nëse i pyet rreth kuptimit të shehadetit (**fjalës la ilahe il-Allah**) dhe kohërave të namazit do të thonë nuk dimë asgjë rreth tyre. Prej nga ta dinë dhe si ta dinë kur ambiciet e tyre janë të drejtuara kah mjetet e informimit dhe programet e tyre, ku pjesën më të madhe të programit të tyre e përfshin muzika dhe veglat muzikore dhe emisionet për këngëtarët dhe këngëtares.

O ju robërit e Allahut, kush ka qenë në dyshim rreth ndalesës së muzikës dhe instrumenteve muzikore, le ta largon dyshimin e tij me bindje prej fjalëve të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. Kanë ardhur

shumë citate prej Kurani dhe Suneti të cilat aludojnë në ndalesën e muzikës dhe kërcënimin e atij që e lejon dhe vazhdon në të. Besimtarit apo besimtares i mjafton edhe po të ishte vetëm se një ajet apo hadith që t'i largohet këtij mëkati e mos të flasim për gjithë ato citate që kanë ardhur rreth ndalesës së muzikës: **“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”** (Ahzab 36)

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, i paralajmëron njerëzit nga rreziku i mëkatis të muzikës dhe instrumenteve të tij dhe ua tërheq vërejtjen atyre që ja dhënë pas dëgjimit të tij dhe përdorimit të mjeteve të tij se do t'i dënon rreptë nëse ata e vazhdojnë këtë rrugë dhe tha: **“Ka disa njerëz që sajojnë tregime të kota, për të shmangur (të tjerët) nga rruga e Allahut me paditurinë e tyre e për t'u tallur me të. Njerëz të tillë i pret dënimi poshtërues. Kur ndonjërit prej tyre i lexohen shpalljet Tona, ai e kthen shpinën me mendjemadhësi, sikur nuk i ka dëgjuar, sikur i janë shurdhuar veshët. Andaj, jepu lajmin e dënimit të dhembshëm.”** (Llukman 6-7)

Shumica e komentuesve të Kuranit janë të mendimit se thënia në ajet: **“tregime të kota”** e ka për qëllim muzikën dhe Abdullah ibën Mesudi, radijAllahu anhu, është betuar tri herë se ajeti e ka për qëllim muzikën.

Imam Buhariu, RahimehUllah, në librin e tij shënon një hadith nga Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i cili kishte thënë: **“Do të ketë njerëz prej Umetit tim që do ta lejojnë kurvërinë, mëndafshin, alkoolin dhe instrumentet muzikore.”**

Ky hadith është argument i qartë dhe i prerë i cili aludon në ndalimin e të gjitha llojeve të instrumenteve muzikore dhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e qortoi lejimin e instrumenteve muzikore dhe ndalesën e lejimin të tyre e bëri paralel me ndalesën e lejimit të mëndafshit, imoralitetit dhe alkoolit.

O ju robërit e Allahut, pasojat e dëgjimit të muzikës janë të shumta dhe të rrezikshme. Prej pasojave veçohet se muzika e shkatërron zemrën dhe ia mbjell cilësitë e hipokrizisë, ashtu siç thanë shumica e selefiteve. Prej pasojave veçohet se dëgjimi i muzikës e largon prej zemrës dashurinë ndaj Kuranit. Nuk ka mundësi asnjëherë që të bashkohet në një zemër dashuria ndaj Kuranit dhe dashuria ndaj muzikës, për arsye se Kurani është shpallje nga Allahu kurse muzika është shpallje nga shejtani dhe çdo herë që janë bashkuar në një zemër shpallja e Allahut dhe shpallja e shejtanit vetëm se e ka nxjerr njëra tjetrën prej asaj zemre. Prej rreziqeve që i sjell dëgjimi i muzikës njeriut janë zemërimi i Allahut ndaj robit për arsye se muzika e largon prej përmendjes së Allahut dhe adhurimit të Tij dhe poashtu është shkak për zbritjen e shumë ndëshkimeve në dynja dhe ahiret.

Ibën el Kajimi, RahimehUllah, thotë: **“Atë që ne dhe të tjerët me sytë e tona e kemi vërejtur dhe e njohëm me prova është se në çdo popull kur janë paraqitur dhe përhapur muzika dhe instrumentet muzikore dhe njerëzit janë preokupuar me to, Allahu ua ka dërguar atij populli armikun që i ka sunduar, janë sprovuar me thatësira dhe varfëri dhe me udhëheqësi të keqe e të padrejtë.”**

Prej rrezikut të dëgjimit të muzikës është edhe afrimi i shejtanëve. Shejtanët janë shokët e këngëtarëve dhe atyre që i dëgjojnë dhe çdo gjë që i afron shejtanët i largon melekët, për arsye se ata janë dy të kundërta që asnjëherë nuk mundën të bashkohen. Shtëpisë ku në të dëgjohej muzika i afrohen shejtanët dhe i largohen melekët dhe paramendoni se si është gjendja e banorëve të saj të cilët jetojnë së bashku me shejtanët?!

Prej rreziqeve që i sjell muzika është edhe inkurajimi i njeriut për të shkuar pas imoralitetit. Këngëtarët i nxisin njerëzit t'i dëgjojnë këngët të cilat fokusohen në portretizimin e bukuri së femërore, tregimet romantike pasionante, poezitë kushtuar dashurisë dhe të dashuruarve, përshkrimi i belit, trupit, gushës, faqeve, syve e buzëve, duke ndezur imagjinatën dhe pasionin e mendjes dhe shpirtit.

O ju robërit e Allahut, pastroni shtëpitë e juaja prej këtyre fëlliqësirave dhe largoni prej tyre ato zëra të mallkuara dhe zëvendësoni ato me përmendjen e Allahut dhe leximin e Kuranit.

O ti që shet kaseta apo disqe që në to janë të incizuara kënga dhe muzikë, dije se mallin që e shet është haram dhe ti je shkak për përhapjen e degjenerimit dhe fitimi i jot është haram. Pendohu tek Allahu me sinqeritet dhe zëvendësoje shitjen e këtyre kasetave dhe disqeve me shitjen e kasetave që në to janë të incizuara Kuran dhe ligjëratat të dobishme dhe dije se: **“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t'i japë risk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai. Allahu e përmbush me siguri vendimin e Tij dhe për çdo gjë Ai ka caktuar masë.”**

(Talak 2-3) Dhe poashtu dije se ai që e le një vepër për hir të Allahut, Allahu ia zëvendëson me diçka më të mirë.

O ju musliman, ne nuk jemi përgjegjës për radiot dhe kanalet televizive të jomuslimanëve që e përhapin degjenerimin për arsye se pas kufrit më nuk ka mëkat dhe prej tyre nuk pritet më asnjë mirësi, mirëpo ne jemi përgjegjës për muslimanët dhe fenë tyre dhe nderin e tyre. A nuk kanë aspak turp ata që këndojnë dhe e përhapin muzikën në mesin e muslimanëve? A nuk kanë aspak turp ata që i dëgjojnë ato muzika dhe i shkatërrojnë zemrat e tyre? A nuk kanë turp aspak ata musliman që gratë e tyre i lejojnë të dalin para ekraneve të këndojnë e të zhvishen para burrave të huaj? A nuk kanë turp ata musliman që nëpër dasmat e tyre shpenzojnë të holla për muzikë kurse muslimanët vuajnë prej varfërisë? A nuk kanë turp ata musliman që shkojnë nëpër dasma

apo koncerte me muzikë dhe vallëzojnë së bashku burra e gra? A mendojnë ata se Allahu nuk i sheh? A mendojnë ata se Allahu është neglizhent dhe nuk do t'i dënon? Pasha Allahun jo. Allahu e di shumë mirë se ata çka veprojnë dhe padyshim se ata do të shpërblehen për veprat e tyre në dynja dhe ahiret.

Allahu, Subhanehu ue Te'Ala, thotë: **“Elif, Lâm, Mîm. Këto janë vargje të Librit plot Urtësi, udhërrëfyes dhe mëshirë për punëmirët, që kryejnë namazin, japin zeqatin dhe besojnë bindshëm në jetën tjetër. Këta janë udhëzuar nga Zoti i tyre dhe vetëm këta janë të shpëtuar. Ka disa njerëz që sajojnë tregime të kota, për të shmangur (të tjerët) nga rruga e Allahut me paditurinë e tyre e për t'u tallur me të. Njerëz të tillë i pret dënimi poshtërues. Kur ndonjërit prej tyre i lexohen shpalljet Tona, ai e kthen shpinën me mendjemadhësi, sikur nuk i ka dëgjuar, sikur i janë shurdhuar veshët. Andaj, jepu lajmin e dënimit të dhembshëm.”** (Llukman 1-7)

42 - LEXIMI I KURANIT.

O ju njerëz, frikojuni Allahut dhe përkujdesuni për librin e Allahut. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë.”** (Fatir 30)

Othman ibën Afani, radijAll-llahu anhu, përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Më i miri i nga ju (muslimanët) është ai që e mëson Kuranin vetë dhe ua mëson atë edhe të tjerëve.”**

Aisha, radijAllahu anha, përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Ai që lexon Kuran bukur do të jetë në shoqëri të shkruesve (engjëjve) të ndershëm, ndërsa kush e lexon duke hasur në vështirësi, do të ketë shpërblim të dyfishuar.”**

Ebu Umameh, radijAll-llahu anhu, tha se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, duke thënë: **“Lexojeni Kuranin, ngase ai do të ndërmmjetëson Ditën e Kiametit për ata që e lexojnë”.**

Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu, përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Nuk ulet një popull në një mexhlis ku përmendet Allahu, përveçse i mbulon mëshira e Allahut, i rrethojnë melekët dhe Allahu i përmend në mesin e atyre që janë tek Ai.”**

Këto citate nga Kurani dhe Syneti, të gjitha ju nxisin në mësimin e Kuranit, dhe të vepruarit me të, dhe leximin e tij, ngase Kurani është burimi i lumturisë së juaj, shpëtues nga sprovat, në të janë lajmet e të parëve, dhe njoftim për atë që do të ndodh më vonë. Kurani është gjykues në mesin e juaj, kush e braktis

nga kryelartësia Allahu ia thyen qafën, dhe kush kërkon udhëzim jashtë Kuranit, Allahu e devijon. Kurani është litari i Allahut i fortë, rruga e drejtë, shpirtrat e ligë s'kanë mundësi ta ndryshojnë, dhe dijetarët nuk ngopen nga ai. Është përplot mrekullira, kush flet me të e thotë të vërtetën, kush punon me të shpërblehet, kush gjykon me të është i drejtë, kush thërret në të udhëzohet në rrugë të drejtë. Për këto arsye mësojeni dhe lexoni dhe persiatni ajetet e tij. Mësojani fëmijëve të juaj, dhe rritni me

leximin e tij, dhe bëjani të dashur librin e Allahut, derisa të lidhen për të dhe tua përmison moralin e tyre, dhe pastron shpirtrat e tyre, dhe të bëhen nga bartësit e Kuranit dhe lexuesit e tij, sepse fëmija kur e mëson Kuranin në fëmijëri, më vonë do ta dinë se çka lexon në namazin e tij. Mësimi i Kuranit në fëmijëri është shumë më i mirë, se sa të mësohet kur të rritet, sepse më shumë përforcohet në mendje dhe mësimin e tij përmendësh e ka më të fortë.

Shumica e njerëzve në këto ditë janë larguar nga mësimi i Kuranit. Të mëdhenjtë janë preokupuar me dynja, të vegjlit janë preokupuar me mësimet shkollore, kurse kohën e lirë e kalojnë nëpër rrugë duke lozur. Kjo i bëri që të largohen nga Kurani dhe mos ta njohin, madje të ketë edhe nga ata që e kryen edhe fakultetin, dhe nuk e din ta lexon një ajet si duhet. Madje ajo më e çuditshmja është se plot nga xhamitë nuk kanë imam, ngase njerëzit nuk donë tu lexohet Kuran tepër në namaz dhe imami ta zgjat namazin. Sebepi i gjithë këtij problemi qëndron në papërgjegjësinë e prindërve ndaj fëmijëve të tyre dhe pakujdesia e tyre për sa i përket Kuranit. Kjo bëri që Kurani të braktiset nga shumë musliman, dhe nga kjo u ankua i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, kur tha: **“O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si (diçka) të urryer.”** (Furkan 30)

Ibën Kethiri, RahimehUllah, thotë: **“Nga shpërfillja e Kuranit është braktisja e meditimit të tij dhe të kuptimit të tij, dhe lënia e të vepruarit me të. Poashtu dëgjimi i poezive, apo muzikës, apo thënieve, apo marrja me dëfrime, duke e zëvendësuar Kuranin me to, është nga shpërfillja e tij.”**

Ibën Kajimi, RahimehUllah, thotë: **“Shpërfillja e Kuranit është shumë llojesh:**

E para: Braktisja e dëgjimit të tij dhe besimit në të.

E dyta: Braktisja e punës me të, edhe nëse e lexon dhe i beson atij.

E treta: Braktisja e gjykimit me të në bazat e fesë dhe në degët e tij.

E katërta: Braktisja e meditimit të tij dhe kuptimit të tij dhe atë që ka dashur Allahu të na e dërgon si mesazh në të.

E pesta: Braktisja e kërkimit të shërimit me të dhe kurimi me të.

Këto të gjitha hyn në ajetin: **“O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si (diçka) të urryer.”** (Furkan 30)

Kurse përcillet në një hadith se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, të ketë thënë: **“Kam frikë se do të vijnë kohëra kur prej Islamit do të mbetet vetëm emri, e prej Kuranit vetëm shkronjat.”**

E domosdoshme është të mësohet Kurani, dhe ai të merret nga mësues të mirë që e njohin leximin e tij. Nuk mjafton të lexohet apo të mësohet vet, po më së miri është të lexohet dhe të nxihet përmendësh duke e përsëritur para tjetrit. Pra patjetër për atë që dëshiron ta mëson Kuranin dhe tua mëson fëmijëve të tij, të zgjedh një lexues të mirë, dhe të mëson tek ai, duke e mësuar leximin dhe rregullat e tij. Përkujdesja për Kuran duhet të jetë prioriteti kryesor i muslimanit.

Kush e mëson Kuranin, le të përkujdeset për të, le ta lexon më tepër dhe le të tenton ta kupton qëllimin e ajeteve, duke qenë i përvuilur dhe me frikë respekt. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kush e lexon një shkronjë nga Libri i Allahut (Kurani), do të ketë shpërblim, e shpërblimi do të dhjetëfishohet. Unë nuk them që ‘Elif Lam Mim’ është një harf – shkronjë, por, ‘Elif’ është harf, ‘Lam’ është harf dhe ‘Mim’ është harf.”**

Ibën Kajimi, RahimehUllah, thotë: **“Meditoje mesazhin e Kuranit dhe do të gjesh se ka Sundues të tij. Sundues ku i tërë sundimi është i Tij, i tërë falënderimi i takon vetëm se Atij, dhe të gjitha çështjet janë në dorën e Tij. Allahu në Kuran i këshillon robërit e Tij dhe i drejton kah ajo që ua jep lumturinë dhe shpëtimin, dhe i nxit në të, dhe i paralajmëron nga ajo që i shkatërron. Ua mëson atyre emrat dhe cilësitë e Tij, dhe ua bën të dashur begatitë e Tij, dhe ua rikujton begatitë e Tij mbi ta, dhe i urdhëron që t’i nënshtrohen urdhrave të Tij, dhe ua rikujton begatitë që i presin nëse i nënshtrohen, dhe ua rikujton dënimin që i pret nëse i bëjnë gjynah dhe nuk i nënshtrohen. I lajmëron për atë se çka vepron me miqtë dhe armiqtë e Tij, se si do të jetë përfundimi i dyja palëve, dhe sjell shembuj, dhe argumentet i sjell të llojllojshme, thërret për në Xhenet, dhe i përmend bukuritë e saj dhe cilësitë e saj. Paralajmëron nga Xhehenemi, dhe ua rikujton dënimin e rreptë dhe dhembjet në të. E përmend nevojën e robërve për Të, dhe se ata nuk mundën pa Allahun, as sa mbyll e hapë sytë. Kurani është libër që ta rikujton Allahun, dhe për këtë arsye muslimani duhet të përkujdeset ta mëson dhe të shpeshton leximin e tij, ngase Kurani është dritë, shërim, mëshirë, shpirt, udhëzim, dallues i të kotës dhe të vërtetës, dhe argument, dhe gjykues.”** (shkurtimisht dhe me kuptim).

Nga muslimani kërkohet ta lexon Kuranin sipas gjendjes së tij, në kufi të mundësive të veta. Nëse din të lexon mirë, kjo është edhe më e mirë dhe më e përsosur. E nëse nuk din mirë të lexon, e lexon sipas mundësive të veta. Ka

ardhur në një hadith: **“Ai që lexon Kuran bukur do të jetë në shoqëri të shkruesve (engjëjve) të ndershëm, ndërsa kush e lexon duke hasur në vështirësi, do të ketë shpërblim të dyfishuar.”**

Për këtë arsye muslimani duhet të bën përpjekje që ta përmison leximin e tij para atij që din më mirë se ai vet të lexon. Nuk duhet ta merr si argument faktin se nuk di të lexon mirë dhe ta braktis leximin, ngase atëherë humb shumë mirësi dhe shpërblime. Le të lexon ashtu si ka mundësi dhe sa ka mundësi të lexon, e nëse e lexon krejt Kuranin, atëherë kjo është më e mira dhe më e dashura.

43 - DISPOZITAT E XHENAZES.

O ju njerëz, frikojuni Allahut dhe rikujtoni vdekjen dhe afrimin e saj, përgatituni për të me vepra të mira dhe pendim nga gjynahet dhe të ligat. Harresa e vdekjes i ngurtëson zemrat dhe nxit pas dynjasë. Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu, përcjell se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Shpeshtoni rikujtimin e shkatërruesit të kënaqësive.”** Dmth. vdekjen.

Abdullah ibën Omeri, Allahu qoftë i kënaqur nga ta, përcjell dhe thotë: Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, më vëndoi dorën mbi supin tim dhe më tha: **“Jeto në këtë botë sikur të jesh i huaj ose si një kalimtarë rruge.”** Ibën Omeri gjithnjë thoshte: kur të ngrysesh mos prit agimin e kur të gdhiesh mos e prit muzgun e mbrëmjes. Merr nga shëndeti yt për sëmundjen tënde dhe nga jeta yte për vdekjen tënde.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Secilit prej jush Xheneti është më i afërt se sa lidhësja (rripi) i nallaneve dhe poashtu Xhehenemi.”**

O ju robërit e Allahut, rikujtimi i vdekjes njeriun e bën asket në dynja, e nxit në vepra të mira dhe në pendim nga gjynahet dhe në braktisjen e padrejtësive dhe dhënien e të drejtave të njerëzve. Pasi që vdekja është fundi i jetës së njeriut në këtë dynja, Allahu i Madhëruar ligjësoi për të vdekurin dispozita ku njeriu detyrohet t'i njeh dhe t'i praktikon te të vdekurit musliman. Këto ligje njihen si dispozita të xhenazes, të cilat është e domosdoshme të njihen.

Imam Ibën Kajimi, RahimehUllah, thotë. **“Udhëzimi i të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ishte udhëzimi më i përsosur, krejtësisht i kundërt me udhëzimet e popujve tjerë. Ky udhëzim përfshin bamirësi për të vdekurin dhe nxit në veprimin asaj që atij i bën dobi në varr dhe në Ditën e Kiametit. Udhëzim i cili nxit në bamirësi ndaj familjes së tij dhe farefisit të tij, i cili nxit në bamirësi ndaj të vdekurit dhe përgatitjes së tij**

për te Zoti i tij, pastaj përcjellja e tij deri në varr dhe pastaj vizita e tij në varreza dhe lutja për të që Allahu ta mëshiron dhe gjynahet t'i fal.”

Nga dispozitat e para është se pëlqehet t'i rikujtohet atij që është në prag të vdekjes dëshmia La ilahe il-lallah duke iu bazuar fjalës së të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“Përkujtonia të vdekurve tuaj (në agoninë e vdekjes) dëshminë La ilahe il-lallah.”** Kjo me qëllim të jetë fjala e fundit e tij më e mirë dhe ajo me të cilën do ta len këtë dynja.

Poashtu përcillet me një hadith se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kush vdes dhe fjala e tij e fundit është La ilahe il-lallah, hyn në Xhenet.”**

Shejtani në prag të vdekjes i afrohet njeriut me qëllim t'ia shkatërron besimin dhe t'i fut vesvese rreth besimit të tij, dhe nëse ia rikujton këtë fjalë madhështore dhe ai e shqipton, shejtanin do ta largon dhe do të vdes me besim të pastër.

Nga dispozitat e xhenazes është përshpejtimi në përgatitjen e të vdekurit, larjen dhe qefinosjen e tij, faljen e xhenazes së tij dhe transportimin e tij deri në varreza, duke u bazuar në fjalët e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, i cili ka thënë: **“Nuk ka hije që kufoma e muslimanit të pengohet nga familjarët e tij.”**

İbën Kajimi, RahimehUllah, thotë: **“Nga udhëzimi i të Dërguarit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ishte përshpejtimi në përgatitjen e të vdekurit duke e larë, pastruar, parfymosur dhe qefinosur. Urdhëronte në larjen e të vdekurit tre apo pesë apo më shumë herë sipas asaj se si e sheh ai që e lan xhenazen dhe urdhëronte të përdoret kafur në larjen e fundit.”**

Burrin detyrohet ta lanë burrë dhe gruan detyrohet ta lanë grua. Lejohet që burri ta lan gruan e tij dhe gruaja ta lan burrin e saj. Mungesa e ujit për ta larë xhenazen apo mos pasja mundësi të lahet xhenazja për shkak se kufoma është e djegur apo e copëtuar dhe nuk mundet ta përballon ujin, e detyron dhënien e tejumumit. Lahet ajo çka ka mundësi të lahet kurse ajo e cila nuk ka mundësi të lahet zëvendësohet me tejumum.

Fëmija i abortuar nëse është katër muajsh, lahet, qefinoset dhe i falet xhenazja dhe emërtohet.

Pasi që i vdekuri lahet dhe qefinoset, i falet xhenazja. Namazi me xhemat pa dyshim se është më i mirë duke u bazuar në veprën e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe në veprën e sahabëve. İbën Kajimi, RahimehUllah, thotë se qëllimi i faljes së namazit të xhenazes është lutja për të vdekurin.

İbën Tejmije, RahimehUllah, rreth komentit të ajetit: **“Askujt prej hipokritëve, kur të vdesin, mos ia fal xhenazen, as mos rri afër varrit të hipokritit”.** (Teube 84), tha: **“Pasi që Allahu ia ndaloi të Dërguarit të Tij t’ia falë hipokritëve namazin, u bë e qartë poashtu, se falja e namazit të besimtarit duhet të kryhet para se të varroset dhe të rrihet afër pasi të varroset. Poashtu ajeti është argument se falja e namazit të vëllaut musliman është një ndër adhurimet më me vlerë dhe më afruese kah Allahu dhe se për kryerjen e tij fitohen shumë shpërblime. Poashtu ajeti është argument se falja e namazit të xhenazes së një muslimani ka qenë tradita e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe se kjo është çështje e vërtetuar tek muslimanët. Sa më shumë që rritet numri i atyre që e falin, aq më mirë është për vëllaun musliman.”** Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Nuk ka ndonjë musliman që vdes e ta falin xhenazen e tij dyzet burra, të cilët nuk i shoqërojnë Allahut asgjë vetëm se Allahu do t’i bëjë ata ndërmjetësues për të.”**

Poashtu i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Nëse ka një të vdekur (musliman) që ia falin namazin e xhenazes një grup muslimanësh që mbërrin të njëqind vetët, ku që të gjithë ndërmjetësojnë për të, atyre do t’u pranohet të ndërmjetësojnë për të.”**

Pasi të falet namazi i xhenazes nxitohet me bartjen e saj për në varreza dhe pëlqehet për atë që ia ka falur vëllaut të tij musliman xhenazen, të prezanton edhe në varrimin e tij. Gjatë rrugës për në varreza ecja duhet të jetë e qetë, të mos ngrihen zërat as me lexim e as me dhikër apo me diçka tjetër. Ebu Hurejra, radijAll-llahu anhu, ka transmetuar se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kush prezanton një xhenaze, derisa ta falë namazin e saj ka shpërblim një kirat, kush prezanton derisa të varroset shpërblehet sa dy kirat.”** Thanë: **“Çfarë janë dy kirate?”** Tha: **“Sa dy male të mëdhenj me shpërblim.”**

Pëlqehet që varri të zgjerohet e të thellohet dhe i vdekuri të vendoset i kthyer kah ana e Kibles në krahun e djathtë të tij. Varri ngrihet nga toka sa një pëllëmbë, me qëllim të dallohet se është varr dhe të mos shkelet apo ulet mbi të askush. Lejohet të vendoset mbi të ndonjë shenjë, si gur apo dërrasë apo diçka tjetër, me qëllim të dallohet varri kur të vizitohet.

Nuk lejohet shkrimi nëpër varre, e as meremetimi dhe ndërtimi mbi to. Transmetohet nga i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në hadithe të vërteta se ai ka ndaluar të suvatohen varret me llaç gëlqereje, të ulet mbi to, të ndërtohet mbi to, apo të shkruhet në to, e gjithë kjo ngase suvatimi i tyre dhe të ndërtuarit mbi to është metodë që shpien në madhërimin e të varrosurve dhe adhurimin e tyre.

Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ceket se i kishte porositur Aliun, radijAll-llahu anhu: **“Të mos lësh statuja pa prishur dhe varr të ngritur pa rrafshuar.”**

Në një transmetim tjetër thuhet: **“As statuja, buste pa i prishur mos lë.”**

Varr i ngritur është ai i cili dallohet prej varreve të tjera. Ai duhet të rrafshohet, të barazohet me të tjerët që të mos mendohet se banori i këtij varri ka ndonjë cilësi të veçantë qoftë kjo pas një farë kohe.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, kur i vizitonte varret e shokëve të tij, i vizitonte për tu lutur për ta he për të bërë istigfar dhe për të kërkuar mëshirë për ta. Kjo është vizita të cilën e pëlqeu për Umetin e tij dhe ua ligjësoi atyre thënien kur të futen në varreza: **“ES-SELAMU ALEJKUM EHLED-DIJARI MINEL-MU’MININE VEL MUSLIMINE VE IN’NA INSHA-ALLAHU BIKUM LAHIKUN. NES’ELU-ILAHE LENA VE LEKUM EL-AFIJE.”**. (Es-selamu alejkum o ju banorë të këtij vendi, besimtarë e muslimanë. Edhe ne inshallah, me urdhrin e Allahut, kur të vijë përcaktimi i Tij, me ju do të radhitemi. Lusim Allahun për ne dhe për ju që të na mëshirojë!).

Nga udhëzimi i tij gjatë vizitës së varrezave ishte ta thotë atë që e thonte dhe e vepronte kur lutej për vëllaun musliman kur ia falte xhenazen: **“O Zot, falja mëkatet dhe mëshiroje, shpëtoje dhe kij ndjesë ndaj tij, bëja vendin e mirë dhe zgjeroja vendin ku do të hyjë, pastroje atë me ujë, borë dhe akull dhe pastroje nga mëkatet, ashtu siç e pastron robën e bardhë nga njollat, zëvendësoja shtëpinë me një shtëpi më të mirë, familjen me një familje më të mirë, bashkëshortin (ten) me një më të mirë, fute në xhenet dhe mbroje prej dënimit të varrit dhe dënimit të zjarrit.”**

O ju musliman, nga gjërat që nuk lejohen është leximi i Kuranit tek kufomat apo te varri me pretekst se kjo i bën dobi të vdekurit, mirëpo kjo është risi në fe dhe kjo nuk ka qenë tradita e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem.

Nga risitë është vendosja apo mbjellja e luleve nëpër varre, veshja e rrobave të zeza, ndërprerja e punës zyrtarisht, qëndrimi disa minuta në heshtje për shpirtin e të vdekurit, e shumë vepra të tjera, të cilat i shëmbëlajnë dhe që janë nga traditat e jobesimtarëve dhe nga koha e injorancës. Muslimanët detyrohen t'i largohen këtyre veprave.

Ajo që duhet të dihet është se ajo që i bën dobi të vdekurit është ajo që e ka cekur Allahu dhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, si përshpejtimi në pagimin apo larjen e borxhit që e ka i vdekuri. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, thotë: **“Shpirti i njeriut është i lidhur për borxhin e tij deri sa t'i paguhet apo lahet.”** Pastaj realizimi i porositve të tij, shkuarja në Haxh për të, lutja për të, etj. Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue

sel-lem, thotë: **“Kur njeriu vdes, atij i ndërpritet puna, përveç tre gjërave: Lëmosha e vazhdueshme, dija nga e cila përfitohet pas tij, apo fëmija i mirë që lutet për të.”**

Poashtu ajo që duhet të dihet është se grave nuk u lejohet ta përcjellin xhenazen për në varreza dhe t'i vizitojnë ato, duke u bazuar në hadithet ku i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, e ndaloi vizitën e varrezave nga ana e grave dhe i mallkoi ato që i vizitojnë.. Gruaja pra, nuk lejohet t'i viziton varrezat dhe as ta viziton varrin e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe kjo është e veçantë për burrat.

Muslimani duhet ta din se Allahu e ka ligjësuar durimin gjatë vështirësive dhe sprovave dhe durimtarëve u ka premtuar shumë shpërblime. E ka ndaluar zemërimin dhe pikëllimin gjatë sprovave dhe është kërcënuar me dënim të rreptë. Allahu i bëri të ndaluara traditat e popujve që nuk besojnë në ringjalljen dhe llogarinë, si rrahja e faqeve, grisja e rrobave, ngritja e zërit dhe të qarit me zë të lart, rroje e kokës etj.

Të qarit pa mos e ngritur zërin dhe pikëllimi i zemrës nuk janë problem. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Syri loton, zemra pikëllohet dhe mos e thoni vetëm se atë që e kënaq Allahun.”**

Pëlqehet ngushëllimi i familjes së të vdekurit dhe nxitja e tyre për në shpërblim dhe durim, dhe fjalët e ngushëllimit janë: **“Allahu ta zmadhoftë shpërblimin dhe ta shtoftë durimin dhe e faltë këtë të vdekur.”** Kjo është sipas Synetit, po lejohen edhe fjalë tjera që nxisin në durim dhe shpërblim.

Ibën Kajimi, RahimehUllah, thotë: **“Nga udhëzimi i të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ishte ngushëllimi i familjes së të vdekurit dhe nuk ishte nga udhëzimi i tij tubimi për ngushëllim, leximi i Kuranit as te varri e as në ndonjë vend tjetër dhe e gjitha kjo është risi e shpikur dhe e fëlliqur. Nga udhëzimi i tij ishte qetësia dhe kënaqësia me caktimin e Allahut, falënderimi i Tij, dhe u distancohte nga ata që i grisin rrobat kur u vinte ndonjë vështirësi apo e ngrinin zërin apo e rruanin kokën.”**

Nga udhëzimi i tij ishte që familja e të vdekurit mos të mundohen të përgatisin ushqim për njerëzit, po urdhëroi që njerëzit tu gatujnë familjes së të vdekurit ushqim dhe kjo padyshim se është nga virtytet e larta të moralit.

Sot plot nga muslimanët i veprojnë këto vepra të ndaluara, si tubimi për ngushëllim, shpallja në gazeta se filani ka vdekur, ka nga atyre që i veçojnë disa vende për tubimin e njerëzve, gatujnë ushqim dhe marin me qira disa lexues të Kuranit me pretekst se këto i bëjnë dobi të vdekurit. Përcjell imam Ahmedi nga Xherir ibën Abdullahu i cili ka thënë: **“E konsideronim të tubuarit në familjen e të vdekurit dhe të gatuarit e ushqimit pas varrosjes së tij nga nijaha (të vajtuarit).”**

Atij që i vdes ndonjë anëtar i familjes apo i afërt duhet të vazhdon ta jeton e tij si më herët duke shkuar në punë dhe duke i kryer detyrimet e tij të përditshme, e jo të ulet në një vend me qëllim ngushëllimi. Lejohet që kush ta takon rrugës ta ngushëllon apo ta ngushëllon edhe në vende të tjera.

Detyra e çdo muslimani është të kapurit për traditën e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, për arsye se udhëzimi i tij është udhëzimi më i mirë, kurse më e keqja është shpikja në të.